Shoqata flladi

Profeti Muhammed (s.a.v.s.) ka thënë:

"Kurrë mos u kërkoni të tjerëve ndihmë për punët tuaja e mos u mbështetni tek të tjerët, qoftë dhe për një copë misuak."

Shehid Murteda Mutahhari

Shoqata Dijetare

Tregime për njerëzit e vërtetë

Ky libër është nderuar me çmimin e letërsisë nga
Komisioni Kombëtar Iranian i UNESCO–s në vitin 1965.

Tiranë, 2007

Titulli i librit: **Tregimet për njerëzit e vërtetë**
Autori: **Shehid Murteda Mutahhari**
E përktheu nga persishtja: **Skerdi Mahmutaj**
Redaktor: **Hajri Shehu**
Korrektura letrare: **Vjollca Feza**
Korrektura teknike: **Vullnet Merja**
Kapaku: **T. Ghorbani**
Përkujdesja grafike: **Sabrie Feza**

E botoi: **Shoqata "FLLADI"**

Copyright: **Shoqata "FLLADI"**

ISBN:

FJALA E BOTUESIT

Gjatë gjithë historisë së njerëzimit janë përdorur metoda të ndryshme për përhapjen e parimeve e të çështjeve që kanë lidhje me jetën e njeriut. Një ndër këto metoda është edhe paraqitja e atyre parimeve në formë tregimi. Këtë metodë e gjejmë edhe në Kur'anin Famëlartë, ku, pothuajse në çdo sure përmendet një tregim i një të dërguari a populli.

Është më se e vërtetë se tregimi ndikon shumë në shpirtin, në zemrën dhe në ndërgjegjen e njerëzve. Ka raste që një njeri lexon një libër voluminoz, i cili përmban edhe tregime të ndryshme. Me kalimin e kohës, njeriu mund ta harrojë pjesën më të madhe që ka lexuar, por tregimet që përmbante ai libër nuk i harron, sidomos kur ato tregime janë të vërteta.

Në disa tregime, autorët e tyre nuk e shfaqin konkluzionin dhe këtë ia lënë në dorë lexuesit që kur ta mbarojë së lexuari, të dalë vetë në konkluzionin e duhur dhe ta mësojë urtësinë e tregimit.

Në vazhdën e veprimtarive të saj, shoqata "Flladi" sjell këtë herë në duart e lexuesve të saj një buqetë tregimesh të vyera dhe plot mësime, të shkruara nga eruditi dhe mendimtari islam, Shehid Murteda Mutahhari, i cili ia përkushtoi jetën studimit dhe përhapjes së fesë së All-llahut (që qoftë i Madhëruar!). Shpresojmë që thelbin e këtyre

tregimeve ta kuptojë vetë lexuesi dhe të marrë mësime prej tyre.

Së fundi Shoqata "Flladi", falënderon të gjithë ata që kontribuan për përgatitjen e këtij libri dhe u uron atyre mbarësi në këtë jetë dhe All-llahu i bashkoftë me të vërtetët në Ditën e Gjykimit!

Shoqata "Flladi"
Gusht, 2007

REFERENCA PËR JETËN DHE VEPRIMTARINË E SHEHID MURTEDA MUTAHHARIUT

Profesori i martirizuar, Shehid Murteda Mutahhari u lind më 1920 në Feriman, qytet në krahinën veri-lindore të Horasanit, Iran. Babai i tij, i ndjeri Shejh Muhammed Husejn Mutahhari, ka qenë njeri i lartë dhe besimtar i përkushtuar, e për këtë arsye nderohej nga të gjitha shtresat shoqërore të Horasanit, si edhe të viseve të tjera të vendit. Murtedai i filloi mësimet e para në Mekteb Hane (shkollë tradicionale fillore) në qytetin Feriman. Që në fëmijërinë e hershme, ai tregoi një talent mahnitës dhe një dashuri të thellë për dijen. Tregoi një zgjuarsi dhe entuziazëm të jashtëzakonshëm për ta kuptuar sa më thellë teologjinë islame. Në vitin 1932, kur ishte dymbëdhjetë vjeç, u shpërngul në qytetin e shenjtë të Meshhedit, ku filloi studimin e shkencave fillestare islame. Në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare udhëtoi për në Kum, ku me dashurinë e zjarrtë në shpirt për studimet islame, përfitoi shumë prej dijetarëve të shquar, si Sejjid Muhammed Muhakkik, Sejjid Muhammed Huxhxhet dhe Ajetull-llah Sadr (All-llahu qoftë i kënaqur me ta!). Më 1940 filloi studime shumë të përparuara. Shehid Mutahhariu gjeti, gjithashtu, lumturi në shoqërinë me Ajetull-llah Buruxherdin, dishepull i të cilit qe që nga viti 1944 e deri pothuajse më 1952. Më

1950, ai nisi punën për njohjen e filozofisë së ibn Sinasë (Avicenës), duke marrë pjesë në mësimet që jepte Sejjid Muhammed Husejn Tabatabaji, dijetari më i dëgjuar i filozofisë në Kum. Më vonë, Mutahhariu shkroi një koment të rëndësishëm për veprën pesëvëllimëshe "Parimet e filozofisë" (Usûlul-felsefeti). Më 1952, Mutahhariu e ndërroi vendbanimin e tij dhe shkoi në Teheran. Që nga kjo kohë e më pas, ai punoi shumë si në dhënien e leksioneve për publikun dhe për qendrat intelektuale, ashtu edhe në shkrimin e një numri shumë të madh librash dhe pamfletesh. Në të dyja këto fusha, ai u përpoq të ndriçonte këndet e panjohura të mendimit islam dhe të ngrinte lart flamurin e gjykimit të pastër islam, kundër kërcënimit të pikëpamjeve materialiste që përhapeshin ndër të rinjtë e Iranit. Ai sakrifikoi shumë, nganjëherë si profesor i jashtëm në Shkollën e Teologjisë së Universitetit të Teheranit, nganjëherë si lektor publik në xhamitë dhe *husejnijjet* (qendra fetare), deri në kulmin e Revolucionit Islamik. Pas fitores së Revolucionit, më 11 shkurt 1979, e, madje edhe më parë, ai ishte anëtar i Këshillit të Revolucionit Islam. Martirizimi i tij nga një grup pseudoislamik ndodhi më 15 maj 1979, kur ai po dilte natën nga një sesion i Këshillit të Revolucionit.

BIBLIOGRAFI E PËRZGJEDHUR E BOTIMEVE TË PROF. MUTAHHARIUT:

1. Liria Shpirtërore
2. Njohje me shkencat islame (1,2,3)
3. Njohje me Kur'anin (1,2,3,4,5,6,7,8...)
4. Islami dhe kërkesat e kohës (1,2)
5. Bazat e filozofisë dhe metoda e realizmit (1,2,3,4,5)
6. Imamati dhe udhëheqja
7. Ndihmat e fshehta në jetën e njeriut
8. Njeriu i përsosur
9. Njeriu dhe përcaktimi (kaderi)
10. Njëzet fjalime
11. Përgjigjet e mësuesit
12. Profeti i pashkolluar
13. Aspiratat e Revolucionit Islamik
14. Aspiratat e Republikës Islamike
15. Mësimi dhe edukimi në Islam
16. Përsosja e shoqërisë njerëzore
17. Teuhidi
18. Mirësitë dhe atraksionet e imam Aliut (a.s.)
19. Xhihadi
20. Beteja e së Vërtetës me të shtrëmbrën (në kuadër të "Ringjalljes së mendimit islam"
21. Urtësitë dhe këshillat
22. Epika Hyseniane (1 e 2)
23. Fundi
24. Fundi i Profetizmës
25. Shërbimi i ndërsjelltë i Islamit me Iranin

26. Tregimet e të drejtëve (1 e 2)
27. Dhjetë fjalë
28. Lundrim nëpër dimensionin e imamëve të lartë(a.s.)
29. Lundrim nëpër dimensionin profetik
30. Lundrim nëpër Nehxhul Belaga
31. Sherh Mendhume (Sqarimi i përgjërimit)
32. Drejtësia e Allahut
33. Mistika e Hafizit
34. Shkaqet e animit kah materializmi
35. Karakteri
36. Filozofia e moralit
37. Filozofia e historisë (1,2,3...)
38. Kryengritja dhe revolucioni
39. Çështja e hixhabit (mbulimit)
40. Çështja e ribbasë (kamatës)
41. Çështja e njohjes
42. Premtimi
43. Artikuj filozofikë
44. Parathënie mbi botëkuptimin islam;
    Njeriu dhe besimi
    Botëkuptimi i Teuhidit (njësimi)
    Zbulesa dhe profetizma
    Njeriu në Kur'an
    Shoqëria dhe historia
    Jeta e përjetshme ose jeta e pafund
45. Profetizma
46. Sistemi i së drejtës së gruas në Islam
47. Vështrim mbi sistemin ekonomik të Islamit
48. Kritikë mbi marksizmin
49. Lëvizja islamike gjatë njëqind vjetëve të fundit

Shpata Flladi

50. Pushteti dhe pushtetarët fetarë
51. Shënimet e Shehid Mutahhariut (1,2,3)

LIBRA TË PROF. MUTAHHARIUT PËR BOTIM:

1. Njohje me Kur'anin (9)
2. Filozofia e Historisë (4)
3. Shënimet e profesor Mutahhariut (4)

LIBRA PËR MUTAHHARIUN

52. Liria sipas pikëpamjes së Shehid Ajetullah Mutahhariut
53. Pasqyra e kupës (Divani i Hafizit, i shoqëruar me shënimet e Shehid Mutahhariut)
54. Profesor Mutahhariu dhe intelektualët
55. Kujtimet e mia me profesor Mutahhariun
56. Në shoqërinë e mësuesit (përmbledhje poetike)
57. Vështrim mbi jetën e profesor Mutahhariut
58. Imazhi i mësuesit në pasqyrën e vështrimit të shokëve
59. Shejhu Shehid
60. Çështja e zgjimit (1-2)

Këtë vepër modeste ia kushtoj babait tim
të nderuar, Haxhi Shejh Muhamed Husejn
Mutahhariut, i cili ishte i pari që më njohu
me besimin dhe me veprimin në rrugën
e drejtë.

PARATHËNIE E AUTORIT

Kur po merresha me tubimin, shkrimin a botimin e këtyre tregimeve, çdo shok, të cilin më binte rasti ta takoja e t'i tregoja që kisha në dorë një libër me tregime të vërteta dhe të marra nga hadithe, libra historikë dhe burime të tjera, me një gjuhë të thjeshtë për t'u kuptuar nga njerezit, më përgëzonin ngaqë e dinin se ishte një punë shumë e dobishme për të rinjtë dhe për të rejat. Disa të tjerë që e dinin se një punë e tillë për tregimet e ngjarjet e vërteta nuk ishte bërë deri tani, e shikonin këtë si një lloj "nisme" dhe thoshin që "vendi i këtij libri deri më tani ka qënë bosh."

Sigurisht, janë shkruar libra të dobishëm për ngjarje të vërteta morale dhe shoqërore, por janë veshur me pektun e "fjalës". Janë shkruar libra nën pektun e "tregimeve", të cilët tregojnë të vërteta për jetën, por shkrimtari i ka sjellë ngjarjet sipas mendjes dhe penës së tij dhe nuk kanë të bëjnë me realitetin. Kanë shkruar libra të cilët janë kryekëput për jetën e njërit a të disa prej personaliteteve të mëdha të historisë. Por deri tani nuk është hasur një libër, ku autori, me qëllim që të drejtojë dhe të ngrejë lart moralin e njerëzve, të ketë nxjerrë tregime shumë të vyera nga librat e historisë dhe hadithet dhe t'i vërë ato në duart e publikut. Edhe në qoftë se kjo punë është bërë, ajo nuk ka të bëjë me tregimet e gjetura në hadithe dhe kronika.

Kjo punë nuk është nisma ime. Një një nga mbledhjet e "Lidhjes së shkrimtarëve dhe të botuesve" e cila ka në gjirin e saj një numër prefesorësh dhe intelektualësh, e ku

edhe une kam kënaqësinë të jem anëtar, njëri prej anëtarëve të saj të nderuar bëri një propozim: është shumë mirë – tha ai- që të shkruhet një libër edukues-mësimor por jo në formën e "fjalës", por ne formën e "tregimeve". Dhe tregimet të mos jenë imagjinare dhe të fantazuara, por t'i përshkruajnë ngjarjet të cilat gjenden në librat historikë, hadithe a libra të tjerë të përkthyer ashtu siç kanë ndodhur me të vërtetë. Ky propozim u pranua nga ana e anëtarëve të lidhjes.

Roli im në këtë punë qëndron këtu; mua më tërhoqi ky propozim më shumë se anëtaret e tjerë e më bëri të mendoj më shumë për të dhe, kështu vendosa që këtë punë ta merrja përsipër.

Vepra që ju tani e keni në duar është fryti i atij propozimi dhe i atij vendimi.

Në shkrimin e tregimeve nuk është bërë asnjë lloj ndërhyrjeje në origjinalin e tyre, i cili gjendet nëpër librat e tjerë historikë e në hadithe; shkrimtari nuk ka shtuar asnjë copëz nga fantazia e tij e nuk ka heq asgjë prej tyre. Këtu është përpjekur vetëm që të sillen ato tregime, të cilat janë brenda normave të natyrës dhe të moralit të njeriut, me qëllim që çdo tregim të japë një vlerë edukative.

Tregimet e ardhura në këtë libër ndryshojnë vetëm nga forma dhe nga gjuha. Ata janë përshtatur në gjuhën e sotme, me qëllim që të jenë më të lehta dhe më të kuptueshme për lexuesin. Nëse lexuesi do të merrte shkrimet origjinale ku gjenden këto tregime dhe t'i krahasonte me tregimet e librit, do të vinte re se tregimi nuk ka asnjë ndryshim a shformim,

por vetem se ngjarja është bërë me e kënshsme dhe më e thjeshtë për ta kuptuar.

Në libër nuk jepet asnjë lloj shpjegimi se cili është morali i tregimit, përveç ndonje fjalie, e cila e jep vetë në tekst përfundimin a rezultatin e tregimit, madje, edhe titulli i çdo tregimi , deri aty ku ka qenë e mundur, është dhënë në atë mënyrë që të mos jepet rezultati i tregimit. Kjo është bërë me qëllim që lexuesi ta nxjerrë vetë përfunimin a moralin e tregimit.

Libri dhe sigurisht çdo shkrim nuk duhet ta mundojë lexuesin, për ta mekur mendimin por njëkohësisht edhe ta fus atë drejt të menduarit dhe t'i forcoj atij mendjen. Ai mundim që duhet të shkarkohet nga shpatullat e lexuesit është gjetja e kuptimit të shprehjeve, e të fjalive. Nga kjo anë, aq sa na ka lejuar koha dhe mundësia, janë bërë përpjekje që shprehjet e fjalitë të jenë të thjeshta dhe të kuptueshme. Por, siç u tha, ai mendim i cili duhet të lihet në përgjegjesinë e lexuesit është mësimi që sjell tregimi. Çdo gjë e cila nuk do të mendohet nga vetë lexuesi dhe nga mendimi i vet ai të mos shtojë gjë, ky përfundim apo mësim i cili nxirret nga vepra nuk do të bëhet pjesë e sjelljes së tij dhe as nuk do të ndikojë në shpirtin e tij. Në fakt, ai mendim të cilin lexuesi do ta shtojë mbi subjektin, është po ai përfundimi i cili natyrshëm mund të kuptohet që nga parathëniet.

Ashtu siç ishte menduar qysh në fillim, shumica e tregimeve janë marrë nga librat e haditheve dhe heroi i tregimit është njëri prej prijësve të mëdhenj të fesë. Por, në libër janë sjellë edhe tregime të tjera të marra nga libra të ndryshëm të historisë a nga libra të tjerë, të përkthyer nga gjuhë të ndryshme, ku

flitet për personalitete të tjera të mëdha të historisë, të cilët janë shumë të dobishëm dhe të vyer për njerëzimin. Në këtë libër nuk flitet vetem për personalitetet e mëdha shiite, por edhe për personalitete të tjera të mëdha të Islamit. Ka tregime edhe për personaliete të larta të dalluara, të cilët nuk janë myslimanë, ashtu siç do ta vini re dhe vetë.

Duke pasur parasysh që pjesa më e madhe e heronjve të këtyre tregimeve janë persona të pastër, të sinqertë dhe ecin pa frikë drejt rrugës së drejtë, të cilët në gjuhën e Kur'anit Fisnik quhen " të Drejtët" ne e titulluam libri "Tregimet e të Drejtëve". Sigurisht, nga ana tjetër, zakonisht adhuruesit dhe lexuesit e këtyre tregimeve janë njerëz që duan t'i hedhin hapat e jetës në rrugën e drejtë. Prandaj, ky libër është për ata dhe për hatrin e tyre, dhe këto tregime i quajmë në të gjitha kuptimet "Tregimet e të Drejtëve".

Duke pasur parasysh se këto tregime nuk janë aspak të fantazuara a të shpikura, por janë ngjarje të natyrshme që kanë ndodhur në botën reale dhe janë shkruajtur në libra ashtu siç kanë rrjedhur ngjarjet në të vërtetë, pra, duke ditur që këto janë tregime të vërteta, edhe nga kjo anë ishte e përshtatshme që mbiemrin " e drejtë" ta vendosnim si pjesë të titullit të këtij libri.

Duke qenë një udhëzues për moralin dhe shoqërinë, tregimet paraqitin shpirtin e mësimeve islame dhe duke kaluar nëpër këtë shteg, lexuesi njihet me të vërtetën dhe me shpirtin e mësimeve të Islamit. Atij i jepet mundesia që të shikojë veten, shoqërinë, mjedisin ku jeton, se ku qëndrojnë në krahasim me realitetin e tregimeve, të shikojë të gjitha shtresat të cilat e quajnë veten myslimanë, të shikojë disa prej këtyre shtresave që hedhin

gurë hapur mbi gjoksin e Islamit e të kuptojë deri në ç'masë shtrihet kuptimi i Islamit dhe e vërteta e Islamit.

Këto tregime janë edhe për "elitën" por edhe për shtresat e "thjeshta", por kjo mënyrë të shkruari është bërë vetëm për "të thjeshtët" sepse janë këto shtresa ato të cilët e kërkojnë drejtësinë, sinqeritetin e barazinë përballë Hak-ut dhe janë të gatshme që sa ta dëgjojnë fjalën e vërtetë, të bashkojnë veten e tyre me të.

Pastrimi dhe degradimi i shtresave shoqërore ndikojnë ndërsjellas tek njëri-tjetri. Nuk është e mundur që në mes të një shtrese të ndërtohet një mur degradim a lartësimi shoqëror e të mos preket shtresa tjetër. Por, zakonisht degradimi vjen nga shtresat "e larta" dhe pastaj kalon tek ato "thjeshtat"; ndërsa reformimi a pastrimi ndodh nga ana e kundërt, me zgjimin e shtresës"të thjeshtë" popullore e pastaj duke kaluar në klasat e "larta". Pra, zakonisht, degradimi fillon nga lartë poshtë kurse ngritja fillon nga poshtë lart.

Nisur nga kjo rregull, vëmë re që edhe Emirul-Mumenin Ali (a.s) në mësimet e tij madhështore, pasi i ndan njerëzit në dy klasa "të thjeshta" dhe "të larta" , pastrimin apo ardhjen në rrugën e drejtë të klasave të larta e shikon me mosbesim dhe pesimizëm, ndërsa klasave të thjeshta u kushton shumë vëmendje.

Më duhet të përmend dhe një pikë tjetër, të cilën nuk mund ta anashkaloj. Gjatë kohës që isha i zënë më mbledhjen, shkrimin dhe botimin e librit, disa prej shokëve të mi të cilët nga njëra anë më përgëzonin për nismën që kisha ndërrmarrë dhe për dobitë që sillte libri, e nga ana tjetër, shprehnin keqardhjen e tyre që unë kisha ndërprerë përkohësisht disa punë të tjera,

të cilat, sipas mendimit të tyre, ishin më të rëndësishme dhe më të nevojshme pra thoshin: përse i kisha lënë mënjanë shkrime të rëndësishmë shkencore dhe po merresha me diçka kaq të thjeshtë. Madje, disa prej tyre propozonin që, meqë e kisha marrë mundimin e kësaj pune, të paktën, të mos e botoja nën emrin tim. Unë i pyesja: Përse? Ç'të keqe ka? Ata thoshin që vepra, e cila botohej me emrin tënd, të paktën duhe të ishte brenda rrethit të filozofisë, ndërsa kjo punë ishte shumë e vogël. I pyeta se cili ishte dallimi mes së voglës dhe së madhes? Atëherë, u bë e qartë që sipas mëndjes së këtyre zotërinjve, dallimi ishte te thjeshtësia dhe vështirësia e punës: çdo punë që është e vështirë, është punë e madhe; çdo punë që është e thjeshtë është punë e vogël.

Nëse kjo logjikë do t'i përkistë një njeriu a disave, unë nuk do ta kisha përmendur. Mirëpo, fatkeqësisht, "kjo mendësi që në fakt, nuk është gjë tjetër vetëm se një sëmundje shoqërore dhe një shmangie e madhe nga mësimet e prijësve të Islamit, është shumë e përhapur në shoqërinë tonë.

Për këtë arsye ne jemi shume të varfër sot për nga ana e librave të dobishëm, të vyer, sidomos për ata fetarë. Shumëkush është i gatshëm të harxhojë dhjetë vjet, mos më shumë, duke qepur gjëra pa lidhje me njëra-tjetrën e duke i botuar si një vepër shkencore, duke e shkruar emrin e vet me tërë mburrje mbi atë libër i cili nuk është i vlefshëm as edhe pak për shoqërinë. Përfundimi është ky: ajo që është e nevojshme dhe e duhur, nuk shkruhet, ndërsa gjëra të cilat nuk hyjnë në punë, që s'kanë kurrfarë përdorimi, shkruhen e botohen njëra pas tjetrës.

Pastaj mendova edhe këtë: ashtu siç ka njerëz të cilët shkruajnë dhe botojnë libra të thjeshtë por të dobishëm, ashtu do të ketë dhe njërëz të cilët do të dinë të përfitojnë nga udhëzimet dhe urtësitë që rrokin nga librat e thjeshtë.

Në libër kemi përdorur dhe tregimet që janë dhënë në Kur'anin e Shenjtë, por duke mos shtuar asgjë tjetër përveçse siç janë shpallur në Kur'an sepse i pari libër i cili i ka thënë " Tregimet e të Drejtëve", që të udhëzojë të drejtojë edukimin e shoqërisë njerëzore, si pjesë e mësimeve të larta të tij, është Kur'ani i Madhërishëm.

Vëllimi përmbledh 75 tregime. Unë kisha pregatitur 100 tregime për një vëllim dhe kisha dëshirë që çdo vëlllim i këtij libri të përmbante nga 100 tregime. Mirëpo pashë që mendimi i miqve e sidomos, i anëtarëve të Lidhjes ishte që 100 tregime e rrisnin shumë vëllimin e librit, dhe nga ana tjetër lloji i letrës në të cilin do të botohej libri ishte me pakicë, u dhashë të drejtë shokëve, duke lënë 75.

Më duhet të them që përfundimi i shumicës së këtyre tregimeve është pozitiv, përveç dy a tre tregimeve të cilat nuk kanë ndonjë fund shumë të gëzueshëm, siç janë ato me titull "Një mallkim", "Shpata e gjuhës", "Miqësia që u pre". Por duke treguar një pikë të dobët në moral, këto tre tregime të bëjnë të nxjerrësh mësim prej tyre.

Teheran
Korrik 1950.

PROFETI I NDERUAR DHE DY GRUPET E NJERËZVE

Profeti i nderuar (paqja dhe bekimet e All-llahut qofshin mbi të!) hyri në xhaminë e Medines* dhe sytë i zunë dy grupe të ndryshme njerëzish të mbledhur në formë rrethi, ku secili po kryente nga një punë. Njëri grup po falej dhe lutej; grupi tjetër po debatonte çështje të ndryshme, lexonte dhe mësonte. Profeti i pa me vëmendje te dyja grupet dhe u kënaq prej tyre. U kthye nga njerëzit të cilët e shoqëronin dhe u tha: "Të dyja këto grupe po bëjnë punë të mirë dhe të pëlqyeshme dhe janë të lumturuar". Pastaj shtoi: "Por edhe unë jam dërguar për të mësuar dhe udhëzuar". Dhe, kështu ai shkoi drejt atij grupi i cili po merrej me mësime dhe diskutime dhe u ul në mesin e tyre.[2]

**) Në fillimet e Islamit Xhamia e Medines nuk ishte njëvend i cili shërbente vetëm për lutjet dhe namazin; ajo ishte dhe qendra e diskutimeve dhe e veprimtarive të tjera fetare e shoqërore të myslimanëve. Sa herë që dilte e nevojshme që të bëhej një kuvend, njerëzit mblidheshin në këtë Xhami. Atje mësonin çdo lajm të rëndësishëm dhe çfarëdo vendimi i ri qëmerrej u shpallej njerëzve po në atë vend. Gjatë që ndrimit të tyre nëMekë, myslimanët kishin shumë liri të kufizuara; ata nuk mund ti kryenin detyrimet e tyre fetare të lirshëm dhe as nuk mund mësonin lirshëm fenë e tyre. Kjo gjendje vazhdoi deri kur Islami hyri në një pikë tjetër të rëndësishme të Arabisë, që quhej "Jethrib" dhe pastaj mori emrin "Medinetu'n Nebij"që do të thotë Qyteti i Profetit. Sipas propozimit të banorëve të këtij qyteti dhe në bazë të besës që ata i kishin dhënë Hazretit Muhammed dhe Profeti i nderuar u shpërngul për në këtë qytet. Ca nga ca, filluan të shpërnguleshin dhe myslimanët e tjerë në këtë qytet. Liria e aktiviteteve të myslimanëve fillon që nga ajo kohë. Puna e parë që Profeti bëri sapo erdhi në këtë qytet, caktoi nje copë tokë dhe me ndihmën e shokëve e tëtjerë ve, ndërtoi aty këtë Xhami.*

1) Munijetul Murijd; f. 10

BURRI QË KËRKOI NDIHMË

Ai po mendontë për të kaluarën e tij plot vështirësi. I kujtoheshin ato ditët e hidhura që kishte kaluar, ditët gjatë të cilave ai nuk mund të siguronte as bukën e gruas dhe të fëmijëve të tij të pafajshëm. Po mendonte me vete sesi ishte e mundur që një fjali, vetëm një fjali e vetme, e cila u tha tri herë në veshin e tij, i dha fuqi shpirtit të tij duke i ndryshuar rrjedhën e jetës, duke e shpëtuar atë dhe familjen e tij nga varfëria dhe mjërimi ku kishin rënë.

Ai ishte njëri prej shokëvë të Profetit. Skamja dhe mjerimi e kishin zaptuar atë. Një ditë, kur ai e ndjeu se i kishte mbërritur thika deri në palcë, duke u këshilluar me të shoqen dhe me propozimin e saj, vendosi që t'ia tregonte gjendjen e tij Profetit dhe t'i kërkonte ndihmë financiare.

U nis drejt tij me këtë qëllim, por përpara se t'ia thoshte atij hallin që kishte, nga goja e Profetit dëgjoi këtë fjali: "Ne do ti japim ndihmë kujtdo që kërkon ndihmë prej nesh, por nëse dikush nuk ka nevojë për diçka dhe nuk ia shtrin dorën një krijese tjetër, Zoti e bën atë që të mos ketë nevojë për gjë." Atë ditë ai nuk tha gjë dhe u kthye në shtëpi. Sërish u përball me përbindëshin e varfërisë që kishtë lëshuar hije në shtëpinë e tij. I pashpresë, edhe ditën e dytë u nis me po atë qëllim drejt Profetit, por edhe atë ditë ai dëgjoi të njëjtën fjali. "Ne do ti japim ndihmë kujtdo që kërkon ndihmë prej nesh, por nëse dikush nuk ka nevojë për diçka dhe nuk ia shtrin dorën një krijese tjetër, Zoti e bën atë që të mos ketë nevojë për gjë."

Edhe kësaj radhe, pa e shprehur hallin që kishte u kthye sërish në shtëpinë e tij. Por duke e parë veten të zënë ngushtë në kthetrat e varfërisë, skamjes dhe mjerimit, u nis për herë të tretë drejt Profetit. Përsëri buzët e Profetit me atë melodi, e cila i fal zemrës fuqi dhe shpirtit besim përsëritën të njëjtën fjali.

Kësaj radhe burri, ndjeu besim më të madh në zemrën e vet. Ndjeu se çelësi i zgjidhjes së hallit të vet gjendej në këtë fjali. Kur doli jashtë, i hodhi hapat me më siguri. Tanimë mendonte me vete se kurrë nuk do të shkonte t'u kërkontë ndihmë njërëzve të tjerë; Mbështetem te Zoti mendoi ai, - dhe do të shfrytëzoj të gjitha fuqitë dhe aftësitë që janë të fshehura brenda meje dhe i kërkoj Zotit që të më mbështesë në punën që dua tëkryej e të më bëjë që të mos kem nevojë për asgjë.

Mendonte më vete se ç'punë mund të bënte? Shumë shpejt i erdhi në mendje se ai mund të shkontë në shkretëtirë dhe të mblidhte shkurre e të vinte t'i shiste. Shkoi, mori një trastë dhe u nis drejt e në shkretëtirë, mblodhi shkurret, erdhi dhe i shiti. Këtu ai ndjeu dhe lehtësimin e tij. Të nesërmen ai bëri të njëjtën gjë, e kështu e vazhdoi dhe ditëve të tjera këtë punë, ca nga ca filloi të blinte gjëra të reja, kafshë, e shumë sende të tjera të nevojshme. E vazhdoi sërish punën e tij derisa fitoi pasuri të madhe e mori shërbëtorë.

Një ditë, i afrohet Profeti dhe i thotë ëmbëlsisht: "A nuk të thashë që: Ne do ti japim ndihmë kujtdo që kërkon ndihmë prej nesh, por nëse dikush nuk ka nevojë për diçka dhe nuk ia shtrin dorën një krijese tjetër, Zoti e bën atë që të mos ketë nevojë për gjë?"[1]

1) Usulul Kafij; vëll.2, f.139 – kreu i bindjes- dhe Sefinetul Bihar; kreu, "kane'a"

KËRKIM LUTJEJE

Dikush, shumë i shqetësuar dhe i stresuar, erdhi pranë imam Sadikut (a.s) dhe i tha:

Aman, të lutem, bëj një duà për mua te Zoti që të më japë pasuri, sepse jam shumë i varfër e i mjerë.

- Kurrë nuk e bëj këtë lutje.

- Përse nuk e bëni?

- Sepse Zoti për këtë punë e ka caktuar një rrugë. Zoti ka urdhëruar që ta kërkoni dhe të punoni për ditën tuaj, kurse ti do që të rrish në shtëpinë tënde dhe duke u lutur të nxjerrësh ditën e punës.[1]

1) El Uesail; vëll. 2 f. 529, botoi Emirbehader.

LIDHJA E GJUNJËVE TË DEVESË

Vargani kishte disa orë që po ecte. Lodhja dukej qartë si te kafshët ashtu edhe te njerëzit. Sapo mbërriti në një banesë ku kishte ujë, vargani ndaloi. Profeti i nderuar, i cili ishte pjesë e këtij vargani, e uli devenë e tij dhe zbriti prej saj. Përpara çdo gjëje tjetër, të gjithë po shkonin drejt ujit për t'u përgatitur për faljen.

Pasi zbriti nga deveja, Profeti i nderuar u nis drejt ujit, por pasi eci disa hapa, pa i thënë asnjë fjalë askujt, u kthye drejt vendit të tij. Shokët e tij e panë njëri-tjetrin me habi dhe thanë që ai nuk e parapëlqeu këtë vend për të qëndruar dhe do të japë urdhër për të lëvizur. Të gjithë sytë dhe veshët u mprehën për të dëgjuar urdhrin. Shoqëruesit u habitën më shumë kur panë që Profeti, pasi mbërriti tek deveja e tij, hoqi fashon nga gjunjët e tij dhe lidhi gjunjët e devesë e u nis sërish drejt ujit.

U dëgjuan zëra që thoshin: "O i Dërguari i Zotit, përse nuk na dhe urdhër që ta bënim ne këtë punë, por u ktheve dhe e mundove veten? Ne do ta bënim me shumë krenari këtë punë për Ju."

Profeti iu përgjigj: "Kurrë mos u kërkoni të tjerëve ndihmë për punët tuaja e mos u mbështetni tek të tjerët, qoftë dhe për një copë mis'uak."[1]

---

1) Kehlul Basar, f. 49, i muhadith Kummij.

BASHKËUDHËTARI I HAXHIT

Një burrë ishte kthyer nga haxhi dhe po i tregonte imam Sadikut si e kishte kaluar udhëtimin dhe për bashkëudhëtarët. Ai lavdëronte shumë njërin prej tyre.Të gjithë ishin të kënaqur që po shoqëroheshin më një burrë të nderuar si ai. Ai gjatë tërë kohës falej dhe lutej. Sapo mbërrinim në ndonjë shtëpi, ai shkonte në një cep, shtronte sixhaden e tij dhe fillonte të falej. Imami e pyeti: "Po, kush i bënte atëherë punët e tij? Kush përkujdesej për kafshën e tij?"

Burri iu përgjigj: "Sigurisht, nderi i këtyre punëve na takonte neve, ai ishte i zënë vetëm me punët e tij të shenjta." "Atëherë, të gjithë ju qëndroni me lart se ai", - u përgjigj imami.

6

USHQIMI I PËRBASHKËT

Sapo Profeti dhe shokët e tij ndalën kafshët e varganit të tyre, zbritën prej tyre dhe shkarkuan ngarkesën, vendosën që të therrnin një dele për të ngrënë. Njëri prej shokëve tha: "Delen e ther unë." "Lëkurën ja heq unë" - tha tjetri. "Unë do ta pjek, - ia priti një tjetër. E kështu me radhë, secili mori përsipër diçka.

Kurse Profeti tha: "Unë do të mbedh krënde nëpër shkretëtirë. Ndërkohë, shokët iu kthyen e i thanë: "O i Dërguari i Zotit, ju nuk duhet të mundoheni, i bëjme ne këto punë me gjithe qejf."

"E di që ju i kryeni këto punë", - tha Profeti - por Zoti nuk e pëlqen që robi i Tij të rrijë duarkryq mes shokëve të tij duke i dhënë privilegje vetes së tij. Pastaj shkoi drejt shkretëtirës, mblodhi shkurre e shkarpa e u kthye.[1]

1) Kehlul Basar, f. 48, i muhadith Kummij

VARGANI QË PO SHKONTE NË HAXH

Një vargan myslimanësh kishte marrë udhën drejt Mekës. Kur mbërriti në Medine, pushoi aty disa ditë dhe pastaj u nis sërish drejt Mekës.

Në rrugën mes Medines dhe Mekës, ata ndaluan te një han. Drejtuesit e varganit njiheshin me të zotin e hanit. I zoti i hanit, kur po fliste me miqtë e tij vuri re mes tyre një njeri të cilit i shkëlqente fytyra gjithë rrezatim, dhe i qeshur e me gëzim ai po merrej me punët e varganit. E njohu atë menjëherë dhe plot habi i pyeti drejtuesit e varganit: "A e njihni atë njeriun i cili po merret me punët e varganit?"

"Jo, nuk e njohim, - iu përgjigjën ata. Ai iu bashkua varganit kur ne ishim në Medine. Është njeri i pastër dhe i drejtë. Ne nuk i thamë që t'i bënte këto punë, por pati dëshirë vetë që t'i ndihmojë të tjerët."

"Është e qartë që nuk e njihni, sepse po ta njihnit, nuk do ta linit atë as edhe për një çast që t'ju shërbente si një shërbëtor," - u tha i zoti i hanit.

"Përse, kush është ai njeri?", - pyetën ata.

-"Ai është, Ali ibn Husejn, Zejnul Abidini," - u përgjigj i zoti i hanit.

Atëherë, ata të gjithë të shtangur, lëvizën nga vendi dhe shkuan drejt imamit, për t'i kërkuar ndjesë e për t'i rënë nën këmbë. U afruan dhe i thanë: "Ç'është kjo punë që ju po bëni për ne?! Shyqyr Zotit, nuk të thamë ndonjë fjalë se atëherë do të ishim futur në gjynah të madh."

Imami iu përgjigj: "Unë prandaj ju zgjodha ju si bashkudhëtarë të mi, sepse nuk më njihnit. Sa herë që udhëtoj me njerëz më njohin, sillen shumë mirë me mua për hir të Profetit të Zotit, nuk më lënë që të bëj punë. Kështu që parapëlqej të udhëtoj me njerëz që nuk më njohin, dhe nuk e paraqit veten time, në mënyrë që të kem kënaqësinë që t'u shërbej shokëve të mi."[1]

1) Biharul Anuar; vëll. 11, f. 21. botuar nga "kompanij".

MYSLIMANI DHE ITHTARI I LIBRIT

Në atë kohë, qyteti i Kufes ishte qendra e pushtetit islamik. Në të gjithë hapësirën e gjërë të shtetit islamik, e veçanërisht në pjesën e Shamit (Sirisë), ato ditë njerëzit pritnin vendimet e reja dhe urdhrat e rinj që do të jepeshin nga ky qytet.

Jashtë rrethinave të qytetit, dy veta, njëri mysliman dhe tjetri i një feje tjetër (hebre, i krishterë a_zerdeshij) ishin takuar gjatë rrugës. Pyetën njëri-tjetrin se për ku ishin nisur dhe doli që myslimani ishte nisur për në Kufe, ndërsa ai tjetri diku aty pranë këtij qyteti. Atëherë, meqë e panë që rrugën e kishin deri diku të njëjtë, vendosën që ta bënin bashkë, kështu që të kishin mundësi që të shkëmbenin edhe nja dy fjalë së bashku. Rruga e përbashkët kaloi më së miri në saj të bisedës së sinqertë dhe shkëmbimit të mendimeve. Kur mbërritën pranë qytetit të Kufes, ai që nuk ishte mysliman, vuri re me plot habi që myslimani nuk u kthye nga ishte rruga e qytetit por hyri rrugës bashkudhëtarit . I habitur nga myslimani, e pyeti atë: " Po ti a nuk më the që ishe nisur për në Kufe?"

"Po, iu përgjigj myslimani."

"Po, atëherë përse iu fute kësaj rruge. Rruga për në qytetin e Kufes është ajo tjetra.

-"E di, iu përgjigj myslimani, por dua të të përcjell pakëz. Profeti ynë ka thënë: "Sa herë që dy veta marrin një rrugë

bashkë dhe bëjnë muhabet, kanë një të drejtë mbi njëri-tjetrin". Kështu dhe ti e ke një të drejtë mbi mua dhe unë për hatër të saj dua që të të përcjell disa hapa dhe pastaj do t'i kthehem rrugës sime."

Burri tjetër, i mahnitur iu përgjigj: "Oh, Profeti juaj që ka gjetur kaq mbështetje dhe përkrahje në mesin e njerëzve dhe me atë shpejtësi që është përhapur feja e tij në botë, patjetër te kjo sjellje e te ky moral duhet ta ketë forcën e vet."

Por habia dhe mahnitja e besimtarit arriti kulmin kur ai mësoi se bashkudhëtari i tij mysliman ishte Kalifi i myslimanëve, Ali ibn Ebu Talibi (a.s) Nuk zgjati shumë dhe vetë ai u kthye më pas në mysliman duke u bërë pjese e besimtarëve dhe shokëve të devotshëm të Aliut (a.s)[1]

1) Usulul Kafij; vëll.2, f.470 – kreu i shoqërisë së mirë dhe të drejtat e shokut në udhëtim"

TEK YZENGJIA E KALIFIT

Imam Aliu (a.s), kur ishte nisur për në qytetin e Kufes, përpara se të mbërrinte atje, u fut në qytetin Anbar, banorët e të cilit ishin iranianë.

Prijësi i qytetit dhe bujqit iranianë, të gëzuar shumë se qytetin e tyre po e nderonte Imami i tyre aq i shtrenjtë, u turrën me nxitim për ta pritur. Kur vargani i Aliut (a.s) hyri në rrugë, ata i dolën përpara dhe filluan të vraponin. Aliu i thërret ata dhe i pyet: "Ç'është kjo gjë që bëni?"

" –Kjo - thanë ata është një mënyrë nderimi që kemi ne për njerëzit që i duam dhe i respektojmë. Është tradita jonë e hershme e për ne është diçka normale."

"Kjo puna juaj, - u tha Aliu - ju bën të vuani në këtë botë, kurse në Ahiret ju bën fatkeqij. Hiqni dorë nga punët që ju ulin e ju shpërfytyrojnë si njerëz. Përveç kësaj, kjo punë ç'të mirë i sjell njeriut?"[1]

1) Nehxhul Balaga, urtësia, nr. 37.

IMAM BAKIRI DHE BURRI I KRISHTERË

Imam Bakiri, emri i tij i vërtetë ka qenë Muhamed ibn Ali ibn Husejn (a.s), e kishin quajtur "Bakir", që do të thotë i pastër (qelibar). E thërrisnin dhe "Bakir el-Ulum" që do të thotë njeri që di dituritë e pastra."

Një i krishterë, e ndryshonte me dashakeqje fjalën "Baker" në "bekare" me kuptimin "lopë" dhe e thërriste imamin "ente bekare" – ti je lopë.

Imami, pa u mërzitur fare dhe pa dhënë asnjë shenjë inati, iu përgjigj qetësisht: - Jo, unë nuk jam "bekare" (lopë), jam Bakir.

I krishteri iu kthye: Ti je djali i një gruaje që ishte kuzhiniere, kjo ishte puna e saj, ajo s'kishte as turp e as nder. I krishteri iu kthye prapë: "Nëna jote ishte një grua e zezë, e keqe, dhe e pander."

Imami i tha: "Nëse këto fjalë që ti thua për nënën time janë të vërteta, Zoti e mëshiroftë dhe e faltë, por nëse fjalët e tua janë gënjeshtra, Zoti të faltë ty dhe mëkatin që gënjeve dhe shpife për të!"

Duke parë gjithë këtë fisnikëri se si reagoi imami ndaj këtyre provokimeve të rënda, të cilat ishin të mjaftueshme për ta nxjerrë një burrë jashtë fesë islame, i krishteri pësoi një revolucion brenda vetes dhe e ktheu veten drejt islamit. Më pas i krishteri u kthye në mysliman.[1]

---

1) Biharul Anuar; vëll. 11, f. 83. (imam Bakir)

BEDUINI DHE PROFETI I MADHËRISHËM

Një arab i egër, endacak shkretëtire u fut brenda në qytetin e Medines, dhe shkoi drejtt e në xhami dhe kërkoi nga Profeti i Zotit flori e argjend. Ai u fut kur Profeti ishte mes shokëve të tij. Arabi ia shprehu Profetit atë që kërkonte. Profeti i dha diçka, mirëpo ai nuk u bind, tha se ishin pak, dhe filloi t'i fliste rëndë Profetit të Zotit. Shokët e Profetit u zemëruan nga sjellja e arabit endacak dhe u bënë gati për ta mësyrë, por Profeti i Zotit i pengoi.

Pastaj Profeti, e mori me vete arabin në shtëpinë e tij dhe aty i dha sërish ndihmë. Këtu arabi vuri re nga afër se Profeti nuk ishte në atë gjëndje që ai ishte mësuar ta shikonte te pasanikët dhe prijësit e tjerë të qytetit, te Profeti nuk kishte ar e pasuri që ai kërkonte.

Atëherë, arabi mbeti i kënaqur dhe e falënderoi Profetin. Tani Profeti i thotë atij: "Ti qëpari fole ashpër me mua përpara shokëve të mi, e ata u nxehen e unë kam frikë se mos të të ndodhë ndonjë gjë prej atyre. Tani, ti mua më falënderove. A është e mundur që këto falënderime t'i thuash edhe përpara shokëve të mi, kështu që ata të mos jenë më të inatosur me ty?" Arabi pranoi.

Të nesërmen, arabi erdhi sërish në xhami, në kohën kur ishin mbledhur të gjithë. Profeti u kthye nga turma e njerëzve dhe tha: "Ky burri ka ardhur të na thotë se është i kënaqur

prej nesh dhe se na falënderon, a është kështu?" "Po, - thotë arabi,- kështu është" dhe i falënderoi të gjithë të pranishmit. Profeti dhe të gjithë shokët e tij qeshën.

Në këtë kohë Profeti u kthye nga shokët dhe tha: "Ndodhia ime me këtë njeri është si puna e atij njeriu,t të cilit i kishte ikur deveja. Njerëzit duke dashur që të ndihmonin të zotin, filluan të bërtisnin dhe ta ndqinin atë. Atëherë dhe deveja filloi të vraponte e të ikte edhe më shpejt. I zoti i devesë u kthehet njerëzve: "Ju lutem, mos e ngisni devenë time se unë e di vetë më mirë si ta kthej.

Sapo njerëzit ndaluan së vrapuari, ai vajti e mori një tufë bar dhe i shkoi pranë devesë dalëngadalë. Pa qënë nevoja që të bërtiste, të vraponte apo të lodhej, ngadalë, kur i tregoi barin, e afroi dhe pastaj e kapi qetësisht.

Edhe unë, po t'ju kisha lënë të lirë dje, patjetër këtë arab të mjerë do ta kishit vrarë, sikur të ishtë ndonjë i pafe idhujtar, por ndërhyra dhe me të mirë e qetësova."[1]

1) *Kehlul Basari; f. 70*

12

BURRI NGA SHAMI (SIRIA) DHE IMAM HYSENI

Një burrë nga Shami ishte nisur për Haxh në Mekë dhe pastaj për në Medine. Diku, sytë i hasën një njeri që ishte ulur aty pranë. Pyeti se kush ishte ai? I thonë që ai ishte "Husejn ibn Ali ibn Ebu Talibi." Mbushur me propagandën e çuditshme[1] në shpirtin e tij, sytë iu errën dhe filloi të hidhte kundër Husejn ibn Aliut, fjalë të këqija, akuza dhe mallkime. Pasi i tha ç'pati për t'i thënë, imam Husejni, pa u mërzitur fare dhe pa shprehur shqetësim, i hodhi një

1) Shami (Siria) u pushtua në kohën e Kalifatit të Ymerit. Njeriu i parë që e mori udhëheqjen e pushtetin e Shamit në Islam ishte Jezidi, biri i Ebu Sufjanit. Jezidi sundoi dy vjet dhe vdiq. Pas tij sundimi i këtij rajoni tërë ndësishëm dhe plot begati i takoi të vëllait të Jezidit, Muavije ibn Ebu Sufjanit. Muavija sundoi totalitarisht në këtë vend për 20 vjet me radhë. Qysh në kohën e Ymerit ishte ca ktuar që askush të mos qëndronte për kohë të gjatë në pushtet, por të ndërroheshin shpejt e shpejt. Muavija që ndroi i palë kundur në fronin e vet dhe askush nuk e shqetësoi. Aq shumë e forcoi fronin e vet sa filloi të më tonte (pretendonte) dhe Kalifatin. Pas 20 vjetësh sundimi dhe pas skenave të përgjakshme që shkaktoi, e arriti dëshirën e vet dhe për 20 vjet të tjera sundoi nën titullin e Kalifit të myslimanëve në Sham dhe rajonet e tjera të territoreve të gjeta islame. Kështu, banorët e Shamit, të cilët u lindën në botën islame të asaj kohe, u rritën nën sundimin e Umovitëve dhe siç dihet Umovitët, qysh në kohët e hershme kishin armiqësi me Hashimitët. Në periudhën e Islamit dhe me lindjen e Islamit, armiqësia e Umovitëve u ashpërsua më tej me Hashimitët dhe u përqendrua te familja e Aliut. Kështu, banorët e Shamit, qysh në fillim, kur dëgjuan emrin e Islamit për herë të parë dhe e pranuan atë, ata dëgjuan e pranuan dhe armiqësinë për familjen e Aliut dhe si pasojë e propagandës së Umovitëve, armiqësinë ndaj familjes së Aliut e shikonin si shtyllë të fesë së tyre. Kjo ishte ajo që "brumi dhe sjellja e tyre është e njohur."

vështrim shumë miqësor dhe pasi këndoi disa ajete kur'anore për mirësinë e Krijimit dhe faljen e mëshirën, i tha sirianit: "Ne jemi të gatshëm për çfarëdolloj ndihme e shërbimi që mund të kesh nevojë."Pastaj e pyeti: "A je nga Shami?" "Po, - iu përgjigj siriani:

"Unë kam parë dhe më përpara kështu sjelljesh dhe e di se kush e gatuan këtë brumë," - iu përgjigj imami. Pastaj i shtoi:

- Ti je i ardhur në qyetetin tonë, pra për çfarëdo ndihme që të kesh nevojë, na thuaj, jemi gati të të pranojmë në shtëpitë tona, jemi gati të të japim për t'u veshur, jemi gati dhe të të japin parà.

Burri nga Shami, i cili pas atyre gjërave që tha priste një kundërveprim të fortë, mbeti i befasuar nga fjalët e imamit dhe tha: "Toka m'u çaftë nën këmbët e mia e të fundosem thellë nën të, e nuk kisha parë, thënë e dëgjuar asgjë. Deri tani, për mua nuk kishte njerëz më të urryer në botë se Husejni dhe i ati, tashti, që nga ky çast është e kundërta, njerëz më të dashur se Husejni dhe i ati për mua nuk ka.[2]

2) Nefthetul Musauiri; f. 4. I autorit muhadith Kummij

BURRI QË KËRKONTE KËSHILLA

Një burrë erdhi nga Badija (shkretëtira) në Medine dhe shkoi e takoi Profetin. I kërkoi Profetit këshilla dhe udhëzime. Profeti i tha vetëm "Mos u nxeh" e nuk i shtoi gjë tjetër.

Burri u kthye te fisi i vet. Kur mbërriti atje, mësoi se gjatë kohës që ai nuk kishte qenë aty, kishte ndodhur një ngjarje e rëndësishme. Të rinjtë e fisit të tij kishin marrë mallrat e një fisi tjetër, pastaj kishin ardhu ata të fisit tjetër e kishin plaçkitur te fisi i tij e kështu, ishin nxehur gjakrat dhe të dy fiset ishin rreshtuar tani përballë njëri-tjetrit, të gatshëm për luftë. Ky lajm e zemëroi atë menjëherë. Kërkoi armët, u vesh dhe u nis me vrap për në luftë duke u rreshtuar përkrah fisit të vet. Papritur iu kujtua që para se të vinte këtu, kishte qenë në Medine. Iu kujtuan gjërat që kishte dëgjuar dhe kishte parë. Iu kujtua këshilla që kishte kërkuar nga Profeti dhe ai i kishte thënë që ta frenonte zemërimin e tij."

Filloi të mendonte se përse e kishte lënë veten të inatosej, përse kishte ngjeshur armët dhe ishte bërë gati për të vrarë dhe për t'u vrarë? Përse e humba logjikën dhe gjakftohtësinë, - mendonte. Tani është ai çasti i duhur për ta përdorur atë fjalinë ë shkurtër, tha me vete.

Doli përpra rreshtit, kërkoi të parin e kundërshtarëve dhe tha: "Për çfarë do bëhet kjo betejë? Nëse bëhet për të marrë

hak ndaj veprimit të pamatur të atyre të rinjve, unë jam gati ta paguaj atë nga malli im. Nuk ka arsye që për diçka fare të paktë të derdhim gjakun e njëri-tjetrit." Pala tjetër, kur dëgjoi fjalët e tij të mençura, iu prek nderi dhe burrëria dhe thanë: "Edhe ne nuk jemi më poshtë se ti. Meqë puna është kështu, edhe ne po heqim dorë nga mëtimet (pretendimet) tona.

Dhe kështu, të dy rreshtat u kthyen drejt fiseve të tyre.[1]

Shoqata Flladi

1) Usulul Kafij; vëll. 2,f. 404

14

I KRISHTERI DHE ARMATURA E ALIUT (A.S)

Në kohën e Kalifatit të imam Aliut, në qytetin e Kufës, imamit i humbi armatura. Pas pak kohe ajo u gjet te një i krishterë. E, kështu, puna shkoi te gjykatësi. Aliu foli përpara gjykatësit dhe tha: "Kjo armaturë është imja, unë as nuk e kam shitur atë, as nuk ia kam falur njeriu, dhe tani ia kam gjetur këtij njeriu." Gjykatësi i thotë të krishterit: "Kalifi e shprehu pretendimin e tij, ti çdo të thuash?" Ai iu përgjigj: "Kjo armaturë është imja, dhe fjalën e Kalifit nuk e pranoj.

Gjykatësi u kthye nga Aliu dhe i tha: "Ti pretendon se kjo armaturë është jotja; po kështu, edhe ky. Për ta provuar atë që thua, duhet të sjellësh një dëshmitar."

Aliu qeshi dhe tha: " Gjykatësi ka të drejtë, tani duhet të sjell dëshmitar, por unë dëshmitar s'kam. Gjykatësi, duke e parë që ai nuk kishte dëshmitar, vendosi që armatura t'i mbetej të krishterit. I krishteri mori armaturën dhe u nis të ikte. I krishteri e dinte shumë mirë se e kujt ishte armatura dhe pas disa hapash e breu ndërgjegjja, u kthye dhe tha: "Kjo lloj qeverisjeje dhe kjo sjellje nuk janë të një njeriu të zakonshëm, ato janë të llojit të Profetëve; që armatura është e Aliut."

Nuk zgjati shumë dhe edhe ai u kthye në mysliman dhe me besim e plot guxim ai luftoi nën flamurin e Aliut në luftën e Nehrevanit.[1]

---

1) Imam Aliu zëri i drejtësisë njerëzore; f. 63 dhe Bihar, vëll. 9, f.598. Botuar në Tebriz

IMAM SADIKU DHE NJË GRUP ASKETËSH

Sufian Theurju[1], i cili jetonte në Medine, shkoi tek imam Sadiku. Ai pa që imami kishte veshur një rrobë të bardhë, shumë të bukur, të hollë e të butë, e cila i rrinte për mrekulli e i jepte një pamje madhështore. Theuriu, duke e kundërshtuar këtë gjë, i tha imamit: "Ti s'duhet të veshësh

1) Afër shekullit të dytë (Hixhri), në mesin e myslimanëve dolën grupe të cilat e quanin veten asketë ose sufistë. Ata kishin një lloj të veçantë jetese e i ftonin të tjerët në rrugën e tyre duke u thënë se rruga e tyre ishte e drejtë. Sipas tyre, se nga të mirat dhe begatitë e botës, duhej larguar. Besimtari nuk duhet të veshë rroba të bukura, të hajë ushqime të shijshme, a të ketë shtëpi të mirë. Kur shikonin të tjerët që jetonin në kushte të mira, i quanin të pafe dhe si njerëz që i janë larguar Zotit. Edhe gabimi që Sufjani ia quajti imam Sadikut, vinte nga kjo mendësi. Kjo mënyrë dhe largim nga bota kishte historinë e saj. Në Greqinë e lashtë dhe në Indi, por edhe në vende të tjera të botës, ekzistonte pak a shumë kjo doktrinë. Ajo u fut dhe në mesin e myslimanëve duke i dhënë asaj ngjyrë fetare. Kjo doktrinë u përcjell më pas te brezat e tjerë e pati ndikim të habitshëm. Ata bënë që në mesin e myslimanëvë të dilnin shkolla të ndryshme duke u përhapur në çdo shtet islamik ku parimi i tyre ishte mosrespektimi i rregullave elementare të jetës. Ndikimi i këtyre shkollave e i kësaj filozofie nuk mbeti vetëm tek ata që e quanin veten sufinj, të cilët kërkonin largimin nga bota, si asketë, por u përhap dhe në mesin e grupeve të tjera fetare islamike që e dinin veten e tyre anti-sufistë. Por, mund të thuhet që të gjithë njerëzit që veten e tyre e quanin sufinj, nuk kishin të tërë këtë mendje. Nuk ka dyshim që këtë mendësi duhet ta quajmë një sëmundje shoqërore, një sëmundje të rrezikshme, e cila cungon shpirtin e moralin e shoqërisë. Kjo sëmundje duhet të luftohet e kjo mendësi duhet të zhduket. Fatkeqësisht, edhe ato beteja a luftime që janë bërë në emër të zhdukjes së këtij mentaliteti, janë bërë për interesa të atyre njerëzve të cilët kërkojnë t'i vjedhin për vete të mirat e kësaj bote në atë mënyrë e kështu, ata që luftojnë. Tasavvufin, kthehen vetë në të sëmurë. Për shkak të padijes së tyre a mendjes së tyre të ngushtë, luftuesit, madje të verbër, luftojnë edhe atë dinasti mendimi të lartë dhe mirësie që është kryevepra e njerëzimit, të cilën shumë pak veta e arrijnë. Lufta ndaj Tassavufit duhet të bëhët në suazën e luftës kundër asaj sëmundjeje dhe asaj mendësie prapanike që u përmend e siç e tha dhe vetë imam Sadiku (a.s), pra të luftohët kudo që të vihet re dhe me çfarëdo emri që ajo të dalë. Sido qoftë, ajo ç'ka thotë Imami në këtë tregim, është arma e cila fatmirësisht është ruajtur mirë në hadithe dhe librat e vëretë, për ta luftuar këtë mendësi e cila, fatkeqësisht, është përhapur shumë.

rrobë kaq të bukur. Ti nuk duhet ta shëmtosh veten me bukuritë e kësaj bote. Nga ti pritet që të bësh jetë si asket dhe të jesh i përmbajtur e ta largosh veten nga kjo botë.
Imami: "Dua të të them diçka dhe më dëgjo mirë, sepse është për dobinë tënde si në këtë botë ashtu dhe në Ahiret. Nëse ti ke gabuar me të vërtetë dhe nuk e di të vërtetën e pikëpamjes së Islamit për këtë çështje, atëherë fjala ime do të të vlejë shumë. Por, nëse ti nënkuptoje që të sjellësh në Islam një ndyshim e t'i shtrëmbërosh të vërtetat, atëherë ajo është një çështje tjetër dhe kjo bisedë ty nuk do të sjellë ndonjë dobi. Mundet që t'i të kesh mëshirua në vetvete gjendjen e thjeshtë dhe të varfër të të Dërguarit të Zotit dhe shokëve të tij në atë kohë dhe kujton se kjo është një mënyrë jetese dhe një detyrë për të gjithë myslimanët deri në Ditën e Kijametit, që të jetojnë në atë mënyrë e të rrinë përherë të varfër. Por unë po të them se Profeti dhe shokët e tij jetonin në një kohë dhe në një mjedis ku mbizotëronte varfëria dhe prapambetja. Njerëzit nuk kishin as idenë e gjërave më elementare për jetën. Edhe gjendja e Profetit dhe e shokëve të tij lidhej me gjendjen e njerëzve në atë kohë. Por, në një kohë kur njerëzimi është zhvilluar dhe kur është rritur mirëqënia, prej bekimeve të Zotit duhet të përfitojnë njerëzit më të mirë dhe më të devotshëm në rrugën e Zotit dhe jo njerëzit e lig, myslimanët e jo të pafetë. Ti çfarë gjëje tek unë pe të gabuar? Të betohem në Zot, se tek unë në kohën që shikon që unë përfitoj dhe përdor bekimet e All-llahut për njeriun, qysh kur jam rritur e pjekur, nuk kalon një çast i vetëm që të mos mendoj, natë e ditë se

nëse një e drejtë do të jetë në dorën time, menjëherë do t'ia jap atë atij që i takon.

Sufiani nuk arriti që t'i jepte përgjigje të arsyeshme Imamit. I mërzitur dhe i mundur, doli jashtë dhe shkoi e takoi shokët e tij dhe u tregoi për gjithçka që i kishte ndodhur. Ata vendosën të gjithë njëzëri që të shkonin tek Imami dhe të ballafaqoheshin me argumente me të. Shkojnë pranë tij dhe i thonë: Shoku ynë nuk arriti që t'i jepte mirë arsyet e veta. Tani ne kemi ardhur që, duke të dhënë argumente të qarta të provojmë që ti je gabim.

Imami: Cilat janë argumentet tuaja? Shprehuni.

Ata thanë: Arsyet tona vijnë nga Kur'ani.

Imami: Atëherë ku ka argument më të mirë se Kur'ani. Flisni, jam gati t'ju dëgjoj.

Kemi dy ajete nga Kur'ani, të cilat provojnë sjelljen tonë dhe ne ecim sipas atyre;- u përgjigjën ata. Zoti i Madhërishëm, në Kur'anin Fisnik, duke lavdëruar një grup shokësh thotë kështu: "Gjatë kohës që ata janë në vështirësi e varfëri, sërish vënë të tjerët përpara vetes. Njerëzit që i rrinë larg vesit të xhelozisë e të zilisë, janë të drejtët", ndërsa në një vend tjetër Kur'ani thotë: "Megjithëse ata kanë nevojë për rroba dhe ushqim, ata ua falin të varfërve, jetimëve dhe robërve." (surja "Hashr", ajeti 9) dhe (surja "Insan", ajeti 8)

Sapo e mbaruan fjalën e tyre, dikush që qe ulur në një cep dhe po i dëgjonte, u ngrit dhe tha: "Ajo që kuptova unë deri tani është që ju nuk keni besim as te fjalët që vetë ju thoni. Ju i keni kthyer këto fjalë në një mjet që t'i bëni mënjanës (indiferentë) njerëzit për mallin e pronat e tyre e që t'ju a

japin juve; pastaj, deri më sot nuk është parë që ju te hiqni dorë nga ushqimet e mira dhe t'ua jepni ato njerëzve që kanë nevojë."

Ndërkohë, ndërhyri imami:"Lërini këto lloj muhabetesh. Këto s'kanë vlerë." Pastaj kthehet nga grupi i asketëve dhe u thotë: "Në fillim, më thoni, ju që argumentoni me Kur'anin, e shfuqizoni Kur'anin nga ajo që nuk e kuptoni apo jo? Çdokush nga ky Ymmet që e ka humbur rrugën e drejtë, që duke mos pasur informacionin e duhur për të kuptuar Kur'anin, e ndjek atë.

Asketët iu përgjigjën: "Sigurisht, ne kemi njohuri rreth tij për këtë çështje, por jo të plotë."

Imami: "Fatkeqësia juaj vjen nga kjo. Edhe hadithet e Profetit janë si ajetet e Kur'anit dhe ju keni nevojë t'i njihni dhe t'i dini plotësisht. Por, le t'u kthehemi ajeteve që kënduat nga Kur'ani. Këto ajete nuk kanë të bëjnë me mospërdorimin e të mirave dhe begative të All-llahut. Ajete janë për faljen, sakrificën dhe tolerancën. Aty lavdërohet një grup i cili në një kohë të caktuar, vuri përpara vetes të tjerët dhe atë mall që e kishin pronë të tyre, ua falën të tjerëve; por, edhe sikur të mos ua falnin, sërish ata do nuk kishin bërë ndonjë gabim. Zoti nuk i kishte urdhëruar ata që të vepronin në atë mënyrë, por sigurisht edhe as nuk i pengoi që të vepronin ashtu. Të drejtuar nga ndjenja e tyre, ata e lanë veten në vështirësi duke u dhënë ndihmë të tjerëve. Zoti do t'i shpërblejë ata. Pra, ky ajet nuk përputhet me pretendimet tuaja. Nga ana tjetër, ju i pengoni njerëzit që mallin e tyre a të mirat që u jep Zoti t'i përdorin për të mirën e tyre vetjake.

Nga ana tjetër Zoti u caktoi atyre masën edhe mënyrën e faljes dhe dhurimit së diçkaje. Pra, ky urdhër që erdhi nga Zoti, e shfuqizoi veprimin e tyre dhe ne duhet t'i bindemi urdhrit të Zotit,e jo veprimit që kryen ata. Për të mirën e robit të tij, dhe të gjendjes së besimtarit, Zoti, nëpërmjet mëshirës së Tij të Madhërishme, e ka ndaluar që njeriu, veten dhe familjen e tij ta lërë në hall e në vështirësi dhe çfarëdo që të ketë ai në dorë t'ua falë të tjerëve. Në mesin e familjarëve të tij ka fëmijë, të dobët të moshuar që nuk kanë fuqi. Nëse atë copë bukë që kam në dorë do t'ia dhuroj dikujt tjetër, atëherë familja ime, përgjegjës i së cilës jam unë, do të vuajë. Edhe i dërguari i Zotit (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të) ka thënë: Ai që ka disa kokrra hurme, ndonjë copë bukë, a ndonjë dinar dhe ka dëshirë që t'i falë më së pari duhet që t'ia japi nënës së tij, babait të tij dhe pastaj vetes gruas dhe fëmijëve; pastaj, kushërinjve më të afërt e vëllezërve besimtarë; pra, dhurimi a bamirësia për këto të katër është pas të gjithë të tjerëve. Kur Profeti dëgjoi që njëri prej shokëve të tij kishte vdekur dhe kishte falur tërë pasurin e tij të paktë duke lënë të varfërë gruan dhe fëmijët e tij, tha: "Nëse do të më kishit thënë më përpara, nuk do ta kisha varrosur atë në varrezën e myslimanëve. Ai la pas fëmijët t'u shtrinë dorën të tjerëve!"

Ndërsa im atë, Imam Bakiri më ka treguar se Profeti i Zotit, ka thënë: "Përherë bamirësinë tuaj fillojeni nga familja juaj, pra në fillim tek ata që janë më të afërm e kështu me radhë."

Përveç këtyre, Kur'ani i Madhërishëm e anulon rrugën dhe përparimin tuaj duke thënë: "Të dalluarit janë ata të cilët në falje e bamirësi as nuk e shpojnë e as nuk e shtrëngojnë

dorën. Ata ecin rrugës së mesit dhe ekuilibrit".(surja "Furkanë", ajeti 67)

Në shumë ajete të Kur'anit ndalohet shpërdorimi me faljen dhe bamirësinë, ashtu siç ndalohet dhe zilia dhe xhelozia. Për këtë Kur'ani ka caktuar një kufi dhe masë; njeriu nuk mund të falë çfarëdo gjëje që ka e të mbetet vetë pa gjë. Profeti i Zotit ka thënë: "Zoti nuk pranon këto lloj lutjesh":

a) Lutjen që ia kërkon Zotit për të keqen për prindërit e vet.

b) Lutjen që ka dhënë borxhe dhe nuk ka marrë asnjë lloj prove a dokumenti për këtë. Borxhliu e ka ngrënë mallin e tij dhe ky i kërkon borxhin duke iu lutur Zotit që t'ia kthejë atë. Sigurisht, lutja e këtij njeriu nuk do të plotësohet, sepse ai ia ka hapur gropën vetes, duke e dhënë mallin e vet pa asnjë lloj dëshime e dokumenti.

c) Lutjen e njeriut i cili kërkon nga Zoti, t'i mbulojë turpin, a të pastrojë të keqen e gruas së tij. Zgjidhja e kësaj pune është në vetë dorën e tij. Nëse është i mërzitur nga gruaja, martesën mund ta kthejë në divorc.

ç) Lutjen e njeriut që rri duarkryq në shtëpi dhe i kërkon Zotit bukën e përditshme. Zoti, ia jep kështu përgjigjen këtij njeriu përtac dhe injorant; "O robi im, a nuk ta kam hapur ty rrugën e lëvizjes dhe të punës? A nuk t'i kam dhënë të gjitha pjesët e trupit në rregull?! Të kam dhënë sy, hundë, buzë, veshë, duar, mendje që të mendosh e të veprosh. Të gjitha këto janë krijuar për punën. Falënderimi ndaj këtyre bekimeve është që ti t'i vësh ato në punë. Kështu pra, Unë me ty e kam kryer detyrën time, që ti të ngrihesh, të punosh me forcat e tua e të mos i varesh kujt mbi supe. Sigurisht,

nëse do t'i bindesh vullnetit Tim, edhe unë do të të bekoj me shumë të mira e begati, edhe sikur për ndonjë arsye a shkak jeta jote nuk do zhvillohet, sepse ti e ke bërë mundimin tënd dhe e ke zbatuar detyrën, e për këtë do të jesh i falur.

d) Lutjen e atij që ka pasur pasuri dhe mbushulli (bollëk të madh) dhe tani e ka humbur ngaqë e ka falur e ka bërë shpenzime të pamatura. Këtij njeriu që ngre duart nga Zoti, e i lutet që t'i japë serish mallin, Zoti këtij i përgjigjet: "A nuk të pata dhënë Unë ty gjithë atë mall e pasuri? Përse nuk e ruajte? A nuk pata dhënë Unë urdhër që të tregohesh i matur? A nuk pata ndaluar Unë faljet dhe dhuratat e pamatura?

e) Lutjen e njeriut që kërkon nga Zoti, të pritet mëshira, ose lutjen e njeriut që e ka larguar mëshirën dhe lutet për diçka.

Në Kur'anin e Madhërishëm dhe veçanërisht Profetit të tij Zoti i mësoi mënyrën e faljes. Në një hadith thuhet: Një ditë, Profeti kishte njëfarë shume në florinj dhe dëshironte që ato t'ua jepte të varfërve, madje nuk donte as edhe për një natë të vetme t'i mbante në shtëpi. Brenda ditës i fali të gjithë florinjtë që kishte. Mëngjesin e ditës së nesërme, erdhi një endacak dhe me ngul i kërkoi Profetit ndihmë. Profeti nuk kishte ç'ti jepte dhe u mërzit shumë prej kësaj. Këtu u shpall dhe ajeti i Kur'anit që thotë: "As mos i mbani të lidhura duart tuaja rreth qafës e as mos i hapni ato plotësisht, që pastaj të mos mbeteni vetë keq, duke u kthyer vetë në të varfër."

Ky është hadith nga Profeti. Edhe ajetet e Kur'anit e theksojnë atë që thuhet në hadithe, dhe sigurisht ata që

janë besimtarë dhe e besojnë Kur'anin dhe i zbatojnë thëniet e tij.

I thanë Ebu Bekrit në kohën kur po vdiste, lër trashëgiminë e mallit tënd. Ai tha: Një të pestën e mallit tim e fal, ndërsa pjesa tjetër është për trashëgimtarët e mi. Dhe një e pesta nuk ishte pak. Por, meqë Ebu Bekri ishte për të vërtetën dhe ishte duke vdekur, për të lejohej që të falte edhe një të tretën; por ai nuk e dinte këtë gjë.

Selmani dhe Ebu Dher-ri, që ju i njihni si njerëz të pastër dhe asketë, vepronin kështu:

Selmani, sa herë që merrte pjesën e vet nga Beitu'l Mali (rezerva e shtetit), merrte rezervat e një viti të plotë. E pyetën: "Ti, që je kaq njeri i kursyer dhe asket, po mendon për rezervat e një viti të plotë? Mundet që sot apo nesër, ti të vdesësh e të mos të arrish fundin e vitit". Ai iu përgjigj: "Ndoshta edhe nuk vdes, përse u dashka që ju të llogarisni vdekjen? Ka dhe një mundësi tjetër e ajo është që unë të jem gjallë dhe nëse do jem gjallë, duhet të shpenzoj që të jetoj, o të paditur! Ju nuk e dini që, nëse nuk do t'i ketë të mjaftueshme kushtet për jetesë, do ta humbë fuqinë e gëzimit që të çon në rrugën e drejtë, kurse kur i krijohen kushtet, atëherë ajo fuqi është e pranishme."

Kurse Ebu Dher-ri, kishte disa deve e dhen për qumësht. Sa herë që donte të hante mish a kur i vinte ndonjë mik në shtëpi, therte dele e u jepte miqve aq sa mbante edhe për vete. Atëherë, kush prej këtyre ishte më asket? Profeti ka thënë për ata, gjëra që të gjithë ju i dini, se janë njerëz shumë të ndershëm. Asnjëherë të tillë njerëz nuk e kanë falur gjithë mallin dhe pasurinë e tyre, por të tillë ishin sufistë dhe nuk

kanë ecur asaj rruge të humbur, që të japin çdo mall që kanë, e ta lënë veten dhe familjen e tyre në baltë.

Tani po ju them këtë hadith, që ka ardhur nga Profeti nëpërmjet baballarëve tanë, "Gjëja më e çuditshme për besimtarin është gjendja kur nëse do t'ia prisnin trupin copa-copa me shpatë, do të ishte mirë dhe lumturi për të e edhe nëse do t'i jepnin mbretërinë e Lindjes dhe të Perëndimit, sërish për atë do të ishte mirë dhe lumturi." E mira për besimtarin nuk qëndron te ajo që ai duhet të jetë patjetër i varfër. Mirësia e besimtarit buron nga shpirti e besimi i tij. Kështu, qoftë i varfër apo i pasur, ai e di se ka një detyrë dhe atë detyrë duhet ta zbatojë sa më mirë. Të gjitha vështirësitë, pasojat e ngushtësitë për besimtarin janë mirësi dhe lumturi, kjo është gjëja më e çutishme.

Nuk e di, aq sa ju thashë , a ju mjafton për sot?

A e dini se në fillimet e Islamit, kur numri i myslimanëve ishte i paktë, ligji i Xhihadit ishte ky: një mysliman duhej të qëndronte përballë dhjetë të pafeve. Nëse nuk do të qëndronte ai bënte mëkat. Por më vonë, kur kushtet u përmirësuan, Zoti me mirësinë dhe me mëshirën e Tij, e ndryshoi këtë ligj, duke caktuar që çdo mysliman duhet të qëndrojë përballë dy njerëzve të pafe. Atëherë, më lejoni që t'ju pyes për ligjin dhe gjyqin sipas Islamit. Supozoni sikur njëri prej jush është i dënuar dhe atij i bie pjesa që t'i japë pensionin ushqimor bashkëshortes dhe vetë gjykatësi të urdhëron ta bësh këtë gjë. Çfarë do të bënit? A do të kërkonit falje, sepse jeni njeri asket e i varfër dhe nuk e pranoni mallin e kësaj botë? Kjo lloj amnistie do t'ju jepet? Për mendimin tuaj, vendimi i gjykatësit, që ju duhet të jepni

shpenzimet për gruan tuaj, a është i drejtë dhe barazi, apo është padrejtësi dhe shtypje? Nëse ju do të thoni që është një vendim i padrejtë, atëherë keni thënë një gënjeshtër shumë të madhe dhe i keni fyer të gjithë myslimanët. Nëse do të thoni që gjykatësi ka të drejtë, atëherë edhe falja që kërkoni ju nuk hyn në punë dhe e pranoni që rruga dhe doktrina juaj është e gabuar.

Edhe diçka tjetër. Ka gjëra që myslimanët edhe janë të detyruar edhe nuk janë të detyruar t'i dhurojnë, si p.sh, zekati etj. Nëse sipas jush njerëzit duhet të heqin të gjithë dorë nga zekati dhe bamirësia, sepse të gjithë duhet të kthehen në asketë, kush prej jush do ta kryejë detyrën e zekatit e të sadekasë? Si i bëhet halli zekatit të detyruar, në ar, në argjënd, në mallra, në bagëti, etj; Kush do t'i japë këto? A nuk është caktuar zekati që këto gjëra t'u shkojnë atyre që kanë nevojë? Kjo tregon më se miri se qëllimi i fesë është për ta bërë jetën sa më të mirë e më të zhvilluar. Nëse qëllimi i fesë do të ishte për ta varfëruar njeriun dhe nëse morali i fesë do të ishte që njeriu të hiqte dorë nga nevojat e kësaj bote, atëherë të varfërit e paskan arritur këtë qëllim të lartë dhe ata nuk u dashkan ndihmuar, dhe meqë qenkan të lumtur sërish ata nuk duhet të pranohen, sepse kanë arritur lumturinë e kësaj bote.

Pra, nëse e vërteta do të ishte kjo që thoni ju, duhet që askush të mos mbajë asgjë ndër duar, çfarëdo që ai të ketë, u dashka falur, e më mos të ketë vend për zekatin.

Pra, u bë e qartë që ju keni marrë një rrugë shumë të shëmtuar dhe të rrezikshme e thirrisni njerëzit drejt kësaj gremine. Rruga ku ecni ju dhe ku i thërrsini njerëzit të shkojnë, vjen

nga padija juaj për Kur'anin, synetin e Profetit dhe hadithet e Profetit. Këto janë hadithe që nuk mund të rrëzohen, ato janë hadithe që mbështeten nga ajetet e Kur'anit. Por hadithet e Profetit që nuk janë në leverdinë tuaj ju i hidhni poshtë; kjo është një injorancë tjetër. Ju nuk i njihni e as nuk i zbatoni ajetet e Kur'anit që flasin për mirësinë dhe ngrohtësinë. Ju nuk e njihni ndryshimin midis abrogimit e të abroguarit në ajete, as nuk i njihni ajetet muhkeme (ajete me kuptim të drejtpërdrejtë) e as ato muteshabihe (ajete me kuptim të tërthortë) dhe nuk e dalloni urdhrin për të mira e ndalimin nga të këqijat.

Atëherë, ma jepni përgjigjen për tregimin e Sulejman bin Daudit, i cili kërkoi nga Zoti pasuri dhe mbetëri aq të madhe sa mos t'ia kalonte asnjë njeri dhe Zoti ia dha atij këtë pasuri. Sigurisht, përveç të Vërtetës, Sulejmani nuk donte gjë tjetër. As Zoti në Kur'an dhe asnjë besimtar tjetër nuk ia ka quajtur gabim Sulejmanit që e kërkoi këtë mbetëri në këtë botë. Po kështu, dhe Profeti Daud i cili ishte përpara Sulejmanit. Po kështu, edhe historia e Jusufit, të cilit të gjithë i thonë Mbret (ai u lut; më jep mua rezervat që edhe t'i ruaj edhe t'i shtoj). Puna e atij shkoi deri aty sa i gjithë shteti i Egjiptit i kaloi atij në dorë pothuajse deri në kufi të Jemenit, e aty vinin në kohën e skamjes dhe të bollëkut të gjithë duke marrë ushqim. Sigurisht që as Jusufi nuk veproi në kundërshtim me të drejtën dhe as Zoti nuk ia quajti atij gabim. Po kështu, historia e Dhul Karnejnit (Dy brirëshit), i cili e donte Zotin dhe Zoti e donte atë. Zoti i dha atij të gjitha mbetëritë e botës, duke e berë atë sundimtar të Lindjes dhe të Perëndimit.

Atëherë, hiqni dorë nga kjo rrugë e humbur dhe bashkojuni kulturës së vërtetë islame. Atë që e ka ndaluar Zoti, mos e pranoni, por mos shpikni urdhra nga vetja. Mos ndërhyni në punë që nuk i dini. Lexoni dhe mësoni për atë që nuk e dini. Mësoni të dalloni të mirën nga e keqja, të fortën nga e dobëta dhe ekuilibrin nga ç'ekuilibri. Kjo është më e mirë e më ë lehtë për ju sesa padituria. Flakeni padijen. Përkrahësit e padijes janë të shumtë; janë përkrahësit dhe ndjekësit e dijes të paktë. Zoti ka thënë: "Më lart së çdo i ditur është dijetari."[2]

Shoqata Flladi

2) Tuheful Ukul; f. 348-354 dhe Kafij; vëll. 5, f. 65-71

ALIU DHE ASIMI

Pas përfundimit të luftës së Xhemelit Aliu (a.s) u fut në qytetin e Basras. Gjatë ditëve që po kalonte në këtë qytet, një ditë prej ditësh shkoi të takonte një shokun e tij, Ala ibn Ziad Harsi. Ky burrë kishte një shtëpi të madhe e të gjerë. Kur pa atë shtëpi të madhe e të gjerë i tha atij Aliu; " Kjo shtëpi e madhe për çfarë pune të hyn në këtë botë, kur për një shtëpi të madhe ke më shumë nevojë në botën tjetër?! Por nëse do, ti mund ta bësh shtëpinë e kësaj bote një mjet për të arritur në shtëpinë e madhe të botës së përtejme. Në këtë shtëpi duhet të presësh miq, të shprehësh mëshirë, këtë shtëpi ta përdorësh për të dhënë dhe shfaqur të drejtën, duke ndimuar të tjerët, në këtë shtëpi të shfaqësh të drejtat e myslimanëve dhe të mos e përdorësh vetëm për qëllimet vetjake."

Alabeni i thotë imamit: "O Emir'ul Mu'minin, unë duhet të të ankohem për vëllanë tim, Asimin.

-Çfarë ankese ke ndaj tij?- i thotë Aliu.

-Ai ka braktisur botën, vishet me zhele, jeton i vetmuar e nëpër vende të veçuara, ka braktisur çdo gjë dhe çdo njeri.

-Ma sillni atë këtu -, thotë imami.

Asimin e gjejnë diku dhe e sjellin pranë imamit. Aliu (a.s) iu kthye dhe i tha: "O armiku i shpirtit tënd, ta ka vjedhur shejtani arsyen, përse nuk pate mëshirë për gruan dhe fëmijët

e tu? Ti mendon se Zoti, i cili ka krijuar dhe dhënë bekimet dhe mirësitë e pastra në botë, duke i bërë ato të lejueshme për ty, do të mërzitet nëse ti i shfrytëzon ato? Ti përpara Zotit, je me i vogël se ato."

Asemi iu përgjigj: "O Emiru'l Mu'minin, edhe ti vetë je si puna ime, edhe ti vuan në jetë dhe ke vështirësi si unë në këtë botë, as ti nuk vesh rroba të buta e as nuk ha ushqime të shijshme; prandaj dhe unë bëj atë që bën edhe Ti dhe eci asaj rruge që ecën dhe Ti."

"Gabon, unë jam ndryshe nga ti,- iu ktheu imami. Unë kam një pozitë, të cilën ti nuk e ke. Unë vesh rrobat e shërbimit dhe të detyrës. Detyra e drejtuesit dhe e prijësit është krejt tjetër. Prijësve të drejtë, Zoti u ka thënë që të jetojnë si klasat më të pafuqishme të kombit të tyre e të jetojnë ashtu siç jetojnë njerëzit më të varfër, në mënyrë që varfëria dhe vuajtjet të mos rëndojnë mbi ato klasa e mbi ata njerëz. Prandaj unë kam një detyrë, dhe ti ke një tjetër."[1]

1) Nehxhul Belaga; fjalimi 207

I VARFRI DHE I PASURI

I Dërguari i Zotit (s.a.v.s.) ishte ulur si zakonisht në kuvend me shokët e tij. Ata ishin mbledhur atij rreth e qark si një formë unaze, duke e bërë atë të shkëlqente si guri i çmuar i kësaj unaze. Në këtë kohë, një mysliman, i cili ishte i varfër dhe i mjerë, hyri brenda nga dera. Sipas zakonit islam, kushdo që futet në një mbledhje a kuvend, çfarëdo pozite që të ketë ai, do të ulet aty ku shikon e gjen vend të lirë, pa u mburrur fare se çfarë posti mban. Kështu dhe ky burri, pa një vend të lirë diku dhe shkoi e u ul mu aty. Atij i qëlloi që të ulej përkrah një burri të pasur. I pasuri mblodhi të gjitha plaçkat që kishte dhe u largua që aty. Profeti, i cili e vuri re të gjithë sjelljen e tij iu kthye dhe i tha;

-U trembe se mos i varfri të falte ndonjë gjë nga varfëria e tij?

-Jo, o i Dërguari i Zotit.

-Atëherë u trembe se mos diçka nga pasuria jote t'i kalonte atij.

-Jo o i Dërguari i Zotit.

- Pate frikë se mos të të bëheshin rrobat pis?

-Jo, o i Dërguari i Zotit.

-Por, pse atëherë mblodhe rrobat e tua dhe u largove prej tij?

- E pranoj dhe them se bëra një gabim të madh,- tha i pasuri. Tani jam i gatshëm që për të shlyer gabimin tim, t'i fal këtij vëllait mysliman gjysmën e pasurisë sime dhe gabimi që bëra të më falet.

-Por unë nuk jam i gatshëm ta pranoj,- iu kthye burri i varfër.

-Pse?,- e pyetën të gjithë të pranishmit.

-Sepse kam frikë se edhe një ditë, edhe unë do të bëhëm mendjemadh si ai, dhe do të sillem me një vëlla timin mysliman ashtu siç u soll dhe ai sot me mua.[1]

Shoqata Flladi

1) Usulul Kafij; vëll. 2,f. 260, kreu: Fadll fukarau'l muslimijne.

TREGTARI DHE KALIMTARI

Një burrë shtatlartë dhe i madh, me një fytyrë të gjërë rrahur nga dielli shenjat e luftës në të, të cilat i kishin lënë një kujtim pranë syrit, po ecte me hapa të sigurt në pazarin e qytetit të Kufës. Një tregtar po rrinte i ulur në dyqanin e tij. Që të tërhiqte vëmendjen e shokëve të tij e t'i bënte ata për të qeshur, tregtari kapi një grusht me mbeturina dhe ia hodhi burrit që hyri në pazar. Kalimtari, pa e prishur fare terezinë e tij, nisi sërish të ecte i sigurt në rrugën e tij. Kur u largua, njeri prej shokëve kthehet dhe i thotë tregtarit;- "A nuk e njohe aspak këtë burrin që e fyeve?"

-Jo, - i thotë ai, nuk e njoha se kush ishte,- ishte një kalimtar si mijëra kalimtarë të tjerë që kalojnë përpara syve tanë përditë. Pse ti e njohe kush ishte?

- E çutishme, si nuk e njohe?! Ai ishte komandanti i famshëm i ushtrisë, Malikul Ashtar Nakhi, i tha i shoku.

- Mos, pse Malik Ashtari ishte?! Maliku që zemra e luanit bëhet ujë kur i dëgjon zërin dhe armiku dridhet kur i dëgjon emrin?

-Po, ishte vetë Maliku,- iu përgjigj shoku.

-Mos! Çfarë i bëra vetes: Tani ai do të japë urdhër që të më dënojnë. Që tani do t'i vrapoj nga pas dhe do t'i lutem që

të ma falë atë që i bëra. Dhe u nis me vrap drejt tij. Pa që ai kishte marrë rrugën drejt xhamisë dhe hyri aty për të falur namazin. Priti derisa ai mbaroi namazin, iu afrua më shumë përulje dhe i tha: "Unë jam ai dyqanxhiu që u solla keq më ty duke ju gjuajtur me mbeturina".

Maliku iu pergjigj: "Por, unë po të betohëm në Zot që erdha në xhami vetëm për shkakun tënd, e kuptova që ti je shumë i paditur e ke dalë nga rruga. I mërzit njerëzit kot së koti. M'u dhimbse. Erdha këtu të lutesha për ty dhe i kërkova Zotit që t'i drejtojë në rrugë të drejtë. Jo, unë nuk kisha atë qëllim ndaj teje që kujtove ti."[1]

Shoqata Flladi

1) Sefinetul Bihar, fjala "shetr"

GAZALIU DHE BANDITËT

Gazali, një dijetar i famshëm islam, ishte nga qyteti i Tusit.(Tusi është një krahinë pranë qytetit të Mashhadit ne Iran). Në atë kohë, pra afër shekullit të 5 të (Hixhrit), Neishaburi ishte qendra e dijes së madhe në ata rajon dhe njihej si një qëndër shumë e madhe shkencore. Në atë kohë, të gjitha ata që donin të merreshin me studime, shkonin në Neishabur. Kështu, dhe Gazali shkon në Neishabur. Qëndroi me vite pranë dijetarëve të mëdhenj të kohës dhe ai arriti të përfitonte dituri të shumta. Që ato të mos i harronte dijet që merrte i shkruante ato rregullisht. Ai i ruante me shumë kujdes këto shënime të cilat ishin fryti i punës së lodhshme disavjeçare.

Pas shumë vitesh, u kthye në vendin e tij. të gjitha librat dhe të gjitha shënimet i kishte rregullaur me kujdes, i kishte hipur në karvan dhe kidhte marrë rrugën drejt atdheut të tij. Gjatë rrugës, në një ngushticë, karvani hasi me një grup banditësh. Banditët morën nga njerëzit e tjerë të karvanit çfarë deshën dhe pastaj u erdhi mallrave rradha të Gazalit. Gazali filloi t'u lutej:" merrni të gjitha përveç kësaj! Këtë ma lini mua.

Banditët kujtuan se brenda asaj arke për të cilën lutej Gazali, patjetër duhej të kishte diçka të çmuar. E hapën arkën. Aty brenda nuk panë asgjë tjetër përveçse një tufë letrash e bojë

të zezë. I thanë –Ç'janë këto dhe për çfarë të hyjnë në punë? Çfarë do që të jetë nuk ju hyn në punë juve, kurse mua po.
- E për çfarë të hyjnë në punë ty?- e pyetën banditët.
-Këto janë puna ime disavjeçare në mësime. Po ju do të m'i merrni e gjithë dituria ime dhe mundi im i këtyre viteve do të shkojë dëm,- u përgjigj Gazali.-
-Me të vërtetë, e tërë dituria jote është këtu?- e pyetën banditët.
-Po, - iu përgjigj ai.
- Dija, e cila e ka vendin në arke dhe mund të vidhet, nuk është dije; shko e gjeji derman vetes,- i thanë banditët.
Kjo fjali e thjeshtë i dha një lëkundje shumë të madhe shpirtërore Gazalit. Deri atëherë ai kishte menduar që vetëm duhej të rrinte e të degjonte mësuesin, të shkruante e të rregjistronte çdo gjëqë thoshte ai. Që nga ajo ditë mendoi se duhej ta mbushte trurin e tij me dituri, të mendonte më shumë, të kërkonte më shumë, dhe gjërat e dobishme t'i regjistronte në fletoren e trurit të tij.
Gazali thotë: "Këshillat më të mira që u bënë drejtuese të jetës së trurit tim i kam dëgjuar nga goja e një hajduti."[1]

1) Gazaliname; f. 116

AVICENA DHE IBN MUSKEUEJ

Ebu Ali ibn Sina apo siç njihet ndryshe Avicena, nuk i kishte mbushur ende të njëzetat dhe kishte mësuar të gjitha diturisë e kohës së tij, duke u berë dijetar i njohur i kohës në shkencat natyrore, në matematikë, e në shkencë fetare. Një ditë, shkoi në një takim mësimor me dijetarin e madh të kohës së tij, ibn Meskuie. Plot krenari dhe mburrje, i doli përpara ibn Maskuiesë dhe i tha: -"Ma përcakto pak gjërësinë e kësaj arre!"

Ibne Maskujeja, i cili kishte shkruar një libër për edukatën dhe moralin me titull "Pastrimi i damarëve", ia nxjerr Avicenës përpara e i thotë:- "Ti në fillim, rregullo sjelljen tënde, apstaj unë të përcaktoj gjërësinë e kësaj arre. Ti ke më shumë nevojë të përmirësosh edukatën tënde sasa unë që të përcaktoj gjarësinë e kësaj arre."

Avicena u prek nga ky qortim dhe gjatë gjithë jetës së tij e pati parasysh atë me një sjelle shembullore.[1]

1) Historia e dijeve logjike në Islam, f. 211.

KËSHILLA E ASKETIT

Vapa e verës kishte nxehur të gjithë vendin. Dielli i nxehtë po përvëlonte Medinen dhe të gjitha kopshtet përreth saj. Një njeri, i quajtur Muhamed ibn Munkeder, që e quante veten asket dhe i larguar nga kjo botë, rastësisht kishte dalë në një vend jashtë Medines. Aty i zuri syri një njeri i cili ishte trupmadh dhe i shoqëruar nga disa njerëz të tjerë, po shkonte të punonte kopshtet e tij e të tjerët po i vinin nga pas për ta ndihmuar. Mendoi me vete: "Kush është ky burrë, që në këtë vapë kaq të madhe po del jashtë të merret me punët e kësaj bote?" U afrua më tej dhe pa që ai ishte Muhamed ibn Ali ibn Husejn (imam Bakiri). "Përse ky burrë kaq i nderuar merret me punët e kësaj bote,- tha me vete asketi; atëherë, e shoh të nevojshme që t'ia them një këshillë e ta ndaloj nga kjo punë."

Iu afrua imamit dhe e përshëndeti. Imami, i lodhur dhe i djersitur iu përgjigj përshëndetjes së tij.

Asketi i foli: A është bukuri që një burrë i nderuar si ti të dalë jashtë në këtë vapë të madhe e të merrët më punët e botës, e aq më tepër, i veshur kështu, kur duhet të vuani edhe më tepër?! Kush e di se kur i vjen vdekja njeriut? A e dini se kur do vdisni? Ndoshta, vdekja ju vjen që tani. Nëse Zoti s'ka dashur që vdekja t'ju rrëmbejë në këtë mënyrë,

çfarë do t'u ndodhë atëherë? Nuk pritet nga ju që të merreni me punët e botës, e aq më tepër të dilni në një kohë kaq të nxehtë, e ta bëni veten tuaj të vuajë kaq shumë."

Imami Bakiri hoqi barrën nga shpina, u mbështet në mur dhe tha: "Nëse vdekja vjen e më rrëmben që tani, atëherë unë kam vdekur duke adhuruar sepse kam kryer detyrën; kjo punë është njësoj si adhurimi i Zotit dhe shërbimi ndaj Zotit. Ti ke kujtuar se adhurimi është vetëm të falesh dhe të lutesh. Unë kam një jetë kam dhe shpenzime. Po të mos punoj dhe po të mos përpiqem, atëherë më duhet t'i shtrij duart drejt teje dhe atyreve që janë si ti. Unë punoj që t'i plotësoj vetë nevojat e mia të mos pres nga të tjerët. Unë duhet ta kem frikë vdekjen atëherë kur nuk kam punuar dhe i jam shmangur urdhrit të Zotit, dhe jo kur punoj dhe adhuroj e i bindem urdhrit të së Vërtetës që thotë se peshën e detyrës sime duhet ta mbaj mbi shpatullat e mia e jo t'ua ngarkoj atë të tjerëve.

"Paskam qënë shumë gabim,- tha asketi! Unë kujtoja se më duhet të të jap një këshillë, por e shikoj se unë vetë paskam qenë në gabim dhe paskam ndjekur një rrugë të gabuar dhe paskam pasur shumë nevojë për këshillën tënde."[1]

1) Biharul Anuar; vëll. 11, f. 82. (imam Bakir). Botuar nga shtypshkronja "kompani"

NË FESTËN E KALIFIT

Mutevekeli, kalifi i vrazhdë dhe tiran Abasid, ishte shumë i shqetësuar e vuanta shumë që populli kishte (dashuria shpirtërore) për imam Hadin (a.s), që populli ishte gati t'i bindej çdo urdhri të imamit. Kështilltarët e tij i thanë që Ali ibn Muhamedi (Imam Hadi) mund të bënte ndonjë revolucion nga brenda dhe nuk ishte çudi që në shtëpinë e tij të gjendeshin armë a letra që japin urdhra për sulm. Kështu, një natë, kur të gjithë ishin të shtrirë në gjumë nëpër shtretërit e tyre, Mutevekeli, dërgon në mes të natës një pjesë të ushtarëve të tij në shtëpinë e imamit që t'ia rrethonin shtëpinë dhe t'ia sillnin imamin atij. Mutevekeli e kishte marrë këtë urdhër kur kishte një feste dhe ishte duke pirë bashkë me të tjerët. Ushtarët e tij u futën në shtëpinë e imamit dhe në fillim shkuan drejt Tij. Hynë në dhomën e tij dhe panë që dhoma ishte e bosh; qilimi i dhomës ishte i mbledhur; imami ishte ulur diku dhe po falej e po i lutej Zotit. U futën në dhomat e tjera, prapë nuk gjetën atë që dëshironin. Të detyruar, morën vetëm imamin dhe e sollën përpara Mutevekelit. Kur imami hyri brenda në sallë, e pa Mutevekelin ulur në mesin e të tjerëve duke festuar e duke pirë. Dha urdhër që imamin t'ia sillnin pranë. Imami u ul.

Mutevekeli i zgjati imamit gotën me verë që kishte në dorë. Imami nuk ia pranoi dhe tha: Betohem për Zotin që brenda gjakut dhe mishit tim nuk ka hyrë kurrë verë, prandaj më fal.

Mutevekeli pranoi dhe pastaj tha;- Atëherë, na këndo një poezi, na thuaj poezitë e vjershat që kemi shkrua ne.

Imami: Unë nuk jam i poezisë, aq më pak, di vetëm poezitë e paraardhësve të mi.

Mutevekeli: Nuk ka rrugë tjetër, duhet të thuash një poezi.

Imami filloi të thoshte një poezi e cila e kishtë kështu përmbajtjen: "... Dhe ata kishin ndërtuar fortesa të larta për të jetuar, të rrethuara më ushtarë të armatosur nga të katër anët, por askush prej tyre nuk mundi ta ndalte vdekjen dhe t'i ruante ata prej harresës së kohës. Në fund fare, ata u zbritën nga ato fortesa të larta drejt varrit dhe me sa fatkeqësi që u rrëzuan! Në këtë kohë lajmërtari thirri: "Ku vajtën ato kurora dhe stoli, ku vajti e gjithë ajo madhështi e shkëlqim? Ku vajtën ato fytyra të bukura e të shndritshme, të cilat rrinin pas perdeve për t'iu fshehur pritjes së njerëzve. Varri, më në fund i mbuloi ata. Ata fytyra te bukura dhe joshëse më në fund u pushtuan nga dheu dhe krimbat e tij lëvizin të lirë mbi ta. Gjatë gjithë kohës kanë ngrënë, marrë e pirë gjithçka , por sot ata janë nën tokë janë ushqim i kandrrave të dheut."

Zëri i Imamit dilte me një tingëllim të fuqishëm e depërtonte thellë në shpirtrat e të gjithë dëgjuesve. Pija u doli të gjithëve. Mutevekeli e përplasi fort kupën e verës mbi dysheme e filloi t'i derdhte lotët lumë. E gjithë ajo festë u prish dhe drita e së Vërtetës depërtoi fuqishëm duke shkundur pluhurin e krenarisë e të fodullëkut, shpejt nga këto zemra.[1]

---

1) Biharul Anuar; vëll. 2, f. 149. (imam Hadi).

NAMAZI I FESTËS

Me'muni, ishte kalif Abasit, i zgjuar dhe i matur, pasi e mundi dhe e theu të vëllanë Muhamed Eminin, i mori të gjitha territoret e tij të gjera dhe i vuri nën sundimin e tij. I vendosur në zonën Marurit (pjesë e Horasanit të sotëm), i shkroi një letër imam Rizait (a.s) që ishte në Medine, dhe e kërkoi atë të vinte në Marur. Imam Rizai i kërkoi ndjesë duke i shprehur dhe arsyet e veta pse nuk mund të shkonte. Mirëpo Mamuni nuk hiqte dorë. I dërgonte letra njëra pas tjetër, derisa për Imamin u bë e qartë se nuk do të tërhiqej nga kjo këmbëngulje.

Imam Rizai u nis nga Medina dhe mbërriti në Marur. Me'muni i propozoi imamit që të merrte përsipër drejtimin e Kalifatit. Imam Rizai e kishte kuptuar qysh në fillim qëllimin e Me'munit dhe e dinte që ky propozim kishte tërësisht aspekt politik dhe kurrë nuk e pranoi.

Kjo gjë vazhdoi për dy muaj: nga njëra anë bëhej këmbëngulje; nga ana tjetër bëhej qëndresë.

Më në fund, Me'muni duke e parë që nuk po ia dilte, i propozoi që të merrte përsipër Vilajetin (drejtimin shpirtëror-fetar). Imam Rizai e pranoi propozimin me kusht, që aty të ishte vetëm i pranishëm e të mos kishte përgjegjësi

për asgjë dhe të mos ndërhynte në asnjë punë. Edhe Me'muni e pranoi kushtin.

Me'muni i mori besën popullit për këtë punë. Kështu, shpërndau nëpër qytete letra dhe fermane që të shtypnin monedha me emrin e imam Rizait dhe nëpër xhami e faltore të këndonin me emrin e imam Rizait.

Erdhi dita e festës së Bajramit të Kurbanit. Me'muni i dërgoi letër duke i kërkuar imamit që në këtë ditë feste ai ta drejtonte faljen për popullin, me qëllim që njerëzit të fitonin më shumë siguri në këtë punë. Imami i ktheu mesazh: "Marrëveshja jonë ishte që unë të mos ndërhyj në asnjë punë zyrtare, prandaj dhe për këtë të kërkoj ndjesë." Me'muni iu përgjigj: "E mira e kësaj pune është që ju të shkoni atje dhe çështja e Vilajetit të bëhet plotësisht e qartë." Ai këmbënguli kaq shumë sa në fund imami tha: Është më mirë të më hiqni nga kjo gjë, por nëse duhet patjetër që të shkoj, atëherë do ta drejtoj lutjen siç e ka drejtuar i Dërguari i Zotit dhe Ali ibn Ebu Talibi." "E ke vetë në dorë, vepro si të duash," – ia ktheu Me'muni.

Mëngjesin e ditës së festës, të gjithë njerëzit, nga shtresa të ndryshme - klasat e larta, komandantët e ushtrisë, shtresat e thjeshta me rrobat e tyre më të mira e të pastruar, ishin mbledhur të gjithë përpara derës së shtëpisë së imamit, për të falur Bajramin. Njerëz të tjerë ishin mbledhur nëpër lagje e rrugica që të kryenin faljen e të shikonin prijësin e Vilajetit. Shumë gra dhe burra kishin hipur nëpër tarracat e shtëpive duke pritur të shikonin nga afër madhështinë dhe shfaqjen e Imam Rizait. Të gjithë prisnin me padurim se kur do hapej dera e të dilte që andej imami i tyre i adhuruar.

Nga ana tjetër, imam Rizai, ashtu siç i kishte thënë dhe më përpara fjalën Me'munit, do të merrte pjesë në ceremoni me kusht që atë ta zhvillonte ashtu siç e kishin zhvilluar i Dërguari i Zotit, Muhamedi dhe Ali Murtezai, e jo ashtu siç kishin vepruar kalifët e mëvonshëm. Në mëngjes u pastrua, veshi rrobat e bardha të asaj dite, hodhi mbulesën e bardhë mbi kokë, e cila i varej deri tek te dy supet, zbathi këmbët, ngriti fundin e rrobës e u tha njerëzve të tij, që edhe ata te vepronin ashtu si ai. Mori ndër duar një bastun që kishte kokë hekuri e pastaj, i shoqëruar nga njerëzit e shtëpisë, doli jashtë dhe sipas traditës islame për atë ditë, thirri më zë të lartë: *All-llahu Ekber, All-llahu Ekber !*

Edhe njerëzit e shoqëruan të gjithë njëzëri plot entuziazëm, me të njëjtën thirrje. Zëri dëgjohej deri në qiell, a thua mes tokës dhe qiellit ishte ngritur një mur. Pastaj, për një çast ndaloi përpara derës së shtëpisë dhe me një zë të lartë thirri: *Allahu ekber, Allahu ekber, Allahu ekber, ala ma Hadana. Allahu ekber ala ma rezekena min behimeti'l en'ami ue'l hamdul-ilahi ala ma eblena.*

Të gjithë njerëzit u bashkuan njëzëri duke shqiptuar. U mallëngjyen aq shumë, sa të gjithëve filluan të derdhin lot nga emocioni . Truprojat ushtarake dhe komandantët e tjerë të lartë të ushtrisë të pranishëm, veshur me uniformat e tyre, mbathur me çizme e hipur mbi kuaj, kujtonin se edhe imami do të dilte jashtë i veshur me rroba zyrtare, tërë salltanet dhe i hipur mbi kalë. Sapo e panë imamin të veshur në atë mënyrë të thjeshtë e dinjitoze, duke ecur më këmbë e duke përmendur Zotin, u emocionuan aq shumë prej Tij, sa filluan të lotonin e të thërrisnin me zë të lartë edhe ata fjalitë që

thoshte Ai. Ata zbritën nga kuajt, hoqën çizmet e filluan të ndiqnin Atë. Të gjithë nxituan që t'i hiqnin çizmet sa më shpejt sa i prenë me thikë që të mos vonoheshin.

Nuk zgjati shumë dhe qyteti i Marurit u mbush plot me njerëz që këndonin, qanin, entuziazmoheshin, binin në sexhde, ngrinin duart lart nga qielli e luteshin. Pas çdo dhjetë hapash që bënte, imam Rizai ndalonte dhe katër herë falënderonte Zotin. Edhe njerëzit bënin të njëjtën gjë si ai. Madhështia dhe Plotfuqia e së Vërtetës kaq shumë i kishte bërë njerëzit për vete, saqë e humbën fare fillin e ceremonisë materiale, që ishin mësuar ta zhvillonin deri tani. Tani, e entuziazmuar e tërë turma lëvizte drejt vendit ku do kryhej ceremonia e faljes.

Ndërkohë i vjen lajmi Me'munit. Këshilltarët dhe oborrtarët i thanë që nëse edhe për disa minuta të tjerë do të vazhdonte kjo gjendje dhe Ali ibn Musai do të futej në vendin ku do kryhej falja, ishte rreziku i një revolucioni. Me'muni u drodh. Mënjëherë, dërgoi lajmëtarët drejt imamit për t'i thënë që të kthehej sepse kishte mundësi që të përfshihej nga turma e të pësonte ndonjë dëmtim. Imami kërkoi këpucët dhe rrobën e vet, i veshi, shkoi te Me'muni dhe i tha: "Unë të thashë qysh në fillim që mua mos më përfshi në këtë punë."[1]

1) Biharul Anuar; vëll. 12, f. 39. (imam Rizai).

DËGJIMI I LUTJES SË NËNËS

Atë natë, veshi po i kapte vetëm lutjet e së ëmës, e cila ishte ulur në një cep të dhomës duke u lutur. Ai po shikonte të ëmën se si ulej e përkulej duke u lutur dhe falur në atë natë të xhumaje. Megjithëse ishte i vogël, diçka i tërhiqte vëmendjen nga këto lutje. E ëma po lutej për të mirën dhe lumturinë e kaq shumë burrave dhe të grave myslimane, duke i përmenduar emrat e tyre një nga një. Po për veten e saj përse nuk po i kërkonte gjë Zotit?

Atë natë, imam Hasani nuk mbylli sy deri të nesërmen në mëngjes; Ndiqte punën e së ëmës, Fatimesë(a.s) (Sidikatu, Merdie) dhe priste me padurim që e ëma të kërkonte diçka për vete, apo jo? Dhe, çfarë do t'i kërkonte ajo Zotit për vete?

Nata mbaroi. Dita u gdhi. Lutja mbaroi. Imam Hasani nuk dëgjoi qoftë dhe një fjalë të vetme nga e ëma që t'ia kërkonte Zotit për vete. Në mëngjes ai i thotë së ëmës: "Oj nënë, përse nuk e the qoftë dhe një lutje të vetme për veten e u lute vetëm për të tjerët?"

Nëna e tij dashamirëse iu përgjigj: Biri im, në fillim fqinjët, pastaj shtëpia jote."[1]

---

1) *Biharul Anuar; vëll. 10, f. 25.*

NË PRANI TË GJYKATËSIT

Një njeri i kishte paraqitur ankesën e tij kundër dikujt tjetri kalifit të asaj kohe, Omer bin Hatabit. Tani, të dyja palët duhej të paraqiteshin përballë gjykatësit për të zgjidhur çështjen. Personi, ndaj të cilit ishte bërë ankesa, ishte Emirul Mumenini, Ali ibn Ebi Talib. Omeri i thirri të dyja palët dhe vetë u vu në vendin e gjykatësit. Sipas udhëzimeve të Islamit, të dyja palët në gjykim duhet të rrinë përkrah njëri-tjetrit, me qëllim që ata të jenë të "barabartë përballë gjyqit." Kalifi thirri me emër palën akuzuese dhe i tha që të qëndronte përballë gjykatësit në një vend të caktuar. Pastaj u kthye nga Aliu dhe i tha: "O Ebu Hasan! Qëndro përballë akuzuesit tënd!" Kur dëgjoi këto fjalë, Aliu u mërzit dhe ndrydhi fytyrën. Kalifi e pyeti: "O Ali, nuk dëshiron të qëndrosh përkrah palës që të ka akuzuar?"

"Unë nuk u mërzita përse duhet të rri përkrah akuzuesit tim, - u përgjigj Aliu, - përkundrazi, mërzitja ime erdhi nga kjo që ti nuk e vendose drejtësinë plotësisht. Mua ma thirre emrin me respekt, duke m'u drejtuar me emrin "O Ebu Hasan" (O babai i Hasanit), kurse palën tjetër e thirre me atë emrin e tij të zakonshëm. Ky është dhe shkaku i mërzitjes sime."[1]

---

1) Imam Aliu zëri i drejtësisë njerëzore; f. 49 dhe Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadijd; vëll. 4, f. 185 botuar në Beirut

NË TOKËN E MINA-SË

Njerëzit që kishin vajtur në Haxh, ishin mbledhur në vendin e quajtur Mina. Imam Sadiku (a.s) dhe një grup shokësh ishin ulur në një vend për t'u çlodhur dhe po hanin atë pak rrush që kishin marrë me vete. Një endacak kaloi pranë dhe u kërkoi ndihmë. Imami mori një vesh rrush dhe ia drejtoi atij. Endacaku nuk pranoi "Më jepni para – tha ai. Mirë është, por para s'kam, - iu përgjigj Imami. Endacaku u largua i zhgënjyer.

Pasi eci disa hapa, u pendua. U kthye dhe tha: "Mirë pra, më jepni atë rrushin." Imami i tha: "Jo, dhe nuk i dha gjë.

Nuk kaloi shumë kohe dhe erdhi një endacak tjetër. Edhe ai deshte ndihmë. Imami këputi një vile rrush edhe për atë dhe ia dha. Endacaku e mori rrushin dhe tha: i falem Zotit të botëve që më dha ditën e sotme." Sa dëgjoi këtë Imami, e ndali e thirri të vinte sërish, i mbushi të dy grushtat plot me rrush dhe ia dha. Endacaku për herë të dytë falënderoi Zotin.

Imami i thirri: "Prit, mos ik! "Pastaj, u kthye nga dikush që ishte aty pranë dhe i tha: "Sa para ke me vete?" Ai kërkoi dhe gjeti afro 20 derham. Me urdhër të Imamit ia dha paratë endacakut. Endacaku sërish, për herë të tretë falënderoi Zotin: "Falënderimi i takon vetëm Zotit, o Zot; Ti je Zoti im dhe ti nuk ke shok e as ortak."

Kur dëgjoi këtë fjalë nga goja e tij, imami hoqi rrobën e trupit dhe ia fali endacakut. Kësaj radhe endacaku e ndryshoi të folurën e tij; ai nuk falëndëroi Zotin, por vetëm imamin, e imami nuk i dha më gjë, dhe endacaku u largua. Shokët dhe miqtë e imamit, që ishin ulur pranë tij thanë: Ne e kuptuam kështu: Po të vazhdonte endacaku të falënderonte Zotin, sërish imami do ta ndihmonte atë; por, meqë ai e ndryshoi fjalën e tij - falënderoi imamin e jo Zotin, imami nuk e ndihmoi më."[1]

Shoqata Flladi

27) Biharul Anuar; vëll. 11, f. 116. (imam Sadik).

PESHËNGRITËSIT

Të rinjtë myslimanë po përgatiteshin për garat e peshëngritjes. Ata ngrihnin gurë të mëdhenj për të matur kështu forcën e tyre. Në këtë çast erdhi Profeti.

-Çfarë po bëni?,- i pyeti.

-Po stërvitemi,- i thanë ata. Duam të shikojmë se kush është më i forti nga ne.

-A keni dëshirë t'ju them se kush është më i forti nga ju? - i pyeti Profeti.

-Me gjithë qejf; e ku ka më mirë që Profeti i Zotit të bëhet gjyqtari i garës sonë,-thanë ata.

Atëherë të gjithë u mblodhën duke pritur me padurim se cilin do të shpallte Profeti si fitues të garës. Kishte disa njerëz që mendonin, që ja tani Profeti i Zotit, do t'i afrohet, do të kapë dorën e atij dhe do ta shpallë atë më të fortin.

Më në fund, Profeti tha: "Më i forti është ai i cili, kur i pëlqen diçka dhe ajo e tërheq drejt vetes të mos arrijë ta largojë nga e Vërteta dhe qënia njeri, të mos e ndotë vetenme veprat e këqija; nëse ai do të nevrikoset, nëse vala e zemërimit i mbulon shpirtin, të ruajë kontrollin e vetvetes; të mos thotë asgjë tjetër përveç së Vërtetës, të mos thotë asnjë gënjeshtër,

asnjë sharje e asnjë mallkim. Dhe nëse do të zotërojë forcën e t'i heqë pengesat që i dalin përpara, të mos e teprojë duke zgjatur duart përtej asaj së drejte që i takon.[1]

Shoqata Flladi

1) El Uesail; vëll. 2, f. 469

MYSLIMANI I RI

Dy fqinj, njëri mysliman e tjetri i një besimi tjetër, po flisnin me njëri-tjetrin për Islamin. Myslimani i cili ishte një besimtar i denjë, po fliste aq bukur për Islamin, saqë fqinji i tij e pëlqeu aq shumë dhe si përfundim, pranoi fenë islame.

Ra nata. Ishte koha e syfyrit dhe fqinji i ri që sapo ishte bërë mysliman, pa që dikush trokiti në derën e shtëpisë së tij. I shqetësuar, pyeti: Kush është?

Nga ana tjetër e derës u dëgjua një zë, i cili tha se kush ishte. Ishte fqinji i tij mysliman.

–Ç'kërkon në këtë kohë nate?, – e pyeti fqinjin.

-Shpejt merr avdes, vish rrobat se do të shkojmë na xhami të falim namazin,- iu përgjigj fqinji mysliman.

Ai që sapo ishte kthyer në mysliman, mori avdes, për herë të parë në jetën e tij dhe së bashku me shokun e tij mysliman shkuan në xhami. Nuk kishte mbetur shumë dhe do të lindte dielli. Ishte fundi i natës. Ata falën namaz deri në agim të ditës e kështu, erdhi koha e faljes së namazit të mëngjesit. Duke falur edhe mëngjesin, jashtë zbardhi dita plotësisht. Ai që sapo ishte bërë mysliman, u bë gati që të nisej për në shtëpi, kur shoku i thotë: -Ku po shkon?

-Po kthehem në shtëpi, edhe namazin e mëngjesit e falëm, tani s'kemi më punë.

-Vazhdoje dhe pak namazin derisa dielli të lindë plotësisht, - iu përgjigj fqinji mysliman.

-Shumë mirë, tha myslimani i ri. Dhe u falën derisa dielli shkëlqeu i plotë. U ngritën që të iknin. Shoku i tij mysliman i dha një Kur'an në dorë dhe i tha: "Lexo tani për tani Kur'anin derisa dielli të ngrihet lart në qiell; të këshilloj që sot edhe të agjërosh; ti nuk e di sa i mirë është agjërimi dhe sa sevape sjell."

Pak nga pak u bë drekë dhe ai i thotë sërish fqinjit: "Prit se nuk ka mbetur dhe shumë e erdhi dreka, ta falim edhe namazin e drekës." Pasi falën edhe namazin e drekës, ai i thotë sërish fqinjit të tij që sapo ishte bërë mysliman: "Prit edhe pak e do falim namazin e pasdites!" E falën dhe namazin e pasdites, po sërish ai e ndali shokun për namazin e mbrëmjes. Myslimani i ri fali edhe namazin e mbrëmjes e pastaj u nis që të hante iftarin. Edhe këtë herë atë e ndali fqinji dhe i tha: "Prit edhe një orë e bëhet namazi i natës, ta falim edhe atë e pastaj të shkojmë." E falën dhe atë e pastaj myslimani i ri u largua.

Natën e dytë fqinji i tij mysliman trokiti sërish në derë dhe i tha të bëhej gati shpejt të shkonin së bashku në xhami.

Fqinji i tij, që sapo ishte bërë mysliman iu përgjigj: "Unë që mbrëmë kur u ktheva nga xhamia, hoqa dorë nga kjo fe. Shko e gjej një njeri tjetër më të papunë se unë e ta kalosh kohën në xhami me të. Unë jam njeri i varfër e më duhet të punoj që të nxjerr bukën e gojës.

Imam Sadiku, pasi ua tregoi shokëve të tij këtë tregim, tha: "Kështu, pra dhe ai besimtari i rreptë e fanatik, atë të shkretë të cilin vetë e kishte futur në Islam, vetë e nxori që andej.

Prandaj edhe ju ta keni përherë parasysh. Asnjëherë mos u tregoni të ashpër dhe të rreptë me njerëzit; kini parasysh aftësitë dhe mundësitë e tyre! Sa keni mundësi, bëni punë që njerëzit të priren vetë më dëshirë drejt fesë. A nuk e dini që edhe politika e umevijëve është ashpërsia e forca. Por rruga dhe metoda jonë mbështetet në butësi e ngrohtësi, në mirësinë dhe afrimin e zemrave me njëra-tjetrën.[1]

Shoqata Flladi

1) *El Uesail; vëll. 2, f. 494, hadithi 3 dhe 9.*

SOFRA E KALIFIT

Sherijk ibn Abdullah Nakhi, një nga klerikët e njohur të shekullit të dytë (Hixhri) ishte shumë i njohur për dituritë e tij. Mehdi ibn Mensuri, kalifi Abasit, kishte shumë dëshirë që ta emërontë atë g jykatës; mirëpo Sherijk ibn Abdullahu, i cili kërkonte ta mbante veten larg nga aparati i shtypjes dhe i dhunës, nuk e pranonte këtë gjë. Pastaj kalifi mendoi që ta bënte atë mësuesin privat të fëmijëve të tij, që t'u mësonte atyre shkencat fetare. Sherijku nuk e pranonte as këtë punë dhe vazhdonte atë jetën e tij të lirë e të thjeshtë. Një ditë, e thirri Kalifi dhe i tha: "Sot duhet të pranosh njërën prej këtyre tri punëve: ose të marrësh gjykatën në dorë, ose të mësosh fëmijët e mi, ose sot të jesh mik i sofrës sonë e të ulesh së bashku me ne në sofër."

Sherijku mendoi me vete dhe tha: "Tashi, meqë qenka me detyrim, nga këto tri punët, kjo e treta për mua është më e lehtë."

Kalifi i dha urdhër kryekuzhinierit që atë ditë të gatuante gjellët më të shijshme për Sherijkun. U përgatitën gjellë të ndryshme e plot erëza e u shtruan në sofër.

Sherijku, i cili deri atëherë as nuk ishte parë e as nuk kishte ngrënë kësisoj gjellërash, hëngri gjithë oreks. Në këtë kohë,

veziri iu afrua kalifit dhe i thotë ngadalë në vesh: "Për Zotin, ky rob doli prej rrugës së vet tashmë."
Nuk kaloi shumë dhe u pa që Sherijku u bë edhe mësuesi privat i fëmijëve të kalifit, por edhe gjykatës, duke marrë edhe një rrogë nga shteti.
Një ditë, kur po merrte rrogën e tij, ai bëri fjalë me arkëtarin. Arkëtari thotë: "Ti nuk ke shitur neve grurë që po na dërdëllit kaq shumë." Sherijku iu kthye: "Unë ju kam shitur diçka më të mirë së gruri; ju kam shitur fenë time."[1]

Shoqata Flladi

1) Muruxhu Dheheb i Mes'udit; vëll. 2 gjendja e Mehdi abasitit.

ANKESA E FQINJIT

Një njeri erdhi te Profeti e u ankua për fqinjin e tij se nuk e linte atë të qetë.

Profeti i tha: "Duro mos bëj zhurmë për fqinjin tënd, por ndrysho sjelljen tënde!"

Pas pak kohe, ai vjen prapë te Profeti e i ankohet. Edhe kësaj radhe Profeti i thotë: "Duro!"

Erdhi për herë të tretë dhe i tha: "O i Dërguari i Zotit, fqinji im nuk ndryshon që nuk po ndryshon, e më shqetëson mua, por edhe familjen time."

Kësaj radhe Profeti i tha: "Kur të vijë dita e xhuma, merri të gjitha plaçkat e shtëpisë që ke, nxirri në rrugë, ku mund t'i shikojnë njerëzit. Ata do të të pyesin ty se përse po i nxjerr rrobat nga shtëpia.? Ti thuaju, se i nxjerr për shkak të këtij fqinji të keq dhe ua thuaj njerëzve të gjitha ankesat që ke.

Ankimtari shkoi dhe bëri këtë punë. Fqinji i tij, i cili kujtonte se Profeti i kishte thënë tjetrit që të bënte durim përherë, nuk e dinte që për të larguar shtypjen dhe për të mbrojtur të drejtën, Islami nuk ka ndrojtje e respekt për agresorin. Sapo e mori vesh se si qëndronte puna, shpejtoi duke u lutur dhe kërkuar falje, që fqinji të mblidhte plaçkat e të kthehej prapë në shtëpi. Ai dha fjalën aty që nuk do ta shqetësonte më fqinjin e tij.[1]

---

1) Usulul Kafij; vëll. 2, kreu "të drejtat e fqinjut", f. 668.

PEMA E HURMËS

Semretu bin Xhendeb kishte një pemë hurme në kopshtin e një shoku të tij. Shtëpia e banimit të shokut të tij, i cili jetonte me gruan dhe fëmijët, ishte në hyrje të kopshtit. Semretu vinte nga nganjëherë në kopsht për të parë pemët, ose merrte ndonjë frutë nga hurma e tij. Sipas ligjit islam, ai kishte të drejtë të hynte dhe të dilte në shtëpi sa herë ishte e nevojshme dhe të përkujdesej për pemën e tij.

Sa herë që shkonte të shihte pemën e tij, Semretu shkonte dhe futej në shtëpi në mënyrë shumë të paedukuar dhe me zhurmë. I zoti i shtëpisë iu lut që kështu të mos hynte në shtëpi, por ai nuk pranoi. I detyruar, i zoti i shtëpisë shkoi dhe iu ankua Profetit: Ky njeri hyn në shtëpinë e time pa pyetur askënd. Të lutem i thuaj që të mos hyjë herë tjetër në shtëpinë time pa lajmëruar e trokitur.

Profeti e thërriti Semretun dhe i tha: "Filani ankohet për ty, thotë që ti futesh në shtëpinë e tij pa e njoftuar, e kur futesh shikon përreth e qark se çfarë ka shtëpia, e ai këtë gjë nuk e lejon. Prandaj, pas kësaj radhe kur të shkosh në shtëpinë e tij, merr leje përpara se të hysh." Semretu nuk pranoi. Atëherë Profeti i tha: "Mirë, në qoftë kështu, shite pemën. Semretu përsëri nuk pranoi. Profeti e rriti çmimin. Semretu sërish e kundërshtoi. Atëherë Profeti i tha: Nëse do të bësh këtë punë, në Xhennet për ty do të jetë një pemë shumë

herë më e mirë. Sërish Semretu nuk pranoi. Ai këmbëngulte keqas që pema ishte e tij dhe nuk do ta shiste dhe se në kopësht do futej sërish në të njëjtën mënyrë.

Atëherë, Profeti tha: "Ti je njeri i dëmshëm dhe i ashpër. Në fenë islame nuk ka vend për dëm dhe për ashpërsi."[1]

Pastaj u kthye nga i zoti i kopshtit dhe i tha: "Shko dhe shkule pemën e hurmës nga toka jote dhe hidhja Semretu's përpara këmbëve."

Ai shkoi dhe e bëri këtë punë. Pastaj Profeti i Zotit i tha Semretu's;- "Tani shko e mbille pemën ku të duash."[2]

Shoqata Flladi

1) Vërtet, ti je njeri i dëmshëm. Islami nuk e lejon as dëmin e as t'i bësh dëm dikujt.

2) El uesail; vëll. 3,kreu I shuf'ati (mosdëmtimi i myslimanit), f. 329, hadithet: 1, 3 dhe 4.

TE SHTËPIA E UM SELEMES

Atë natë Profeti i nderuar ishte te shtëpia e Umu Selemes. Kishte kaluar mesi i natës kur Umu- Selemes i del gjumi dhe vë re që Profeti nuk ishte në shtrat. U shqetësua se çfarë mund t'i kishte ndodhur. Xhelozia femërore e bëri atë që të ngrihej dhe të kërkonte Profetin. E gjeti Profetin ulur në një cep të errët të shtëpisë; kishte ngritur duart lart nga qielli dhe duke derdhur lot thoshte:

"O Zot, gjërat e mira që m'i ke dhënë, mos m'i merr! O Zot, mos më lër të bie pre e zilisë dhe e qëllimeve dashakëqija të armiqve! O Zot, mos më kthe drejt të këqijave, prej të cilave vetë Ti më shpëtove! O Zot, mos më lër vetëm qoftë edhe sa hap e mbyll syt!

Duke dëgjuar këto fjalë, Umu Selemes iu drodh i gjithë trupi. Shkoi, u ul në një cep dhe filloi të qante. Ajo qau me aq dënesë, saqë Profeti e vuri re dhe erdhi dhe e pyeti ; Përse po qan?

-Përse të mos qaj,-i tha Umu Selemeja, - kur ti me gjithë atë pozitë të madhe që ke pranë Zotit, e ke kaq shumë frikë Atë dhe i lutesh që, qoftë dhe për një çast sa të mbyllësh e hapësh sytë mos të të lërë vetëm, atëherë mjerë unë dhe ata si unë.

-Oj Umu Seleme, si mundem unë të mos jem i shqetësuar dhe ta kem mendjen e mbledhur. Profeti Junus, vetëm për një çast u la vetëm dhe ne e dimë të gjithë se ç'e gjeti.[1]

Shoqata Flladi

1) *Biharul Anuar; vëll. 6, kreu "mekarimul ahlakihi ue sejruhu ue sunuuhu."*

TREGU I ZI

Familja e imam Sadikut dhe shpenzimet e jetës së tij ishin shtuar shumë. Imami mendoi që të merrej me tregëti në mënyrë që të përballonte shpenzimet e shtëpisë. Mblodhi rreth një mijë dinarë dhe thirri shërbëtorin e tij, Musadefin, dhe i tha të merrte paratë e të shkonte në Egjipt e të bënte tregti.

Musadefi bleu disa mallra, të cilat zakonisht i transportonin për në Egjipt, dhe bashkë me një vargan tregtarësh, të cilët mbanin nga ky lloj malli, u nis drejt Egjiptit.

Kur u afruan pranë Egjiptit, ata hasën me një vargan tjetër tregtarësh, të cilët po dilnin nga Egjipti. U takuan dhe e pyetën njëri -tjetrin se si u shkonin punët. Aty mësuan se malli që Musadefi dhe shokët e tij kishin me vete kishte treg shumë të mirë në Egjipt, sepse ishte pakësuar, e që ishte mall pa të cilin njerëzit nuk mund të bënin dot; njerëzit ishin të gatshëm ta blinin atë me çfarëdolloj çmimi. Tregtarët e mallit u gëzuan shumë kur morën vesh këtë lajm dhe vendosën me njëri-tjetrin që të mos e shisnin mallin pa fitim të plotë.

U futën në Egjipt. Gjendja ishte ashtu siç u kishin thënë. Siç e patën vendosur më parë, ata hapën kështu tregun e zi duke e shitur mallin me dyfishin e çmimit që e kishin blerë.

Musadefi u kthye në Medine, më një fitim prej një mijë dinarësh të tjerë. Shumë i gëzuar vajti tek imam Sadiku dhe i la përpara

dy qese me nga një mijë dinarë secila. Imami e pyeti se çishin ato? Ai iu përgjigj: "Njëra nga këto qeset ka një mijë dinarët që ju më dhatë mua për tregti; tjetra e cila ka të njëjtën shumë, është fitimi nga shitja e mallit."

"Fitimi është shumë - i tha imami. Pa më trego si arritët t'i fitonin të gjitha këto para?

Musadefi filloi t'i tregonte imamit gjithë ngjarjen si kishte ndodhur.

"O Zot i Madh!, -tha imami pasi dëgjoi rrëfimin e Musadefit. Ju paskeni bërë këtë punë?! Jeni betuar që në mesin e myslimanëve të hapni tregun e zi?! Jeni betuar që të mos e shisni mallin pa pasur dyfish fitim?! Jo. Unë këtë lloj fitimi nuk e dua. Pastaj mori njërën nga të dyja qeset dhe tha: "Kjo është paraja ime, kurse me atë tjetrën nuk kam punë fare," - tha pa e prekur fare qesen tjetër.

Pastaj shtoi: "O Musadef, të qëllosh me shpatë është më e lehtë se fitimi hallall."[1]

1) *Biharul Anuar; vëll. 11, f. 121.*

I MBETURI I VARGANIT

Në terrin e natës, nga larg dëgjohej zëri i një të riu, që po qante dhe kërkonte ndihmë: "Oj nënë, oj nënë!" Deveja e tij e dobët kishte mbetur prapa varganit dhe më në fund, e lodhur dhe e rraskapitur, kishte rënë në gjumë. Bëri çmos që ta lëvizte devenë, por nuk mundi. I pashpresë, rrinte sipër kokës së devesë dhe qante.

Në këtë kohë Profeti i nderuar, i cili lëvizte përherë i fundit i varganit me qëllim që, nëse dikush ishte i dobët dhe ndahej nga vargani, ta ndihmonte e të mos e linte vetëm, dëgjon nga larg zërin e djaloshit që po qante. Iu afrua dhe e pyeti se kush ishte.

-Jam unë Xhabiri, - iu përgjigj djaloshi.

-Çfarë ke kështu?, - e pyeti Profeti.

- O i Dërguari i Zotit, më ka mbetur deveja në rrugë e po vuaj tani.

- A ke ndonjë shkop me vete?

-Po.

-Ma jep mua!

Profeti mori shkopin dhe me ndihmën e tij e ngriti devenë nga vendi pastaj, bashkoi duart dhe i tha Xhabirit: "Hip!"

Xhabiri hipi dhe të dy bashkë morën rrugën. Tani deveja e Xhabirit ecte më shpejt e ishte gjithmonë e para. Përgjatë rrugës Profeti sillej me shumë ngrohtësi dhe dashamirësi me Xhabirin. Xhabiri numëroi me vete dhe i doli se Profeti i kishte kërkuar ndjesë deri atëherë njëzet e pesë herë.

Në mes të rrugës e pyeti Xhabarin: Sa fëmijë kanë mbetur nga yt atë, Abdullahu?

-Shtatë vajza dhe një djalë; djali jam unë, - iu përgjigj Xhabiri.

-Po ndonjë borxh i ka mbetur babait tënd?

-Po.

-Kur të kthehesh në Medine, lër një takim me ata, të cilëve u ke borxh dhe kur të vijë koha e hurmave, më thuaj mua!

-Shumë mirë.

-Je i martuar?

-Po.

-Me kë je martuar?

-Me filan grua, vajza e filanit, ka qënë një nga vejushat e Medines.

-Përse nuk more një vajzë të re, që të ishte ishte si ti?

-O, i Dërguari i Zotit, unë kam disa motra të reja dhe janë të paditura e pa përvojë. Nuk doja të merrja një grua të re dhe të papjekur, e pashë më të arsyeshme të zgjidhja një njeri të pjekur.

-Ke bërë punë shumë të mirë. Sa e ke blerë këtë devenë?

-Pesë monedha ari.

-Me këtë çmim do të jetë e jona. Kur të vish në Medine, eja dhe merr paratë!

Udhëtim mbaroi. Mbërrtitën në Medine. Xhabiri erdhi që të dorëzonte devenë. Profeti i nderuar i tha Bilalit: "Jepi

pesë monedha ari Xhabirit për devenë; jepi dhe tri monedha të tjera për borxhet e të atit dhe deveja të jetë e vetja!"
Pastaj e pyeti Xhabirin: "A ke mbyllur marrëveshjen me ata që u ke borxh?
-Jo, o i Dërguari i Zotit.
-Çfarë të ka lënë babai, të del për të larë borxhet?
-Jo, o i Dërguari i Zotit.
-Atëherë, kur të vijë koha e hurmave më thuaj.
Erdhi edhe koha e pjekjes së hurmave dhe Xhabiri e njoftoi Profetin. Profeti erdhi, lau borxhin që kishte Xhabiri, i la diçka edhe familjes së tij.[1]

Shoqata Flladi

1) *Biharul Anuar; vëll. 6, kreu "mekarimul ahlakihi ue sejruhu ue sunnuhu."*

LIDHËSJA E KËPUCËS

Imam Sadiku (a.s) me disa shokë të tij po shkonte për ngushëllime te shtëpia e njërit prej fisit të tij. Gjatë rrugës imamit iu këput lidhësja e këpucës, në atë mënyrë sa nuk mund ta përdorte më. Imami i mori këpucët në duar dhe u nis këmbëzbathur.

Ibni Ebi Ja'furi, njëri prej shokëve të mëdhenj të imamit, hoqi këpucët e veta menjëherë nga këmbët. Hoqi lidhëset e këpucëve dhe ia zgjati imamit: Imami të mos ecte më zbathur por të lidhte këpucën, ndërsa ai vetë ta bënte rrugën i zbathur.

Me një shprehje të vranët në fytyrë, imami u kthye nga Abdullah Ja'furi dhe nuk ia pranoi aspak lidhëset. "Kur dikujt i bie një vështirësi, vetë ai është i pari që e duron më shumë se gjithë të tjerët. Nuk ka kuptim që dikujt t'i ndodhë diçka dhe vuajtjen ta durojë një tjetër."[1]

1) Biharul Anuar; vëll.11, f. 117.

36

HISHAMI DHE FERAZDAKU

Hisham ibn Abdulmelik kishte postin e drejtuesit të Vilajetit. Ishin vitet e para të shekullit të dytë (Hixhri), kur pushteti i Umovijëve kishte arritur kulmin e tij. Sado që u rretullua rreth Qabes, nuk ia arriti dot të shkonte ta prekte vetë me dorë "Haxhru'l es'ued" (Gurin e Zi). Të gjithë njerëzit kishin veshur një rrobë të thjeshtë, e cila ishte rrobja e Haxhit. Të gjithë kishin në gojë vetëm fjalën e Zotit. Të gjithë kryenin njëkohësisht të njëjtin veprim. Të gjithë, të zhytur thellë në lutjet dhe ndjenjat e tyre të pastra të adhurimit të Zotit, nuk e kishin mendjen të mendonin se kush ishte Hishami, se cila ishte pozita e tij shoqërore a personaliteti i tij materialist. Njerëzit të cilët ai i kishte sjellë me vete që nga Siria, për të ruajtur pozitën dhe figurën e tij, përballë asaj turme aq të madhe, lëvizte si vorbull e madhe përreth Qabes, nuk mund të bënin asgjë. Sado që u mundua të arrinte te "Haxhru'l es'uedi" dhe sipas traditës së Haxhit ta prekte atë, Hishami prapë nuk ia arriti ta prekte atë për shkak të turmës së madhe të njerëzve. Kështu, i detyruar, u kthye dhe i shtruan për t'u ulur në një vend të ngritur. Që nga aty lart, ai rrinte e vështronte turmën e madhe të njerëzve. Sirianët që ai i kishte sjellë me vete, e rrethuan duke i ndenjur pranë. Edhe ata, si ai po vështronin turmën.

Në këtë mes u shfaq një burrë me fytyrë shumë të pastër e qiellore. Edhe ai, si të gjithë të tjerët ishte veshur më një rrobë të thjeshtë. Në fytyrën e tij shiheshin qartë shenjat e besimit dhe të përkushtimit ndaj Zotit. Në fillim shkoi dhe i erdhi rreth e qark Qabes; pastaj, shumë i qetë dhe me hapa të sigurt, shkoi drejt Gurit të Zi ("haxhrul es'ued"). Turma e njerëzve, megjithëse ishte e humbur në atë shtjellën e saj, sapo e panë këtë njeri t'i afrohej Gurit të Zi, i hapën menjëherë rrugë. Ai iu afrua qetësisht Gurit të Zi. Sirianët që kishin ardhur së bashku me Kalifin, i cili me tërë atë pozitë që kishte nuk arriti të çante dot drejt Gurit të Zi, kur panë burrin që iu afrua aq qetësisht Gurit, i shqyen sytë nga habia. Njëri prej tyre pyeti e vete Hishamin se kush ishte ai njeri. Hishami, i cili e dinte shumë mirë që ai ishte Ali ibn Husejn, Zeinul Abedini, bëri sikur nuk e njihte. "Nuk e njoh," tha

Në këtë mes, kush mund të guxonte të fliste prej frikës së Hishamit, nga shpata e të cilit rridhte vetëm gjak, e të thoshte se kush ishte ai njeri?! Por, mu në këtë kohë, Hamam ibn Golebi, i njohur si Farazdaku, poet dhe shkrimtar arab, i cili kishte për detyrë që me artin dhe aftësitë e tij të bënte propagandën dhe të ruante pozitat e Hishamit, u ngrit dhe tha: "Unë e njoh atë" dhe nuk i bëri një paraqitje të thjeshtë imamit, por hipi në një vend të ngritur dhe filloi të recitonte një "kaside" (poezi lirike), e cila është një nga kryeveprat e letërsisë arabe dhe mund të krijohet nga poeti vetëm në rastet e një frymëzimi shumë të fuqishëm. Duke folur për madhështinë e atij njeriu, ai thotë: "Ky është njeriu, të cilin e njohin dhe guralecët më të vegjël të Tokës, kjo

Qabe e njeh Atë, Atë e njeh toka e xhamisë dhe toka jashtë saj." Ky është djali i njerëzve më të mirë të Zotit, ky është ai i devotshmi, i pastri dhe besimtari i famshëm.

Ti që thua se nuk e njeh atë (Zejnul Abidinin), nuk i ke bërë asnjë dëm atij. Nëse ti bën sikur nuk e njeh, edhe po ta njohësh, do të thuash është arab ose i huaj.

Me të dëgjuar këtë poezi kaq realiste dhe plot ndjenjë e logjikë, Hishami mori flakë nga inati dhe dha urdhër që Farzdakut t'i prisnin rrogën dhe ta burgosin përgjatë rrugës Mekë - Medine. Farzdaku nuk u dha rëndësi fare ngjarjeve që rrodhën për të; ato ishin rezultati i trimërisë së shprehjes dhe i besimit të tij. Nuk iu bë vonë as për prerjen e rrogës e as se do të burgosej. Edhe kur u burgos, nuk pushoi së recituari poezi ku kritikonte ashpër Heshamin.

Ali ibn Husejni (a.s) i dërgoi një shumë parash Farzdakut, i cili tashmë ishte në burg dhe të ardhurat i ishin prerë. Farzdaku i refuzoi ato dhe tha: "Unë atë poezi e thashë për hir të besimit tim që kam në Zotin, dhe nuk dua të marr asnjë para për atë që thashë." Ali ibn Husejni i dërgoi për herë të dytë paratë Farzdakut bashkë me një mesazh që thoshte: "Zoti e njeh shumë mirë qëllimin dhe dëshirën tënde dhe po të shpërblen ty për atë qëllimin dhe dëshirën tënde të mirë. Nëse ti e pranon këtë shpërblim, sërish nuk i sjell asnjë dëm shpërblimit që të jep Zoti" Farzdaku e pranoi ndihmën.[1]

1) *Biharul Anuar; vëll. 11, f. 36.*

BIZANTI

Ahmed ibn Muhamed ibn Ebi Nasr Bizanti, qe një nga klerikët dhe dijetarët më të mëdhenj të kohës së tij. Më në fund, pas shumë paqartësish, debatesh e diskutimesh që pati me imam Rizain (a.s) dhe pyetjesh që pati e përgjigjesh që mori, u bind për imammatin e imam Rizait. Një ditë i tha imamit: "Unë kam dëshirë që kur të mos ketë asnjë pengesë dhe hyrjet e daljet e mia nga ana e aparatit shtetëror të mos sjellin asnjë problem, do të vij vetë në shtëpinë tuaj dhe do të përfitoj nga prania juaj"

Një ditë të vonë, imam Rizai kishte dërguar një shërbyesin e tij për të thirrur Bizantin që të vinte tek ai. E kaluan mesin e natës duke shkëmbyer pyetje e përgjigje shkencore. Bizanti pyeste problemet e veta dhe imami i kthente përgjigje. Bizanti ishte shumë i gëzuar dhe i kënaqur.

Erdhi koha për gjumë. Imami thirri shërbyesin dhe i tha: "Më sillni shtratin tim dhe shtrojani Bizantit që të flerë. Kjo shprehje mirësie ndikoi shumë Bizanti. Nisi të mendonte me vete; me zemër thoshte; tani, njeri më të lumtur se unë në botë nuk ka; jam unë ai, të cilin imami e thirri në shtëpinë e tij si mik; jam unë ai me të cilin imami ndenji deri në mesnatës duke iu përgjigjur pyetjeve të mia; e, më në fund,

jam unë ai për të cilin imami dha urdhër që të lironin shtratin e tij e të të ma përgatisnin mua për të fjetur; pra cili njeri në botë është më i lumtur dhe më me fat se unë?!

Bizanti kishte humbur në këto mendime dhe të tërë botën e shikonte nën këmbët e tij. Në këtë kohë imam Rizai (a.s), i cili kishte vënë pëllmëbët e tij mbi dysheme për t'u bërë gati që të ngrihej e të ikte thirri "O Ahmed", duke e ulur Bizantin nga bota e fantazisë me këmbë në tokë. Pastaj i tha: "Kurrë mos e mburr mos e lavdëro veten përpara të tjerëve me ato që pe dhe dëgjove sonte. Kështu, njëherë edhe Ali ibn Ebu Talibi shkoi te shoku i tij, Seseteh ibn Suhan, i cili ishte shumë i sëmurë. I qëndroi atij shumë pranë, e ndihmoi, ,i vuri duart e tij mbi ballë, e shëroi Sesetenë; kur po ikte, i tha: Këto punë mos i ki asnjëherë si mburrje e lavdërim. Këto nuk janë gjëra që të bëjnë ty të jesh dikush. Unë i bëra të gjitha këto për të kryer detyrën që më përket mua dhe asnjëherë askush nuk duhet të kujtojë se kësi lloj punësh bëhen për arsye se kush është më i miri."[1]

1) *Biharul Anuar; vëll. 12, f. 14*

AKILI, MIKU I ALIUT

Akili, në kohën e Kalifatit të vëllait të tij, Emiru'l Mu'mininit, Aliut (a.s), shkoi i ftuar si mik në shtëpinë e imamit në qytetin e Kufës. Aliu i tha të birit, Hasanit që t'i dhuronte një rrobë të bukur xhaxhait të tij. Imam Hasani mori një këmishë dhe një rrobë nga ato të vetat dhe ia dhuroi xhaxhait të vet, Akilit.U bë natë dhe ishte shumë vapë. Aliu dhe i vëllai Akili kishin hipur në tarracën e shtëpisë dhe po bisedonin. Erdhi koha e darkës. Akili mik në shtëpinë e Kalifit, priste që sofra të ishte e shtruar me shumë gjellëra. Por ndryshe nga ç'priste ai, sofra ishte shtruar shumë thjeshtë. Shumë i habitur, pyeti:
-Kjo është e gjithë darka?
-Po pse, ky nuk është bekimi i Zotit? Unë e falënderoj shumë Zotin për këto bekime e mirësi, - tha Aliu.
-Atëherë, më duhet ta them sa më shpejt hallin tim e të ikë që këtej. Unë jam në borxhe, jep urdhër sa më shpejt t'i laj borxhet dhe ndihmoje vëllanë tënd me sa të duash.
-Sa borxhe ke?- i thotë Aliu.
-100.000 dërhem.
-100.000 dërhem! Sa shumë! Më vjen keq vëllai i dashur, - i thotë Aliu, por nuk kam kaq shumë sa të laj borxhet e tua. Prit deri kur të vijë dita e pagave që të jap pjesën time

ty. Po të mos kisha familje, të gjitha të ardhurat e mia do të t'i jepja ty.

-Çfarë? Të pres deri ditën kur jepen pagat? -iu përgjigj Akili. I tërë buxheti i shtetit dhe shpenzimet e vendit janë në dorën tënde e ti më thua që të pres deri ditën kur të jepen pagat e të më japësh nga pjesa jote. Ti ke në dorë të marrësh kur të duash dhe sa të duash. Përse më thua që të pres deri ditën e pagave? Pastaj, e gjithë rroga jote sa është? Po të më japësh rrogën tënde çfarë ndihmë më ke dhënë mua?

-Unë habitem nga propozimi yt, -iu përgjigj Aliu. Ka apo nuk ka para shteti ç'lidhje ka ajo me ne? Unë dhe ti jemi te dy njerëz si të gjithë myslimanët e tjerë. Po, është e vërtetë se ti je vëllai im dhe unë për aq sa e kam të mundur, më duhet të të ndihmoj; por nga ajo çka është e imja dhe jo nga arka e pasurisë së myslimanëve.

Biseda vazhdoi dhe Akili në mënyra të ndryshme këmbëngulte në kërkesën e vet: "Jep leje që nga arka e shtetit të më japin para aq sa më duhen a të ikë në punën time!

Aty ku ata ishin ulur, ishin shumë pranë me pazarin e Kufes. Aty dukeshin arkat dhe sëndukët me para të tregtarëve e të shitësve. Akili vazhdonte të këmbëngultë në kërkesën a tij. Aliu i kthehet dhe i thotë: "Në qoftë se vazhdon të këmbëngulësh ende e nuk e pranon fjalën time, po të jap një propozim. Po të veprosh ashtu, mund të marrësh aq para sa të nevojiten dhe të të teprojnë sërish.

-Çfarë duhet të bëj?, -e pyet Akili.

-Këtu poshtë janë arkat me para. Sa po të bjerë i tërë vendi në qetësi dhe të mos ketë asnjë njeri, zbrit poshtë, thyeji arkat dhe merr çfarë të gjesh brenda,- i thotë Aliu.

-Të kujt janë arkat?, - pyeti Akili.
-Janë të tregtarëve këtu, ata mbajnë aty kursimet dhe fitimet e veta, -iu përgjigj Aliu.
-Çudi! Ti po më propozon që të shkoj poshtë e të thyej arkat e njerëzve që i kanë lënë në duart të Zotit e t'u marr të gjitha paratë që i kanë mbledhur me mund e me djersë, e të iki?!
-Po ti atëherë, si më propozon mua që të marr para nga arka e shtetit të myslimanëve e të t'i jap ty? Përse, ato para kujt i përkasin? Edhe ato para u përkasin atyre njerëzve që me mendje të qetë po flenë në shtëpitë e tyre. Tani kam një propozim tjetër; po deshe, dëgjoje, - i thotë Aliu.
-Çfarë propozimi?, - e pyet Akili.
-Nëse je i gatshëm, ti merr shpatën tënde, unë të marr timen dhe të dalim te qyteti i vjetër i Hiresë, afër Kufës. Aty janë tregtarët e shumicës dhe pasanikë të mëdhenj. Natën dalim të dy, i presim rrugën ndonjërit prej tyre dhe i marrim të gjithë mallin dhe pasurinë që ka ai.
-Vëlla i dashur, –thotë Akili, unë nuk kam ardhur këtu për të vjedhur, që ti po më flet mua kështu. Unë po të them merr para për mua nga arka e shtetit dhe m'i jep e unë të shkoj në punën time.
-Po të vjedhim mallin e njërit prej atyre tregtarëve është shumë herë më mirë se të vjedhim pasurinë e qindra mijëra myslimanëve, pra mallin e të gjithë myslimanëve. Si u bëka që vjedhja e një njeriu me anë të shpatës qenka vjedhje, kurse vjedhja e pasurisë së popullit nuk u quajka vjedhje? Ti kujton se vjedhje është vetëm kur një njeri vjedh një njeri tjetër me dhunë? Forma më e keqe e vjedhjes është pikërisht kjo që ti më kërkon mua, - iu përgjigj Aliu.[1]

1) Biharul Anuar; vëll. 9, f. 613. Botuar në Tebriz

ËNDRRA E FRIKSHME

Ëndrra e zgjoi shumë të trembur nga gjumi. Sa herë që mbyllte sytë, atij i dilnin imazhet e frikshme që kishte parë. I shqetësuar, vajti tek imam Sadiku dhe i tha: "Kam parë një ëndërr sikur një fantazmë prej druri së bashku me një njeri prej druri, hipur mbi një kalë druri, mbante në dorë një shpatë dhe e vërtiste nëpër ajër. U tremba shumë dhe tani dua të më thoni kuptimin e saj."

Imami i tha: "Pa dyshim, është një njeri që ka një pasuri, të cilën ti kërkon t'ia rrëmbesh, me çdo kusht. Ki frikë Zotin që të ka krijuar dhe të vdes, prandaj hiq dorë nga vendimi që ke marrë."

-Me të vërtetë, ti je bota e së Vërtetës dhe e ke marrë dijen nga miniera e saj. Po të them se e kam pasur për qëllim një gjë të tillë. Një prej fqinjëve të mi ka një arë dhe meqë ka nevojë për para kërkon ta shesë, por deri më tani nuk ka klient tjetër përveç meje. Gjatë gjithë këtyre ditëve kam menduar se si t'ia marr arën duke i dhënë shumë pak para.[1]

---

1) El Uesail; vëll. 2, f. 582

TEK STREHA E BENI SA'AD

Ishte natë. Koha ishte e lagësht e plot me shi. Vetëm dhe pa njoftuar askënd, imam Sadiku kishte dalë nga shtëpia e tij duke shfrytëzuar natën dhe qetësinë e rrugicave dhe po shkonte drejt strehës vorfnore.

Nga gjykata Mua'la ibn Khanis, i cili ishte njëri prej shokëve të ngushtë të imamit dhe mbikqyrësi i shpenzimeve të shtëpisë së tij, e vuri re imamin tek po dilte nga shtëpia. Mendoi me vete që mos ta linte imamin të vetëm në këtë errësirë. Me disa hapa largësi, në atë errësirë, ku vetëm hijen e imamit vinte re ai ndiqte imamin.

Ashtu, duke ecur qetësisht drejt imamit, papritur vuri re që diçka i ra nga shpatullat imamit dhe u derdh mbi tokë. Lehtësisht, dëgjoi zërin e imamit, i cili me qetësi tha: "O Zot, të lutem na e kthe këtë gjë!"

Në këtë çast Mua'la iu afrua imamit dhe e përshëndeti. Imami e njohu atë nga zëri dhe i tha: -Ti, Mua'la je?

-Po, -iu përgjigj ai dhe ndërkohë vuri re që përtokë kishin rënë disa copa buke.

-Mblidhi pak këto që kanë rënë në tokë dhe m'i jep mua. Mua'la i mblodhi dhe i vuri ato në duart e imamit. Aty pa që imami po mbante një kapistër të madhe mbi shpinë, të cilën

zakonisht një njeri e kishte të vështirë për ta mbajtur dhe i tha imamit;- Ma jep mua ta mbaj kapistrën.
-Jo, nuk është nevoja, jam unë ai që duhet ta kryej këtë punë, - i tha imami.
Imami i hodhi bukët mbi sup dhe të dy bashku u nisën drejt strehës së të varfërve. Aty ishin mbledhur njerëz të varfër e të mjerë, njerëz që nuk kishin as shtëpi e as katandi. Asnjë nuk ishte zgjuar, të gjithë kishin rënë në gjumë. Imami mori një nga një bukët dhe filloi t'i vinte përkrah secilit nga varfanjakët dhe pa bërë zhurmë mbaroi punën e u kthyen.
Rrugës Mua'la e pyeti: -Këta që ti ndihmove a e besojnë imamatin?
-Jo, ata nuk besojnë në imamat. Po të besonin, do t'u kisha sjellë edhe kripë.[1]

Shoqata Illadi

1) Biharul Anuar; vëll. 11, f. 110, botuar nga "kumpanij" dhe El Uesail; vëll. 2, f. 49, botuar nga Emijrbehader.

41

SELAMI (PËRSHËNDETJA) I HEBREUT

Aishja, bashkëshortja e Profetit të nderuar ishte ulur pranë tij, kur aty hyri një hebre. Në vend që të përshëndeste me "Selam alejkum" hebreu tha "Es Samu alejkum" që do të thotë "vdekja qoftë mbi ju". Nuk zgjati shumë dhe e përsërit edhe një herë tjetër: "Es Samu alejkum." U bë e qartë që kjo nuk ishte e rastësishme, por diçka e menduar me qëllim për të ngacmuar dhe mërzitur Profetin. Aishja u inatos shumë dhe thirri: " Vdekja qoftë mbi, që...?"

Ndërkohë, Profeti i Zotit ndërhyri dhe tha; Oj Aishe, mos mallko! Nëse mallkimi do të përmbushet, do të ketë format më të shëmtuara dhe më të këqija. Nëse flitet bukur, me butësi dhe me mirësi, atëherë dhe gjërat bëhen më të bukura; çdo veprim i kundërt e ul bukurinë e mirësinë e diçkaje. Përse u inatose?

Nuk e shikon, o i Dërguari i Zotit çfarë thonë këta me paturpësinë më të madhe në vend të selamit?

-Po, edhe unë iu përgjigja atyre "Alejkum" (qoftë mbi vetë ju) dhe kaq mjafton, - u përgjigj Profeti.[1]

---

1) El Uesail; vëll. 2, f. 212.

NJË LETËR PËR EBU DHER-RIN

Një letër i mbërrti në dorë Ebu Dher-rit. Ai e hapi dhe e lexoi. Letra kishe ardhur nga larg. Ia kishte dërguar një njeri që e njihte Ebu Dher-rin nëpërmjet Profetit, i cili kishte folur shumë mirë për Abudharin, si njeri fort i ndritur dhe i ditur, si njeri që jepte mësime me urtësinë e tij. Kështu dhe njeriu që kishte dërguar letrën, i kërkontë një këshillë Ebu Dher-rit.

Në përgjigje të letrës së tij Ebu Dher-ri i shkroi një fjali të shkurtër: "Me atë njeri, të cilin njerëzit e duan më shumë se të tjerët, mos mbaj armiqësi dhe mos i bëj asnjë të keqe!" Mbylli letrën dhe e dërgoi andej nga kishte ardhur.

Tjetri mori letrën që i kishte dërguar Ebu Dher-ri. E hapi dhe e lexoi, mirëpo nuk kuptoi asgjë. Tha me vetë: Po kjo ç'do të thotë? Ku e ka qëllimin? Kjo është një diçka që dihet. Njerëzit, jo vetëm që nuk mund t'i bëjnë keq atij që duan, por i japin dhe i falin çdo gjë që kanë atij e sakrifikohen për të."

Nga ana tjetër, mendoi me vete që nuk duhej nënvlerësuar njeriu që kishte thënë këtë, e ai njeri ishte Ebu Dher-ri. Ebu Dher-ri ishte Llukmani i Ymetit, ishte shumë njeri i mençur

e i ditur. Nuk i pa zgjidhje tjetër vetes, veç t'ia kërkonte shpjegimin vetë Ebu Dher-rit sërish.

I shkroi një letër tjetër Ebu Dher-rit, ku i kërkonte shpjegimin.

Ebu Dher-ri i shkroi si përgjigje: "Njeriu më i dashur për ty është vetë vetja jote. Nuk nënkuptoj njeri tjetër. Ti e do veten më shumë se çe duan atë njerëzit e tjerë. Kur të thashë "Me atë njeri, të cilin njerëzit e duan më shumë se të tjerët, mos mbaj armiqësi dhe mos i bëj asnjë të keqe", do të thotë që të mos sillesh keq me veten. Nuk e di që çfarëdo gabimi e mëkati të bëjë njeriu, pasoja a dëmi i bie drejtpërdrejt atij vetë të parit dhe rrezikun e saj e vuan vetë ai."[1]

Shqata flladi

1) Irshad Dulejmij

SHPËRBLIMI I PACAKTUAR

Atë ditë, Sulejman ibn Xhafer Xhaferi dhe imam Rizai (a.s) kishin dalë së bashku jashtë për punë. Dielli perëndoi dhe Sulejamni deshte të kthehej në shtëpinë e vet. Ali ibn Musa Riza i tha: "Eja në shtëpinë time dhe rri sonte nga unë" Ai e pranoi ftesën dhe së bashku me imamin shkuan në shtëpi. Kur u kthye në shtëpi, imami pa që shërbyesit e tij po punonin jashtë në oborr. Sytë i zunë një djalë të ri, i cili po punonte me të tjerët. Imami pyeti se kush ishte ai. Ne sot morën një punëtor që të na ndihmonte, -iu përgjigjën shërbyesit.

-Shumë mirë,- tha imami. Sa ja keni caktuar shpërblimin?

-Do t'i japim diçka në fund e ai do të jetë i kënaqur, - iu përgjigjën shërbyesit.

Imami u mërzit e nevrikos nga përgjigjja e tyre dhe u bë gati të përballej me shërbyesit për këtë sjellje. Në këtë kohë

Sulejmani u fut në mes dhe tha: -Përse e mërzit veten?

Unë ua kam përsëritur shumë herë që të mos marrin njeri në punë pa ia caktuar punën që do bëjë dhe sa do të paguhet, vijoi imami. Në fillim të caktojnë punën dhe shpërmblimin e njeriut e pastaj t'i japin atij punën. Në fund të punës, madje t'i japin edhe diçka më tepër mbi atë që ishte caktuar.

Sigurisht që edhe ai kur e shikon që ju i keni dhënë diçka me tepër nga ajo që ishte caktuar, do t'ju falënderojë dhe do t'ju respektojë duke krijuar miqësi me ju. Por edhe sikur t'i jepni atë shumë që ishte caktuar, njeriu sërish nuk do të ngelet i pakënaqur prej jush. Por nëse ju nuk e caktoni pagesën, e ndërkoh e merrni atë në punë, çfarëdo shume që t'i jepni, ai nuk do të thotë gjë, sepse ju i bëtë nder, por do mendojë që ju i dhatë më pak nga haku që i takonte.

Shoqata Flladi

1) *Biharul Anuar; vëll. 12, f. 31*

ËSHTË ROB APO I LIRË

Zëri i zhurmave dhe i muzikës ishte shumë i lartë. Kushdo që kalonte aty pranë, e merrte me mend se ç'mund të bëhej në atë shtëpi. Aty ishte shtruar sofra e mbushur gotat plot me verë që ishin zbrazur herë pas here. Shërbëtorja e shtëpisë mblodhi të gjitha mbeturinat dhe gjërat e thyera e doli jashtë shtëpisë për t'i derdhur. Në këtë çast ajo shikon një burrë, të cilit i dukej qartë ngazëllimi i besimit, në fytyrë kurse balli i tij tregonte për sexhdet e shumta që kishte bërë. Duke kaluar aty pranë burri e pyet shërbëtoren;

- I zoti i shtëpisë, është rob apo i lirë?

-I lirë,- iu përgjigj ajo.

-Është e qartë që ai është i lirë. Po të ishtë rob, ai do t'ia kishte frikën pronarit, mbretit a Zotit të tij e nuk do ta kishte shtruar gjithë këtë festë sot.

Shkëmbimi i këtij dialogu u bë shkak që shërbëtorja të qëndronte më shumë kohë jashtë shtëpisë duke menduar. Kur ajo u kthye në shtëpi, i zoti e pyeti: "Përse u vonove kaq shumë?"

Shërbëtorja i tregoi atë që i kishte ndodhur dhe shtoi: "Dikush kaloi aty pranë dhe më pyeti kështu dhe unë iu përgjigja."
Kur dëgjoi ngjarjen, i zoti i shtëpisë ra thellë në mendime. Sidomos fjalët *"po të ishte rob, do të kishte frikë Zotin"* iu ngulën si shigjetë në zemër. U ngrit nga vendi pa e kuptuar aq shpejt saqë as për të mbathur këpucët nuk i dha kohë vetes. Këmbëzbathur u nis në kërkim të atij që tha këto fjalë. Vrapoi derisa e arriti njeriun që i kishte thënë këto fjalë. Përveç imamit të shtatë, Hazretit Musa ibn Xhafer (a.s) nuk kishte se kush të ishte tjetër. Ai shkoi te imami, i mori dorën dhe me nderim i kërkoi falje. Dhe që nga ajo ditë kur ai kishte dhënë besën këmbëzbathur, nuk mbathi më këpucë. Deri atë ditë të gjithë e njihnin me emrin " Bishr bin Hareth ibn Abdurrahman Meruzij", ndërsa nga ajo ditë e më pas të gjithë i thërrisnin "këmbëzbathuri". Derisa qe gjallë, i ndenji besnik besës së tij. Nuk bëri më mëkate. Deri në atë ditë ai ishte pjesë e aristokracisë dhe e qeflinjve. Që nga ajo ditë e më pas ai u bë pjesë e besimtarëve dhe prej të devotshmëve ndaj Zotit.[1]

1) El Kunaa uel elkab, i Muhaddith Kummij; vëll. 2 f. 153, marrë nga libri "Minhaxhul Kerameh

45

TEK MEIKATI[1]

Malik ibn Enesi, dijetar i njohur nga Medina, ishte një vit në haxh së bashku me imam Sadikun (a.s). Arritën në Mikat. Veshën rrobat e haxhit dhe shqiptuan fjalët "lebejkell'llahume lebejk". Edhe të tjerët, që ishin shoqëruesit e tyre bënë të njëjtën gjë. Malik ibn Enesi vuri re që sa herë që imami donte të thoshte këtë fjali, ai nuk ndihej mirë, fillonte e dridhej, zëri i bllokohej në fyt dhe gati sa nuk binte në tokë pa ndjenja. Maliku iu afrua dhe i tha: "O biri i të Dërguarit të Zotit! Nuk ka zgjidhje tjetër, thuaje këtë fjali ashtu siç është!"

Imami iu përgjigj: "O i biri i Ebu Omerit! Si mund të guxoj unë e t'i jap vetes guxim e të them "lebejk"? Të thuash "lebejke", do të thotë që t'i thuash Zotit "O Zot, për çfarëdo që të më thërrasësh, vij me tërë shpejtësinë dhe jam gati për shërbim." Me çfarë sigurie të flas kështu me Zotin tim dhe veten time ta paraqes si rob i gatshëm për shërbim?! Po të më vinte përgjigjeja "la lebejk"(nuk e pranoj thirrjen tënde), atëherë çfarë të bëj unë?"[2]

---

1) *Vendi ku haxhinjtë veshin rrobat e haxhit*

2) *Biharul Anuar; vëll. 11, f. 109.*

46

NGARKESA E PALMËS

Ali ibn Ebu Talibi kishte dalë jashtë nga shtëpia dhe si zakonisht, kishte vajtur te kopshtet në shkretëtirë, ku njihej dhe me punëtorët e atyshëm. Ishte i ngarkur me diçka që kishte marrë me vete. Aty dikush e pyeti: -O Ali! Çfarë ke me vete?

-Disa fara hurme, ishallah, - iu përgjigj Aliu.

Habia e njeriut që pyeti arriti kulmin kur pas disa kohësh ai pa që ato fara hurmash që Aliu kishte sjellë me vete atë ditë për t'i mbjellë, kishin mbirë të gjitha dhe çdo farë ishte kthyer në pemë plot me fruta.[1]

1) El Uesail; vëll. 2, f. 531 dhe Biharul Anuar; vëll. 9, f. 599

47

DJERSA E PUNËS

Imam Kadhimi po punonte në tokën e tij. Kishte punuar shumë dhe të gjithë trupin ia kishin mbuluar djersët. Në këtë kohë mbërriti Ali ibn Ebi Hamze Betainij. Përse nuk i lë të tjerët ta bëjnë këtë punë?, - i tha.

-Përse t'ua lë të tjerëve, - iu përgjigj imami. Ka pasur njerëz më të mirë se unë që e kanë bërë këtë punë.

-Për shëmbull, cilët njerëz?

- Profeti i Zotit, Emiru'l Mu'minini dhe të gjithë baballarët e paraardhësit e mi. Pastaj, punimi i tokës është traditë e Profetëve dhe e njerëzve më të dalluar të Zotit,- iu përgjigj imami.[1]

1) Biharul Anuar; vëll. 11, f. 266 dhe El Uesail; vëll. 2,f. 531.

MIQËSIA QË U SHKËPUT

Ndoshta askush nuk e mendonte se ajo miqësi do të prishej një ditë dhe se ata dy shokë të ngushtë, që kishin bërë aq shumë për njëri-tjetrin do të ndaheshin një ditë. Njerëzit nuk e thërrsinin ndonjëherë atë me emër të plotë, por në fillim me emrin e shokut, duke i thënë "o shoku i ....".

Po. Ai ishte i njohur si "shoku i imam Sadikut". Atë ditë, si gjithmonë, ata ishin sërish bashkë dhe po shkonin tek tregu i këpucarëve. Mirëpo, a e mendonte ndokush se kur të dilnin që andej, miqësia e tyre do të ishte prishur përgjithmonë?! Shoku i imamit kishte me vete shërbëtorin e tij zezak. Zezaku po i vinte nga pas. Në mes të tregut, ai kthen papritur kokën dhe nuk e shikon shërbëtorin e tij. Eci dhe dy tre hapa të tjerë, ktheu kokën dhe sërish nuk e pa shërbëtorin e tij. E ktheu kokën për herë të tretë dhe sërish nuk e pa shërbëtorin e tij. Shërbëtori ishte hutuar duke parë pazarin dhe kishte mbetur larg nga pronari i tij. Kur e ktheu kokën për herë të katërt pa shërbëtorin që erdhi. Atëherë, me inat i tha atij: "Ec këtu, o bir bushtre! Ku ishe?"

Sapo kjo fjalë i doli atij nga goja, imam Sadiku ngriti dorën lart, e përplasi atë fort në ballë dhe tha: "O Zot i Madh! Po

e shan nga e ëma?! Po i vesh së ëmës një punë të pa hijshme?! Unë kujtoja se ti je burrë fisnik e i edukuar. Tek ti s'paska hijeshi dhe turp."

-O i biri i të Dërguarit të Zotit! Ky shërbëtori është nga Sanadi, po ashtu edhe e ëma. Ti vetë e di që ata nuk janë myslimanë e që unë të kem shpifur keqazi për atë.

-E ëma le të ketë qenë e pafe. Çdo fis e çdo popull ka zakonin dhe ligjin e tij të martesës. Nëse ata sillen sipas atij zakoni dhe ligji, veprimi i tyre nuk quhet i paligjshëm dhe fëmijët e tyre nuk janë të jashtëligjshëm (kopilë). Tani largohu prej meje, - i tha imami. Më pas, askush nuk e pa imam Sadikun që të shoqërohej me atë, derisa vdekja i ndau ata plotësisht.[1]

Shqeta Flladi

1) El Kafij; vëll.2, f. 324 dhe El Uesail; vëll. 2, f. 477.

NJË MALLKIM

Shërbëtori i Abdullah ibn Makaffa', dijetar dhe shkrimtar i famshëm persian, po mbante ndër duar frerët e kalit të të zotit të tij dhe ishte i ulur jashtë shtëpisë së Sufjan ibn Muavije Mehlebisë, komandatit të Basras. Po priste të zotin e tij që të mbaronte punën që kishte aty dhe pastaj të vinte t'i hipte kalit e të niseshin për në shtëpi.

Pritja zgjati më shumë se ç'duhej; Ibn Mukaffa' nuk po vinte. Njerëzit e tjerë që kishin ardhur pas tij te shtëpia e komandatit, kishin dalë që andej dhe kishin ikur, kurse për ibn Mukaffa, jo. Pak nga pak shërbëtori filloi të interesohej për të. Këdo që pyeste ose i thonin që nuk dinin gjë ose i hidhnin një vështrim nga koka deri te këmbët shërbëtorit dhe kalit e pastaj iknin pa thënë asnjë fjalë.

Koha kaloi shumë dhe shërbëtori shkoi e ua shprehu shqetësimin e zhgënjimin e tij Isait dhe Sulejmanit që ishin bijtë e Ali ibn Abdullah ibn Abas dhe xhaxhallarët e Kalifit të asaj kohe, Mensur Davanikit, ku ibn Mukaffa ishte sekretari dhe shkrimtari i tij.

Isai dhe Sulemjani ishin shumë të interesuar për Abdullah ibn Mukaffa-në dhe e përkrahinin përherë sepse ai ishte shkrimtar i aftë, dijetar dhe përkthyes i zoti. Nga ana tjetër,

edhe ibni Mukaffa, duke pasur mbështetjen e Sulejmanit dhe të Isait, të cilët ishin xhaxhallarët e Kalifit, ishte bërë më trim e me i guximshëm dhe nuk stepej përballë provokimeve që i bënin njerëzit keqdashës. Përveç kësaj, ai fliste edhe ashpër e madj,e duke i thumbuar nganjëherë njerëzit me të cilët kishte debat.

Isai dhe Sulejmani shkuan dhe e kërkuan ibni Mukaffanë te shtëpia e Sufjan ibn Muavisë por ai u tha që ibn Mukkaffa nuk kishte ardhur fare në shtëpinë e tij. Por, meqë kishte qenë ditë dhe të gjithë e kishin parë ibn Mukaffanë të hynte në shtëpinë e tij dhe betoheshin e dëshmonin për këtë gjë, mohimit të Muavijes nuk i mbeti më vend.

Nuk ishte punë e thjeshtë. Vinte era e një vrasjeje dhe ajo kishte të bënte me një personalitet të shquar dhe dijetar të madh si ibn Mukaffaja. Nga njëra anë, në këtë çështje qëndronte komandanti i Basras dhe nga ana tjetër, qëndronin xhaxhallarët e Kalifit. Lajmi për këtë çështje vajti deri tek oborri i Kalifit në Bagdad. Kështu, të gjitha palët, si të akuzuarit, akuzuesit dhe dëshmitarët u mblodhën përpara Mensurit. U parashtrua çështja dhe dëshmitarët dhanë dëshmitë e tyre. Pasi dëgjoi dëshmitë, Mensuri u kthye nga xhaxhallarët e tij dhe tha: "Për mua nuk ka ndonjë pengesë që tani Sufjanin ta dënoj me vdekje për vrasjen e ibn Mukaffasë; mirëpo, kush prej ju të dyve do ta marrë përsipër përgjegjësinë që nëse ibn Makfeja do të jetë gjallë e shëndoshë e mirë pas vrasjes së Sufjanit dhe vjen e futet këtu nga kjo derë (dhe bëri me dorë nga një derë) dhe të pranojë të dënohet për vrasjen e Sufjanit?

Isai dhe Sulejmani mbetën të habitur nga kjo pyetje e nuk dinin ç'përgjigje të jepnin. Me vete thanë, po sikur ibn Mukaffaja të jetë i gjallë dhe Sufjani e ka dërguar atë shëndoshë e mirë te kalifi.?! Të detyruar, u tërhoqën nga çështja e tyre dhe u larguan.

Koha kaloi dhe pak nga pak edhe për ibn Mukaffanë as nuk u dëgjua e as nuk u pa gjë. Pak nga pak ai po shkonte drejt harresës.

Pas kalimit të njëfarë kohe, u bë e qartë se ibn Mukaffaja e kishte sulmuar disa herë ibn Sufjanin me gjuhën e tij duke e fyer rëndë atë. Madje, një ditë, e kishte fyer atë nga e ëma në prani të njerëzve të tjerë. Sufjani gjithmonë kishte pritur rastin që të hakmerrej ndaj ibn Mukaffasë, por nuk guxonte nga frika e Isait dhe e Sulejmanit, xhaxhallarëve të kalifit, derisa ndodhi kjo ngjarje: Duhej që xhaxhai tjetër i Mensurit, Abdullah ibn Aliu të shkruante një letër dhe pastaj ajo t'i shkonte Mensurit që ta nënshkruante atë. Abdullah bin Aliu thirri bin Mukaffanë, i cili ishte sekretari i vëllezërve të tij, që t'a shkruante letrën për të. Ibn Mukaffaja e shkroi letrën. Tek ajo letër përveç kërkesave që parashtroheshin, ishin bërë edhe komentime e akuza drejtpërdrejta ndaj Mensurit, Kalifit Abasit. Kur Mensurit i ra letra në dorë, u mërzit dhe u inatos shumë dhe pyeti se kush e kishte shkruar e i thanë që ishte ibn Mukaffaja. Edhe Mensuri ndjeu pikërisht të njëjtën gjë që kishte ndjerë dhe Sufjani për ibn Mukaffanë më përpara.

Atëherë, fshehtas i shkruan Mensuri Sufjanit dhe i kërkon që ibn Mukaffaja të dënohet sa më shpejt. Tani Sufjani po kërkonte rastin e duhur që ta ndëshkonte ibn Mukafanë.

Rasti qe kur u thirr në shtëpinë e vet atë ditë, e kur shërbëtori i ibn Mukaffasë ndenji jashtë duke e pritur.
Kur ibn Mukaffaja hyri në shtëpinë e Sufjanit atë ditë, pa se brenda ishin mbledhur disa prej shërbëtorëve dhe ushtarëve të tij. Sapo Sufjanit i zunë sytë ibn Mukaffanë, iu kujtuan të gjitha fyerjet që i kishte thënë ai deri atëherë. I thotë ibn Mukaffasë: "A të kujtohet kur më fyeve atë ditë nga nëna? Tani ka ardhur koha të lajmë hesapet. As lutjet e as përgjërimi nuk bëjnë punë dhe Sufjani e hoqi qafe ibn Mukaffanë në mënyrën më të dhunshme.[1]

Shoqata Flladi

1) Sherh Nehxhul Belafa i ibn Ebi Hadijdit; vëll. 4, f. 389, botuar në Beirut.

GJUHËMPREHTI

Ali ibn Abasi, i njohur si ibn Rumiu, poet i vrullshëm i periudhës së Abasitëve, gjatë gjysmës së dytë të shekullit të tretë (Hixhri), kishte ardhur në festën që kishte shtruar veziri Abasit, Kasim ibn Abdullah. Poeti krekosej përherë për mprehtësinë e gjuhës dhe logjikën e arsyen e fjalës që kishte. Kasim ibn Abdullahu i trembej shumë gjuhës së ibn Rumiut dhe ishte shumë i shqetësuar; mirëpo nuk e shfaqte shqetësimin e tij; përkundrazi, ai sillej shumë mirë me ibn Rumiun, megjithëse ky i fliste atij shumë vrazhdë e duke e fyer, ai bëhej i padurueshëm. Në mënyrë të fshehtë, Kasim dha urdhër që të hidhnin helm në gjellën e ibn Rumiut. Pasi e hëngri gjellën, ibn Rumiu e vuri re se ç'kishte ndodhur. U ngrit menjëherë nga vendi që të ikte. Kasimi i thotë;

-Ku po shkon?

-Aty ku më dërgove, -iu përgjigj poeti.

-Atëherë, bëji të fala nënës time dhe babait tim, - i tha Kasimi.

-Unë nuk shkoj rrugës së ferrit, - iu përgjigj ibn Rumiu.

Ibni Rumiu shkoi menjëherë në shtëpi dhe nisi të mjekohej, mirëpo nuk mundi të gjente shpëtim. Kështu, vdiq bashkë me gjuhën e tij të mprehtë si shpatë.[1]

---

1) Tetimetul Muntehai muhaddith Kummij; vëll. 2, f. 400 dhe Tarijh ibn Khal-lekanij; vëll. 3, f. 44.

DY KOLEGËT

Çiltërsia, miqësia dhe bashkëpunimi që ekzistonte mes Hisham ibn Hakemit dhe Abdullah ibn Jezid Abadij i habiste të gjithë njerëzit e Kufes. Këta dy njerëz ishin bërë shembulli i miqësisë dhe ishin dy bashkëpunëtorë besnikë e të çiltër. Kishin një dyqan së bashku e merreshin me shit-blerje mallrash. Sa ishin gjallë, mes atyre nuk ndodhi asnjëherë asnjë mosmarrëveshja a grindje.

Gjëja që u bë shkak që njerëzit të habiteshin me miqësinë e këtyre dy njerëzve ishte ajo se ata u përkisnin dy rrymave të kundërta fetare. Hishami ishte një nga klerikët e dijetarët e njohur shiitë, besonte në Imamat dhe ishte një nga shokët e miqtë e imam Xhaferr Sadikut (a.s) e ndiqte rrugën e Ehli Bejtit. Ndërsa Abdullah ibn Jezidi ishte një nga klerikët Abadijeh.[1] Kështu nga pikëpamja e bindjeve fetare këta ishin

---

1) Abadijeh sekt fanatikësh rebelë. Sekti u krijua në luftën e Sifinit. Ishin një grup i shokëve të Imam Aliut, të cilët iu rebeluan atij. Ky grup vepronte sipas bindjeve të tyre dhe ishin injorantë e fanatikë. Për këtë ata kanë qënë dhe grupi më i rrezikshëm në mesin e myslimanëve dhe për herë kanë qënë një shqetësim për qeveritë e kohës. Havarixhwt pwrgjithwsisht gjendeshin tek ushtria e Aliut dhe e Osmanit dhe, zakonisht myslimanwt e tjerw tw cilwt nuk ndanin tw njwjtin mendim me ta, ata i quanin tw pafe dhe politeistw. Ata marteswn me myslimanwt e tjerw nuk e shikon fort tw pwlqyeshme e as nuk u linin atyre trashwgimi, e po kwshtu edhe mallin e gjakun e tyre nuk e quanin tw pastwr. Por sekti Abadijeh, nw krahasim me sektet e tjera Havarixh, ishin mw tolerant, kumartesa, mallie, pasuria e te drejtat e tyre ishin tw respektushme. Kryetari i Abadijeh wshtw njw burrw i quajtur "Abdullah Bin Abadh" i cili u shfaq aty nga fundi i Kalifatit Umejad. "Milal va nah li Shahrestani, Vëll 1, f f 172-212,botuar në Egjipt.

plotësisht të kundërt me njëri-tjetrin. Por, ata kishin arritur t'i linin mënjanë dallimet fetare e të mos i përfshinin ato në skenat e tjera të jetës, dhe merreshin me tregëtinë e tyre me sinqeritet e bashkëpunim. Më i habitshëm ishte nganjëherë fakti që te shitorja vinin nxënësit shiitë të Hishamit dhe ai u jepte aty mësimet e rregullat e shiitëve dhe Abdullahu, i cili ishte i pranishëm aty, nuk shqetësohej fare kur dëgjonte fjalë në kundërshtim me bindjet e tij fetare. Po kështu, ndodhte që të vinin Abazitë dhe merrnin mësimet e tyre përpara syve të Hishamit, të cilat ishin krejt në kundërshtim me bindjet e tij shiite. Por as ai nuk shqetësohej.

Një ditë, Abdullahu i tha Hishamit "Unë dhe ti kemi një miqësi të çiltër. Ti më njeh mua shumë mirë. Unë kam dëshirë që ti të më pranosh mua si dhëndrin tënd dhe të më martosh me vajzën tënde, Fatimenë."

Me një fjali të vetme Hishami ia ktheu përgjigjen Abdullahut. Përgjigja ishte që: "Fatimja është besimtare".

Me të dëgjuar këtë fjalë, Abdullahu ra në qetësi dhe nuk foli më për këtë çështje. Por edhe kjo ngjarje nuk mundi, që ta prishte miqësinë ndërmjet tyre. Bashkëpunimi i tyre vazhdoi përsëri. Vetëm vdekja ishte ajo e cila arriti të fuste ndarjen mes këtyre dy shokëve, duke i larguar ata nga njëri-tjetri.[2]

2) Muruxhu Dhehebi; vëll. 2, f. 174, botuar në Egjipt. (në fund të pjesës për Umer ibn Abdul Azijz)

NDALIMI I PIJES

Me urdhër të Mensurit,u hap arka e shtetit dhe iu dha njerëzve diçka prej saj. Shakrani ishte një burrë, i cili, ashtu si të tjerët, kishte ardhur të merrte diçka tek arka e shtetit (Beitul Mali). Mirëpo, meqë nuk e njihte njeri, nuk po arrinte të merrte dot gjë. Shakrani kishte pasur dikur një paraardhës të tij skllav, të cilin e pati liruar Profeti i Zotit dhe pasardhësit të tij e kishin trashëguar të gjithë lirinë nga ai. Atij i thoshin" i liruari i Profetit të Zotit" dhe ai mburrej me këtë dhe tani nga kjo anë ai e lidhte veten më të parët e shoqërisë.

Kur sytë e Shakranit po lëviznin nxitimthi për të njohur ndokënd me qëllim që të merrte dhe ai diçka nga arka e shtetit, sytë i zunë imam Sadikun (a.s). I doli përpara dhe e përshëndeti e i tha hallin që kishte. Imami u largua. Nuk zgjati shumë dhe ai u kthye së bashku me pjesën e Shakranit. Sapo ia dha ndër duar Shakranit pjesën e vet, me një gjuhë shumë të butë e të ëmbël i tha: "Puna e mirë, nga kushdo që të bëhet, është e mirë, por puna jote, ku ti e lidh veten me ne dhe na respekton shumë , është edhe më e bukur dhe më e mirë. Puna e keqe, nga kushdo që të bëhet është e shëmtuar, por prej teje për shkak të asaj lidhjeje, është edhe më e keqe dhe më e shëmtuar. Pasi tha këtë fjali, imam Sadiku u largua.

Pasi dëgjoi fjalën e imam Sadikut Shakrani e kuptoi që imami e dinte që ai ishte i dhënë pas pijes dhe, megjithëse imami e dinte shumë mirë që ai pinte, sërish u soll ëmbël dhe ia vuri në dukje gabimin me butësi. Atë çast e vrau shumë ndërgjegjja, u turpërua, e hoqi dorë nga ai ves.[1]

Shoqata Flladi

1) Enuarul Behijeti, i muhaddith Kummij, f. 76, marrë nga libri "Rabijul Ebrar" i Zamahshariut

KËMISHA E KALIFIT

Omer ibn Abdul Aziz gjatë kalifatit të tij, ishte ulur në mimber të xhamisë dhe po mbante fjalim. Njerëzit po dëgjonin çfarë thoshte ai, shikonin se herë pas here Omeri lëvizte me dorë këmishën e tij. Kjo lëvizje u tërhoqi vëmendjen të pranishmëve dhe të gjithë pyesnin se ç'kishte ai që e lëvizte këmishën kështu gjatë fjalimit.

Më në fund, mbaroi dhe kuvendi. Pasi u interesuan, e morën vesh se ç'kishte kalifi që e lëvizte këmishën e tij ashtu. Kështu u bë e ditur se kalifi për të kursyer shpenzimet e arkës së shtetit (beitul malit) dhe për të ndrequr shpërdorimet që kishin bërë paraardhësit e tij me arkën, nuk kishte vetëm se një këmishë të vetme. Kështu, meqë e kishte larë atë ditë këmishën e meqë nuk kishte tjetër e kishte veshur atë shpejt e shpejt ashtu të lagur dhe po e lëvizte me dorë që këmisha t'i thahej sa më shpejt.[1]

---

1) ……..

I RIU NË GJENDJE TË HUTUAR

Profeti i nderuar fali namazin e mëngjesit në xhami së bashku me nxhematin. Dita tashmë kishte zbardhur plotësisht dhe njerëzit po shkonin secili në punë të vet. Ndërkohë, Profetit i zënë sytë një djalë të ri, i cili dukej se nuk ishte mirë. Ishte i shqetësuar dhe e kthente kokën herë pas here sa andej – këtej. I hodhi një vështrim të riut në fytyrë dhe pa se ai ishte zbehur; sytë i ishin futur thellë në zgavra dhe ishte dobësuar shumë në trup. Profeti i afrohet dhe e pyet: Në ç'gjendje je?

- Jam në gjendjen e besimit, - thotë ai.

- Çdo besimtar ka shenjat e tij që tregojnë të vërtetën e tij, ti çfarë shenjash ke?, – e pyeti Profeti.

-Netëve nuk më zë gjumi, kurse ditët e mia mbarojnë me etje. Tashmë i kam kthyer shpinën botës dhe të gjitha gjërave të saj e jam drejtuar për nga ana tjetër. Më duket sikur po shikoj Arshin (Fronin e Zotit) dhe krijimin e të gjitha krijesave të tjera. Më duket sikur shikoj banorët e Xhennetit në mirësi dhe banorët e Xhehennemit në dënime. Më bëhet sikur dëgjoj qysh tani zhurmën e zjarrit të Xhehennemit në veshët e mi.

Atëherë, Profeti u kthye nga xhemati dhe tha: "Ky djaloshi këtu është një rob të cilit Zoti i ka ndezur brenda zemrës

së tij dritën e besimit." Pastaj u kthye nga djaloshi dhe i tha: "Mbaje për vete këtë gjendje të mirë!"
Djaloshi iu përgjigj: "O i Dërguari i Zotit, lutu që Zoti të më vërë në rrugën e luftës së drejtë dhe të dëshmorit." Profeti u lut. Nuk zgjati shumë dhe myslimanët hynë në luftë, ku mori pjesë dhe ky djaloshi. Ai qe njeriu i dhjetë që ra dëshmor në atë luftë.[1]

1) El Kafij; vëll. 2, f. 53 (kreu: E vërteta e besimit dhe e bindjes.)

EMIGRANTËT E HABESHESË

Vit për vit dhe muaj për muaj shtohej numri i myslimanëve që shkonin në Mekë. Presionet e shumta të mekasve jo vetëmn që nuk ia kishin dalë mbanë t'u prishnin mendjen njerëzve, që kishin pranuar Islamin, por as nuk kishin mundur t'i bënin ballë tërë atij lumi të madh njerëzish -burra a gra-, të cilët po përkrahnin Islamin. Shtimi i numrit të madh të njerëzve, që dita-ditës po e përkrahnin gjithmonë e më shumë Islamin, të cilët as nuk u thyen e as nuk u bënë pesimistë përballë trysnive shumta. Kjo i inatosi edhe më shumë Kurejshët, e i shtonin dita-ditës presionet dhe ngacmimet e tyre kundër myslimanëve.

Gjendja e myslimanët ishte më e vështirë, por ata vazhdonin të kishin durim. Me qëllim që t'i ndalonte përkohësisht Kurejshët nga ngacmimet e myslimanëve, Profeti i nderuar u propozoi myslimanëve që të largoheshin nga Meka e të shpërnguleshin në Habeshe. Ai u tha atyre: "Meqë prijësi i Habeshesë është njeri i drejtë e i mirë, ju mund të rrini për pak kohë nën kujdesin e atij, derisa Zoti i Madh të krijojë një mundësi të mirë për të gjithë."

Kështu, një numër i madh myslimanësh shkuan drejt Habeshesë. Atje ata nisën të jetonin të qetë dhe të lirë, duke kryer lirshëm dhe ritet e tyre fetare.

Sapo mësuan që myslimanët kishin vajtur në Habeshe dhe atje tani ishin të lirë, duke pasur frikë se mos ata tani do të organizoheshin e do të formoheshin për Islamin, Kurejshët u mblodhën të gjithë së bashku dhe hartuan një plan, me qëllim që t'i kthenin sërish myslimanët në Mekë dhe t'i mbanin nën kontroll si përherë. Për ta kryer këtë punë, ata zgjodhën dy burra dinakë dhe tinëzarë nga mesi i tyre. Për t'i dërguar ato për në Habeshe mbodhën disa njerëz dhe dhurata të shumta për Nexhashin, mbretin e Habeshesë, si edhe për personalitetet e njerëzit e tjerë që ishin pranë Nexhashit, fjalët e të cilëve kishin ndikim mbi mbretin.

Këtyre dy vetave u dhanë urdhër që pasi të futeshin në Habeshe, në fillim të takonin krerët dhe njerëzit e afërm të Nexhashit, t'u jepnin atyre dhuratat që kishin marrë e t'u thoshin: "Një grup të rinjsh të papjekur të vendit tonë, kanë dalë nga feja jonë, kohët e fundit por nuk janë futur as në fenë tuaj dhe tani ata janë në shtetin tuaj. Prijësit dhe të parët e fisit tonë na kanë dërguar te ju që t'ju lutemi që këta njerëz t'i largoni nga vendi juaj dhe të na i dorëzoni neve. Ju lutemi që edhe kur t'ia parashtrojmë kërkesën tonë dhe Nexhashit, ju ta mbështesni mendimin tonë."

Të dërguarit e Kurejshve vajtën e i takuan një nga një të gjithë personat e rëndësishëm, u dhanë atyre dhuratat dhe u morën fjalën se ata do t'i mbështesnin kur të takoheshin me mbretin e tyre.

Pastaj shkuan e takuan vetë Nexhashin. I dhuruan atij dhurata nga më të shtrenjtat e më të çmuarat e i paraqitën kërkesën që kishin.

Sipas asaj që ishte dhënë më përpara, njerëzit e afërt të Nexhashit, folën e përkrahën Kurejshët, duke thënë që myslimanët të nxirreshin sa më shpejt nga vendi i tyre e t'u dorëzoheshin të dërguarve të Kurejshëve.

Mirëpo, vetë Nexhashi nuk ishte i një mendjëje me këtë kërkesë dhe tha: "Njerëz nga vendi juaj kanë ardhur dhe janë strehuar në vendin tim. Mirëpo, nuk është e drejtë që unë, pa kërkuar dhe mësuar përreth tyre të jap urdhër për t'i nxjerrë ata nga vendi im. Më duhet që t'i thërras këtu, të dëgjoj se çfarë thonë, që të shikoj se çfarë duhet të bëj?" Kur të dërguarit e Kurejshëve dëgjuan fjalën e fundit që tha Nexhashi, u iku dhe zemra filloi t'u rrihte me shpejtësi. Ata i druheshin përballjes së Nexhashit me myslimanët. Atëherë ata parapëlqyen që myslimanët të rrinin në Habeshe, por të mos përballeshin me Nexhashin, sepse, nëse myslimanët do të shprehnin fjalët e tyre dhe Muhamedi do të shpallte që i kishte ardhur urdhri nga Zoti, atëherë feja e tij do të tërhiqte edhe më shumë njerëz edhe në vendin e Nexhashit. E kështu, puna do shkonte me tubim të myslimanëve si në Mekë. Pra duhej menduar diçka. Nexhashi kishte dhënë urdhër që të ikurit e strehuar në vendin e tij, të vinin në një kohë të caktuar përpara tij.

Myslimanët e dinin që në Habeshe kishin ardhur të dërguarit e Kurejshëve, dinin dhe për dhuratat u kishin dhënë oborrtarëve të Nexhashit dhe vetë atij, dinin po ashtu dhe qëllimin e tyre, prandaj ishin shumë të shqetësuar: a do

të përmbushej qëllimi i tyre e ata të ktheheshin sërish ne Mekë!

Kur erdhi i dërguari i Nexhashit dhe i thirri, ata e kuptuan që një rrezik i madh ishte mbi kokat e tyre. U grumbulluan dhe formuan një këshill, që të parcaktonin se çfarë të thoshin në takimin me Nexhashin. Të gjithë ranë në një mendje që të mos thoshin gjë tjetër përveç së Vërtetës: Ia shpjegonin gjëndjen e tyre të padijes të tregonin për të vërtetën e Islamit dhe urdhrat e tij e të flisnin për shpirtin e ftesës së Islamit, pra, t'i tregonin të gjitha e përveç realitetit të mos shtonin asnjë fjalë.

Me këtë qëllim ata shkuan në takim me Nexhashin. Nga ana tjetër, mbreti duke e ditur që kishte të bënte me paraqitjen e një besimi të ri, thirri edhe klerikët e tij, të cilët ishin të krishterë, të ishin të pranishëm në atë mbledhje. Kështu, aty ishin edhe një numër i madh peshkopësh. Përpara gjithsecilit prej tyre ishte vënë nga një Bibël. Nga ana tjetër e sallonin ishin autoritetet shtetërore. Autoritetet fetare dhe ato mbretërore u takuan me njëri-tjetrin sipas zakonit e kështu e tërë mbledhja mori një atmosferë madhështore. Nexhashi ishte ulur në fron dhe rrinte në krye të sallonit dhe pastaj të tjerët, me radhë, sipas gradave që kishin, kishin zënë vendet. Çdo spektator mbetej i mahnitur nga madhështia e autoriteteve.

Myslimanët, të cilëve besimi dhe bindja në Islam u kishte falur një vetësiguri dhe qëtësi të madhe, u futën plot hijeshi e fisnikëri në atë mbledhje madhështore. Në krye të tyre qëndronte Xhafer ibn Ebu Talib, e pastaj të tjerët vinin me radhë pas tij. Ata hynë pa u kushtuar kurrfarë vëmëndje

atyreve që po rrinin me madhështi përballë tyre. Ata nuk zbatuan as zakonin e asaj kohe, që ishte përkulja dhe puthja e tokës para autoriteteve mbretërore. Hynë brenda dhe përshëndetën.

Kjo lloj sjelljeje solli u mor si fyese dhe solli shumë reagime. Mirëpo ato të gjithë menjëhëre iu përgjigjën: "Feja jonë, për arsye të së cilës ne jemi strehuar këtu, nuk la lejon që t'i përkulemi njeriu tjetër përveçse Zotit, që është Një.

Kjo sjellje dhe fjalët e tyre u dha një forcë dhe një madhështi tjetër në fytyrë myslimanëve, e të gjithë të pranishmit e tjerë u mahnitën nga personaliteti i tyre.

Nexhashi, i cili kishte vendosur që pyetjet t'i bënte ai vetë, tha: "Kjo feja juaj e re, çfarë feje është që është më vete si nga feja juaj e parë, ashtu dhe nga feja e jonë?"

Drejtimi i myslimanëve në Habeshe ishte në përgjegjësinë e Xhaferr ibn Ebu Talibit, vëllait të madh të Emirul Mu'mininit, Aliut (a.s), i cili duhej të jepte dhe përgjigjet e pyetjeve.

Xhaferi u përgjigj: "Ne kemi qenë njerëz që kemi jetuar në padituri. Ne adhuronim idhuj. Hanim gjallesa të ndyra e ushqime të dëmshme. Kryenim veprime të shëmtuara. Ishim injorantë, arrogantë e vulgarë. Flisnin keq për fqinjin dhe i bënin keq fqinjit. Hanim dhe shkelnim më të dobëtit tanë. Jetonim në këto kushte, kur Zoti na dërgoi Profetin, të cilin ne të gjithë e njohim për drejtësine e ndershmërinë e tij. Ai na ftoi drejt adhurimit të Zotit të vetëm, që është Një e t'u largohemi idhujve prej guri e druri. Na urdhëroi që të flasim të drejtën, të ruajmë amanetin, të jemi të mëshirshëm, të sillemi mirë me fqinjin e të respektojmë

vetveten. Na ndaloi nga veprat e shëmtuara dhe fjala e kotë. Na ndaloi të hanim mallin e jetimëve e të shpifim për gratë e ndershme. Na ftoi që të mos
i bënjmë shok Zotit, të falim namazin, të japim zekatin etj... Ne e besuam Atë dhe e ndjekim Atë. Po kështu, dhe urdhrat që na dha ai. Por, ne na ka kundërshtuar vendi ynë e na kanë thënë që të heqim dorë nga këto rregulla e bindje e të kthehemi në atë gjendjen tonë të parë, t'u kthehemi sërish idhujtarisë dhe atyre pndyrësive që kishim. Meqë ne kundërshtuam, ata na kërcënuan dhe na torturuan. Kjo ishte dhe arsyeja që ne u larguam që andej dhe erdhëm në shtetin tuaj dhe shpresojmë që këtu do të jemi të sigurt."
Kur fjala e Xhaferit arriti këtu, Nexhashi pyeti: - A të kujtohet ndonjë fajlë nga ato që i janë zbritur nga bota tjetër Profetit tënd?
-Po, - iu përgjigj Xhaferi.
-Më fol pak,- tha Nexhashi.
Xhaferi duke pasur parasysh që të gjithë të mbledhurit aty ishin të krishterë dhe vetë Nexhashi ishte i krishterë dhe peshkopët e mëdhenj mbanin para duarve të tyrë Biblën, u lexoi atyre Suren "Merjem", e cila flet për Merjemen, Isanë, Jahjanë dhe Zekerianë. Ai këndoi më një zë shumë të qetë dhe melodik të gjitha ato ajete që flisnin për profetët. Njëherësh me këndimin e këtyre ajeteve, Xhaferi deshte që t'u shprehte të krishterëve dhe pikëpamjen e drejtë të Kur'anit për Isanë, dhe Merjemen (Shën Marinë). Duke u bërë të ditur atyre që Kur'ani i çon Isanë dhe Merjemen që në gradat të larta të shenjtërisë, në të njëjtën kohë i shikon

ata si njerëz. Në këtë kohë, mbledhja mori një atmosferë shumë të çuditshme. Të gjithëve iu mbushën sytë me lot.
Nexhashi tha: "Për Zotin, çfarëdo që ka thënë Isai, janë po këto. Këto fjalë dhe fjalët e Isait, kanë një rrënjë."
Pastaj ai u kthye nga të dërguarit e Kurejshëve dhe u tha: "Shkoni në punët tuaja!" U ktheu atyre edhe dhuratat që patën dhënë.
Pas pak kohe, Nexhashi u bë zyrtarisht mysliman. Vdiq në vitin e nëntë (Hixhri). Profeti i nderuar fali namazin e varrimit të tij që nga larg.[1]

Shoqata Flladi

1) Historia e ibn Hishamit; vëll. 1, f. 321 – 338. Sherh Nehxhul Belaga I ibn Ebi Hadijd; vëll. 4,f.175 -177, botuar në Beirut hde Neuasikhu Tarikh; Ndodhitë para emigrimit

PUNËTORI DHE DIELLI

Imam Sadiku (a.s) kishte veshur rroba e punëtori dhe me bel në dorë po punonte në kopshtin e tij. Kishte punuar me aq zell, saqë i gjithë trupi i ishte mbuluar me djersë.

Në atë kohë aty vjen Ebu Omer Shibanij dhe shikon të lodhur imamin. Me vete mendoi që imami nuk duhej të kishte pasur njeri pranë, dhe prandaj ka qenë i detyruar të vishte rrobat e punëtorit, të merrte belin në dorë dhe ta punonte kopshtin vetë. Iu afrua imamit dhe i tha:- Ma jep mua belin, ta bëj unë punën!

Unë kam dëshirë që për të nxjerrë ditën e tij burri të mundohet dhe të hajë rrezet e diellit, -ia ktheu imami.[1]

---

1) "Unë e pëlqej që njeriu të mundohet në vapën e nxehtë në kërkim të jetesës." Biharul Anuar; vëll. 11, f. 120.

57

FQINJI I RI

Një shok i Profetit kishte blerë një shtëpi të re në një prej lagjeve të Medines dhe ishte vendosur aty. Aty i kishte qëlluar për fqinj një njeri, të cilin nuk e kishte shumë qejf. Shkoi te Profeti dhe i tha: "Kam blerë një shtëpi në aksh vënd, në mes të aksh fisi dhe jam vendosur aty. Fatkeqësisht fqinji im më i afërt është një njeri që jo vetëm prej atij nuk kam parë mirë, por nuk jam as edhe i sigurtë prej tij. E kështu, kam frikë se ai do të më sjellë shumë dëme."

Profeti i nderuar thirri katër veta - Aliun, Selmanin, Ebu Dher-rin dhe Migdadin. U tha që të thërrisnin me zë të lartë të xhami për njerëzit - burra dhe gra e t'u thoshin: "Kushdo që shqetëson fqinjin e tij, nuk është besimtar."

Kjo fjalë u përsërit tri herë. Profeti bëri me dorë nga të katër anët dhe tha: "Nga çdo anë llogaritet deri në dyzet shtëpi fqinjësh."[1]

1) El Kafij; vëll. 2, f. 666, kreu; të drejtat e fqinjut.

58

FJALA E FUNDIT

Sytë e Ebu Basirit u mbushën me lot sapo ranë mbi nënën e imam Kadhimit (a.s), Umu Hamidenë. Ai kishte ardhur për të shprehur ngushëllimet e tij për vdekjen e bashkëshortit të saj, imam Sadikut dhe Abu Basiri qau për pak çaste. Umu Hamideja i mbajti lotët e saj dhe i tha Abu Basirit: "Ti nuk ishe i pranishëm në çastet e fundit të jetës së imamit. Ndodhi diçka e habitshme." Ebu Basiri pyeti se çfarë kishte ndodhur. Umu Hamideja tha: "Imami po kalonte çastet e fundit të jetës së tij. Papritur hapi sytë dhe kërkoi që të gjithë njerëzit e tij t'i mblidheshin menjëherë aty. Ishte një gjë e çuditshme që në ato çaste imami të jepte këtë urdhër. Ne të gjithë iu mblodhëm pranë për ta dëgjuar se ç'do thoshte. Imami, pasi pa se aty ishin mbledhur të gjithë, u tha të pranishmëve: "Ndërmjetësia jonë kurrë nuk do të bëhet e njerëzve, të cilët lutjen e marrin si diçka te lehtë."[1]

1) Biharul Anuar; vëll.11, f. 105

NUSEJBEJA

Shenja që i kishte mbetur mbi shpatull Nusejbesë, tregonte për një ndodhi të madhe në jetën e saj. Gratë a vajzat e reja të cilat nuk e kishin arritur kohën e të Dërguarit të Zotit, sa herë që vinin re shenjën në shpatullën e Nusejbesë, e pyesin atë me kureshtje për atë ngjarje të tmerrshme që i kishte ndodhur asaj, e cila kishte çuar në plagosjen e saj në shpatull. Të gjithë dëshironin që ngjarjen e Nusejbesë në luftën e Uhudit ta dëgjonin nga goja e saj.

Nasibeja nuk e mendonte kurrë që në luftën e Uhudit, edhe ajo do të luftonte përkrah burrit dhe dy djemve të saj në mbrojtje të Profetit. Ajo mbante ndër duar një shtambë dhe kujdesej për të plagosurit në sheshbetejë duke u sjellë ujë. Ajo kishte sjellë dhe disa lecka, të cilat ajo i kishte bërë si fasha dhe me ato u mbyllte plagët të plagosurve. Përveç këtyre dy punëve, atë ditë nuk parashikonte gjë tjetër.

Myslimanët, në fillim të betejës, megjithëse ishin të paktë në numër dhe nuk kishin armë të mjaftueshme, e thyen fuqishëm armikun. Armiku iku nga sheshbeteja dhe e la vendin bosh. Mirëpo nuk zgjati shumë dhe për shkak të një pakujdesie që treguan disa roja myslimane, armiku erdhi dhe

u ra pas shpine, duke bërë që shumë myslimanë të shpërndahen larg Profetit.

Kur e pa gjendjen kështu, Nusejbeja lëshoi përtokë shtambën e ujit dhe mori në dorë shpatën. Herë qëllonte me shpatë dhe herë gjuante shigjeta me hark. Mori dhe mburojën e një burri që iku dhe filloi ta përdorte atë. Ndërkohë që po luftonte, dëgjoi që dikush nga armiqtë po thërriste: "Ku është Muhamedi, ku është Muhamedi?" Nusejbeja i shkoi afër dhe e qëlloi fort me shpatë; mirëpo ai kishte veshur dy armatura e nuk u plagos rëndë nga goditja e Nusejbesë, por u kthye dhe e qëlloi fort në shpatull. Kur vuri re që nga shpatulla e Nusejbesë po dilte gjak, Profeti thirri menjëherë njërin prej djemve të saj dhe i tha që t'i lidhte plagën së ëmës menjëherë. Djali ia lidhi plagën asaj dhe Nusejbeja filloi sërish të luftonte.

Nusejbeja vuri re që njëri prej djemve të saj ishte plagosur. Mori menjëherë fashat që kishte përgatitur për të plagosurit e shkoi e i lidhi plagën të birit. Profeti po e vështronte Nusejbenë dhe buzëqeshi për trimërinë e pashoqe të saj gruaje. Sapo i lidhi plagën të birit, i tha që të ngrihej e të luftonte mënjëherë. Ende nuk kishte mbaruar së thëni këtë fjalë, kur Profeti i tregoi asaj një njeri dhe i tha: "Ky ta plagosi djalin." Nasibeja iu sul si një luaneshë me shpatë në dorë, e goditi fuqishëm dhe ai ra menjëherë përtokë përpara këmbëve të saj. Ia more mirë hakun, - i tha Profeti, -falëndero Zotin që të dha forcë e të bëri të hapësh sytë."

Disa prej myslimanëve ranë dëshmorë e të tjerë u plagosën. Nusejbeja kishte marrë plagë të mëdha, të cilat nuk të jepnin shumë shpresa që ajo të jetonte.

Pas ngjarjes së Uhudit, për siguri ndaj armikut, Profeti,dha urdhër që të lëviznin menjëherë drejt "Hamra Sa'dit". Këmbësoria filloi lëvizjen. Nusejbeja, ashtu e plagosur kërkoi të lëvizte. Mirëpo nuk e linin plagët e mëdha që kishte marrë në trup. Kur Profeti u kthye nga " Hamra Sa'di", ende pa shkuar mirë në shtëpinë e tij, dërgoi një njeri që të pyeste se si ishte Nusejbeja. I erdhi lajmi që ajo ishte mirë. I Dërguari i Zotit u gëzua shumë nga lajmi që mori.[1]

Shoqata Flladi

1) *Sherhu I ibn Ebi Hadijdit; vëll. 3, f. 568 -570, marr nga Megazij Uakidij.*

KËRKESA E ISAIT

Isai (a.s) u tha dishepujve të tij: Unë kam një lutje. Po të më premtoni se do ta zbatoni do ta them.

Dishepujt iu përgjigjën: "Çfarëdo që të thuash, do të bindemi."

Isai u çua nga vendi dhe u lau këmbët atyre një nga një. Dishepujt filluan të mos ndiheshin aspak mirë, por meqë i kishin dhënë fjalën Isait se do bënin ashtu siç u kishte kërkuar ai, pranuan." Pasi Isai mbaroi punën, ata i thanë: "Ti je mësuesi ynë, prandaj duhej që ne të t'i lanim këmbët, e jo ti ne.

Isai iu përgjigj: "Unë veprova kështu që të kuptoni se nga të gjithë njerëzit, më i duhuri për të marrë përsipër shërbimin e drejtimin e tyre është ai **"**i Urti**".** Këtë punë e bëra që të tregoja modesitnë dhe që ju të mësonit përuljen dhe, kur ju të merrni përsipër drejtimin e mësimin e njerëzve pas meje, metodën tuaj ta vini në shërbim të krijimit. Urtësia zhvillohet me përulje, e thjeshtësi, dhe jo me mendjemadhësi. Ashtu siç rritet bima ne tokë të lagësht e të butë dhe jo në tokë të thatë e të ashpër."[1]

---

1) Uesail; vëll. 2, f. 457.

61

MBLEDHJA E SHKARPAVE NË SHKRETËTIRË

Në një udhëtim të tij së bashku me shokët, Profeti i Zotit (s.a.v.s) kishte ndaluar në një tokë të thatë dhe të shkretë. Ata kishin nevojë për disa shkarpa, që të ndiznin zjarrin. Profeti tha: Mblidhni shkarpa. O i Dërguari i Zotit, shikojeni sa e shkretë është kjo tokë, nuk duket fije shkarpe. –Çdokush të mbedhë aq sa të mundë!

Shokët dolën nëpër shkretëtirë. Mblidhin tek-tuk ndonjë shkarpë e shkop e i sillnin në vendin ku duheshin. Pak nga pak u bë një turrë e madhe me shkarpa. Profeti ndërkohë tha: Edhe mëkatet e vogla, janë si këto shkarpat e vogla. Në fillim nuk bien në sy, por çdo gjë e cila i kërkon dhe i mbledh, ashtu siç bëtë edhe ju duke i kërkuar e mbledhur shkarpat, ato bëhen shumë; edhe mëkatet mblidhen e shtohen dhe një ditë, shikoni se nga ato mëkate të vegla, që nuk binin në sy, keni mbledhur një turrë të madhe."[1]

---

1) Uesail; vëll. 2, f. 462.

62

VERA NË SOFËR

Mensur Davaniku, shpeshherë me raste të ndryshme, e thërriste imam Sadikun nga Medinia në Irak. Nganjëherë ai e mbante imamin edhe për kohë të gjatë.

Njëherë, kur imami ishte në Irak, njëri prej komandantëve të ushtrisë së Mensurit kishte bërë synet djalin e vet dhe me këtë rast, kishte shtruar një festë të madhe e kishte ftuar shumë njerëz. Ishin mbledhur aristokratët e shtresat e larta. Mes të gjithë atyre të ftuarve ishte dhe imam Sadiku. Ishte shtruar sofra e madhe dhe të gjithë ishin duke ngrënë e pirë. Në këtë mes, njëri prej të ftuarve kërkoi ujë. Gjoja për t'i dhënë ujë, i shtinë verë. Sapo e mori gotën në dorë, imam Sadiku u ngrit menjëherë, e la ushqimin përgjysmë dhe u largua. Iu turrën imamit nga pas që ta kthenin, por ai nuk u kthye. Imami u tha se Profeti kishte thënë: "Zoti nuk e do atë që është i ulur në një tryezë ku aty ka pije."[1]

---

1) Biharul Anuar; vëll. 11, f. 115.

63

DËGJIMI I KUR'ANIT ME VËMENDJE

Ibn Mes'udi ishte njëri prej shkruesve të Zbulesës, pra ishte nga ata njerëz që shkruanin ç'do gjë që shpallej nga Kur'ani. Ai i shkruante ato rregullisht dhe nuk linte që asgjë të fshihej a të humbiste.

Një ditë, erdhi Profeti atij dhe i tha: "Më lexo pak Kur'an që ta dëgjoj! Ibn Mes'udi nxori disa prej shënimeve të tij. Qëlloi Surja "Nisai." Ai po lexonte dhe Profeti po e dëgjonte me vëmendje derisa arriti në ajetin 41 të sures "Nisa" *"Dhe si do të jetë gjendja e atyre (që nuk besuan), kur Ne do të sjellim dëshmitarë për çdo popull, e ty do të sjellim dëshmitarë mbi ata (që nuk të besuan)?"*

Sapo ibn Mes'udi lexoi këtë ajet, sytë e Profetit u mbushën me lot dhe tha: "Kaq mjafton."[1]

---

1) Kehlul Basari; f. 79, i Muhaddith Kummij

64

I FAMSHMI I POPULLIT

Kishte kohë që në popull përmendej shumë emri i një njeriu. Fama e tij kishte arritur qiejt. Kudo, të gjithë njerëzit flisnin vetëm për famën e tij. Shpeshherë kishte qëlluar që njerëzit t'ia përmendin emrin dhe ta lavdëronin atë edhe në prani të imam Sadikut. Imami mendoi që larg syve të të tjerëve ta takonte një ditë këtë njeriun " e madhërishëm" për të cilin njerëzit flsinin e nuk dinin të pushonin, e ta shikonte me vetë sytë e tij se ç'kishte ky njeri që të tjerët ishin kaq shumë të dhënë pas tij. Kështu, një ditë shkoi që ta takonte pa i dhënë të njohur. Kur mbërriti tek ai, pa se njerëzit e thjeshtë ishin mbledhur përreth tij e po bisedonin. Imami pa e paraqitur e treguar veten se kush ishte, nisi të shikonte ngjarjet se si do rridhnin. Gjëja që i tërhoqi vëmendjen imamit ishte se rreth tij ishin mbledhur shumë njerëz të rëndomtë.

Pas pak, burri u nda nga njerëzit dhe filloi të ecte vetëm rrugës. Imami iu vu nga pas ngadalë që ta shikonte se ku do shkonte,dhe çfarë veprimi interesant do të bënte ai, që i kishte tërhequr të gjithë njerëzit.

Nuk zgjati shumë dhe burri shkoi përpara shitores së bukës. Me habinë më të madhe, imami pa që, sapo shitësi e kthehu kokën mënjanë, burri mori me lehtësi dy copë bukë, i fshehu nën rrobën e tij dhe iku. Imami mendoi me vete se ai ka dashur t'i blinte dhe për këtë i ka dhënë paratë më përpara, ose do t'ia japë më vonë. Mirëpo, pastaj mendoi ndryshe: po të ishte kështu, nuk kishte pse t'i merrte bukën kur shitësi nuk e kishte mendjen.

Ndërkohë që imami po mendonte për këto gjëra, burri mbërriti përpara një shitësi frutash dhe ndaloi aty. Sapo pa që shitësi nuk e kishte mendjen, mori dy kokrra shegë, i fshehu nën rrobë dhe iku. Imami u habit edhe më shumë. Imami u habit edhe më shumë kur pa se burri shkoi dhe ndaloi pastaj te një i sëmurë dhe i dha atij bukën shegët dhe iku. Në këtë kohë, imami i del atij përpara dhe i thotë: "Unë sot kam parë një punë shumë të çuditshme nga ti:" Dhe i tregoi atij të gjithë ngjarjen dhe i kërkoi shpjegim.

Ai i hodhi një vështrim fytyrës së imamit dhe i tha: - Mendoj se ti je Xhafer ibn Muhamedi.

-Po, drejt mendove, - i tha imami. Unë jam Xhafer ibn Muhamedi.

- Sigurisht që ti je biri i të Dërguarit të Zotit dhe ke nder e madhështi, por sa gjynah që je kaq i paditur.

- Ku e pe padituri në time?, - e pyeti imami.

- Kjo pyetje që bëre tani tregon padituri në tënde. Dihet që nuk mund të bësh llogari të thjeshtë në punët e fesë. A nuk e di ti që vetë Zoti në Kur'an e thotë që: "...çdo punë e mirë ka dhjetëfish shpërblim." Kur'ani thotë edhe: " ...çdo punë e keqe vlen sa për vete." Kështu, duke bërë këto llogari,

unë vodha dy bukë dhe dy shegë, që bëjnë gjithsej katër gjynahe. Mirëpo, ato dy bukë dhe dy shegë i dhashë në rrugën e Zotit dhe për secilën kam dhjetëfish shpërblim e gjithsej më llogariten dyzet të mira. Kështu, duke bërë një llogari të thjeshtë, nga dyzet të mira që kam, heq katër të këqija dhe me mbeten gjithsej 36 të mira. Pra, unë kam 36 të mira të plota. Kjo është dhe ajo llogaritja e thjeshtë që unë të thashë që ti nuk e kupton, - iu përgjigj ai burri imamit.

- O Zoti të vraftë ty - i tha imami. I padituri je ti që mendon kështu. A nuk e ke dëgjuar ajetin e Kur'anit i cili thotë: "Zoti pranon vetëm veprën e të pastërve". Tani një llogaritje shumë e thjeshtë mjafton që ti të kuptosh që je gabim. Ti, me mendjen tënde kujton se ke bërë katër gjynahe. Por, meqë ke marrë mallin e të tjerëve dhe e ke dhënë me emrin e bamirësisë dhe sadekasë, ti jo vetëm që nuk ke asnjë meritë e të mirë, por ke shtuar edhe numrin e atyre gjynaheve. Pra, katër gjynahe të para, u ke shtuar edhe katër gjynahe të tjera e gjithsej ke tetë gjynahe dhe asnjë meritë e të mirë.

Imami i tha këto fjalë, kur sytë e atij burri ishin qepur pas fytyrës së imamit me habi. E lëshoi atë dhe iku.

Kur ua tregoi shokëve të tij këtë tregim, imam Sadiku shtoi: "Ato lloj komentimesh dhe shpjegimesh injorante dhe të shëmtuara bëhen shkak që në çështjet e fesë të humbasin rrugën disa veta, sepse i bëjnë edhe të tjerët që të humbasin rrugën.[1]

1) *Uesail; vëll. 2, f. 57*

FJALA QË I DHA FUQI EBU TALIBIT

Profeti i Madhërishëm, pa u kushtuar rëndësinë më të vogël pasojave, bënte një qëndresë të habitshme përballë Kurejshëve, dhe vazhdonte rrugën e tij drejt qëllimeve që kishte. Ai nuk stepej: idhujt të rrëzohen e flaken tej. Ai vinte në lojë logjikën e paktë të idhujtarëve, duke u argumentuar atyre se ishin të humbur qysh me paraardhësit e baballarët e tyre. Krerët e Kurejshëve u zunë shumë ngushtë. Për këtë ata shkuan dhe folën me Ebu Talibin, që ose ai vetë ta ndalonte nipin e tij, Muhamedin, ose vetë Kurejshët të merreshin me të. Ebu Talibi, me një gjuhë të butë i ndaloi Kurejshët. Ca nga ca gjendja filloi të bëhej edhe më shtrënguese, për Kurejshët saqë ata vendosën të mos duronin më. Në çdo shtëpi flitej për Muhamedin (s.a.v.s). Sa herë që dy veta prej atyre takoheshin me njëri-tjetrin, flisnin me shqetësim se si njerëzit grupe-grupe a edhe një nga një po i bashkoheshin atij. Nuk duhej humbur më kohë. Të gjithë ranë në një mendje që këtë fortesë që po ngrihej, duhej ta rrëzonin me çdo kusht. Vendosën që edhe njëherë tjetër të shkonin tek Ebu Talibi, por kësaj radhe, të tregoheshin më seriozë dhe më të vendosur.

Krerët e Kurejshëve erdhën tek Ebu Talibi dhe i thanë: "Ne të patëm kërkuar që ta ndaloje nipin tënd, mirëpo ti këtë gjë nuk e bëre. Për shkak të respektit që kishim ndaj teje si burrë i mençur, nuk u ballafaquam vetë drejtpërdrejt me atë. Mirëpo tani nuk do të durojmë më, që ai të tallë zotat tanë, të qeshë me mendjet tona dhe të na quajë ne dhe baballarët tanë si të humbur. Këtë herë kemi ardhur për t'i dhënë fund çështjes: nëqoftë se ti nuk e ndalon nipin tënd kësaj radhe, atëherë ne nuk do ta respektojmë më figurën tënde dhe moshën tënde dhe do të futemi në luftë si me ty, ashtu dhe me atë, deri sa njëra palë të humbë plotësisht."

Ky ultimatum e shqetësoi shumë Ebu Talibin. Deri tani nuk kishte dëgjuar asnjëherë kaq fjalë të rënda nga Kurejshët. Ishte e qartë që Ebu Talibi nuk kishte fuqi që të ngrihej dhe të bënte qëndresë përballë Kurejshëve dhe, nëse puna do të shkonte deri aty, sa të bëhej me të vërtetë e rrezikshme, ai vetë, nipi i tij, dhe e gjithë familja e tij e fisi i tij do të ndëshkoheshin.

Duke parë këtë gjëndje, ai dërgoi një njeri te Profeti, i cili i shpjegoi atij gjendjen dhe i tha: "Meqë puna arriti deri këtu, tërhiqusepse si ti, ashtu dhe unë jemi që të dy në rrezik."

Profeti e ndjeu se ultimatumi i Kurejshëve kishte ndikuar te xhaxhai i tij, Ebu Talibi. Ai shkoi dhe e takoi xhaxhanë e tij. Duke iu përgjigjur Ebu Talibit, ai tha një fjalë, e cila i zhduku nga mendja të gjitha fjalët që Kurejshët i kishin thënë xhaxhait: "Xhaxha i dashur, edhe sikur të më thonë që në dorën e djathtë do të më vendosin diellin dhe në dorën e majtë do të më japin hënën, unë prapë nuk heq dorë nga rruga ime, derisa Zoti ta shpalosë plotësisht fenë e tij, ose

derisa unë të jap shpirtin tim në këtë rrugë." Pasi tha këto fjalë, sytë iu mbushën me lot dhe lëvizi që të largohej. Nuk kishte bërë as dy hapa, kur ndaloi me urdhër të Ebu Talibit dhe ky i tha: "Atëherë, meqë është kështu, vepro ashtu siç di ti më mirë. Betohem në Zot, që deri në frymën e fundit unë do të të mbroj."[1]

1) *Sijretu ibn Hisham; vëll. 1, f.265.*

STUDENTI NË MOSHË TË MADHE

Sekaki ishte një zanatçi në punimin e gdhendjen e metalit. Ai kishte arritur që më mjeshtërinë e tij të ndërtontë një bravë me një çelës shumë të vogël dhe këtë gjë me shumë dëshirë priste që t'ia dhuronte mbretit. Priste që të gjithë ta lavdëronin e ta përgëzonin për mjeshtërinë e tij. Me një mijë shpresa dhe dëshira shkoi te mbreti. Në fillim, ashtu siç e kishte paramenduar dhe vetë, tërhoqi vëmendjen e të gjithëve, mirëpo ndodhi diçka, e cila e ndryshoi plotësisht rrjedhën e mendimit dhe të jetës së Sekakit.

Kur mbreti po vështronte shpikjen e Sekakit, edhe ai ishte i zhytur në ëndërrimet e veta. U dha lajmi që aty po vinte një dijetar shumë i madh. Sapo dijetari u fut brenda, mbreti aq shumë u dha pas tij duke e pritur dhe duke folur me të, saqë e harroi plotësisht Sekakin dhe punën e tij. Duke parë këtë skenë, Sekaki pësoi një ndryshim shumë të thellë në shpirt. Ai kuptoi që nga kjo punë ai nuk mund ta arrinte atë famë e përkujdesje që ai priste dhe se të gjitha ato shpresa e dëshira ishin të kota. Mirëpo shpirti entuziast i Sekakit nuk mund ta linte atë të qetë. Ç'duhej bërë tani? Mendoi që të bënte atë punë që kishin bërë të gjithë dhe të ecte asaj

rruge që kishin ecur të gjithë. Duhej që të ndiqte librat dhe studimet dhe t'i kërkonte aty shpresat dhe ëndrrat e humbura. Megjithëse e dinte shumë mirë që për një burrë në moshë madhore si ai, të shkonte e të ulej në mësime me nxënës të rinj e të papjekur, nuk ishte një punë e lehtë; por nuk kishte rrugë zgjidhje tjetër. Peshku në çdo kohë që të peshkohet, është i freskët.

Më e keqja nga të gjitha ishte se kur filloi të mësonte, vuri re që nuk kishte asnjë lloj dëshire e talenti për këtë punë. Ndoshta, meqë për shumë vjet kishte punuar si zanatçi duke u marrë me metalet, i ishte larguar dëshira për mësime.

Por, as mosha, as mungesa e dëshirës për të mësuar nuk arritën ta kthejnë atë nga vendimi që kishte marrë. E mori punën e re me shumë seriozitet, derisa ndodhi diçka.

Një ditë mësimi, mësuesi po i shpjegonte diçka: "Mendimi i mësuesit është ky: lëkura e qenit pastrohet me regjës lëkure." Sekaki e përsëriti kaq shpesh këtë fjali në mendjen e tij që ta jepte mirë provimin kur të vinte. Por në kohën kur po jepte provimin e tha kështu fjalinë: "Mendimi i qenit është që lëkura e mësuesit pastrohet regjës lëkure**"**

Plasën të qeshurat gjithandej. Të gjithë u bindën që ky burrë në këtë moshë, edhe pse i është mbushur mendja për të studiuar, nuk do të arrijë gjëkundi. Sekaki nuk mund të rrinte më as në shkollë e as në qytet, e kështu shkoi drejt shkretëtirës. Tani bota e gjërë i ishte ngushtuar shumë. Ec e ec mbërrin buzë një mali. Aty pa që nga lart binin pikat e ujit mbi një shkëmb, dhe e kishin bërë vrimë vendin ku binin. E vështroi për pak çaste këtë skenë. Një mendim i shkrepi si rrufe në mendje e tha me vete: "Zemra ime sido

që të jetë, më e fortë se ky shkëmbi nuk është.”U kthye menjëherë në shkolë dhe filloi sërish studimet. Pak nga pak, filloi t’i rilindë pasioni për të mësuar dhe arriti të bëhej një nga mësuesit e rrallë të letërsisë.[1]

1) *Reudatul Xennati; f. 747, botuar nga Haxhi Sejjid Said*

67

BOTANISTI

Mësuesit e Karl Linesë, skeptikë e të pashpresë; vajtën tek i ati, i cili ishte prift dhe i thanë që të mos shpresonte te përparimi e zhvillimi i të birit , sepse ai nuk kuptonte asgjë dhe se nuk vinin re asnjë prirje tek ai. I propozuan që do të ishte më mirë që të birit t'i jepte një punë krahu sesa studime.

Por prindërit e Linesë, të cilët ishin shumë të dhënë pas të birit, ndonëse pesimistë, e dërguan të studionte për mjekësi në universitet. Ata nuk kishin shumë të ardhura e prandaj paguan një shumë fare të vogël për studimet e të birit. Nëse nuk do të kishte qenë ndihma e një njeriu bamirës i cili u njoh me Linenë në oborrin e universitetit, mjerimi dhe varfëria do ta kishte mbytur Linenë. Përkundër dëshirës së prindërve të tij të cilët i kishin caktuar degën që ai duhej të studionte në universitet, Lineja u fut të studionte botanikë**.** Ai kishte qënë i dhënë pas bimëve qysh në vogëli dhe këtë dhunti e kishte të trashëguar nga i ati. Kopshti i të atit ishte i mbushur me bimë të shumëllojshme dhe qysh kur ishte fëmijë, e ëma e kishte mësuar që sa herë që ai qante, ajo i jepte atij në dorë një lule dhe ai pushonte.

Kur studionte për mjekësi, atij i ra në dorë libri i një botanisti francez dhe vendosi që të merrej me zbulimin e sekreteve të bimëve. Në atë kohë, një nga çështjet e cila zinte shumë vend në mesin e dijetarëve dhe botanistëve ishte klasifikimi i drejtë i bimëve. Lineja arriti që të jepte një klasifikim të vetin të veçantë në bazë të substacës së bimëve, çka tërhoqi shumë vëmëndje.

Për këtë botoi dhe një libër, i cili u bë shkak që në universitetin ku studionte të zinte një pozitë në degën, ku tashmë u bë e qartë që ai kishte talent. Mirëpo xhelozia e të tjerëve u bë pengesë që kjo punë të zhvillohej më tej.

Lineja u deh nga suksesi i vet. Ishte hera e parë që ai po ndjente gëzimin dhe kënaqësinë e punës së tij. Nga ana tjetër, ai nuk u dha aspak rëndësi pasojave dhe arriti të shtinte në dorë një mision shkencor, duke u nisur kështu në një udhëtim të largët e të gjatë për studimin e natyrës dhe të bimëve. Mjetet që mori me vete ishin një palë rroba, një lupë, dhe një tufë me letra. Ai arriti të bënte gjithsej shtatë mijë km rrugë, duke u përballur me probleme dhe vështtirësi të ndryshme dhe u kthye me një pasuri të madhe diturish dhe studimesh. Pas tre vjetësh, në vitin 1735, ai kthehet në vendlindjen e tij, në Suedi. Duke parë që aty nuk kishte punë të sigurt u shpërngul për në Hamburg. Gjatë kohës që ai po vizitonte një nga muzetë e Hamburgut, i tregoi drejtorit të muzeut një prej thesareve të tij më të rralla, që kishte gjetur në udhëtimin e tij të gjatë që pati bërë. Dhe ai ishte një gjarpër ngjyrë blu me shtatë koka. Kokat nuk ngjanin me kokë gjarpëri, por më shumë me koka nuselalesh. Gjykatësi i zonës, i trembur nga ky vizitor i pazakontë dhe

ters, dha urdhër që ai të largohej nga qyteti. Sërish, Lineja iu fut udhëtimeve të gjata. Në këtë kohë ai dha dhe tezën e tij në mjekësi. Madje gjatë udhëtimeve të tij që i dha më shumë famë,ai arriti të botonte dhe një libër me titull "Aparati i Natyrës". Një prej pasanikëve të Amsterdamit i propozon që të ndërtonte një kopsht me lule, shumë të bukur dhe të pashoq. Në këtë mënyrë, ai arriti që të çlodhte këmbët e tij, të lodhura nga udhëtimet. Në saje të mirësisë së bamirësit të tij ai arriti të shkonte edhe në Francë, dhe të futej në pyjet "Mudun" për të studiuar bimët.

Më në fund, dhimbja e kurbetit dhe malli për atdheun e mundën atë e kështu, u kthye në Suedi. Kësaj radhe, atdheu ia diti vlerën duke e vlerësuar dhe nderuar me shumë tituj e çmime. Në saje të vullnetit e punës, mësuesit e shkollës së tij i erdhën dhe i kërkuan të falur.[1]

1) Tarihul Ulum Pijerusu; f. 382 dhe 383.

ORATORI

Demosteni, shkrimtar dhe politikan i famshëm në Greqinë e lashtë, ka lindur në të njëjtin vit me Sokratin dhe ka vdekur po në të njëjtin vit me të. Në vitet e fillimit të rinisë së tij nisi të mësonte artin e gojtarisë. Këtë nuk e bëri me qëllim që të bëhej mësues dhe edukator i mirë, as për të marrë pjesë në mbledhjet e rëndësihme politiko-shoqërore që të jepte mendime, as për t'u bërë gjykatës a avokat mbrojtës i mirë. Ai ia hyri kësaj rruge vetëm e vetëm që të merrte hak ndaj njerëzve të cilët kishin qenë tutorët e tij në fëmijëri dhe i kishin ngrënë pasurinë që kishte trashëguar nga i ati.

Kishte kaluar disa kohë që ai po merrej me këtë punë. Nga malli i të atit nuk arriti të shtinte në dorë asgjë. Por kishte ecur shumë në oratori dhe vendosi që të merrte pjesë në mbledhjet e popullit dhe të mbante fjalime. Në fillim, kur i kishte hyrë kësaj pune ai nuk kishte shkëlqyer kushedi se çfarë, as nga shprehja, as nga tonaliteti i zërit, theksi, frymëmarrja, as edhe nga ana teknike e gjërave që shprehte. Por me përkrahjen e shokëve dhe të miqve dhe me shumë ambicje ai i rregulloi të gjitha të metat që kishte. Ai mori një shtëpi nën tokë dhe vetëm aty ushtrohej. Për të rregulluar theksin e vet, filloi të recitonte poezi me zë të lartë; që

të rregullonte frymën, ai ngjitej me vrap maloreve, ose recitonte me një frymë epika të gjata. Mbante fjalim përpara pasqyrës, që të gjente të metat e veta në shprehjen e fytyrës. Aq shumë i vazhdoi ushtrimet e veta derisa u bë një prej oratorëve më të mëdhenj të botës.[1]

Shoqata flladi

1) Njohja e oratorisë; vëll. 2, f. 5 dhe 6, i autorit, i ndjeri Muhamed Ali Furugij.

FRYTI I UDHËTIMIT NË TAIF

Ebu Talibi, xhaxhai i Profetit dhe Hatixheja, bashkëshortja e tij e dashur, me një periudhë të shkurtër kohe nga njëri-tjetri, ishin larguar që të dy përgjithmonë nga kjo botë. Në këtë mënyrë, për pak ditë, Profeti kishte humbur mbrojtësit dhe mbështetësit e tij më të mirë, si jashtë shtëpisë, pra xhaxhanë e tij, Ebu Talibin, ashtu dhe brenda shtëpisë, gruan e tij, Hatixhenë, e cila ishte më e përzemërta dhe më dhembshura e tij brenda familjes.

Vdekja e Ebu Talibit, aq sa kishte qënë e rëndë për Profetin, kaq u kishte hapur rrugë të lirë edhe Kurejshëve që ta sulmonin më lirshëm tani Profetin. Nuk kishin kaluar veç disa ditë nga vdekja e Ebu Talibit, kur Profeti po kalonte nga një rrugicë dhe i hodhën baltë e dhè mbi kokë. Ashtu, i bërë tërë dhè, ai kthehet në shtëpi. Njëra prej vajzave të Profetit, që ishte dhe më e vogla Fatimeja (a.s) vrapoi drejt të atit dhe i pastroi rrobat dhe kokën. Profeti pa që e bija po qante dhe i tha: "Bija ime, mos qaj! Babi yt nuk është i vetëm. Ai ka Zotin që e mbron."

Nuk kaloi shumë kohë nga kjo ngjarje dhe ai largohet nga Meka për në qytetin me klimë shumë të mirë e plot begati që quhej Taif. Ky qytet ishte dhe vendi i çlodhjes dhe

i dëfrimit të pasanikëve Mekas. Profeti shkoi aty që të ftonte në fenë e tij të parët e fisit "Thakif."

Nga banorët e Taifit nuk pritej ndonjë gjë e madhe. Banorët e qytetit ishin plot huqe dhe teka e kishin pothuajse të njëjtin temperament si Mekasit që jetonin përreth Qabes, të cilët jetonin me dhuratat që u faleshin idhujve. Por Profeti nuk ishte njeri që mërzitej a bëhej pesimist prej problemeve. Për të fituar zemrën e dikujt, ai ishte i gatshëm të përballej me vështirësitë më të mëdha.

Hyri brenda ne Taif. Nga banorët e qytetit, dëgjoi po ato fjalë që kishte dëgjuar nga Mekasit. Njëri i tha: "A nuk kishte njeri tjetër Zoti që të zgjodhi ty Profet?!" Kurse një tjetër i tha: "Paça vjedhur unë mbulesën e Qabes, në qofsh ti Profet!" Kurse një i tretë i tha: "Unë nuk dua të dëgjoj asnjë fjalë prej teje, e kështu llafesh të tjera."

Jo vetëm që nuk pranuan të dëgjonin fjalët e Profetit, por nga frika se dikush tjetër mund t'i dëgjonte ato, provokuan një grup fëmijësh dhe vagabondësh që ta përzinin Profetin nga qyteti i Taifit.

Nisën ta shanin, ta fyenin e ta gjëmonin me gurë Profetin. Me shumë mundime dhe vështirësi Profeti i nderuar arriti të largohej nga qytetei i Taifit dhe të shkonte në një kopësht jashtë qytetit për të pushuar. Kopësht u përkistë dy vetave - Atibesë dhe Shibesë, të cilët ishin dy pasanikë të mëdhenj Kurejshë. Rastësisht, atë çast, edhe ata të dy gjendeshin aty. Këta i kishin parë që nga larg ngjarjet dhe ishin shumë të gëzuar për atë që kishte ndodhur. Fëmijët dhe të tjerët u kthyen pas në Taif.

Profeti i Zotit u ul nën hijen e rrushit të vreshtave, larg Atibesë dhe Shibesë, që të çlodhej pak. Ishte vetëm ai. Ai dhe Zoti i tij. U kthye drejt Zotit dhe tha: "O Zot, po të tregoj për dobësinë dhe paaftësinë time dhe mbylljen e rrugës për shpëtimin e njerëzve. O Më i Miri i më të mirëve! Ti je Zoti i të gjithë atyre që janë më të vegjël. Ti je Zoti im, mua në dorë të kujt më lë? O Zot, ajo që më ndodhi mua nuk vjen prej asaj që unë e kisha hak dhe Ti ishe i zemëruar prej meje. Fusha e shëndetit tim është shumë herë më e gjerë. Unë strehohem tek drita Jote, e cila i ndriçon të gjitha errësirat dhe drejton punën e kësaj bote dhe të Tjetrës. Nëse Ti do ta zbresësh zemërimin Tënd mbi mua, unë sërish jam i lumtur për atë që më vjen nga Ty. Asgjë në botë, asnjë forcë, asnjë ndryshim, asnjë rrotullim nuk bëhet veçse me Ty dhe nga Ti."

Atibeja dhe Shibeja, të cilët ishin të gëzuar nga humbja e Profetit, thirrën shërbëtorin e tyre të krishterë, Edasin dhe i thanë të merrte një vesh rrush, e t'ia çonte atij burrit që ishte ulur nën hije dhe të kthehej menjëherë tek ata.

Edasi, ia çoi vilen e rrushit Profetit dhe i tha: "Ha!" Profeti zgjati dorën dhe përpara së t'i hante kokrrat e rrushit tha: "Bismilah".

Këtë fjalë Edasi nuk e kishtë dëgjuar ndonjëherë më parë. Ishte hera e parë që e dëgjonte dhe i nguhitur te fytyra e Profetit, tha: "Kjo fjali nuk është e njërëzve të kësaj zone. Çfarë fjalie është ajo?!"

Profeti e pyeti Edasin se nga ishte dhe çfarë feje kishte. Edasi iu përgjigj që ishte nga Nejneva.

-Pra, ti qënke nga qyteti i njeriut të Zotit, Junus ibn Matit?

- E habitshme, ti këtu dhe në mesin e këtyre njerëzve nga e di emrin e Junus ibn Matit? Vetë në Nejneva, ku isha unë, as dhjetë veta nuk bëheshin që ta dinin emrin "Mati", babait të Junusit.

-Junusi është vëllai im. Ai ishte Profeti i Zotit. Edhe unë jam Profeti i Tij,- iu përgjigj Pejgamberi.

Atibeja dhe Shibeja panë nga larg që Edasi po qëndronte dhe po rrinte me Profetin. U mërzitën shumë nga kjo gjë. Ata u trembeshin shumë bisedave të njerëzve me Profetin. Pastaj, ata vunë re që Edasi ra në gjunjë dhe po i puthte duart Profetit. U kthyen dhe i thanë njëri-tjetrit: "A e pe që na e prishi dhe shërbëtorin e shkretë!"[1]

Shoqata Flladi

1) Sijretu ibn Hisham; vëll. 1, f.419 - 421.

EBU IS'HAK SABI

Ebu Is'hak Sabi është një prej shkrimtarëve të famshëm të shekullit të katërt (Hixhri). Për njëfarë kohe ka jetuar në oborrin e Kalifit Abasit dhe njëfarë kohe tjetër e ka kaluar në oborrin e Azaldule Bakhtiarit. Ebu Is'haku mbiquhej "Sabi", që do të thotë që "besonte se Zoti nështë Një (teuhid) por nuk besonte në profetësinë. Bakhtiari u mundua shumë që ta bënte Ebu Is'hakun të pranonte Islamin, por nuk ia arriti. Gjatë maujit të Ramazanit, ai mbante agjërim për respket të myslimanëve dhe dinte shumë gjëra përmendsh edhe nga Kur'ani. Në shkrimet dhe letart e veta, e përmendte shumë Kur'anin. Ebu Is'haku ishte letrar dhe poet. Ishte edhe shok i afërt me Sejjid Sherif Radjiun, poet e letrar gjithashtu i cili ka vdekur rreth vitit 384 (Hixhri).

Sejjid Radiju ka shkruar një poezi për Ebu Is'hakun e cila ka tri strofa që kanë këtë përmbajtje:

A e pe se çfarë njeriu po mbartin në arkëmort? A e pe se si u shua qiriri?

U rrëzua një mal. Nëse ky mal do të rrëzohej në det, do ta trazonte atë duke ia bërë sipërfaqen tërë shkumë.

Unë, përpara se ty të të përpijë dheu, nuk e besoja që dheu mund të mbulonte edhe majat e maleve më të larta.

Disa njerëz erdhën e i thanë, që një njeriu si ai që ishte aq i ditur dhe kishte dritën profetike në shpirt, nuk i shkonte që të shkrunate një poezi për vdekjen e Sabiut dhe të shprehte keqardhjen për vdekjen e tij.

Sabiu u tha: "Unë i këndova atij për shkak të dijes dhe njohurivë që kishte. Pra në të vërtetë i këndova, dijes dhe mençurisë."[1]

Shoqata Flladi

1) *Uefijatul A'jani; vëll. 1, f. 36, i ibn Hal-lakanit dhe El Kunaa uel Elkabi; vëll. 2, f. 365, i muhaddith Kummij.*

NË KËRKIM TË SË VËRTETËS

Kërkimi i së vërtetës dhe arritja te burimi i besimit, nuk e linte të qetë Envan Basrin. Udhëtoi shumë dhe më në fund, mbërrti në Medine, e cila ishte qendra e mësimeve islame. Shkoi të mësonte pranë dijetarit të madh të asaj kohe Malik ibn Enesit.

Te Maliku, zakonisht thuheshin, shkruheshin dhe mësoheshin hadithet e Profetit. Kështu, edhe Basri, ashtu si të gjithë studentët e tjerë merrej me shkrimin dhe mësimin e hadithëve, si edhe emrat e njerëzve që kishin përcjellë hadithet. Ai merrej me këtë që të shuante zjarrin e tij të brëndshëm.

Në atë kohë, imam Sadiku (a.s) nuk ishte në Medine. Pas pak kohë imami u kthye në Medine dhe, Envan Basriun e dërguan të mësonte tek imami, ashtu siç kishte mësuar tek Maliku.

Por, me qëllim që t'ia nxiste më shumë atë zjarrin e brëndshëm që kishte, imami e largoi atë duke i thënë: "Unë jam zënë me shumë punë, kështu që mos më shqetëso. Siç ke shkuar më përpara te Maliku, shko mëso sërish!"

Këto fjali iu lëshuan menjëherë si shigjeta në trurin e Basrit. I erdhi keq nga vetja. Mendoi me vete që nëse imami do

të shikonte talent, dhunti a aftësi tek ai, nuk do ta kishte larguar. Shumë i mërzitur, shkoi në xhami, i përshëndeti të gjithë dhe pastaj me një mijë hidhërime u kthye në shtëpinë e tij.

Të nesërmen pasi kreu faljen, u kthye nga Zoti dhe tha: O Zot, Ti që je Sunduesi i të gjitha zemrave. Të lutem që të zbusësh zemrën e Xhafer ibn Muhamedit për mua dhe të më pranojë në gjirin e tij, të më mësojë nga dituria e tij, që unë të gjej rrugën tënde të drejtë?"

Pasi u fal dhe bëri këtë lutje, u kthye menjëherë në shtëpinë e tij. Nga çasti në çast e ndjente se po i shtohej dashamirësia për imam Sadikun. Kjo gjë e bënte të vuante edhe më shumë. Nuk dilte nga shtëpia e tij, vetëm se për t'u falur. Nuk shihte rrugëzgjidhje. Nga njëra anë imami i kishte thënë të mos e shqetësonte, ndërsa nga ana tjetër, kaq shumë e vlerësonte dhe donte ta takonte imamin e të mësonte prej tij. Nuk kishte ç'të bënte tjetër, derisa i sosi durimi. Veshi rrobat e mbathi këpucët e shkoi te shtëpia e imamit. Tek dera i del shërbyesi, që e pyet se ç'punë kishte.

- Asgjë, vetëm desha ta përshëndes pak imamin,
- i përgjigjet Basriu.
- Imami po fal namazin,- i thotë shërbyesi.

Nuk zgjati shumë, kur shërbyesi i kthehet dhe i thotë: Urdhëroni brenda!

Basriu hyri në shtëpi. Sapo pa imamin, e përshëndeti. Imami ia ktheu përshëndetjen dhe bëri një lutje të shkurtër për të e pastaj e pyeti: Si e ke emrin?

- Ebu Abdullah, - iu përgjigj ai.

- Zoti ta ruajt këtë emër e të dhashtë ndriçim!, - iu përgjigj imami.

Kur dëgjoi këtë lutje, Basriu mori shumë zemër e guxim, e tha me vete: Edhe sikur të mos përfitoj gjë tjetër nga ky takim, ajo lutja ishte më se e mjaftueshme. Pastaj imami e pyeti:- Çfarë pune ke dhe çfarë kërkon?

- I kërkova Zotit që të hapte zemrën tënde për mua dhe unë të mësoja nga dituria jote. Shpresoj që Zoti të ma ketë plotësuar dëshirën.

- "O Ebu Abdullah! Urtësia e Zotit dhe drita e besimit nuk mësohen duke shkuar atje e duke ardhur këtu, duke trokitur te kjo derë e duke trokitur tek ajo tjetra; as duke shkuar te ky person e as tek tjetri. Kështu nuk mund ta fitosh atë dritë. Kjo dituri nuk është mësim. Është drita, të cilën, sa herë që Zoti dëshiron, ta drejtojë një rob të Tijin, e fut atë në zemrën e tij. Nëse ti kërkon këtë lloj urtësie dhe drite, atëherë atë kërkoje brenda vetë shpirtit tënd dhe gjeje te vetja. Dijen kërkoje nga rruga e veprimit. Kërkoja Zotit dhe Ai vetë do ta japë atë në zemër..." – iu përgjigj imami.[1]

---

1) El Kunaa uel Elkabi; vëll. 2 dhe *Biharul Anuar; vëll. 1, f. 224, hadithi17.*

KËRKUESI I QETËSISË

Në të gjithë shtetin e gjërë Selxhuk, shkolla e Bagdadit dhe shkolla e Neishaburit shkëlqenin si dy yje. Kërkuesit e dijes dhe të diturisë turreshin drejt njërës prej këtyre qendrave të mëdha të dijes. Rreth viteve 450-478 (Hixhri) drejtimin e shkollës së Neishaburit e kishte në dorë Ebu Meala, imamu'l Haremejni Xheuini. Me qindra studentë mblidheshin në shkollën e tij e studionin, shkruanin e mësonin. Në mesin e të gjithë studentëve dalloheshin tre veta, të cilët ishin: Muhamed Gazali Tusi, Kejahrasi, Ahmed bin Khauafij.

Për këta tre veta i erdhi kështu fjala në vesh imam Haremejnit: "Gazali është një det plot dallgë; Kia është një luan i fuqishëm; Kheuafij është një zjarr përvëlues." Në mesin e këtyre tre vetave Gazali mbahej si më kërkuesi dhe luftuesi. Kështu gjatë gjithë asaj kohe, e tërë shkolla e Neishaburit i kishte sytë nga Muhamed Gazali.

Imam Haremejni, i cili vdiq në vitin 478, filloi ta mbante Gazalin afër. Ai e dërgoi atë pastaj te veziri i ditur Selxhuk, Hauaxha Nidhamul Melik Tusi. Aty Gazali u prit shumë mirë dhe u respektua ng atë gjithë. Në të gjitha bisedat dhe argumentat ai dilte i fituar mbi të gjithë. Posti i drejtimit

të shkollës së Bagdadit kishte mbetur bosh dhe për këtë duhej një njeri i aftë e i ditur. Nuk kishte pikë dyshimi që njeri më të duhur se ky djalosh që vinte nga Horasani nuk kishte. Në vitin 484 (Hixhri), Gazali u fut plot nderime në Bagdad duke u ulur në postin e drejtorit të shkollës.

Tashmë, Gazali kishte arritur postin më të lartë të dijetarëve. Ai shikohej si dijetari dhe kleriku më i madh i kohës. Ai ndërhynte edhe në punët politike. Kalifi i asaj kohe, Muktedir Bil-lah dhe ai pas tij, Mustedh'hir Bil-lah kishin shumë respekt për të. Po kështu, edhe mbreti i Persisë së asaj kohe, Melikshah Selxhuki dhe veziri i tij, Melik Tusi kishin shumë nderim e respekt për të. Mesa dukej, Gazali kishte arritur kulmin e tij dhe për të nuk kishte mbetur më post tjetër. Por mu kur ai ishte ulur në fronin e lavdisë, ajo flaka që gjendej brenda tij, e cila, pak a shumë e shoqëroi gjatë gjithë jetës së tij, e dogji menjëherë.

Gazali seç kishte një ndjenjë të veçantë brenda vetes gjatë kohës së studimeve, nga e cila ai kërkonte qetësi, besim dhe siguri. Sapo arriti te kulmi i të mirave tokësore, sërish ajo ndjenja e kureshtjes iu ngjall nga brenda. Gjërat të cilat kënaqnin të tjerët, nuk ishin të mjaftueshme për të. Atij nuk i ishte kënaqur ende shpirti i tij i etur dhe kurioz. E pa që mësimet dhe studimet nuk ishin më të mjaftueshme e tashmë duhej vepruar dhe besuar. Me vete tha që emri i bukës nuk të ngop, emri i verës nuk të deh, dhe as emri i ilaçit nuk të shëron. Edhe të flasësh për të Vërtetën, besimin dhe qetësinë sërish nuk i arrin ato. Për të arritur të Vërtetën duhet të jesh i pastër e kjo nuk arrihet me famën , as me postin e as me lëvdatat.

Brenda shpirtit të tij lindi një konflikt i çuditshëm. Ishte një dhimbje që askush përveç tij dhe Zotit të tij nuk mund ta dinte dhe ta zgjidhte.

Gjashtë muaj vazhdoi kjo gjendje, derisa ai më në fu n dpreu ushqimin. Gjuha nuk i fliste më. Nuk kishte më fuqi që të jepte mësim. Ra në shtrat i sëmurë. Mjekët thanë se ai kishte sëmundje shpirtërore. Rruga e shpëtimit ishte e mbyllur nga të gjitha anët. Nuk kishtë shpëtim tjetër veç Zotit dhe së Vërtetës. I kërkoi Zotit që ta shpëtonte nga ajo gjendje. Mirëpo nuk ishte e lehtë. Nga njëra anë, ajo ndenjë e fuqishme i vlonte nga brenda; nga ana tjetër, nuk ishte punë e lehtë të hiqej dorë nga tërë ajo pozitë, respekt e madhështi. Më në fund, vendosi që të largohej nga e gjithë ajo pozitë tokësore. Nga frika se mos mërziteshin njerëzit hapi lajmin se do të shkonte në Mekë. Kështu, doli jashtë Bagdadit. Sapo ishte larguar disi nga Bagdadi, i ktheu mbrapsht të gjithë shoqëruesit që kishte me vete dhe mori rrugën për në Siri dhe Palestinë. Me qëllim që të mos e njihte askush dhe të mos e shqetësonte njeri gjatë udhëtimit të tij të brendshëm, ai veshi rrobat e dervishit. Ai eci drejt rrugës së tij, derisa më në fund, arrti besimin dhe qetësinë e brendshme që kërkonte. Dhjetë vjet zgjati e gjitha koha e tij e mendimit, qetësisë dhe kënaqësisë shpirtërore.[1]

---

1) *Përkthim nga MUnkidh mine Dalaletu (I'tiraft Gazali) dhe tarih ibn Hal-lakan; vëll. 5, f.351 dhe 352 dhe Gazaliname*

I ETURI QË MBANTE SHTAMBËN E UJIT MBI SUPE

Ishte fundi i stinës së verës dhe vapa kishte pushtuar të tërë vendin. Thatësia dhe shtrenjtësia kishte rënë mbi banorët e qytetit të Medinës. Ishte stina e mbledhjes se hurmave. Njerëzit donin që të jetonin pak të qetë, por pas lajmeve shqetësuese që kishin mbërritur, Profeti i nderuar dha urdhër për mobilizim të përgjithshëm, pasi myslimanët kërcënoheshin nga ana e romakëve në pjesën e tyre verilindore. Për myslimanët nuk ishte një punë e lehtë që, pas asaj thatësire dhe vape që kishin kaluar, të linin tani mbledhjen e frutave dhe në mes të vapës të niseshin nga Medina për në Siri. U krijuan plotësisht edhe kushtet e duhura për sabotuesit.

Por as thatësira, as vapa, as ndërhyrjet e sabotuesve, asnjëra prej tyre nuk arritën t'i parandalonin myslimanët për të krijuar një ushtri prej rreth 30 mijë vetash, për të përballuar një sulm të mundshëm nga ana e romakëve (Bizantit).

Morën rrugën e shkretëtirës. Dielli përvëlonte mbi krye. Ushqimet dhe uji nuk ishin në masën e duhur. Rreziku i mbarimit të ushqimeve dhe shtimi i vapës nuk ishtë më i paktë se sa rreziku i armikut. Disa veta me besim të dobët

u penduan gjatë rrugës. Papritur një burrë, i quajtur Ka'ab ibn Malik, u kthye mbrapsht dhe mori rrugën e Medines. Shokët i thanë Profetit që Ka'ab bin Maliku ishte kthyer. Profeti u tha: "Lëreni të shkojë! Nëse tek ai do të ketë ndonjë të mirë, Zoti do t'jua japë atë ju shpejt; e, nëse jo, Zoti ju ka shpëtuar juve prej dëmit të tij."

Nuk zgjati shumë dhe shokët i thanë Profetit: "O i Dërguari i Zotit, u kthye edhe Meraretu ibn Rabi'i. Profeti u tha: "Lëreni të shkojë. Nëse tek ai do të ketë ndonjë të mirë, Zoti do t'jua japë atë ju shpejt; e nëse, jo, Zoti ju ka shpëtuar ju prej dëmit të tij."

Sërish nuk zgjati shumë dhe shokët i thanë Profetit sërish: "U kthye dhe Hilal ibn Amije. Profeti i Zotit sërish u tha shokëve të tij të njëjtën fjali si më parë.

Deveja e Ebu Dher-rit, që ishte së bashku me varganin, mbeti në mes të rrugës dhe nuk ecte më. Abudhari sado që u mundua ta kapte varganin, nuk ia arriti. Shokët e Profetit e vunë re këtë gjë dhe i thanë: "O i Dërguar, u kthye dhe Ebu Dher-ri." Sërish, Profeti u përgjigj me gjakftohtësi: "Lëreni. Nëse tek ai do të ketë ndonjë të mirë, Zoti do t'jua japë atë ju shpejt; e nëse, jo, Zoti ju ka shpëtuar ju prej dëmit të tij."

Ebu Dher-ri sado që u përpoq duke e nxitur devenë që të lëvizte, sërish nuk ia doli mbanë ta kapte varganin. Zbriti nga deveja, mori të gjitha mjetet e tij mbi supe dhe u nis më këmbë. Iu tha goja për ujë. E kishte ngulitur mendjen që nuk kishte qëllim tjetër veç të arrinte sa më shpejt Profetin dhe shokët e tjerë dhe kishte harruar çdo gjë tjetër. Ashtu siç po vazhdonte rrugën, pa që nga njëra anë e qiellit ishte

një re që dukej se kishte hedhur shi. E ktheu drejtimin e rrugës andej nga ishte reja. Arriti te një shkëmb ku ishte mbledhur pak ujë shiu. Piu shumë pak ujë dhe me me vete mendoi që atë ujë ta merrte me vete e t'ia shpinte Profetit, se mos ndoshta ai kishte mbetur pa ujë e nuk kishte se çfarë të pinte. Mbushi me ujë shtambat që kishte me vete, i vuri mbi supe dhe u nis rrugës. Ecte i djegur për ujë nëpër shkretëtirë, derisa nga larg sytë i zunë ushtrinë e myslimanëve. Zemra i rrahu nga gëzimi dhe filloi të ecte edhe më shpejt. Një ushtari i ra në sy diçka e zezë, e cila po vinte drejt tyre. Shkoi dhe i tha Profetit: më duket se dikush po vjen drejt nesh.

"Sa mirë është sikur të jetë Ebu Dher-ri," - tha Profeti

Pika e zezë u afrua më shumë, kur dikush thirri: "Po për Zotin, është vetë Ebu Dher-ri."

-Zoti e ndihmoftë Ebu Dher-rin. Ai jeton vetëm, do të vdesë vetëm, dhe do të ringjallet i vetëm.

Profeti i doli përpara Ebu Dher-rit, i hoqi ngarkesat që kishte mbi supe dhe i uli përtokë. Ebu Dher-ri, i etur dhe i lodhur, u shtri përtokë.

-Sillni shpejt ujë Ebu Dher-rit sepse është i etur, - urdhëroi Profeti.

-Kam ujë me vetë, - tha Ebu Dher-ri.

- Ke pasur ujë me vete dhe nuk e ke pirë?, - e pyeti Profeti.

-Po, iu përgjigj. Arrita te një shkemb, ku ishte mbledhur pak ujë. Piva pak vetë, pastaj thashë më vete nuk po pi se do t'ia çoj Profetit, që të pijë ai."[1]

---

1) Ebu Dher-rul Gaffari, I autorit Abdul Hamijd Xhudetu Es Sahhar, përkthyer nga Ali Sheriati.

74

GODITJA PËR TË RRËZUARIN

Abdullah bin Mervani vdiq në vitin 86 (Hixhri), pas 21 vjetësh sundimi të egër. Pas tij, postin e zuri i biri, Velidi. Me qëllim që të ulte pakënaqësitë e popullit, Velidi vendosi të ndërmerrte disa reforma dhe të ndryshonte sjelljen e tij me popullin. Sidomos, me popullin e Medines,sepse ishte një nga dy qytetet më të shenjta të myslimanëve, si edhe qendra e pasardhësve të Profetit dhe e shokëve të tij. Kështu, si masë të parë, hoqi nga detyra Hisham ibn Ismailin, që ishte vjehrri i Abdul Malikut, e më përpara guvernatori i Medines dhe kishte bërë shumë shtypje e padrejtësi e njerëzit e dëshironin rrëzimin e tij.

Hishami kishte bërë shumë padrejtësi me popullin e Medines. Seid ibn Musejjebin, i cili ishte dijetar i përmendur i haditheve dhe respektohej shumë nga populli i Medines, e kishte rrahur me kamzhik 60 herë, pastaj të veshur me zhele, e kishte hipur mbi deve dhe e kishte sjellë vërdallë gjithë rrugëve të Medines. Po kështu, ai ishte sjellë keq dhe me pasardhësit e Aliut (a.s) e veçanërisht, me imam Ali ibn Husejn; me Zejnul Abidinin ishte sjellë shumë herë më keq.

Velidi, e shfuqizoi Hishamin dhe në vend të tij vuri Omer ibn Abdul Azizin, djalin e ri të xhaxhait të vet, duke e paraqitur si njëri të mirë dhe të drejtë. Që të fitonte zemrën e popullit, Omeri dha urdhër që Hisham ibn Ismailin ta sillnin përpara derës së shtëpisë së sundimtarit dhe kushdo që kishte parë a dëgjuar keq prej tij, të vinte dhe të merrte hakun tashmë. Njërëzit filluan të vinin grupe-grupe. Hisham ibn Ismaili nuk dëgjonte gjë tjetër përveç se të shara, të goditura, fyerje e mallkime. Hishami vetë, më shumë së të gjithë të tjerëve i trembej imam Ali ibn Husenjit dhe Alevitëve. Me vete mendonte që hakmarrja e imamit për ato fyerje dhe të këqija, që unë u kam bërë atij dhe familjarve të vet, nuk do të jetë gjë tjetër veçse vrasja ime. Por, imami u tha Alavive që "ne nuk jemi nga ata që godasim armikun kur ai është rrëzuar e t'ia marrim hakun atij kur ai është i dobët; përkundrazi, morali ynë është që t'i ndihmojmë të rrëzuarit." Në kohën kur imami erdhi së bashku me pasuesit e tij, Hishamit i iku fytyra. Priste nga çasti në çast vdekjen e tij. Por përkundër asaj që priste ai, imami iu afrua zakonisht ashtu si myslimani myslimanit dhe i tha: "Selam Alejkum!" Pastaj iu afrua dhe i tha" "Nesë ka ndonjë ndihmë që mund të ta jap unë, jam i gatshëm."
Pas kësaj ngjarje, edhe populli i Medines, e la atë të qetë.[1]

1) Biharul Anuar; vëll. 11, f. 17 dhe 27. El Imamu Sadik; vëll. 1,f. 111. Imam Zejnul Abidin. i autorit Abdul Azijz Sejjidul Ehl, përkthyer nga Husejn Vixhdanij, f.92

BURRI I PANJOHUR

Grujaja e shkretë kishte vënë mbi supe shtambën e ujit dhe duke marrë frymë e lodhur, po shkonte për në shtëpi. Një burrë i panjohur e hasi atë rrugës, ia mori asaj shtanbën e ujit nga shpina dhe e vari mbi supet e veta. Fëmijët e vegjël ia kishin qepur sytë derës së shtëpisë dhe prisnin të vinte nëna e tyre. Dera e shtëpisë u hap. Fëmijët panë se së bashku më të ëmën hyri në shtëpi edhe një burrë i panjohur, që po mbante mbi supe shtambën e ujit. Pasi vuri shtambën e ujit mbi tokë, burri pyeti: Duket që nuk ke burrë, sepse shkon vetë e mbush ujë. Si ka ndodhur që keni mbetur pa burrë?

"Im shoq ishte ushtar. Ali ibn Ebu Talibi e dërgoi atë në kufi dhe atje u vra. Kështu që kam mbetur e ve, me fëmijët e mi të vegjël", - u përgjigj gruaja.

Burri i panjohur nuk tha më asnjë fjalë. Uli kokën, i përshëndeti ata e u largua. Mirëpo atij nuk i dilte nga mendja gruaja e ve dhe fëmijët e saj. Nuk e kaloi natën i qetë. Të nesërmen në mëngjes mori pak miell, mish, fruta e hurma dhe shkoi drejt shtëpisë, ku kishte qenë dje. Trokiti në derë.

-Kush është?, - pyeti gruaja.

-Jam unë, ai burri që ju ndihmoi dje të mbanit shtambën e ujit. Ju kam sjellë pak ushqim për fëmijët.

-Zoti qoftë i kënaqur prej jush dhe mes nesh dhe Ali Abu Talibit, Zoti të vendosë vetë, - tha gruaja dhe i hapi derën.
Burri i panjohur u fut në shtëpi: -Kam dëshirë që brumin dhe gatimin e bukës ose fëmijët t'i kem unë përsipër.
-Shumë mirë, - tha gruaja, por unë di më mirë ta përgatis brumin e të gatuaj bukën. Ti kujdesu për fëmijët, atëherë.
Gruaja shkoi të përgatiste brumin. Burri i panjohur mori mishin që kishte sjellë me vete, e poqi dhe së bashku me hurmat filloi të ushqente fëmijët. Kur i ushqente, u thoshte: "Fëmijët e mi, faleni Ali ibn Abu Talibin në qoftë se nuk është kujdesur për ju!"
Gruaja e bëri brumin gati dhe i tha burrit të panjohur që të përgatiste zjarrin. Flakët e zjarrit filluan të nxirrnin lart gjuhët e tyre. Burri i panjohur afroi fytyrën drejt tyre, dhe tha: "Shijoje nxehtësinë e zjarrit! Ky është shpërblimi i atij që nuk kujdeset për jetimët dhe gratë e veja."
Ndërkohë, në shtëpi vjen një grua fqinje e cila e shikon dhe e njeh burrin e panjohur dhe i thotë zonjës së shtëpisë: "Nuk e njeh këtë burrin që të ka ndihmuar?! Ky është Emirul Mu'minini Ali ibn Ebu Talibi."
Gruaja e shkretë i doli përpara Aliut dhe i tha: "Të lutem, më fal një mijë herë! Është shumë turp për mua. Të kërkoj shumë ndjesë!"
"Jo, - iu përgjigj Aliu. Jam unë ai që duhet të të kërkoj falje, që nuk jam kujdesur për ju".[1]

1) Biharul Anuar; vëll. 7, f. 597 kreu 103

DJALI I HATEMIT

Përpara shfaqjes së Islamit dhe krijimit të shtetit Islam, arabët ishin të ndarë në fise e secili fis kishte kryetarin e tij. Duke iu bindur urdhërave të prijësve të tyre, arabët e kishin bërë traditë që prijësve t'u paguan atyre taksa e t'u jepnin gjë të gjallë. Njëri nga këta prijës ishte dhe Hatem Taj, një prijës autoritar i fisit Taj. Pas vdekjes së Hatemit, vendin e tij e zuri i biri, Eadi, dhe fisi Taj e pranoi atë. Eadi,çdo vit u merrte pjesëtarëve të fisit një të katërtën e të ardhurave si taksë. Sundimi dhe pushteti i Eadit qëlloi në të njëjtën kohë me ardhjen e Profetit dhe zgjerimin e Islamit.

Fisi Taj ishte idhujtar. Vetë Eadi ishte i besimit të krishterë, por e mbante këtë të fshehur prej popullit.

Arabët të cilit kishin pranuar Islamin dhe ishin kthyer ne myslimanë tashmë, duke u njohur dhe me mësimet liridhënëse të Islamit, pak nga pak filluan të dilnin jashtë bindjes dhe sundimit prijësve të tyre, duke u bërë të lirë. Kështu, edhe Eadi ibn Hatem, ashtu si të gjithë sunduesit dhe aristokratët e tjerë, e shikonin Islamin si rrezikun më të madh, e shfaën armiqësi ndaj Profetit të nderuar. Por, tanimë nuk mund të bëhej asgjë. Dita ditës, njerëzit përkrahnin Islamin duke u kthyer në myslimanë. Edhe Eadi

e dinte që një ditë do t'i vintë radha dhe atij e do t'i kërkonin që dhe ai të hiqte dorë nga pushteti i tij. Eadi i dha urdhër shërbëtorit të tij personal që të grumbullonte dhe të mbante gati devetë më të shëndetshme dhe, kur ushtria e Islamit të afrohej, ai ta njoftonte menjëherë atë.

Një ditë, shërbëtori erdhi duke thirrur: "Vendos ç'ke për të bërë sepse ushtria e Islamit është afruar shumë". Eadi dha urdhër dhe të gjithë familiarët e tij, bashk me mallrat e plaçkat e shtrenjta që kishte, i hipën e i ngurzuan nëpër deve dhe me nxitim u nis drejt Sirisë, ku kishte njerëzit e të tjerë të tij. Mirëpo nga nxitimi i madh, kur po bëhej gati për t'u larguar, harroi të merrte me vete të motrën e tij, Sefanenë.

Ushtria e Islamit mbërriti aty kur Eadi ishte larguar. Sefanenë e morën së bashku me robërit e tjerë dhe e dërguan në Medine, Profetit i treguan për ikjen e Eadit. Jashtë xhamisë së Medines kishte një mur ndarës. Aty i vendosën robërit. Një ditë prej ditësh, Profeti i nderuar po kalonte aty pranë që të futej në xhami. Ndërkohë, Sefaneja, e cila ishte një grua e kuptueshme dhe e shkathët, lëvizi nga vendi dhe i tha Profetit: "Babai më ka vdekur, kurse kujdestari im është arratisur. Të lutem ndihmomë, e Ty të ndihmoftë Zoti!.

Profeti e pyeti;- Kush ishte kujdestari i saj?

"Eadi ibn Hatem"- iu përgjigj ajo.

"Ai që është arratisur prej Zotit dhe të Dërguarit të Tij?!" - tha Profeti dhe u largua prej andej pa e zgjatur shumë.

Të nesërmen sërish Profeti po kalonte andej dhe Sefaneja iu afrua e i tha të njëjtën gjë si ditën e shkuar. Edhe Profeti iu përgjigj po në të njëjtën mënyrë si ditën e mëparshme.

Sërish Sefaneja nuk mori asnjë përgjigje edhe këtë ditë. Sefaneja e cila i kishte humbur shpresat tashmë dhe ditën e tretë vendosi mos t'i kërkontë asgjë Profetit, sepse e dinte që kërkesa e saj nuk do pranohej. Kur Profeti po kalonte aty pranë, ajo pa një djalë të ri, i cili po ecte pas Profetit, i cili ia bëri me shenjë që t'u bënte kërkesën Profetit. Sefaneja lëvizi dhe bëri kërkesën e saj si dy ditët e para. Ajo i doli përpara Profetit dhe i tha: "Babai më ka vdekur, kurse kujdestari im është fshehur. Të lutem ndihmomë e Ty të ndihmoftë Zoti!"
Profeti kësaj radhe iu përgjigj: "Shumë mirë, jam në pritje të gjetjes së njerëzve të besueshëm, që së bashku me ta të të dërgoj te fisi yt. Nëse mëson se kanë ardhur njerëz të tillë në Medine, më njofto!"
Menjëherë pas kësaj Sefaneja pyeti njerëzit që ishin aty se kush ishte ai djali i ri që vinte pas Profetit dhe që ia bëri asaj me shenjë që t'u thoshte kërkesën e vet Profetit? I thanë që ai ishte Ali ibn Ebu Talibi.
Pas disa kohësh, Sefaneja e lajmëroi Profetin që në Medine kishte ardhur një grup nga fisi i saj dhe ajo kërkonte që tani të ikte së bashku me ta. Profeti i dha asaj një palë rroba të reja dhe disa para për rrugë dhe e nisi drejt të vëllait për në Siri.
Kur pa të vëllanë, Eadin, i tha; "Ti u ngrite menjëherë, mblodhe gruan dhe fëmijët, e unë që jam kujtimi i babait tënd, më harrove?"
Eadi i kërkoi shumë të falur. Meqë Sefaneja ishte një grua e kuptueshme, Eadi kërkoi të këshillohej me të, dhe një ditë e pyeti: Si mendon ti, ti që e pe Muhamedin nga afër, si

është më mirë, të shkoj e të bashkohem me të, apo t'i largohem edhe më shumë?

Sefaneja iu përgjigj: "Për mendimin tim, është mirë që ti të shkosh e të bashkohesh me të. Nëse ai është me të vërtetë Profeti i Zotit, atëherë për ty veç të mira do të ketë; nëse nuk është Profet dhe kërkon vetëm që të marrë pasuri, atëherë shko në Jemen që nuk është larg që andej dhe vendosu aty me atë personalitet që kenë mes të banorëve të Jemenit dhe kështu që sërish nuk humbet asgjë."

Eadi ra një mendje me këtë dhe vendosi të shkonte në Medine, e ta shikonte me vëmendje nga afër punën e Profetit: ishte, me të vërtetë Profeti i Zotit dhe të bashkohej me të, apo kishte thjesht dëshirë për pushtet e mbretëri, e të mos i bashkangjitej atij.

Profeti ishte brenda xhamisë së Medines kur hyri Eadi. Profeti pyeti se kush ishte?

"Jam Ead ben Hatemi",- iu përgjigj ai.

Profeti u ngrit dhe e respektoi atë e pastaj e mori me vete në shtëpi. Gjatë rrugës për në shtëpi, një grua e dobët dhe e moshuar i del përpara Profetit dhe fillon ta pyesë. Kjo gjë zgjati për pak kohë; Profeti qetësisht u përgjigjej të gjitha pyetjeve të saj.

Eadi tha me vete: "Kjo është një shenjë e tij që tregon se ai është Profet. Ata që kërkojnë pushtet e pasuri, nuk e kanë këtë sjellje e edukatë, që t'i përgjigjen një plake me kaq dashamirësi."

Kur Eadi u fut në shtëpinë e Profetit, pa që ajo ishte një shtëpi e thjeshtë dhe pa luks. Aty ishte vetëm një dyshek, ku dukej e qartë që në të ulej vetë Profeti. Profeti ia shtroi

dyshekun Eadit. Sado që Eadi këmbënguli që në të të ulej vetë Profeti, ai nuk pranoi. Eadi u ul në dyshek; Profeti u ul përtokë. Eadi tha me vete: "Kjo është shenja e dytë e këtij burri, që tregon sjellje Profetësh dhe jo sjellje mbretërish." Profeti u drejtua nga Eadi dhe i tha: A nuk ishte ti besimit të krishterë?

-Po, -u përgjigj Eadi.

-Atëherë pse ti mblidhje një të katërtën e të ardhurave të fisit tënd? Te feja jotë nuk është kjo punë?

Eadi, i cili fenë e tij e kishte mbajtur gjithmonë të fshehtë edhe nga njerëzit e tij më të afërt, u befasua dhe habit shumë nga kjo që dëgjoi prej Profetit e tha me vete; "Kjo është shenja e tretë që tregon që ky burrë është Profet".

Pastaj Profeti i tha Eadit: "Ti e shikon varfërinë dhe dobësinë financiare të sotme të myslimanëve, Ai e shikon që në kundërshtim me kombet e tjera, myslimanët janë të varfër. Ti e shikon që të gjithë armiqtë u janë vërsulur myslimanëve, dhe ata nuk kanë aspak siguri për jetën dhe për mallin e tyre, e shikon që fuqia dhe pushteti është në duart e të tjerëve. Të betohem në Zot, që kjo gjendje nuk do të zgjatë shumë dhe kaq pasuri e madhe do të bjerë në duart e myslimanëve, sa ne mes tyre nuk do të mund të gjëndet një i varfër. Betohem në Zot që armiqtë e tyre do të thyhen keqas, dhe do të vendoset siguria e plotë, saqë një femër mund të udhëtojë e vetme nga Iraku në Siri,e askush nuk do ta shqetësojë atë. Betohem në Zot, se është e afërt koha kur kullat e bardha të Babilonisë do të bien në duart e myslimanëve".

Eadi, i bindur, e pranoi Islamin me pastërti dhe deri në fund të jetës së tij ai i qëndroi atij besnik. Ai jetoi edhe shumë vite të tjera pas Profetit. Ai përherë kujtonte takimin e tij të parë me Profetin dhe parashikimet që i kishte thënë e thoshte të tjerëve: "Betohen në Zot se nuk vdiqa dhe arrita të shikoj kullat e bardha të Babilonisë që ranë në duart e myslimanëve. Siguria u vendos aq e fortë saqë një grua mund të udhëtojë e vetme nga Iraku në Siri, pa e shqetësuar askush. Betohem në Zot se kam besim që do të vijë koha kur në mesin e myslimanëve nuk do të gjendet as edhe një i varfër."[1]

Shoqata Flladi

1) Siiretu Ibën Hisham; vëll. 2, f. 578-780. Ndodhitë e vitit 10 të Hixhrit

77

PROVIMI I INTELIGJENCËS

Si përfundim, askush prej nxënësve nuk kishte arritur që t'i jepte një përgjigje të saktë pyetjeve të përgatitura prej mësuesit të tyre të madh. Secili dha përgjigjen e tij, mirëpo asnjëra nuk u pranua. Pyetja që Profeti kishte përgatitur për shokët e tij ishte: Ndër elementet e besimit, cili është më i forti?"

Njëri u përgjigj: "Namazi"

Tjetri tha: "Zekati"

Dikush tha: "Agjërimi".

Një tjetër tha: "Haxhi".

Njëri u hodh e tha: "Xhihadi", e të gjitha këtyre pyetjeve Profeti u dha përgjigjen "Jo".

Meqë askush prej të pranishmëve nuk e dha përgjigjen e duhur, vetë Profeti u përgjigj: "Të gjitha këto që ju thatë, janë punë të mëdha dhe të nderuara, por asnjëra prej tyre nuk është ajo që unë pyeta. Pjesa më e fortë e besimit është të duash dikë për hir të Zotit dhe, të qëndrosh larg diçkaje po për hir të Zotit".[1]

1) El Kafij vëll. 2, f. 25, kreu Dashuria dhe urrejtja për hir të All-llahut. Uesail; vëll. 2, f. 497

XHUJBERI DHE ZELFA

- Sa mirë do të ishte sikur të martoheshe dhe të krijojë familjen tënde e t'i jepje fund kësaj jete të vetmuar. Ti të ndihmoje gruan tënde dhe ajo të të ndihmonte ty në punët e kësaj bote dhe të botës tjetër,- i tha Profeti Xhujberit.

- O i Dërguari i Zotit,- iu përgjigj ai. Unë nuk kam asgjë, as pasuri e as bukuri, as shtëpi e as katandi, e kush do të më japë mua nuse? Cila është ajo femër do të ishte e gatshme që të jetonte më një burrë të varfër, të shkurtër, zezak dhe të shëmtuar si unë?

-O Xhubar, i tha Profeti. Nëpërmjet Islamit Zoti i ka ndërruar vlerat e njerëzve dhe të individeve. Shumë prej atyre që kanë qenë të respektuar para padijes, para Islamit, Islami i ka vënë poshtë.

Shumë veta të tjerë gjatë kohës së injorancës nuk kishin asgjë e ishin të vobektë, mirëpo Islami u ngriti atyre vlerat e personalitetin.Islami hoqi fodullëkun e injorancës dhe i dha krenari familjes dhe bashkimit. Tashmë, të bardhë e të zinj, kurejshë e jokurejshë, arabë dhe joarabë, janë të gjithë në një shkallë, askush nuk është më lart se tjetri, përveç në besim dhe pastërti. Në mes të myslimanëve unë shikoj më lart se ti vetem një njeri, i cili besimin dhe veprimin e ka më të mirë se ty. Tani bëj ashtu siç të thashë.

Këto ishin fjalët që u shkëmbyen një ditë mes Profetit dhe Xhujberit në një prej takimeve me Shokët e Sofesë
Xhujberi ishte nga qyteti i Jemamesë. Ai kishte qenë aty kur dëgjoi për famën dhe zërin e Islamit dhe ardhjen e Profetit të fundit. Sado që ishte i varfër, zezak dhe i shkurtër, ishte shumë i zgjuar dhe njeri i drejtë. Pasi ia dëgjoi zërin Islamit, shkoi menjëherë në Medine, që t'i shikonte më nga afër ngjarjet.
Nuk zgjati shumë dhe pranoi Islamin, duke u bërë pjesë e myslimanëve. Mirëpo meqë nuk kishte as shtëpi, as katandi e as njohje, me urdhër të Profetit, ishte vendosur përkohësisht në xhami. Ca e nga ca, ai u njoh edhe me njerëz të tjerë, të cilët, edhe ata si Xhujberi, ishin bërë myslimanë e kishin ardhur në Medine, por meqë qënë të varfër, me urdhër të Profetit ishin të strehuar të gjithë në xhami. Më pas Profetit iu shpall që xhamia nuk ishte vendbanimi dhe ata duhej të dilnin që andej e të vendoseshin diku tjetër. Profeti caktoi një vend jashtë xhamisë, dhe aty u ndërtua një banesë për këtë grup njerëzish. Këtë vend e quajtën "Sofe". Meqë aty banonin njerëzit që ishin dhe të varfër, edhe të huaj në qytet, thirreshin "shokët e Sofesë". Profeti dhe shokët e tij përkujdeseshin për ta.
Një ditë Profeti kishte ardhur t'i takonte ata. Në mes të të gjithëve sytë I zunë Xhujberin dhe mendoi me vete që ta nxirrte nga ajo gjëndje e t'i japte një drejtim jetës së tij. Mirëpo gjëja e cila nuk i shkonte kurrë ndërmend Xhujberit, duke pasur parasysh gjendjen e tij, ishte ajo që ai një ditë të kishte shtëpinë dhe gruan e tij. Kjo ishte dhe arsyeja që, kur Profeti bëri propozimin e martesës, ai me habi u përgjigj:

"A është e mundur që dikush të martohet me mua?" Por Profeti e shmangu menjëherë nga gabimi duke i folur për ndryshimin e gjendjes shoqërore që kishte sjellë Islami.
Pasi e shmangu nga gabimi Xhujberin, duke e bërë atë të sigurt dhe optimist për jetën, Dërguari i Zotit, dha urdhër që të shkonte menjëherë te shtëpia e Zijad ibn Labid Nasarit dhe të kërkonte dorën e së bijës, Zelfës.
Zijad ibn Labidi ishte një nga njerëzit e pasur dhe të respektuar të Medines. Anëtarët e fisit të tij e respektonin shumë atë. Kur Xhujberi u fut në shtëpin e Zijadit, pa që ishin mbledhur njerëz shumë nga fisi i Labidëve.
Xhujberi, pasi u ul, ndenji pak, pastaj ngriti kokën dhe i tha Zijadit: Unë kam një fjalë për ju nga Profeti, t'jua them fshehurazi apo haptazi?
-Fjala e Profetit është nder për mua. Sigurisht, thuaje haptazi: - u përgjigj Zijadi.
-Profeti ka thënë që unë t'ju kërkoj ju për vet dorën e vajzës suaj, Zelfën,- i tha Xhujberi - Profeti vetë ta ka thënë ty këtë gjë? - e pyeti Zijadi.
-Unë nuk flas nga vetja, të gjithë më njohin dhe e dinë që unë nuk gënjej,- tha Xhujberi.
- E habitshme, -tha Zijadi, ne nuk e kemi per zakon që vajzën tonë t'ia japim përveç atij të rangut tonë. Ti shko, unë do ta takoj vetë Profetin dhe do të flas vetë me të për këtë çështje.
Xhujberi u ngrit dhe doli nga shtëpia. Rrugës kur po dilte po mendonte me vete: "Për Zotin ajo që thuhet në Kur'an dhe ajo që thotë Profeti, është tjetër gjë me atë që thotë Zijadi."

Kushdo që kalonte afër, e dëgjonte Xhujberin t'i thoshte këto fjalë me vete.

Zelfa ishte një vajzë e bukur, e njohur për bukurinë e saj. Kur dëgjoi fjalët e Xhujberit, erdhi tek i ati dhe deshte të mësonte më shumë rreth çështjes. Ajo e pyeti të atin: -"Baba! Ky burri që sapo doli nga shtëpia çfarë pëshpëriste me vete dhe çfarë qëllimi kishte?

-Ky burri kishte ardhur të kërkonte dorën tënde dhe mëtonte se e kishte dërguar Profeti,- iu përgjigj i ati.

-Po sikur ta ketë dërguar Profeti me tërë mend atëherë përgjigjja jote del si mospranim i kërkesës së Profetit?!, – iu përgjigj e bija.

-Sipas teje si t'ia bëj?,- e pyeti i ati.

-Për mendimin tim, dil jashtë dhe ktheje në shtëpi përpara se të shkojë te Profeti dhe pastaj shko vetë te Profeti dhe pyete sesi është puna, – i tha e bija.

Zijadi e ktheu Xhujberin me respekt në shtëpinë e tij dhe vetë u nis për te Profeti. Sapo e pa, i tha:-"O i dërguari i Zotit! Xhujberi erdhi në shtëpinë tonë dhe tha se kishte një fjalë prej jush, kërkonte dorën e vajzës sime. Dua të them se zakoni ynë është që vajzat tona t'ua japim vetëm atyre të rangut tonë, të gjithë shokëve dhe miqëve tënd."

O Zijad!,-iu kthye Profeti. Xhujberi është besimtar. Ata njerëz të cilët thua ti, sot kanë humbur. Burri besimtar është më i përshtashmi për gruan besimtare.

Zijadi u kthye menjëherë në shtëpi dhe i tregoi ngjarjen së bijës Zelfës.

"Për mendimin tim, mos e hidh poshtë propozimin e Profetit. Çështja më përket mua. Me Xhujberin sido që

të jetë, unë duhet të jem e kënaqur. Përderisa Profeti i Zotit është i kënaqur me këtë punë, edhe unë duhet të jem e kënaqur", -u përgjigj Zelfa.

Zijadi e martoi Zelfën me Xhujberin. Edhe pajën e nuses e bëri vetë ai. Pastaj e pyeti Xhujberin nëse kishte shtëpi ku ta fuste nusen.

Xhujberi iu përgjigj:- "Unë nuk e kisha menduar që një ditë të bëhesha me nuse dhe të filloja jetën time. Profeti erdhi e ma tha këtë gjë papritur."

Shih, Zijadi e bleu vetë shtëpinë. E pajisi me të gjitha mjetet e nevojshme. Bleu dhe rroba të përshtatshme për dhëndrin. E çoi nusen në shtëpinë e re me të gjithë pajën e sendet e nevojshme.

U bë natë. Xhujberin e morën dhe e dërguan te shtëpia e re dhe te nusja e tij. Sapo i ranë sytë mbi nusen e bukur, shtëpinë, rrobat, iu kujtua e kaluara. Mendonte me vete që ai kishte qenë një njeri i varfër dhe i panjohur kur kishte ardhur në qytet. Nuk kishte pasur asgjë, as mall as pasuri e as të afërm. Zoti, nëpërmjet Islamit, krijoi gjithë këto të mira për mua,- tha ai me vete. Është Islami ai, i cili ka sjellë kaq shumë ndryshim në jetën e njerëzv, që as nuk mund të paramendohej. Sa duhet ta falenderoj unë Zotin!

I mallëngjyer nga e gjitha kjo shkoi në një cep të shtëpisë dhe filloi të këndonte Kur'anin. Kur e mori veten, dëgjoi se kishte ardhur koha namazit të mëngjesit. Atë ditë, për të shprehur falenderimin e tij, Xhujberi vendosi ta agjeronte. Kur gratë e reja shkuan të shikonin Zelfën, vunë re që ajo ishte ende e virgjër, e paprekur. Xhujberi nuk i ishte afruar Zelfës. Këtë gjë nuk ia treguan Zijadit.

Edhe dy ditë e dy netë të tjera kaluan në këtë mënyrë. Xhujberi agjëronte ditën kurse natën falej dhe lexonte Kur'anin. Pak nga pak te famija e nuses filloi të krijohej mendimi se mos ndoshta Xhujberi ishtei paaftë për bashkëshort dhe nuk kishte nevojë për femër. Të detyruar, çështjen ia thanë Zijadit. Zijadi shkoi dhe e foli me Profetin. Profeti thirri Xhujberin dhe i tha;- "A thua tek ti nuk ekziston dëshira për femrën?"

-Nuk është kështu,- iu përgjigj Xhujberi, tek unë kjo dëshirë është e fortë.

-Po, atëherë deri tani përse nuk i je afruar nuses?, – e pyeti Profeti.

- O, i Dërguari Zotit!- Kur e pashe veten mes atyre bekimeve brenda asaj shtëpie , rashë në mendime se si Zoti e kishte ndihmuar një njeri të shkretë si unë. U ndjeva i detyruar që të falënderoj Zotin. E pashë të nevojshme që përpara çdo gjëje tjetër, të falënderoja Zotin. Që sonte, do te shkoj pranë gruas sime.

Profeti i tregoi Zijadinit se si qëndronte puna. Xhujberi dhe Zelfa u martuan dhe të dy bashkë kaluan kohë të lumtura. Filloi një luftë e shenjtë. Xhujberi, me atë zellin e entuziazmin që është e veçanta e njerëzve besimtarë, luftoi nën flamurin e Islamit dhe ra dëshmor. Pas vdekjes së Xhujberit, asnjë grua tjetër nuk kishte më shumë kërkesa se Zelfa, dhe për asnjë grua nuk ishin të gatshëm të harxhonin aq para sa për Zelfan.[1]

1) El Kafij; vëll. 5, f. 34)

79

NJË KËSHILLË

Një njeri këmbëngulte shumë: kërkonte një fjali prej Profetit si këshillë. Profeti i tha: - po të ta them, a do ta vësh në jetë?
-Po, o Profet i Nderuar,- iu përgjigj ai.
-Po të ta them, do ta vësh në jetë?,- e pyeti sërish Profeti
-Po, -u përgjigj sërish ai.
Nëse ta them, do ta vësh në punë? -e pyeti sërish Profeti
-Po, u përgjigj sërish ai.
Pasi e mori prej tij tri herë fjalën që ai do ta zbatonte këshillën e tij, duke i tërhequr vëmendjen për atë që do t'i thoshte, Profeti i tha: "Sa herë që të marrësh vendim për të bërë një punë, mendo më përpara për frytin, për përfundimin e saj. Po e pe që ajo e ka përfundimin e mirë, vazhdoje atë punë; po e pe se ajo punë nuk e ka fundin e mirë e të çon në humbje, hiq dorë nga vendimi yt."[1]

1) Uesail; vwll. 2, f.457.

VENDIMI I PAPRITUR

Kur Harun Rashidi dëgjoi që Sefvani, "karvanthiu" i kishte shitur të gjitha devetë e karvanit dhe tashmë kalifi duhej të mendonte diçka tjetër për të shkuar në Haxh, u habit dhe u inatos shumë. Filloi të mendonte që shitja e të gjitha deveve të karvanit kur kishte lidhur marrëveshje me kalifin, për të transportuar të gjitha mjetet dhe plaçkat për udhëtimin e Haxhit, nuk ishte një gjë e zakonshme, nuk ishtë e pamundur që shitja e deveve të mos kishte lidhje më kontratën e tyre. Ai e thirri Sefvanin dhe i tha: - Kam dëgjuar që e ke shitur të gjithë karvanin e deveve përnjëherësh.

- Po, O Emiru'l Mu'menin,- iu përgjigj Sefvani.
- Përse?- e pyeti kalifi.
- Jam plakur dhe nuk kam me fuqi të punoj. Fëmijët nuk e kanë ndër mend këtë punë. Kështu që e pashë më të dobishme t'i shisja.
- Më thuaj të vërtetën, përse i shite?,- i tha kalifi sërish.
- Kjo ishte, ashtu siç ju thashë,- iu përgjigj ai.
- Por unë e di përse ti e ke bërë këtë punë,- iu përgjigj Haruni. Pa dyshim që Musa ibn Xhaferi ka marrë vesh për kontratën që lidhe me ne për transportimin e mallrave tona e të ka penguar nga kjo gjë.Ai të ka urdhëruar që t'i shesësh devetë. Ky është dhe shkaku i vendimit tënd të papritur.

Pastaj Haruni shumë i zemëruar thirri: "Sefvan! Po të mos ishte për hatër të miqësisë së vjetër, ta kisha prerë kokën m'u në vend".

Haruni e kishte menduar mirë.Sefvani, sado që ishte pranë aparatit shtetëror të kalifit e në të kaluarën kishte kaluar shumë kohë në oborr pranë kalifit, ishte një prej ithtarëve të Ehli Bejtit familjes së Profetit

Pasi kishte lidhur marrëveshje me Harunin për të transportuar rrobat dhe mallrat për në haxh, një ditë Sefvani kishte takuar imam Musa ibn Xhaferin (a.s) i cili i kishte thënë:

-Sefvan, të gjitha gjërat e tua janë të mira, përveç një gjëje.

-Cila është ajo gjë, O biri i Profetit?,- e kishte pyetur Sefvani.

-Ajo që i ke dhënë devetë e tua me qira atij burrit,- i tha imami.

- O i Biri i Profetit,- tha Sefvani. Unë nuk kam dhënë gjë të ndaluar me qera. Haruni po niset për në haxh dhe unë e dhashë karvanin me qira për në haxh. Veç kësaj unë nuk do të shkoj vetë më të, do të dërgoj disa njerëz të mi.

-Sefvan! Të të pyes për diçka?, - tha imami. Ti i dhe devetë e tua që të marrësh qira për të. Ai do të marrë devetë e tua, dhe sipas marrëveshjes, pret që të marrësh qiranë prej tij. A nuk është kështu?

-Po, kështu është,- u përgjigj Sefvani.

-Atëherë, ti nuk ke dëshirë që Haruni të jetojë, të paktën derisa të të japi ty qiranë tënde?

-Po,- u përgjigj Sefvani.

-Kush kërkon, në çfarëdo menyre qoftë që shtypësi të jetojë a ti qëndrojë, llogaritet si vetë ai dhe konsiderohet shtypës e nuk ka vend tjetër vetëm se në zjarr.
Pas kësaj bisede, Sefvani mori vendim menjëherë që ta shiste karvanin e tij të deveve, sado që e kishte menduar që ky vendim mund t'i kushtonte atij jetën.[1]

Shoqata Flladi

1) *Sefinetul Bihari; vëll. 2, fjala dhulmun (padrejtwsi).*

PARAJA ME BEREQET

Ali ibn Ebu Talibin e kishte dërguar Profeti në pazar për t'i blerë një këmishë. Shkoi atje dhe bleu një këmishë, që kushtonte 12 dërhem dhe ia solli Profetit. Profeti e pyeti se sa e kishte blerë?

-12 dërhem,- iu përgjigj Aliu.

-Kjo nuk më pëlqen dhe aq shumë,- tha Profeti. Dua një më të lirë se kjo. A pranon shitësi t'ia kthejmë?

-Nuk e di o i Dërguari i Zotit,- u përgjigj Aliu.

-Shko e pyete,- i tha Profeti.

Aliu mori këmishën dhe u nis sërish drejt pazarit. Shkoi te shitësi dhe i tha: "Profeti kërkon një këmishë më të lirë se kjo.A je i gatshëm të marrësh këmishën e të na kthesh paratë?"

Shitësi pranoi. Aliu mori paratë e shkoi tek Profeti. Pastaj Profeti së bashku me Aliun u nisën për në pazar. Rrugës, sytë e Profetit panë një skllave të vogël e cila po qante. Profeti i shkoi afër dhe e pyeti përse po qante:

-Të zotët e shtëpisë më dhanë 4 dërhem dhe më dërguan në pazar për të blerë diçka; Nuk e di sesi ndodhi, por mua më humbën paratë; tani kam frikë të kthehem në shtëpi,- u përgjigj vajza e vogël.

Profeti hoqi katër dërhem nga 12 dërhemët e këmishës dhe ia dha vajzës së vogël: "Bli ç'kishe për të blerë dhe kthehu në shtëpi", - i tha Profeti. Pastaj shkoi në pazar dhe bleu një këmishë prej katër dërhemësh dhe e veshi.

Kur po kthehej, rrugës pa dikë të rreckosur; hoqi këmishën e tij dhe ia dha atij. Pastaj, u kthye sërish në pazar dhe bleu sërish një këmishë tjetër po me atë çmim.

Rrugës së kthimit pa sërish atë skalleven e vogël, e cila po rrinte ulur në një cep, e shqetësuar. Profeti iu afrua dhe e pyeti përse nuk kishte shkuar në shtëpi?

- O Profet i nderuar, është bërë shumë vonë dhe kam frikë se do të më rrahin ngaqe jam vonuar.
- Eja, të shkojmë bashkë në shtëpi. Tregomë mua të zotët e shtëpisë dhe do do t'u them unë që mos të të prekin.

U nisën së bashku dhe mbërritën te shtëpia. Shërbëtorja i tregoi derën e shtëpisë dhe Profeti thirri: "O ju të shtëpisë! Selam Alejkum!"

Nuk u dëgjua asnjë përgjigje. Thirri sërish. Edhe herën e dytë nuk mori asnjë përgjigjë. Herën e tretë, nga brenda shtëpisë i erdhi përgjigjja. Dolën të zotët e shtëpisë dhe e takuan.

- Përse nuk m'u përgjigjët kur ju thirra për herë të parë? - E pyeti Profeti.- A nuk e dëgjonit zërin tim?

-Po, -iu përgjigjën ata, e dëgjuam qysh në fillim dhe e dalluam që ishit ju. Por kishim shumë dëshirë të dëgjonim selamin tuaj mbi shtëpinë tonë, sepse ai është bekim per ne.

-Kjo shërbëtorja juaj është vonuar sonte dhe unë kam ardhur këtu për t'ju lutur që të mos e ndëshkoni.

- O i dërguari i Zotit, qysh tani, ne për hatër të Madhështisë suaj, këtë skllaven po e lëmë të lirë.
Falënderuar qoftë Zoti,- tha Profeti, ata 12 dërhemet sa me bereqet pasken qenë. Ata veshën dy njerëz dhe liruan një skllave.[1]

Shoqata Flladi

1) Biharul Anuar; vëll. 6, kreu: Mekarimul ahlakihi uesejrihi ue sunenihi

SHTRENJTËSIMI I USHQIMEVE

Çmimi i grurit dhe i bukës po rritej dita-ditës në Medine. Të gjithë njerëzit ishin shumë të shqetësuar nga kjo gjendje. Ai që nuk e kishte siguruar bukën e vitit,

po përpiqej ta siguronte, kurse ai që i kishte siguruar, ishte i detyruar të ruanterezerva. Kishte dhe njerëz të cilët ishin të detyruar që ushqimet dhe rezervat e tyre t'i blinin përditë në treg.

Imam Sadiku (a.s) pyeti Mateebin, financierin e shtëpisë së tij:- A kemi grurë sivjet në shtëpi?

- Po, o, i biri i Profetit.- u përgjigj Mateebi. Kemi aq grurë për disa muaj.
- Mirë, merre grurin dhe nxirre në treg e shite për popullin.
- O, imam i nderuar, gruri në Medine është pakësuar shumë; po të shesim këtë grurë që kemi, atëherë nuk kemi ku të gjejmë tjetër që të blejmë.
- Bëj, ashtu siç të thashë!,- i tha imami. Nxirre të gjithin për popullin.

Mateebi iu bind urdhrit të imamit. E shiti grurin dhe erdhi t'i thoshte imamit.

"Bukën e shtëpisë, që sot fillo ta blesh ditë për ditë në treg, - i tha imami. Buka e shtëpisë sime nuk duhet të ndryshojë nga buka që përdorin të gjithë njerëzit. Buka e shtëpisë sime

duhet të jetë gjysmë grurë e gjysmë maja. Unë, falë Zotit, kam mundësi që shtëpinë time ta drejtoj si më mirë deri ne fund të vitit me bukën e grurit. Por nuk e bëj këtë punë me qëllim që përballë Fronit Hyjnor të respektoj çështjen e "ruajtjes së masës"[1]

Shoqata Flladi

1) Biharul Anuar; vëll.11, f. 121.

REZERVIMI I HAMAMIT

Mënyrat dhe sjelljet e ashpra e të vrazhda të kalifëve Umovitë dhe më pas të atyre Abasitë kishin ndikuar shumë në shtresat e ndryshme të popullit. Gradualisht, njerëzit filluan ta harronin atë rrugën e duhur për jetën që Islami kishte caktuar për ta. Sjellja dhe mirësia e Profetit të Madhërishëm, e Ali Murtezait, si edhe e të mirëve të tjerë kishin filluar të fshiheshin nga kujtesa. Njerëzit, kishin filluar të familjarizoheshinme ato mënyrat dhe sjelljet e kota të kalifëve, pa ndjerë asnjë lloj ndjenje antipatie dhe ndotje prej tyre.

Një ditë imam Sadiku (a.s), deshte të shkonte në hamam. Pronari i dusheve, siç ishte bërë zakon për të respektuar njerëzit e mëdhenj dhe personalitetet, tha:- Më lejoni që të rezervoj dushin posaçërisht për ju.

- Nuk është nevoja,- i tha imami.
- Përse?!,- e pyeti ai i habitur.
- Besimtari është më i rëndësishëm se këto fjalë.[1]

---

1) Biharul Anuar; vëll.11, f. 117.

VËSHTIRËSIA PËR UJË

Muavije ibn Ebu Sufjani kishte afro 16 vjet që sundonte si mbret në Siri. Pa pyetur as për rregulla e as për njeri, ai po përgatitej të merrte dhe drejtimin e Kalifatit. Ai po përdorte çdo rast për të përmbushur qëllimin e tij. Rasti më i mirë për të rrëzuar pushtetin qendror dhe për ta marrë vetë Kalifatin në dorë ishte vrasja e Osmanit. Gjatë kohës së sundimit të Osmanit, ai nuk zbatonte aspak kërkesat që Osmani i drejtonte atij, por i shtynte ngjarjet vetëm drejt acarimit, duke pritur vrasjen e Osmanit. Osmani u vra dhe Muavija u turr menjëherë që të përfitonte prej këtij rasti.

Nga ana tjetër, pas vrasjes së Osmanit, njerëzit u mblodhën dhe lidhën besën me Aliun, i cili deri atëherë në mënyra të ndryshme e kishte shmangur marrjen përsipër të drejtimit të kalifatit. Aliu, pasi vuri re që zyrtarisht kjo përgjegjësi iu caktua atij, pranoi dhe shpalli zyrtarisht në Medine, që ishte qendra e Kalifëve, kalifatin e vet.

Të gjitha krahinat e shtetit të gjërë islamik të asaj kohe përveç Sirisë, të cilat ishin nën sundimin e Muavijes njohën Aliun si kalifin e ri. Muavija nuk pranonte t'i bindej pushtetit qendror dhe e akuzonte Aliun se po strehonte vrasësit e Osmanit, e deklaronte se ishte i gatshëm të shpallte pavarësinë e Sirisë si krijoi një ushtri të madhe siriane.

Pasi caktoi njerëzit nëpër punët e duhura, Aliu (a.s), i kushtoi vëmendje Muavijes. Filloi letërkëmbimi më Muavijen, por letrat e Aliut nuk ndikonin aspak te zemra e zezë e Muavijes. Atëherë, të dyja palët, me ushtri të mëdha u vunë përballë njëra-tjetrës. Ebu A'uar Silmi komandonte ushtrinë e Muavijes, ndërsa Maliku'l Eshter Nakhi komandonte ushtrinë e Aliut. Të dyja kalorësitë e ushtrive mbërritën te bregu i lumit Eufrat dhe u vendosën përballë njëra- tjetrës. Maliku nuk ishte lejuar nga Aliu, që ta fillonte ai luftën. Ndërsa Ebu Alauri, për të rënë në sy, nisi një sulm të fuqishëm. Sulmi i tij u mbraps prej Malikut dhe ushtrisë së tij dhe sirianët filluan të tërhiqeshin. Ebu A'uari i dha urdhër ushtrisë së tij që të vendosej në Sharie**:** Ishte ajo pikë e lumit Eufrat ku të dyja ushtritë mund të furnizoheshin me ujë. Ebu A'uari i dha urdhër harkëtarëve të tij që të rreshtoheshin aty e të mos e linin ushtrinë e Malikut të afrohej për të marrë ujë. Nuk zgjati shumë dhe aty erdhi Muavija me ushtrinë e tij të madhe dhe u kënaq më atë që kishte bërë Ebu A'uari. Ushtarëve të Ebu A'uarit iu shtua më shumë vetëbesimi.

Nga ana tjetër, shokët e Aliut, kishin mbetur pa ujë. Sirianët ishin të gëzuar që kushtet ishin vendosur kështu dhe Muavija deklaronte gjithë mburrje:

" Kjo është fitorja e parë".

Vetëm Omar ibn Aasi, që ishte zevëndësi dhe këshilltari personal i Muavijes, nuk e shikonte me sy të mirë këtë punë. Aliu (a.s) shkoi vetë dhe e pa si qëndronte gjendja. Aty i shkroi një letër Muavijes dhe e nisi me një prej shokëve të tij të mëdhenj, Sa'sa'atu. Në lëtër shkruhej: "Ne kemi

ardhur këtu, pa nuk kemi dëshirë, përderisa të jetë e mundur, që në mes të myslimanëve të bëhet luftë e të ndodhë vëllavrasja. Shpresojmë që mosmarrëveshjet t'i zgjidhim me dialog, por shikoj që ti dhe shokët e tu përpara çdo gjëje merrni në duar armët. Përveç kësaj, u keni zënë dhe ujin shokëve të mi. Jep urdhër që ta lëshojnë ujin menjëherë e të fillojmë bisedimet. Sigurisht, në qoftë se ti nuk kënaqesh me gjë tjetër përveç se me luftë, unë nuk kam as frikë as ngurrim".

Letra i mbërriti në dorë Muavijes. E diskutoi çështjen me këshilltarët e tij. Në përgjithësi, mendimi i tyre ishte: "Na ka ardhur një rast i mirë në dorë, duhet ta shfrytëzojmë atë e të mos ndikohemi nga kjo letër." Vetëm Omar ibn Aasi ishte kundër këtyre mendimeve. "Po gaboheni, -u tha ai. Aliu dhe shokët e tij nuk duan që të behët luftë e gjakderdhje, për momentin kanë heshtur dhe nëpërmjet letrës kanë kërkuar prej jush që të hiqni dorë. Mos kujtoni që duke i lënë ata të rrinë pa ujë, ushtria e tyre do të tërhiqet. Ata do të marrin shpatat ndër duar dhe nuk do të ndalojnë derisa t'ju kenë shporrur nga Eufrati". Mirëpo mendimi i shumicës ishte që thatësia do t'i lodhte ata e kështu që, më në fund ata do të dorëzoheshin. Këtë mendim e mbështeste edhe Muavija.

Pasi u mbyll mbledhja e tyre, Sa'sa'atu po priste të merrte përgjigjen e letrës dhe shkoi te Muavija. Muavija i cili nuk kishte për qëllim t'i jepete përgjigje letrës, i tha: "Të përgjigjem më vonë". Pastaj dha urdhër që të gjithë ushtarët të ishin në gadishmëri e të pengonin hyrjen apo ikjen e ushtrisë së Aliut.

Kur e pa që nuk mbetej më shpresë për zgjidhjen e çështjes me anë të bisedimeve, Aliu (a.s) u mërzit shumë. Pa që nuk kishte mbetur rrugë tjetër përveç përdorimit të forcës. Doli përpara trupave të tij, e mbajti një fjalim të shkurtër por shumë frymëzues:

"Këta kanë filluar shtypjen, i kanë hapur rrugën konfliktit, duke ndezur armiqësinë ndaj jush. Këta janë të uritur për luftë dhe për gjak. Ju kanë prerë ujin e pijshëm. Tani duhet të zgjedhni njërën prej dy rrugëve. Rrugë të tretë nuk ka. Ose të uleni e të poshtëroheni duke ndenjur të etur, ose t'i ngopni shpatat tuaja me gjakun e tyre të ndyrë, e të arrini e të ngopeni me ujë. Të rrosh, do të thotë që të jesh i lirë edhe sikur kjo të sjellë vdekjen. Të jesh i shtypur dhe i nënshtruar do të thotë të vdesësh edhe sikur të jesh gjallë. Muavija ka mbledhur rreth vetes një tufë të këqijsh dhe të humburish si vetja, duke shfrytëzuar padituринë e tyre, duke e bërë fytin e tyre shënjestër për shigjetat.e vdekjes".[1]

Ky fjalim i dha shumë zemër e guxim ushtrisë së Aliut. Atyre filloi t'u ziejë gjaku. Ata u bënë gati t'i jepnin armikut një goditje të fuqishme për ta larguar nga burimi i ujit.

Në këtë kohë Omar ibn Aasi, duke parë që po i dilte parashikimi i vet i tha Muavijes: "Tani, nëse ushtria e Aliut do të të rrethojë e do të bëje me ty atë që bëre ti me ata, si do të veprosh? A do të arrish t'ua marrësh atyre sërish burimin e ujit?"

Muavija, "Për mendimin tënd, si do të sillet tani Aliu me ne?"

---

1) Nehxhul Belaga, fjalimi 51.

"Për mendimin tim Aliu, nuk do të veprojë si ne dhe nuk do të na lërë pa ujë. Ai nuk ka ardhur për këto punë"- u përgjigj Omari.

Kur ushtria e Aliut e largoi ushtrinë e Muavijes nga burimi i ujit, i kërkuan Aliut leje që ta bllokonin ujin e për Muavijen. Aliu u tha;

"Mos ua bllokoni ujin. Unë nuk i përdor këto mënyra që janë punë e injorantëve. Unë do ta shfrytëzoj këtë rast, për të filluar bisedimet e mia me ta sipas librit të Zotit. Në qoftë se propozimet e mia do të pranohen, aq më mirë; Në qoftë se nuk pranohen, do të luftoj me ta, por burrërisht e jo duke u prerë ujin. Unë kurrë nuk do t'i bëj këto punë dhe nuk do të lë njeri pa ujë". Ende nuk ishte ngrysur. Ushtarët e Aliut dhe të Muavijes vinin bashkë dhe furnizoheshin me ujë, askush nuk shqetësoi ushtarët e Muavijes.[2]

2) Sherh Nehxhul Belaga i ibn ebi Hadijdit, fjalimi 51, vwll. 1, botuar nw Bejrut, f. 419-428.

85

ANKESA NDAJ JETËS

Mufadal ibn Kajs ishte vënë keqas nën peshën e jetës. Varfëria dhe skamja, borxhet dhe shpenzimet e shqetësonin shumë. Një ditë, shkuan tek Imam Sadiku, hapi zemrën dhe ia shprehu të gjitha hallet e sikletet që e mundonin. Nisi t'i thoshte: "Kam kaq para borxh e nuk di si t'i jap. Kam kaq shpenzime e nuk kam asnjë të ardhur. Jam shumë keq. Kam mbetur i mjerë. Te çdo derë që trokas, më mbyllet…" Në fund kërkoi nga imami që t'i bënte një lutje e t'i kërkonte Zotit, që t'i hapte rrugët.

Imami urdhëroi një shërbëtore që ishte aty: "Shko dhe na e sill pak atë qesen që Mensuri ka sjellë për ne!." Shërbëtorja vajti dhe e solli qesen menjëherë. Imami mori qesen dhe u kthye nga Mufadal ibn Kajsi dhe i tha: "Në këtë qese janë katërqind dinarë. Merri, janë ndihmë për jetën tënde!."

-Oh, unë nuk kisha këtë qëllim kur erdha këtu te ju; unë doja vetëm një lutje prej jush:- iu përgjigj Mufadali.

- Shumë mirë, edhe lutjen do ta bëj, - tha imami. Por po të them diçka. Kurrë mos ua thuaj njerëzve vështirësitë dhe hallet e tua. Përshtypja e parë që lë është që ti je thyer e ke dështuar në jetë; - Zvogëlohesh shumë për mendjen e njerëzve e kështu, humbet personalitetin dhe respektin tënd.[1]

---

1) Biharul Anuar; vëll.11, f. 114.

QORTIMI I MËSUESIT

Sejjid Xhevad Amili, dijetar i shquar dhe autori i librit "Miftahu'l Kerameti", ishte duke ngrënë darkë, kur dëgjoi që dikush i trokiti në derën e shtëpisë. Kur i thanë se ishte shërbëtori i mesuesit të tij, Mehdi Bahrul ulum, vrapoi menjëherë tek dera. Shërbëtori i tha: "Mësuesi ka shtruar darkën e tij, por nuk do e prekë atë pa ardhur ju".

Nuk kishte kohë për të humbur. Sejjid Xhevadi e la përgjysmë darkën e vet dhe u nis drejt shtëpisë së mësuesit të tij. sapo hyri Sejjid Xhevadin, Mësuesi me inat të madh i bërtiti: "Sejjid Xhevad! A nuk e ke frikë Zotin. A nuk ke turp prej Zotit?" Sejjid Xhavadi mbeti i shtangur në vend. Çfarë kishte ndodhur e çfarë kishte bërë? Deri tani nuk kishte ndodhur që ai të sulmohej kështu. Sado që e shtrydhi trurin e vet për të gjetur se ç'kishte bërë, nuk gjeti gjë dhe tha;

-A është e mundur, o mësues të më thoni se çfarë kam bërë?

"U bënë shtatë ditë e shtatë netë që njëri prej fqinjëve të tu nuk ka grurë e oriz për të ushqyer familjen dhe veten. Ka shkuar tek dyqani më i afërt dhe ka marrë hurma për të shtyrë vaktet. Sot ka shkuar prapë për të marrë hurma dhe shitësi i ka thënë që i është shtuar shumë boxhi. Atij i ka ardhur turp nga këto fjalë dhe është kthyer në shtëpi duarbosh. Kështu, që sot, vetë dhe familja e tij kanë mbetur pa darkë".

-Të betohem në Zot, që unë nuk di gjë farë për këtë ngjarje. Pota dija, do ta kisha ndihmuar atë.
- Për këtë po të bërtas dhe unë. Përse nuk je interesuar për gjendjen e fqinjit tënd? Përse ata duhet të kalojnë një javë në këtë gjëndje dhe ti të mos kuptosh gjë? Po ta dije, dhe nuk do të veproje, atëherë nuk do të ishe aspak mysliman.
- Tani, më thoni çfarë të bëj?.
-Shërbëtori im do të marrë tepsinë e darkës dhe së bashku do të shkoni atje tek ai. Kur të mbërrini tek dera, shërbëtori im do të kthehet, ti trokit, dhe lutiu që sonte të hani dark bashkë. Merri dhe këto paratë edhe vëri nën qilimin e shtëpisë së tij. I kërko të falur që ti je fqinji i tij dhe nuk i ke ndhmuar. Lëre tepsinë aty edhe eja tek unë e më thuaj. Unë do të të pres këtu e nuk do ta prek darkën pa u kthyer ti,
- përfundoi mësuesi.
Shërbëtori mori tepsinë e madhe, mbushur plot më ushqime e gjellëra dhe u nis së bashku me Sejjid Xhevadin. Te pragu i derës ai e ktheu mbrapsht shërbëtorin. Pasi mori leje nga i zoti i shtëpisë, Sejjid Xhevadi u fut brenda. I zoti i shtëpisë, pasi dëgjoi dhe pranoi ndjesën që Sejjidi i kërkoi atij, u ul të hante gjellët. Sapo provoi pak nga gjella, iu duk e shijshme dhe e kuptoi që ajo nuk ishte gatuar nga Sejjid Xhevadi, që ishte arab. Hoqi dorë menjëherë nga gjella dhe tha: "Kjo gjellë nuk është gatuar nga një dorë arabe.Kështu që ajo nuk ka ardhur nga shtëpia juaj. Po nuk më tregove se nga ka ardhur gjella, unë nuk e prek atë."
I zoti i shtëpisë e kishte menduar mirë. Gjella ishte gatuar në shtëpinë e Bahrul ulumit. Ata ishin me origjinë persiane, dhe gjellët e tyre nuk ishin si gjellët e arabëve. Sado që Sejjid

Xhevadi këmbënguli që i zoti i shtëpisë të hante, ai nuk pranoi. Atëherë, Sejjidi nuk i pa rrugë tjetër vetes dhe i tregoi ngjarjen. Pasi e dëgjoi ngjarjen, i zoti i shtëpisë mbeti shumë i habitur. Ai thoshte: "Unë nuk i kam treguar askujt për gjendjen time, e kam mbajtur të fshehtë edhe nga fqinjët e mi më të afërt. Po mësuesi nga e kishte mësuar?"[1]

Shoqata Flladi

1) El Kunaa uel Elkabi; vëll. 2 f. 62

IFTARI

Enes ibn Malik kishte vite që shërbente në shtëpinë e Profetit të nderuar. Këtë nder e pati deri në ditën e fundit të jetës së Profetit. Ai i njihte zakonet dhe sjelljen e Profetit më shumë se kushdo tjetër. Ai e dinte më shumë se kushdo tjetër sa i thjeshtë ishte Profeti në të veshur dhe në të ngrënë. Gjatë agjërimit, i gjithë iftari dhe syfyri i tij ishte vetëm pak qumësht a shërbet dhe pak fruta.

Një natë, si zakonisht, Enes ibn Malik kishte përgatitur pak qumësht për iftarin e Profetit. Mirëpo Profeti nuk erdhi për iftar. U afrua gati mesi i natës dhe ai ende nuk po vinte në shtëpi. Atëherë, Enesi u bind që Profeti kishte pranuar ftesën e shokëve të tij për të ngrënë iftar me todhe për të ndenjur me ta. Duke menduar kështu, atë që kishte përgatitur, që të mos shkonte dëm, e hëngri vetë.

Nuk zgjati shumë dhe Hazreti Muhamed u kthye në shtëpi. Enesi pyeti dikë, që kishte qenë me Profetin se ku kishin ngrënë iftar atë natë. Ai iu përgjigj që ashtu kishin dalë disa punë dhe ende nuk kishin ngrënë iftar.

Kur mësoi këtë gjë Enesi u turpërua dhe u pendua shumë për atë që kishte bërë. Aq më tepër, që tashmë ai s'mund të përgatiste asgjë. Po priste që Profeti t'i kërkonte diçka për

të ngrënë dhe t'i kërkontë të falur. Mirëpo Profeti e kuptoi se ç'kishte ndodhur dhe shkoi të flinte pa kërkuar asgjë për të ngrënë. Enesi më pas do të tregonte që deri ditën që kishte qenë gjallë Profeti nuk ia përmendi asnjëherë atij ndodhinë e asaj ngjarje.[1]

Shoqata Flladi

1) Kehlul besari, i muhaddith Kummij, f. 67

PUNONJËSI NË DYQANIN E METRAZHEVE

Një djalosh që ishte shegert në dyqanin e metrazheve, nuk e dinte se çfarë kurthi ishte ngritur për të. Ai nuk e dinte që ajo gruaja e bukur dhe me autoritet, e cila hynte dhe dilte tek dyqani i tyre nën preteksin se blinte copa, kishte rënë marrëzisht në dashuri me të e në zemrën e saj rrihte një tufan. Një ditë, gruaja futet në dyqanin e metrazheve dhe urdhëron që t'i ndajnë veçmas një sasi të madhe malli. Pastaj, duke kërkuar ndjesë që nuk kishte para të mjaftueshme me vete dhe nuk mund ta mbarte e vetme të gjithë ngarkesën, tha: "Copat jepjani këtij djaloshit që të m'i sjellë në shtëpi dhe aty unë t'i jap paratë."

Gruaja i kishte marrë masat qysh në fillim. I kishte përzënë të gjithë; në shtëpi nuk kishte veçse disa shërbëtore të besueshme.

Shegerti quhej Muhamed ibn Sirin. Ishte në lule të rinisë së tij, Ishte edhe shumë i pashëm. Ai hodhi stofrat mbi supe dhe së bashku me gruan u nisën drejt shtëpis së saj. Sapo u fut në shtëpi, atij i mbyllën derën. Ibn Sirinin e dërguan te dhoma e pritjes.Tani po priste që zonja të vinte sa më shpejt, e ai të dorëzonte mallin, të merrte paratë e të kthehej në punë. Pritja po zgjatej. Pas pak kohe, u ngrit perdja dhe në

dhomë hyn zonja gjithë salltanet dhe fillon t'i afrohet atij ngadalë. Ibn Sirini e kuptoi menjëherë se ç'kishin gatuar për të. Mendoi që duke e marrë me të mirë, duke iu lutur, ta shmangte, por pa që zonja po përvëlohej nga dëshira dhe pasioni. Ajo iu afrua dhe i foli me zë të ulët: "Unë nuk bleva mallin, por të bleva ty". Ibn Sirini filloi t'i jepte këshilla duke folur për Zotin dhe Ditën e Gjykimit. Mirëpo asgjë nuk ndikonte në zemrën e gruas. Ibn Sirini filloi t'i lutej e t'i përgjërohej që ta linte të ikte, por prap nuk ia doli. Zonja i tha: "Nuk ke rrugë tjetër, duhet të plotësosh mangësinë time". Pastaj, kur e pa që ibn Sirini vazhdonte të këmbëngulte në qëndrimin e tij, e kërcënoi; "Qoftë se ti nuk e respekton dashurinë time, që tani do të ulëras e do të them që ky djalosh kërkon të më përdhunojë. Atëherë mendoje dhe vetë se çfarë të pret."

Ibne Sirinit iu ngritën qimet e trupit përpjetë. Nga njëra anët, besimi, virtyti dhe morali e urdhëronin që të përmbahej e të ruante pastërtinë e tij nga ana tjetër, ajo grua e kërcënonte me humbjen e nderit, të jetës dhe të çdo gjëje tjetër. Një mendim i kaloi si rrufe nëpër mendje. Mendoi me vete që i kishte mbetur vetëm një rrugë e vetme: të bënte diçka që dashuria e saj të kthehej në urrejtje, dhe ajo vetë të hiqte dorë prej tij. Nëse më duhet ta ruaj të pastër veten dhe virtytin, - mendoi ai,- duhet që për një çast të duroj ndotjet sipërfaqësore. Me preteks që të shkonte e të ndërronte rrobat, ai del nga dhoma, pastaj vjen me rroba të ndyra sërish në dhomë. Gruaja sapo e pa, u turr menjëherë dhe e përzuri nga shtëpia.[1]

---

1) El Kunaa uel Elkabi; vëll. 1, f. 313

SUPERSTICIOZI - HOROSKOPI

Abdul Melik ibn A'juni, vëllai I Zuraretu ibn A'juni, megjithëse ishte një nga shpjeguesit e haditheve, besonte shumë në astrologji dhe në shenjat e horoskopit. Kishte mbledhur libra të shumtë në këtë fushë dhe i lexonte me shumë ëndje. Për çfarëdo vendimi që donte të merrte,a punë që donte të kryente, në fillim shkonte e konsultohej me librat e astrologjisë, duke pritur të shikonte se çfarë do ti thoshte horoskopi.

Pak nga pak, kjo punë iu kthye në ves dhe në një tundim të fuqishëm: ai nuk mund të bënte më asnjë punë pa u konsultuar më parë me yjet. Filloi të ndjente se kjo punë po i drejtonte jetën tashmë. Ky ndikim nisi të shtohej dita-ditës, saqë, nëse horoskopi i thoshte që ato orë do t'ë kesh të mira e në ato orë, të këqija, i terë sistemi i jetes i çrregullohej. I shikonte që nuk kishte guxim brenda vetes të shkëputej nga e gjithë kjo dhe sa herë që shikonte njerëzit, të cilët këtyre gjërave nuk ua vinin veshin fare e vazhdonin të qetë punët e tyre duke u mbështetur vetëm te Zoti, ai bëhej nervoz.

Një ditë ky erdhi tek imam Sadiku dhe i tha: -Unë jam infektuar nga kjo shkencë tashmë e nuk mund të bëj asgjë që të largohem prej saj.

Imam Sadiku e pa me habi dhe i tha: Ti u beson këtyre gjërave?

-Po, - iu përgjigj ai.

-Unë të urdhëroj që të shkosh që tani dhe t'i djegësh të gjithë ata libra.

Urdhri i imamit i dha atij forcën e duhur në zemër. Shkoi dhe i dogji të gjithë ata libra menjëherë dhe ra në qetësi.[1]

Shoqata Flladi

1) Uesail; vëll. 2, f. 181.

ASTROLOGU

Emiru'l Mu'menin, Aliu (a.s) dhe ushtria e tij, hipur mbi kuaj, po lëviznin drejt Nehrevanit. Papritur iu afrua një shok, i cili kishte dhe një njeri me vete dhe i tha: "O Emiru'l Mu'menin! Ky burri është astrolog dhe kërkon t'u thotë diçka.

Astrologu ndërhyri dhe i tha imam Aliut: -O Emiru'l Mu'menin! Mos lëvizni në këtë orë, ju lutem prisni pak! Lërini të kalojnë dy-tri orë nga dita, pastaj lëvizni sërish!

-Pse?, -e pyeti imam Aliu.

-Sepse tani yjet tregojnë që gjendja nuk është e mirë. Ai që lëviz në këtë orë, do të thyhet prej armikut të tij, ai dhe shokët e tij do të pësojnë shumë dëme. Por, po lëvizët në atë orë që them unë, do të arrini fitoren.

- Pela ime është me barrë. A mund të më thuash nëse mëzi i saj është mashkull apo femër?, – e pyeti imam Aliu.

- Po të ulem dhe ta llogaris, edhe mundem, –u përgjigj astrologu.

-Gënjen! Ti nuk mundesh,- i tha imam Aliu. Kur'ani thotë: "Vetëm Zoti është Ai që e di çfarë ka e fshehta. Vetëm Zoti e di ç'është krijuar në mitër".

As Muhamedi, i Dërguari i Zotit, nuk i thoshte këto pretendime që bën ti. Ti pretendon se di çfarëdo gjëje që ndodh në botë dhe e kupton se çfarë ore është e mirë e çfarë ore është e keqe. Pra, nëse dikush të beson ty, në të gjithë atë që thua, atëherë ai s'ka nevojë për Zotin.

Pastaj imani u kthye nga njerëzit dhe tha; "Kurrë mos u besoni këtyre gjërave! Këto të shpien në fall. Falli ë në magji e magjia të shpie mosbesim. E, mosbesuesi është në ferr".

Imami ktheu kokën nga qielli dhe tha një lutje që kishte të bënte më besimin dhe mbështetjen te Zoti i Plotfuqishëm.

Pastaj u kthye nga astrologu dhe i tha: "Ne do të veprojmë kundër urdhrit tënd dhe pa frikë do të lëvizim që tani".

Imami dha menjëherë urdhër për të lëvizur e shkoi drejt armikut. Aliu (a.s) arriti të korrte një fitore në atë luftë si rrallë ndonjëherë.[1]

1) Nehxhul Belaga; fjalimi 77 dhe Uesail; vvll. 2, f. 181.

ZGJIDHJA E PROBLEMIT

Sefvani ishte ulur pranë imam Sadikut. Papritur aty erdhi një burrë nga Meka dhe filloi të tregonte të gjitha hallet e telashet që e kishin gjetur. Ishte e qartë se çështja qëndronte tek qiraja e një pune e cila për momentin ishte bllokuar.
Imami udhëroi Sefvanin: "Lëviz menjëherë dhe thuaji vëllait tënd ta ndihmojë këtë njeri për punën që ka".
Sefvani u ngrit dhe pasi puna u zgjidh përfundimisht si më mirë, u kthye sërish imami e pyeti: - Si u bë?

- E rregulloi Zoti,- u përgjigj Sefvani.

-Ta dish që kjo punë që ty të duket si diçka e vogël dhe nuk të mori shumë kohë, është shumë herë më e mirë dhe më e pëlqyeshme se sa shtatë rrotullime rreth Qabes.
Më pas imam Sadiku e vazhdoi kështu fjalën e tij: "Një burrë kishte njëherë një problem dhe për këtë shkoi tek Imam Hasani për t'i kërkuar atij ndihmë. Imam Hasani mbathi kepucët e doli menjëherë jashtë. Arritën te Husejn ibn Aliu kur ai po falte namazin. Imam Hasani i tha atij burrit: "Ti, përse nuk ke shkuar te Husejni më përpara?"
- Unë kam dashur të shkoja tek ai dhe ti kërkoja ndihmë për punën time,- u përgjigj burri,- por meqë më thanë ai ishte

mënjanuar duke u marrë me lutje dhe adhurim, nuk i shkova".

Imam Hasani ia ktheu: Por, po ta kishte zgjidhur ai vetë punën tënde, për të do të kishte qënë me e mirë se sa një muaj adhurim."[1]

Shoqata Flladi

1) Kafij; vëll. 2, f. 198.

KUSH ËSHTË MË ADHURUESI

Njëri prej shokëve të imam Sadikut, i cili ishte zakonisht i pranishëm në mësimet që jepte Hazreti dhe në mbledhjet që bënin shokët kishte disa kohë që nuk ishte parë. Një ditë, imam Sadiku i pyeti shokët e tij: - Më të vërtetë, ku është filani, sepse u bë kohë që nuk e kemi parë?

- O biri i Profetit, kohëve të fundit është varfëruar e mjeruar shumë,- iu përgjigjën shokët.
- Çfarë bën tani? – pyeti imami.
- Asgjë, rri në shtëpi dhe merret vetëm me falje e me adhurim,- u përgjigjën ata.
- Po nga i nxjerr të ardhurat për jetën e tij?, -pyeti sërish imami.
- Njëri prej shokëve të tij ka marrë përsipër shpenzimet e jetës së tij, -u përgjigjën shokët.
- Betohem për Zotin, që ky shoku i tij qenka shumë herë më i devotshëm se ai,-tha imami.[1]

---

1) Uesail; vwll. 2, f. 529.

ALEKSANDRI I MADH DHE DIOGJENI

Kur Aleksandri i Madh i Maqedonisë u bë sundues i Greqisë, filloi të bëhej gati për fushatën e tij ushtarake kundër Persië. Atij i vinin njerëz nga të gjitha shtresat e shoqërisë për ta uruar e përgëzuar. Mirëpo Diogjeni, dijetari i famshëm, i cili jetonte në Korint, nuk i kushtoi atij as vëmendjen më të vogël. Aleksandri i shkoi vetë që ta takonte. Diogjeni, cili ishte një nga dijetarët dhe të urtët e Greqisë, ishte shtrirë për shtatë palë qejfe në diell. Duke e ndjerë që një turmë e madhe me njerëz po vinte drejt tij, u ngrit pak dhe ia nguli sytë Aleksandrit, që po vinte gjithë madhështi hipur mbi kalë. Diogjeni nuk bëri asnjë dallim midis Aleksandrit dhe një njeriu të thjeshtë që vinte të takonte atë. Duke ruajtur mënjanësinë e tij, Diogjeni u shtri sërish dhe filloi të ngrohej në diell. Ndërkohë, i vjen Aleksandri, i qëndron mbi kokë dhe pasi e përshëndet, i thotë: "Nëse ke ndonjë kërkesë ndaj meje, ma thuaj!"

"Nuk kam më shumë se një kërkesë. Hapu pak anash se më ke zënë diellin!- i tha Diogjeni.

Shoqëruesve të Aleksandrit kjo fjali iu duk shumë tallëse dhe idiote. Ata thanë me vete shiko sa njeri idiot qënka që nuk shfrytëzon rastin. Mirëpo Aleksandri i cili në fjalët e tij,

vuri re çiltërsinë e vërtetë të Diogjenit, ra thellë në mendime. Pasi u nis rrugës, i tha shoqërueve të tij që ishin filozovë e njerëz më pozitë; "Nëse nuk do të isha Aleksandri, do të doja të isha Diogjeni."[1]

Shoqata flladi

1) Tarihul ilm i autorit Xhorxh Sarten. Përktheu sejjid Ahmed Aram, f. 525.

MBRETI DHE I URTI

Gjatë udhëtimit për në Horasan, kur hynte në ndonjë qytet, sipas zakonit, Naserudin Shahu shkonin ta takonin njerëz të shtresave të ndryshme të shoqërisë. Po kështu, edhe kur ngrihej për të ikur nga ai qytet, të gjithë dilnin për t'a përcjellë. Një ditë, ai hyri në qytetin e Sebzevarit. Të gjithë njerëzit i dolën përpara për ta pritur, përveç një njeriu, i cili ishte dijetari, filozofi dhe mistiku i famshëm Haxhi Mullah Hadi Sebzevari. I vetmi personalitet të cilin mbreti Naseredin kishte dashur të takonte gjatë gjithë udhëtimit të tij në Horasan, ishte pikërisht ky burrë, i cili kishte fituar gjithë atë emër në të gjithë Persinë, duke bërë që te qyteti i tij të vinin njerëz nga të katër anët për të mësuar nga ai.

Mbreti ishte i lodhur duke pritur e përcjellë gjithë ata njerëz që sillnin e thurnin lavde të shumta, e vendosi të shkontë vetë dhe ta takonte dijetarin e famshëm.

I thanë mbretit: "Dijetari i madh nuk njeh as mbret e as vezir"

"Mirëpo mbreti e njeh atë",- u përgjigj mbreti. Kjo fjalë i ra në vesh dijetarit. Atëherë u caktua një orë për t'u takuar. Kështu, një ditë, aty nga dreka, mbreti, i shoqëruar vetëm

nga një shërbëtor, shkoi te shtëpia e dijetarit. Shtëpia e tij ishte e mbushur me gjëra shumë të thjeshta. Gjatë bisedës mbreti tha: "Çdo bekim ka ëmbëlsinë e vet. Embëlsia e bekimit të dijes është mësimi dhe njohuria. Embëlsia e bekimit të pasurisë është mirëqënia. Ëmbëlsia e mbretërimit është plotësimi i nevojave të shumta. Kam dëshirë që ju të më kërkoni diçka dhe unë të ta plotësoj".

- Unë nuk kam nevojë për gjë dhe nuk dua gjë,- tha dijetari.
- Kam dëgjuar, - tha mbreti, që ju keni një copë tokë të vogël e punoni. Me lejoni që të jap urdhër që të falen të gjitha taksat e tua.

- Zyra e mbledhjes së taksave të qeverisë ka për detyrë që nga çdo qytet të mbledhë një shumë të caktuar parash,- iu përgjigj dijetari i mbretit. Kështu që baza e saj prishet me disa ndryshime të vogla. Nëse në këtë qytet nuk do të merren taksa prej meje, taksa ime do të bjerë mbi të tjerët, me qëllim që nga qyteti i Sabzevarit të mblidhet shuma e caktuar. Mbreti mos ngeltë i kënaqur që falja e taksave të mia të rëndojë mbi jetimët dhe mbi vejushat. Përveç kësaj, qeveria ka detyrë që të ruajë e të sigurojë mallin dhe jetën e qytetarëve të saj e kjo gjë kërkon shpenzime që duhet të sigurohen në një mënyrë. Ne e japim me kënaqësi taksën tonë për këtë punë.

Kam dëshirë që sot të hamë drekë bashkë dhe unë të provoj ato gjellë që hani edhe ju; pra urdhëroni të sjellin drekën, - foli mbreti.

Dijetari pa lëvizuar fare nga vendi thirri; "Na sillni drekën!" Menjëherë sollën nja tabaka druri që kishte pak bukë, gjellë, disa lugë, dhallë dhe kripë dhe e shtruan përpara mbretit dhe dijetarit.

Dijetari i tha mbreti: "Ha, se buka është hallall, e kam bërë miellin me grurin që kam korrur vetë në arë" - Mbreti provoi vetëm një lugë gjellë, por e pa që nuk ishte mësuar me këtë lloj ushqimi dhe i kërkoi dijetarit që t'i mbeshtillte disa nga ato bukët se do t'i merrte me vete. Pas pak çastesh mbreti u largua nga shtëpia e dijetarit krejt i habitur dhe pa fjalë.[1]

Shoqata Flladi

1) Rejhanetul edebi; vëll. 2, f. 157dhe 158.

UNITETI I MUFADALIT

Mufadal ibn Omer Xhaferi, pasi kreu faljen e pasdites në Xhaminë e Profetit, u ul diku aty pranë varrit të Profetit dhe pak nga pak, filloi të zhytej në mendime, për madhështinë dhe personalitetin e lartë dhe qiellor të Profetit të nderuar. Sa më shumë që mendohej, aq më shumë e merrte malli për Hazretin Muhamed. Me vete mendonte që grada e personalitetit të lartë të Profetit është shumë herë më e lartë nga ajo që mendojmë dhe shikojmë. Njerëzit dinë shumë më pak për madhështinë e virtytin e lartë të Profetit, sa ç'kujtojnë se dinë.

Mofazeli ishte i zhytur në këto mendime, kur u fut në xhami erdhi dhe u ul diku aty afër tij e edhe materialisti i njohur na atë vend, ibn Ebu Auxha Madiu. Nuk zgjati shumë dhe aty erdhi u ul dhe një shok i ibn Ebu Auxhas dhe filluan të bisedonin.

Ishte dhe fillimi i kalifatit Abasit e kjo gjë nënkuptonte dhe ndryshime të mëdha në kulturën islam. Në atë kohë, disa prej myslimanëve kishin hapur disa degë shkencore. Ata kishin përkthyer libra shkencorë dhe filozofikë nga gjuha greke, indiane dhe persiane. Kështu, ishin krijuar degë të ndryshme shkencash dhe filozofie. Ishte periudha e përplasjes së mendimeve dhe ideve. Abasitët e përkrahnin

lirinë e ideve deri aty ku ato nuk kishin punë me politikën. Edhe dijetarët jomyslimanë, ishin të lirë që të shprehnin idetë dhe mendimet e tyre; madje ata kishin arritur deri aty, sa mendimet e tyre t'i shprehin edhe xhamia pranë Qabesë, dhe në Xhamia e Profetit në Medine, duke u mbledhur grupe-grupe e duke biseduar. Ibn Ebu Auxha i përkiste këtij grupi. Atë ditë, ai dhe shoku i tij u futën njëri pas tjetrit në Xhaminë e Profetit dhe nisën të bisedonin së bashku. Mirëpo nuk ishin shumë larg prej Mufadalit dhe kështu, ishte e pamundur që ai të mos i dëgjonte fjalët e tyre. Rastësisht, fjala e parë që tha Ebu Auxha dhe që ia zuri veshi Mufadalit ishte pikërisht nga ato fjalë që ai vetë po i mendonte deri më tani. Ata po flisnin për Profetin. Ai i tha shokut të tij: "Sa lart i shkoi puna këtij burri (Profetit). Arriti në një vend ku askush nuk mund të shkonte më lart."

Shoku iu përgjigj; "Ishte gjeni. Pretendonte se i përkiste gjithë botës, duke bërë dhe punë të çutishme dhe të mbinatyrshme, të cilat i habitën mendjet e njerëzve. Kështu, njerëzit e panë veten e tyre të pafuqishëm përballë tij dhe e pranuan ftesën e tij. Drejt tij erdhën edhe klasat e tjera të shoqërisë dhe i sollën besë. Puna e tij arriti deri aty, sa emri i tij shkoi shumë lart.

Tani, kur këndohet ezani në qytete e fshatra, në kodra, fusha, male, dete e shkretëtira dëgjohet edhe emri i tij. Në çdo vend thërrasin ditë e natë nga pesë herë "Muhamedi është i Dërguari i Zotit".E, pra emri i tij përmendet gjithandej dhe ai kurrë nuk do të harrohet".

Ibn Ebu Auxha i tha shokut të tij: "Për Muhamedin të mos flasim më shumë. Unë ende nuk kam arritur ti gjej të fshehtat

e personalitetit të tij. Më mirë të bisedojmë për fillimin dhe fundin e ekzistencës, që ishte baza, në të cilën Muhamedi hodhi themelet e fesë së tij." Dhe Ebu Auxha filloi të shprehte idetë materialiste nuk ekziston paracaktimi dhe asgjë e shkruar, natyra është nëna e gjithçkaje, kështu ka qenë jeta e kështu do të jetë përherë, e të tjera si këto.

Kur biseda e tij mbërriti këtu, Mufadali nuk mundi të duronte më, por shpërtheu si një top dhe thirri: "Armik i Zotit! Ti mohon krijuesin tënd!i Cili të ka krijuar në formën dhe mënyrën më përsosur?! Mos shko shumë larg. Hidhi një sy vetes dhe jetës dhe mjedisetqë ke përreth e të vësh re shenjat dhe veprat e krijimit dhe të kuptosh qëllimin e qenies….." Ebu Auxha, i cili nuk e njihte Mafdalin, pyeti: "Ti kush je dhe nga cili grup je? Në qoftë se je nje njeri i argumentit, atëherë eja të bisedojmë bashkë, dhe nëse ke argument të fort, ne do të të ndjekim. Në qoftë se nuk je njeri i fjalës, atëherë s'kemi çflasim me ty. Në qoftë se je prej shokëve të Xhafer ibn Muhamedit, ai nuk flet kështu me ne. Nganjëherë, ai dëgjon prej nesh shumë fjalë më të mëdha se këto që n dëgjove ti tani prej ne. Por nuk është parë dhe dëgjuar kurrë që të inatoset dhe të na bërtasë. Ai nuk nxehet kurrë dhe nuk na fyen. Ai e dëgjon fjalën tonë me kulmin e miqësisë dhe të respektit. Ai pret që ta shprehim të gjithë atë që kemi në zemër e të mos na mbetet pa thënë asnjë fjalë. Kur shprehim arsyet dhe bindjet tona, ai na dëgjon shumë qetësisht, sa ne kujtojmë se ai u është dorëzuar bindjeve tona. Atëherë, ai fillon e na përgjigjet me respekt. Disa fjalive të shkurtra dhe plot mençuri, na e bllokon rrugën,

duke na e marrë edhe fuqinë e arratisjes. Në qoftë se ti je prej shokëve të tij, atëherë fol si ai!"

Mufadali, i inatosur me fytin që i digjte nga inati, doli jashtë nga xhamia. Ai mendonte me vete e deri ku kishte mbërritur puna për Islamin. Njerëz të këtillë uleshin në Xhaminë e Profetit dhe pa farë frikë mohonin çdo gjë. Shkoi menjëherë te shtëpia e imamit. Imami sa e pa, i tha: - Mufadal, çfarë ka ndodhur që je kaq i mërzitur?

- O biri i Resulit!,- tha Mufadali. Tani isha te xhamia e Profetit. Pranë meje erdhën e u ulën nja dy veta prej mohuesve. Prej tyre dëgjova fjalë për mohimin e Zotit dhe të Profetit dhe mora flakë. Thoshin kështu e ashtu, dhe unë iu përgjigja në këtë mënyrë, - shpjegoi ai.
- Mos u mërzit, - i tha imami. Që nesër eja tek unë e të filloj të të jap disa mësime për Njësinë e Tij. Aq shumë do të të flas për Urtësinë e Zotit në krijim, për krijesa të ndryshme, si për gjallesat dhe sendet, për njerëzit dhe kafshët, për zogjtë dhe shpendët, për gjërat që hahen dhe për ato që nuk hahen e shumë të tjera, saqë ti dhe çdo nxënës tjetër që kërkon të Vërtetën të mbetet i mahnitur, dhe t'i lërë pa gojë materialistët dhe mohuesit. Të pres nesër në mëngjes.

Mufadali u largua shumë i kënaqur prej imamit. Me vete thoshte: Kjo mërzitja ime sot paska pasur përfundim të këndshëm. Atë natë nuk mundi të flinte. Priste me padurim që të bëhej mëngjes dhe të shkonte te imami. Ajo natë i dukej më e gjatë se çdo natë tjetër. Në mëngjes herët shkoi tek imami. Imami e mori dhe e çoi te dhoma ku priste vetëm të ftuar të veçantë. Mufadali i ndiqte imamin nga pas. Atëherë

imami, i cili e njihte karakterin e Mufadalit i tha: "Them se mbrëmë nuk të ka zënë gjumi gjithë natën, duke pritur që, kur do të bëhej mëngjes, të vish, këtu."

- Po, kështu është siç thoni ju,- u pergjigj Mufadali.
- O Mufadal, Zoti e thotë që ai është fillimi dhe fundi për të gjitha krijesat…
- O ibn Resulullah! A me jep leje që çfarëdo që të thuash t'i shkruaj?, – pyeti Mufadali.
- Po, shkruaji,- i tha imami.

Katër ditë me radhë, në katër seanca të gjata, imami i dha mësime Mufadalit dhe ai i shkroi të gjitha. Këto shkrime ai i tuboi dhe i bëri si libër.

Sot libri mban titullin "Teuhidi i Mufdalit" dhe është një nga librat më të saktë për çështjen e krijimit ai është fryt i asaj ndodhie dhe i atyre seancave të gjata mësimi.

GARAT ME DEVE

Myslimanët ishin shumë të dhënë pas garave me kuaj, me deve, me shigjeta e pas shumë garave të tjera. Islami e kishte bërë traditë ushtrimin e garave sepse njohja dhe mjeshtëria e tyre ishte e nevojshme për ushtarët.

Profeti, udhëheqësi i bashkësisë islame, merrte pjesë vetë në këto gara, dhe kjo ishte nxitja më e madhe dhe më i mirë për të rinjtë për të mësuar artet ushtarake. Deri në kohën kur në këto gara merrnin pjesë vetë prijësit e Islamit, në mesin e ushtarëve ruhej shpirti i vetëmohimit dhe i heroizmit. Profeti herë i hipte kalit dhe herë devesë e hynte vetë në garë me të tjerët.

Profeti kishte një deve, e cila njihej që vraponte shpejt dhe me çdo deve tjetër që garonte, kishte fituar. Pak nga pak, disa njerëz naivë filluan të mendonin se deveja ecte shpejt vetëm e vetëm se i përkiste Profeti dhe nuk ishtedeve në botë e cila mund të matej me të.

Një ditë aty vjen një arab, i cili tha se ishtegati të bënte gara me devenë e Profetit. Shokët e Profetit, të sigurt ne vetvete, dolën jashtë qyteteit për të parë garën, aq më tepër që tani vetë Profeti do ta ngiste devenë e tij. Profeti dhe arabi dolën përpara njerëzve dhe i vunë devetë në vijën e nisjes. Shikuesit

ishin shumë të entuziazmuar.Thërrisnin e bërtisnin nga gëzimi. Gara filloi dhe për habinë e të gjithëve, deveja e arabit e la pas devenë e Profetit. Ata myslimanëve që patën menduar për me devenë e Profetit, u zhgënjyen. Ata u prishën në fytyrë. Profeti u kthye dhe u tha: "S'keni përse të mërziteni. Deveja ime, duke ua kaluar të gjithave, i hyri vetja në qejf, filloi të mburrej e mendoi se asnjëra nuk ishte më lart se ajo. Mirëpo rregulli i Zotit është që mbi një dorë, të jetë një dorë tjetër, dhe pas çdo ngritjeje të fillojë ulja, dhe çdo mendjemadhësi të thyhet.

Mençuri e dobishme e Profetit i bëri të kuptonin gabimin.[1]

Shoqata Flladi

1) Uesail; vëll. 2, f. 472.

97

KRISHTERI I ETUR

Imam Sadiku (a.s) po kalonte në rrugën mes Mekës dhe Medines. Musadefi, shërbëtori i njohur i imamit ishte bashkë më të. Në mes të rrugës sytë i zunë një burrë, shtrirë pa ndjenja rrëzë një peme. Imami i tha Musadefit: "Shkojmë ta shikojmë atë burrë, se mos i ka rënë të fikët nga etja."
Iu afruan dhe imami e pyeti:- A ke etje?
-Po, -u përgjigj burri.me gjysmë zëri.
Musadefi zbriti nga deveja me urdhër të imamit dhe i dha ujë burrit. Mirëpo nga fytyra, veshja dhe rrobat u kuptua që ai nuk ishte mysliman, por i krishterë. Pasi imami dhe Musadefi u larguan që andej, Musadefi e pyeti imamin: - A lejohet t'i japësh lëmoshë të krishterit?
- Kur është e domosdoshme, si tani, sigurisht që po, – iu përgjigj imami.[1]

---

1) Uesail; vëll. 2, f. 50.

MIQTË E ALIUT

Një burrë së bashku me të birin shkuan si miq në shtëpinë e Aliut (a.s). Aliu i priti me të gjitha nderet dhe të mirat, duke u ulur përballë tyre. Erdhi koha e drekës. U sollën drekë dhe ata hëngrën. Pas drekës, Kamberi, shërbëtori i përmendur i Aliut, solli një peshqir, një sapun dhe ibrikun e ujit që të lanin duart. Aliu ia mori ata nga duart Kamberit dhe shkoi përpara që t'u shtinte ujë miqve që të lanin duart. Miku, i habitur, u tërhoq pas dhe tha: "Nuk është e mundur që ju të më hidhni mua ujë për të larë duart!"

"Vëllai yt është si ty,- ia ktheu Aliu. Nuk është veçan teje. Kërkon të të shërbejë dhe për këtë punë Zoti do ta shpërblejë. Përse kërkon ta pengosh sevapin e një pune?"

Prapë miku kundërshtoi. Më në fund, Aliu ia bëri të qartë: "Unë dua t'i shërbej nderit të vëllait tim besimtar, kështu që mos më pengo në punën time!" Miku pranoi me shumë ndrojtje. "Të lutem, mbaji duart mirë dhe drejt, ashtu siç do t'i laje, po qe se do të hidhte ujë Kamberi,"- i foli Aliu.

Pasi e mbaroi këtë punë, i tha të birit, Muhamed ibn Hanfijeh: "Ti tani shtiji ujë e djalit të lajë duart! Unë që jam babai yt, i shtiva ujë babait, ti shtijë djalit! Nëse i ati i këtij djali nuk do të ishte këtu dhe djali do të ishte mik vetëm, atëherë unë do

t'i shtija ujë atij, por Zoti dëshiron, meqë janë të pranishëm si djali ashtu dhe babai, të bëhet dallim në respektin mes tyre. Muhamedi e zbatoi kërkesën e të atit, dhe i shtiu ujë djalit mik.

Imam Askeriu, pasi e tregoi këtë histori tha: "Besimtari i vërtetë duhet të jetë kështu."[1]

Shoqata Flladi

1) Biharul Anuar; vëll. 9, f. 598, botuar në Tebriz

LEBROZËT

Në Medine ishin disa të sëmurë me lebrozë. Njerëzit iknin prej tyre të tronditur dhe të trembur. Të sëmurët përveç se duhej të duronin sëmundjen mbi trupin e tyre, vuanin shpirtërisht dhe nga sjellja e njerëzve. E, meqë që të tjerët i kishin neveri, ata rrinin të grumbulluar bashkë. Një ditë, kur ata ishin të mbledhur bashkë dhe po hanin diçka, kaloi pranë tyre Ali ibn Husejn, Zeinul Abidini. Ata e ftuan imamin që të hante me ta. Imami u kërkoi ndjesë dhe u tha: "Unë agjeroj, po të mos isha me agjerim, do të vija. Ju kërkoj që filan ditë të jeni miqtë e mi." Tha këtë dhe iku.

Imami dha urdhër që në shtëpi të gatuanin një gjellë shumë të mirë e të shijshme. Miqtë erdhën pikërisht ditën që ishin ftuar. Ata hëngrën drekë e bashkë me ta dhe imami, ulur në sofër me ta.[1]

1) Uesail; vëll. 2, f. 457.

IBN SIABEJA

Adurrahman ibn Siabe Kufi, ishte një djalë i ri i varfër, të cilit i kishte vdekur i ati. Vdekja e të atit, nga njëra anë dhe varfëria dhe papunësia nga ana tjetër, po e mundonin shumë shpirtin e tij të ndjeshëm. Një ditë, po rrinte në shtëpi, kur dikush trokiti në shtëpinë e tij. Ishte njëri prej shokëve të të atit. Ai erdhi t'i shprehte atij ngushëllimet. Pastaj e pyeti:
A të ka mbetur pasuri nga babai?
-Jo,- u përgjigj djaloshi.
- Dëgjo këtu, merri këta një mijë dërhem, por mundohu që t'i shpenzosh aty ku kanë vlerëprej interesit të tyre.
Këto fjalë tha shoku i babait dhe doli.
Shumë i gëzuar Abdurrahmani, shkoi me vrap tek e ëma dhe i tregoi qesen me para. I foli për atë që i kishte ndodhur. Sipas këshillës së shokut të babit të tij, ai nisi të mendonte se çfarë të bënte me ato para. Nuk priti që të bëhej natë dhe në darkë me paratë bleu mall. Zuri dhe një dyqan për vete e filloi të merrej me shit-blerje. Nuk zgjati shumë dhe puna filloi t'i ecte mirë kishte blerës.Bëri një llogari të vogël dhe i doli që jo vetëm mund ta kalonte mirë jetën e tij, me ato para por edhe do të bënte shumë të madhe mbi pasurinë që

kishte. Mendoi të shkonte në haxh. Foli me të ëmën dhe ajo i tha: Shko njëherë e ia ktheji ato një mijë dërhem atij shokut të babait tënd, i cili na ndihmoi, pastaj shko në Mekë."
Me një qese prej një mijë dërham ndër duar, Abdurrahmani shkoi te shoku i të atit dhe i tha: "Urdhëroni paratë!"
Në fillim, burri kujtoi se mos shuma e parave nuk mjaftonte dhë për këtë arsye Abdulrahmani kërkonte t'ia kthente dhe i tha: "Në qoftë se këto para janë pak, t'i shtoj".

- Jo, nuk janë pak; - tha Abdurrahmani. Ishin para plot bereqet. Por, meqë unë tani kam krijuar pasurinë time dhe nuk kam më nevojë për to, kam ardhur për t'ju falenderuar për bujarinë tuaj, dhe t'ua kthej ato. Kisha dëshirë që t'ju ktheja paratë tani që po iki dhe për haxh."

Abdurrahmani doli nga shtëpia dhe u nis për në haxh.
Pas mbarimit të haxhit ai u kthye sërish në Medine dhe së bashku me njerëz të tjerë shkuan të takonin imam Sadikun. Përpara derës së shtëpisë së imamit ishin mbledhur njerëz të shumtë. Abdulrahmani, i ndronjtur, qëndroi në fund të të gjithëve dhe vështronte të tjerët kur takonin imamin, dhe dëgjonte pyetjet e përgjigjet që shkëmbenin më të. Sapo u qetësua pak vendi, Imam Sadiku e vuri re atë, ia bëri me shenjë që të afrohej dhe e pyeti: - Ti kishe ndonjë gjë?
-Unë jam Abdulrahmani, biri i Siabe Kufi Bexhelit.
- Si është babai?- pyeti imami.
- Babai im ka shkuar te mëshira e Zotit,- u përgjigj ai.
-Zoti pastë mëshirë për të!,- tha imami. Pastaj e pyeti nëse i kishte mbetur ndonjë gjë trashëgim prej të atit.
- Jo, asgjë, – i tha Abdurrahmani.
-Po atëherë, si munde të shkosh në Haxh?, -e pyeti imami.

- Puna qëndron kështu,- filloi Abdurrahmani të tregonte ngjarjen. Vdekja e babait na rëndoi shumë. Varfëria nga ana tjetër. Derisa një ditë në shtëpi erdhi për ngushëllime një shok i babait, i cili më dha një mijë dërhem, e më tha që t'i vija në punë. Unë bëra këtë punë, fillova të nxjerr fitim dhe mendova të shkoja në haxh,- shpjegoi ai.

Kur tregimi i Abdurrahmanit mbërriti këtu, imami e ndërpreu dhe e pyeti: - Më thuaj çfarë bëre me një mijë dërhemët e shokut të babait?

-Bëra, ashtu siç më tha nëna. Përpara se te nisesha për haxh, ia ktheva shokut të babait.

- Të lumtë! Ti je njeri i mirë dhe i drejtë, - i tha imami. Njeriu i mirë dhe i drejtë është është ortak i mallit të të tjerëve…[1]

Shtëpia Shqiptare Filadelfia

1) Sefinetul Bihar; vëll.2, fjala "abede"

MIKU I GJYKATËSIT

Një njeri shkoi si mik i thjeshtë tek Aliu (a.s). Për ditë me radhë qe mik në shtëpinë e imamit. Mirëpo nuk qe mik i zakonshëm. Ai mbante diçka në zemër që kurrë nuk e shprehte. E vërteta ishte që ai ishte zënë me një njeri tjetër dhe po priste që të vinte dhe pala tjetër dhe t'i tregonte Aliut (a.s) si qëndronte puna. Mirëpo më në fund, një ditë, nuk duroi më dhe i tregoi vetë Aliut për zënkën dhe dënimin që kërkonte.

Aliu i tha: -Pra, ti tani qenke në konflikt?

-Po, o Emirul Mu'menin,- u përgjigj ai.

-Më vjen shumë keq, por që sot unë nuk mund të të pres më si mik ti,- vijoi Aliu. Vetë Profeti ka thënë se kur parashtrohet një konflikt përpara gjykatësit, gjykatësi nuk ka të drejtë të rrijë me asnjërën palë, përveçse kur të dyja palët i shkojnë atij bashkë si miq.[1]

1) *Uesail; vëll. 3, f. 395.*

FJALA E DYQANXHIVE

Ali ibn Musa Riza (a.s) qe dërguar nga Me'muni në Horasan duke pranuar kushtet e veçanta të vilajetit të Me'munit. Në këtë kohë edhe vëllai i tij Zeidu Nar ishte në Horasan. Për shkak të kryengritjes që kishte ndezur në Medine, Zeidi shikohej me sy shumë të keq nga ana e Me'munit. Por meqë politika e Me'munit ishte që të ruante marrëdheniet e mira të ndërsjellta me imam Rizain, nuk ia kishte burgosur a vrarë të vëllanë.

Një ditë, ishin mbledhur në kuvend shumë njerëz dhe imam Rizai po u fliste atyre. Nga ana tjetër Zeidi kishte mbledhur për vete një turmë njerëzish e po u fliste për virtytet e familjes së Profetit, pë euliatë dhe për një pozitën e tyre, shumë të veçantë duke përsëritur: "Neve jemi kështu; ne jemi ashtu," imam Rizai i dëgjoi fjalët që po thoshte Zeidi. E pa njëherë shtrëmbër dhe i thirri: "Zeid!" Të gjithë njerëzit dhe Zeidi u kthyen nga imami. "O Zeid,- vijoi imami, edhe ti i ke besuar fjalët e dyqanxhive të Kufës dhe tani po ua thua njerëzve. Ç'janë këto fjalë që thua? Ajo që ti ke dëgjuar që Zoti i ka shpëtuar nga zjarri bijtë e Fatimes, e ka pasur qëllimin për fëmijët e lindur nga vetë Fatimeja, Hasani, Husejni dhe dy

motrat e tyre. Nëse çështja qëndron ashtu siç thua ti që pasardhësit e Fatimesë kane pozitë të veçantë, dhe sido që të jetë ata janë të shpëtuar dhe të lumtur, i bie që ti të jesh me pranë Zotit se yt atë, Musa ibn Xhaferi. Mirëpo ai e ka zbatuar urdhrin e Zotit, kurse ti e kundërshton. Dhe, sipas asaj që thua ti, del që të dy jemi të shpëtuar dhe të lumtur. Por nuk është kështu. Humbja është me ty sepse Musa ibn Xhaferi bëri vepra të mira dhe u lumturua, ndërsa ti nuk ke punuar, e as vuajtur. Pra, si ke fituar? Ali ibn Husejn Zejnul Abidini thoshte: "Punët tona të mira të Ehli Bejtit të Profetit llogariten dyfish por, po ashtu dhe punët e këqija llogariten dyfish. Ashtu siç e ka shpjeguar edhe Kur'ani për gratë e Profetit. Kështu, ai ndër ne që bën një punë të mirë, në të vërtetë ai ka bërë dy punë të mira; e para është se ai ka bërë një punë si të gjithë të tjerët dhe e dyta është se ai ka ruajtur nderin dhe dinjitetin e Profetit. Nga ana tjetër atij edhe që bën gabim, i llogariten dy gabime: i pari është vetë gabimi i bërë dhe i dyti është turpërimi i emrit të Profetit." Pastaj imami u kthye nga Hasan ibn Musa**,** që ishte nga Iraku dhe e pyeti: Si e lexon populli i Irakut këtë ajet të Kur'anit: **"… O Nuh, ai nuk është nga familja jote, ai ka bërë punë të keqe..."** *(Sure "Hud", ajeti 46)*

"O nipi i Profetit!- i foli ai. Disa njerëz e lexojnë në mënyrë: "innehu amelun gajre salih", por disa të tjerë, të cilët nuk besojnë që Zoti të ndëshkojë një fëmijë të ndonjë Profeti. Për këtë ata lexojnë ajetin kështu: "innehu amelu gajru salih" dhe thonë se ai nuk ishte prej gjenezës së Nuhut; _Zoti atij i kishte thënë; "O Nuh, ai nuk është prej gjenezës tënde, nëse do të ishte unë do ta shpëtoja atë për hatrin tënd."

Imami ndërhyri e tha; "Jo, nuk ka qenë ashtu. Ai ishte djali i vërtetë dhe nga gjeneza e Nuhut. Por, meqë ai u bë punëkeq dhe iu rebelua rrugës së Zotit, ai e humbi dhe lidhjen shpirtërore me Nuhun. Nuhut iu tha, - "ky biri yt nuk është prej të drejtëve" dhe për këtë ai nuk mund të rreshtohet në mesin e tyre. Edhe çështja e familjes sonë kështu është. Themeli i punës është lidhja shpirtërore, drejtësia në veprim dhe bindja ndaj urdhrit të Zotit. Ai që e zbaton urdhrin e Zotit, është prej nesh, prej Ehli Bejtit, edhe sikur të mos ketë asnjë lidhje gjaku, fisi e trupi me ne. Dhe, kushdo që është mëkatar, nuk është prej nesh, edhe sikur ai të jetë nga pasardhësit e vërtetë të Fatimes. Edhe ti që nuk ke asnjë lidhje gjaku me ne, nëse je njeri i drejtë dhe zbatues i fjalës së Hakut (Allahut), je prej nesh".[1]

1) Biharul Anuar; vëll. 10, f. 65.

PLAKU DHE FËMIJËT

Një burrë i moshuar po merrte abdes. Mirëpo nuk dinte si ta merrte. Imam Hasani dhe Imam Husejni, të cilët në atë kohë ishin fëmijë, e vunë re plakun se si po merrte abdes. Nuk kishte vend më për dyshim; plakut i duhej mësuar si të merrte abdes. Mirëpo po t'i thuhej, plakut drejtadrejt që avdesi i tij nuk ishte në rregull, ai do të fyhej, dhe kjo gjë do t'i mbetej gjithmonë si një kujtim hidhur në mendje.Kështu, duhej vepruar më atë mënyrë që plaku të mos ndihej i fyer dhe si merrej abdesi ta mësonte siç duhej.

Kështu, të dy fëmijët, menduan që t'ia mësonin plakut mënyrën të marrjes së abdesit në mënyrë indirekte. E ujdisën punën njëri me tjetrin dhe filluan të flisnin me zë të lartë dhe plaku i dëgjonte. Njëri tha: "Abdesi im është më i plotë si avdesi yt. – "Jo, i imi është më i plotë," - u përgjigj tjetri. Pastaj ranë në ujdi që të dy të merrnin abdes dhe plaku t'i gjykonte. Vepruan ashtu siç ia vendosën.Që të dy e morën abdesin të plotë, ashtu siç duhet. Tashmë plaku e kuptoi se si merrej abdesi, Ai e kuptoi që fëmijët kishin dashur ta mësonin me ëmbëlsi. Ai u ndikua shumë nga kjo gjë dhe tha: "Abdesi juaj është ai i duhuri dhe i ploti. Unë, një plak

i vjetër dhe i paditur, ende nuk e dija se si merrej abdesi. Në sajë të mirësisë që keni ndaj Ymetit të gjyshit tuaj, ma mësuat atë. Ju falemnderit."[1]

1) Biharul Anuar; vëll. 10, f. 89.

MESAZHI I SA'ADIT

Ngjarja gjithë tronditje e hidhërim e Uhudit kishte përfunduar. Në fillim të betejës, në sajë të një sulmi të fuqishëm e të shpejtë, myslimanët kishin arritur t'u jepnin një goditje të fortë trupave të Kurejshëve, duke i detyruar të tërhiqeshin por, për arsye të hutimit dhe të shpërfilljes nga disa prej ushtarëve, gjendja u përmbys plotësisht: myslimanët u kapën në befasi dhe shumë prej tyre mbetën të vrarë. Po të mos kishte qenë qëndresa e vetë Profetit dhe e një grupi të kufizuar trimash, e tërë puna e myslimanëve do të kishte marrë fund; myslimanët arritën t'i mblidhnin forcat e tyre dhe t'i bënin ballë thyerjes përfundimtare.

Gjëja, e cila u bë shkaku më kryesor që myslimanët të humbisnin moralin e tyre ishte gënjeshtra dhe shpifja që gjoja Profeti Muhamed ishte vrarë. Kjo fjalë bëri që morali i myslimanëve të dobësohej shumë, ndërsa Kurejshët të merrnin zemër. Por, kur Kurejshët e morën vesh fjala qe gënjeshtër dhe se Profeti ishte gjallë, vendosën të ishin të kënaqur me atë fitore që kishin arritur dhe u kthyen në Mekë.

Myslimanët kishin rënë të vrarë dhe të plagosur mbi tokë. Një pjesë tjetër e madhe ishin shpërndarë të hutuar dhe të lodhur. Një grup i paktë kishte mbetur përreth Profetit.

Ata, që ishin hutuar a ishin arratisur nuk e dinin se si kishte vajtur puna. Nuk e dinin a ishte Profeti akoma gjallë apo jo? Në këtë mes, një mysliman që po largohej nga fushëbeteja, kaloi pranë një të plagosuri, i cili quhej S'ad ibn Rabi'. I plagosuri kishte marrë dymbëdhjetë plagë të rënda mbi trup. Ai e pyet myslimanin për Profetin. Myslimanit që po ikte dhe i thotë; "Nga ajo që dëgjova unë, Profeti është vrarë!" Sa'di ia ktheu; "Por, Zoti i Muhamedit është gjallë dhe nuk vdes kurrë. Ti pse sorrollatesh dhe nuk e mbron fenë tënde? Detyra jonë nuk ishte të mbronin personin e Profetit, e nëse ai është vrarë të ndryshojë çështja. Ne kemi mbrojtur fenë tonë dhe kjo çështje kështu do të jetë përherë."
Profeti nga ana tjetër, i cili po interesohej se kush ishte gjallë dhe kush ishte i vdekur, kush ishte plagosur, kujt i mjekohej plaga dhe kujt jo, tha: "Kush nga ju del vullnetar që të më sjellë informacion të saktë për Sa'd ibn Rabinë?"
Njëri prej shokëve doli e tha, -"Unë".
Shoku u nis dhe e gjeti Sa'din mes trupave të tjerë të pajetë. Sa'dit nuk i kishte mbetur vetëm pak frymë jetë, kur ai i tha: "Më ka dërguar Profeti të pyes për ty, në je ende gjallë apo jo?"
"Profetit çoji të falat e mia,- foli Sa'di, - dhe thuaji që Sa'di është prej të vdekurve, sepse nuk i ka mbetur shumë për të jetuar. Thuaji edhe që Sa'di tha: Zoti të dhëntë shpërblimet më të çmuara që meriton një Profet." Pastaj shtoi: "Shokëve të Profetit jepu dhe këtë fjalë nga ana ime: "Nuk do të faleni prej Zotit, nëse Profetit tuaj i ndodh diçka gjatë kohës që ju keni shpirtin në trup."

Shoku ende nuk ishte larguar mirë prej Sa'dit, kur Sa'di ia dorëzoi shpirtin e tij Krijuesit të shpirtit.[1]

Shoqata Flladi

1) Sherh Nehxhul Belaga i ibn ebi Hadijdit; vëll. 3,f. 584 dhe Siretu ibn Hisham; vëll. 2, f. 94.

LUTJA QË U PLOTËSUA

"O Zot, kthemë te paraardhësit e mi". Kjo ishte lutja që Hindit, gruaja e Omar ibn Alxhamuhut, dëgjoi nga goja e bashkëshortit të saj, kur rroku armët dhe u bë gati të shkonte e të bashkohej më myslimanët në Luftën e Uhudit. Kjo ishte hera e parë që Omari bashkohej më myslimanët për luftë. Ai nuk kishte marrë pjesë asnjëherë deri atëherë, sepse ishte i çalë. Edhe vetë Kur'ani, thotë se për të verbrin, të çalin dhe të sëmurin lufta nuk është detyrim. Kishte katër djem si luanë të cilët luftonin përherë përkrah Profetit të Nderuar. Për këtë arsye askush nuk priste që Omari të nisej dhe vetë për në fushbetejë.

Sapo e mësuan vendimin e tij, i erdhën farefisi e tij për ta ndaluar dhe i thanë: "Në radhë të parë, ti je i falur nga vetë ligji i luftës, dhe së dyti, ti ke katër djem të cilët janë ushtarë të Profetit e nuk është e nevojshme që edhe ti vetë të shkosh të luftosh."

Omari u tha: "Ashtu siç e dëshirojnë lumturinë dhe xennetin e përjetshëm djemtë e mij,, edhe unë e kërkoj atë. Ata të shkojnë e të bien dëshmorë, ndërsa unë të rri këtu në shtëpi me ju?! S'bëhet kurrë."

Farefisi i tij u tërhoqën nga kërkesa e tyre. Njëri pas tjetrit, ata vinin duke i kërkuar Omarit që të hiqte dorë nga ajo punë.

Për të shpëtuar prej tyre, Omari shkoi e foli me vetë Profetin.

- Familjarët e mi, kërkojnë që të më mbajnë të mbyllur në shtëpi dhe të mos luftoj në rrugën e Zotit. Për Zotin, dëshiroj që të shkoj në parajsë me këtë këmbë të çalë që kam.

- O Omar, ti je i falur nga kjo vepër. Vetë Zoti të ka falur ty, dhe nuk je i detyruar të luftosh,- i tha Profeti.
- O Profet i nderuar, unë e di këtë gjë. Megjithëse nuk e kam të detyruar, unë dua sërish…, - u përgjigj Omari.

Atëherë Profeti tha: "Mos e pengoni! Ka dëshirë të bëhet dëshmor, ndoshta Zoti ia plotëson këtë gjë"

Një nga skenat më tërheqëse të betejës së Uhudit, ishte lufta që bënte Omar ben Alxhamuhu: me atë këmbën e tij të çalë, futej në mes të ushtrisë armike dhe thërriste: "Dua Xhennetin". Një prej djemve të tij i rrinte gjithmonë pas shpine. Me kaq vrull luftuan këta të dy, saqë më në fund u vranë.

Pas mbarimit të luftës, shumë prej grave të Medines dolën nga qyteti që të shikonin nga afër atë që kishte ndodhur, sidomos pas atyre lajmeve të tmerrshme që vinin. Njëra prej këtyre grave ishte dhe Aishja, e shoqja e Profetit. Aishja, sapo kishte dalë pak nga qyteti, pa Hindin, gruan e Omar ibn Alxhumuhut, e cila po vinte drejt Medines me një deve, që mbarte tre trupa të pajetë. Aishja e pyeti: - Ç'ka ndodhur?

"Falë Zotit, Profeti është shëndoshë e mirë. Ai të jetë mirë dhe ne nuk kemi hidhërim tjetër. Ndërsa lajmi tjetër është

që: "Allahu i zmrapsi jobesimtarët (e ushtrisë së aleateve)me hidhërimin e tyre." *(Sure "Ahzab"ajeti 25*

-Të kujt janë këta trupa?,- e pyeti Aishja.

-Janë trupat e pajetë të vëllait tim, djalit dhe burrit tim, - u përgjigj Hindi.

-Ku po i çon? – e pyeti Aishja.

-Po i çoj në Medine, që t'i varros,- u përgjigj Hindi.

Hindi tha këto fjalë dhe e tërhoqi devenë drejt Medines, por deveja më zor ecte pas Hindit, dhe pastaj ndaloi.

- Pesha është e rëndë, kafsha nuk mund ta mbajë,- i tha Aishja.

-Kjo deveja jonë është shumë e fuqishme. Ajo shpesh mban ngarkesën e dy deveve. Duhet të këtë ndonjë hall tjetër, - tha Hindi. Tha këto fjalë dhe e tërhoqi sërish devenë. Kur e ktheu nga krahu i Medines, deveja ra në gjunjë. Kur e kthente devenë nga ana e Uhudit, deveja ecte lirshëm.

Kjo ishte diçka e habitshme: kafsha nuk donte të ecte për në Medine, ndërsa për nga ana e Uhudit ecte me shpejtësi. Duhet të ketë ndonjë sekret kjo punë, - mendoi me vete Hindi. Atëherë tërhoqi devenë, dhe se bashku me tre trupat e pajetë të të afërmëve të saj u kthye në Uhudit dhe pyeti Profetin:

-O i Dërguar i Zotit! Është diçka e çuditshme. Sa herë që dua ta çoj devenë për në Medine, nuk më bindet, sa herë që kthehem drejt Uhudit ajo fillon e të ecë me të shpejtë. Përse?

- A të ka thënë gjë burri përpara se të nisej për në luftën e Uhudit?- e pyeti Profeti.

- O i Dërguar! Kur u nis, unë i dëgjova atij këtë fjali: "O Zot, kthemë te paraardhësit e mi"!

- Kjo është arsyeja,- tha Profeti. Është pranuar lutja e pastër e burrit tënd dëshmor. Zoti nuk kërkon që trupi i tij të kthehet në Medine. Në mesin tuaj ka njerëz, të cilët, nëse ia kërkojnë Zotit diçka dhe të betohen për këtë gjë, Zoti ua plotëson atyre lutjet. Edhe burri yt, Omar ibn Almaxhuhu ishte prej këtyre njerëzve,- tha Profeti.

Me fjalën e Profetit, të tre trupat u varrosën në Uhud. Pastaj, Profeti iu drejtua Hindit dhe i tha:

- Këta tre veta do të jenë së bashku në atë Botë.
- O, i Dërguar i Zotit,- u lut Hindi. Kërkoji Zotit që edhe unë të jem me ata.[1]

Shoqata Flladi

1) Sherh Nehxhul Belaga i ibn ebi Hadijdit; vëll. 3,f. 566.

IMUNITETI QË U ANULLUA

Për shkak të torturave dhe shtypjeve që bënin Kurejshët në Mekë, myslimanët kishin emigruar në Habeshe. Ata prisnin çdo ditë lajme të reja nga Meka. Sado që ishin paktë, kurse numri i kundërshtarëve dhe i idhujtarëve ishte shumë i madh, ata sërish nuk i kishin humbur shpresat, sepse shikonin që numri i tyre rritej dita-ditës, ndërsa ai i idhujtarëve pakësohej dita ditës. Ata shpresonin që së shpejti edhe kundërshtarët e tyre do ta grisnin perden e padijes dhe një ditë do të bashkoheshin me ta, duke u bërë myslimanë.

Kështu, gjatë kohës që myslimanët po qëndronin në Habeshe, u përhap lajmi se Kurejshët e kishin ndryshuar besimin e tyre dhe se që të gjithë kishin pranuar Islamin. Megjithëse ky lajm ende nuk ishte pranuar zyrtarisht, besimi dhe shpresa e madhe që kishin myslimanët për fitoren e fesë islame u bë shkak që një grup prej tyre, pa pritur që lajmi të aprovohej, u nisën të entuziazmuar drejt Mekës. Njëri prej tyre ishte Osman ibn Mazuni, një prej shokëve më të dashur të Profetit dhe të të gjithë myslimanëve. Osmani, sapo mbërriti pranë Mekës, e kuptoi që e gjitha kishte qënë një gënjeshtër dhe se përkundrazi, Kurejshët i kishin shtuar edhe më shumë torturat ndaj myslimanëve.

Nuk kishte as rrugë kthimi e as rrugë për përpara. Habesheja nuk ishte afër gjithashtu që të ktheheshe lehtë. Po të futej në Mekë, sërish do të kapej e torturohej. Më në fund, i erdhi në mëndje të bënte vetëm një gjë, dhe ajo ishte që të shfrytëzonte atë zakonin arab duke u bërë si fqinju i një prej Kurejshëve.

Zipas zakonit të arabëve, kur dikush kërkonte që tjetri ta strehonte dhe ta mbështeste, ky i jepte besën dhe e mbronte atë deri në vdekje. Për arabin ishte një turp shumë i madh që dikush të kërkonte besën, qoftë dhe armik**,** mos t'ia jepje, a të mos e përkrahje. Kështu edhe Osmani, në mes të natës u fut në Mekë dhe shkoi te shtëpia e Velid ibn Mugireje Makhzumi, që ishte një prej personaliteteve dhe pasanikëve të Mekës, e i kërkoi besën. Edhe Velidi ia dha atij besë.

Të nesërmen, Velidi shkoi në kuvendin krerëve të Kurejshëve, duke sjellë me vete dhe Osmanin. Pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit, shpalli se Osmani ishte nën besën e tij dhe që nga ajo orë, ai që i kundërvihej atij, ishte armik me Velidin. Kurejshët e respektonin besën e Validit dhe kështu që nuk iu kundërvunë Osmanit dhe që nga ajo orë ai fitoi "imunitet". Lëvizte i lirshëm dhe shkonte e vinte nëpër takimet e mbledhjet e Kurejshëve.

Por, ndërkohë, Kurejshët nuk hiqnin dorë së torturuari dhe së përndjekuri myslimanët. Kjo ishte shumë e rëndë për Osmanin, i cili kurrë nuk donte të shikonte vuajtjet dhe torturat e shokëve të tij.

Një ditë, Osmani mendoi me vete që nuk ishte gjë e mirë që ai të rrinte i paprekur nën mbrotjen e dikujt, ndërsa vëllezërit e tij të një besimi të vuanin. Prandaj shkoi te Velidi dhe i tha;

"Unë të falenderoj, ti më strehove dhe më mbrojte. Por që sot dua të dal nga besa dhe të bashkohem me shokët e mi. Lërmë që çfarëdo që u ndodh atyre, të më ndodhë dhe mua!"

- Vëllai i dashur!, – i tha Velidi. Mos vallë nuk ia ke kaluar mirë dhe nuk je ndjerë i sigurt nga mbrojtja ime?
- Jo, përkundrazi, unë kam qenë shumë i kënaqur, por tani dua të jetoj nën mbrojtjen e Zotit,- u përgjigj Osmani.

-Tani, meqë more këtë vendim, le të shkojmë përpara Kurejshëve, siç shkuam ditën e parë, kur shpalla mbrotjen time për ty dhe thuaj përpara tyre që po del vetë nga mbrojtja dhe besa ime,- i tha Velidi.

- Shumë mirë,- tha Osmani. Dhe, që të dy bashkë u nisën për te Kurejshtë. Kur u mblodhën të gjithë Kurejshët, Velidi tha: "Të gjithë le ta dinë që Osmani ka ardhur që të dalë nga besa ime."

"Kështu është, - tha Osmani, për këtë gjë kam ardhur. Dua të shtoj që gjatë kohës që kam qenë nën mbrotjen e tij, nuk kam pasur asnjë shqetësim a pakënaqësi. Shkaku që dal nga besa e tij është vetëm ky: nuk dua që dikush tjetër të më ketë nën mbrojtje, përveç Zotit që është Një".

Kështu, mbrotja dhe imuniteti që Osmani kishte deri në atë orë, u anulua. Osmani vazhdoi të shkonte në mbledhjet e Kurejshëve pa i ndodhur asgjë.

Ato ditë, në Mekë vjen dhe poeti i famshëm arab i asaj kohe, Labidan Rabie, i cili kishte shumë dëshirë të recitonte në mesin e Kurejshëve poezinë e tij të re që ishte një prej kryeveprave të poezisë arabe të kohës para Islamit Labidi doli përpara Kurejshëve dhe filloi të këndonte poezinë e tij. Me plot krenari dhe mburrje ai filloi të recitonte.

Vargu parë i poezisë së Labidit fillonte me: "Asgjë nuk është e qëndrueshme, përveç Zotit".
Për këtë varg, Profeti kishte thënë: është vargu më i drejtë që ka kënduar ndojnjë arab"
Pasi tha vargun e parë,"Asgjë nuk është e qëndrueshme, përveç Zotit", Osmani i cili ishte ulur aty pranë, nuk la kohë që ai të thoshte vargun e dytë të poezisë e, u hodh e tha: "Të lumtë, mirë e the, kjo është e vërteta. Të gjitha gjërat e tjera janë kalimtare dhe të pavërteta, përveç Zotit!"
Labidi recitoi vargun e dytë dhe tha: "Çdo bekim dhe e mirë vdes e humbet".
Kësaj radhe Osmani e ngrit zërin dhe tha: "Kësaj radhe gënjeve. Nuk marrin fund të gjitha bekimet. Kjo gjë vlen vetëm për bekimet e kësaj bote. Bekimet e botës tjetër janë të qëndrueshme dhe të përjetshme."
Të gjithë u kthyen nga ana e Osmani, nga ai burri trim. Askush nuk e priste që në mesin e krerëve të Kurejshëve e të poetit të famshëm Labid, që kishte bërë gjithë atë rrugë për të ardhur deri këtu që të thoshte poezinë e tij për krerët e Kurejshëve, që Osmani, i cili deri para pak orësh ishte nën mbrotjen e një tjetri e tani nuk kishte as fizike as siguri materiale e kur shokët e besimit të tij ishin nën vuajtje e tortura, të ngrihej dhe të thoshte me aq guxim ato fjalë.
Të pranishmit i thanë Labidit që ta përsëriste poezinë e tij.
Labidi filloi përsëri:
"Asgjë nuk eshtë e qëndrueshme, përveç Zotit".
Sërish u ngrit Osmani dhe tha: "Është e vërtetë, është e vërtetë".
Pastaj Labidi tha: "Çdo bekim dhe e mirë vdes e humbet".

Osmani tha: "Kjo është gënjeshtër. Nuk është kështu. Bekimet e asaj Botë janë të përjetshme."

Kësaj radhe Labidi u nxeh shumë dhe tha; "O populli i Kurejshëve! Ç'ju ka gjetur kështu? Ju nuk vepronit kështu më parë. Nuk kishit në mesin tuaj kështu njerëz të paedukatë. Si ka mundësi që në mesin tuaj të gjënden të tillë njerëz?"

Ndërkohë u ngrit njëri prej të pranishmëve dhe i tha Labidit që të mos mërzitej, por të vazhdonte me poezinë e tij: "Mos u mërzit prej fjalëve të këtij burri, është njeri i marrë, ka dhe njerëz të tjerë si vetja, që kanë dalë nga feja jonë e kanë zgjedhur fe tjetër për vete."

Osmani iu përgjigj shumë ashpër edhe ky nuk mundi ta duronte këtë njeriu. U ngrit nga vendi dhe e goditi fort Osmanin në fytyrë sa i nxori syrin vendit. Njëri prej të pranishmëve thirri; "Osman! Mosmirënjohës! Ishe nën besën e një njeriu të mirë. Nëse nuk do të kisha dalë nga besa e Velidit, nuk do të të ishte bërë syri kështu."

"Mbrojtja e Zotit është më fortë dhe më e sigurt,- u përgjigj Osmani. Sa për syrin tim, dije që edhe syri tjetër është i gatshëm të bëhet si syri i parë".

Në këtë mes hyri Velidi dhe tha; "Osman! Unë jam gati sërish të të jap besën."

"Por unë kam vendosur që të mos pranoj besën e askujt, përveç besës së Zotit",-tha Osmani.[1]

---

1) Esedul Gabeti; vëll. 3, f. 385 dhe 386. Siretu ibn Hisham; vëll. 1, f. 364-370

PARULLA E PARË

Thashethemet që herë pas herë vinin nga Meka në mesin e fisit Beni Gafur i kishin tërhequr vëmendjen dhe ngjallur kureshtjen Ebu Dher-rit. Ai kishte shumë dëshirë të mësonte se çfarë po ndodhte në të vërtetënë Mekë, sepse nga lajmet që vinin nga njerëz të pabesueshëm, nuk kuptohej asjë e saktë. Ajo që kishte arritur të kuptonte me siguri ishte që në Mekë kishte filluar një lëvizje e re për të cilën mekasit po bënin shumë përpjekje për ta shuar. Mirëpo, ç'ishte ajo lëvizje, ç'fjalë thuheshindhe përse mekasit e kundërshtonin, nuk dihej asgjë. Të vëllait, që po nisej për në Mekë, i tha: "Thonë që në Mekë është shfaqur një njeri, i cili po thotë fjalë të reja dhe mëton se ato fjalë janë zbuluar nga ana e Zotit.Tani, ti, që po shkon në Mekë, interesohu dhe merr vesh si qëndron puna, dhe eja e më thuaj"!

Ndenji me ditë duke pritur të vëllanë. Pasi ai u kthye, shkoi ta takonte menjëherë dhe e pyeti; -Pa hë, çfarë po ndodhte atje, si ishte puna?

-Aq munda unë të mësoj: ishte një burrë, i cili i ftonte njerëzit drejt moralit të mirë; edhe fjalët që thoshte, nuk ishin vjershë;

- iu përgjigj i vëllai.

-Unë të thashë të pyesje për më shumë;- i tha Ebu Dher-ri. E shikoj që duhet të nisem vetë për në Mekë, e ta shohj si qëndron puna.

Abuzari mori ushiqimin, me vete dhe u nis për në Mekë. Vendosi që sido që të ishte, të takohej vetë me atë burrë dhe fjalët e tij t'i dëgjonte vetë nga goja e tij. Mirëpo as nuk e njihte atë dhe as nuk guxonte të pyeste njeri se ku rrinte ai. Mjedisi i Mekës ishte shumë i zymtë dhe i egër. Pa bërë fjalë më askënd, Abuzari hapte veshët se mos dëgjonte ndonjë gjë nga njerëzit përreth.

Qëndra e të gjitha lajmeve dhe ngjarjeve ishte Qabja dhe Ebu Dher-ri me një frymë shkoi atje. Ditën e bëri natë, e gjë nuk arriti. Pasi kaloi mesi i natës, i lodhur, u shtri aty. Nuk zgjati shumë dhe një djalosh i ri i kaloi aty pranë Ebu Dher-rit. I riu i hodhi një vështrim nga kokat e këmbët Ebu Dher-rit dhe pastaj u largua. Për Ebu Dher-rin, vështrimi i të riut ishte kuptimplotë. Mendoi me vete që ndoshta ky djalë i ri e meritonte që t'ia shprehte atë që mbante në zemër. U ngrit dhe filloi ta ndiqte djaloshin; mirëpo nuk guxoi t'i thoshte gjë e u kthye sërish ne vendin e tij.

Ditën e nesërme kaloi sërish aty rreth Qabesë. Sërish edhe atë ditë nuk arriti të mësonte gjë. Ra nata dhe u shtri po në të njëjtin vend. Mu në atë orën e natës së kaluar u shfaq ai djali i ri. Iu afrua Ebu Dher-rit dhe me respekt i tha; "A nuk ka ardhur koha që të vish në shtëpinë time, dha ta kalosh aty natën"? Tha këto fjalë dhe e mori Ebu Dher-rin në shtëpi. Atë natë, Abuzari ishte mik në shtëpinë e djali të ri, por sërish stepej që t'i tregonte çfarë mbante në zemër. Edhe i riu nuk i pyeti gjë atij.U bë mëngjes Ebu Dhr-ri doli nga

shtëpia, u nda nga i riu, e shkoi në Qabe. Gjatë gjithë ditës Ebu Dher-ri nuk arriti të mësonte asgjë nga fjalët e njerëzve. Ra përsëri nata. Mu në orën e natës së kaluar djali i ri. E mori sërish Ebu Dher-rin me vete në shtëpi. Mirëpo kësaj rradhe djali e theu heshtjen:- "A mund të më thoni se për çfarë pune keni ardhur në qytet?,- e pyeti Ebu Dher-rin.

- Po më dhe fjalën që do të më ndihmosh, do të ta them, - iu përgjigj Ebu Dher-ri.

-Të premtoj që do të të ndihmoj,- iu përgjigj djaloshi.

U bë kohë,- filloi të tregonte Ebu Dher-ri që dëgjoj në mesin e fisit tim në Mekë është shfaqur një njeri, që thotë fjalë, të cilat mëton se ia ka zbuluar Zoti. Unë kam ardhur që ta takoj vetë atë dhe të shikoj si qëndron puna e tij. Tani, ti si mendon për këtë burrë? Dhe a mund të më ndihmosh që ta takoj atë?

-Të jesh i bindur, - I tha djaloshi,- që ai është i vërtetë dhe çfarëdo që thotë, e thotë nga Zoti. Në mëngjes unë do të të çoj tek ai. Por, pa e kuptuar banorët e këtij qyteti që unë të kam dërguar tek ai, atëherë me të dy jemi në rrezik. Nëser në mëngjes unë do të dal nga shtëpia; ti më ndiq me pak largesë dhe eja aty ku të shikosh se shkova unë. Unë do të mbikëqyr rreth e qark. Po pashë se afrohet ndonjë rrezik, do të ulem përtokë, sikur më ka humbur diçka.Ti kuptoje që kjo është shenja e rrezikut dhe largohu që andej; por s'paske asnjë rrezikut, ti eja aty ku do të shkoj unë.

Të nesërmen, djaloshi i ri, i cili nuk ishte njeri tjetër përveçse Ali ibn Ebu Talibit, doli nga shtëpia dhe nisi të ecte. Ebu Dher-ri filloi ta ndiqte. Fatmirësisht, rruga nuk paraqiti asnjë rrezik. Aliu e shpuri Ebu Dher-rin te shtëpia e Profetit.

Ebu Dher-ri nisi të bisedonte ngrohtësisht me Profetin dhe dëgjonte ajetet e Kur'anit. Nuk shkoi puna as për te takimi i dytë, sepse Ebu Dher-ri e pranoi Islamin dhe i dha besën Profetit, që derisa të ishte gjallë, në rrugën e Zotit nuk do të kishte asnjë frikë edhe ne hallin më të madh, ai do të thoshte fjalën e së Vërtetës.

"Tani ktheu te fisi yt, - i tha Profeti,- dhe ata ftoji në Islam derisa të jap një porosi të dytë."

-Shumë mirë,- tha Ebu Dher-ri. Betohem për Zotin që përpara se të largohem nga ky qytet, do të kaloj mes banorëve të tij dhe do të ftoj për Islam. U bëftë ç'u bëftë!

Abuzari doli nga shtëpia dhe shkoi në Qabe, e cila ishte qendra e qytetit të Mekës dhe e Kurejshëve dhe thirri: "S'ka zot tjetër përveç Zotit dhe Muhamedi është i dërguari i Tij". Mekasit, sapo e dëgjuan, pa pyetur fare se kush ishte dhe nga ishte ai, iu hodhën përsipër. Nëse nuk do të kishte dalë Abas ibn Abdul Matalibi, prej Abuzarit nuk do të kishte mbetur as nam e as nishan. Abasi u tha mekasve: "Ky burri është prej fisit Bani Gafur. Rruga e karvanëve të tregtisë së kurejshëve nga Meka për në Siri kalon nga toka e këtij fisi. Ju nuk mendoni që po t'a vrisni atë, nuk do të mund të kaloni shëndoshë e mirë nga rruga e tyre".

Ebu Dher-rin e liruan, mirëpo atij ende nuk i ishte kënaqur zemra dhe tha me vete: Ta përsëris edhe njëherë këtë fjali, që këta njerëz, t cilëve nuk u pëlqen, pak nga pak të mësohen me të. Prandaj të nesërmen erdhi sërish dhe thirri parrullën me gjithë fuqi. Sërish mekasit iu derdhën mbi shpinë, e sërish atë e shpëtoi Abas ibn Abdul Matalibi.

Pas këtij veprimi, ashtu siç e pati urdhëruar Profeti, Abuzari vajti në mesin e fisit të tij dhe filloi të përhapte mësimet e Profetit. Kur Profeti vajti nga Meka për në Medine, edhe Ebu Dher-ri vajti atje e qëndroi aty derisa vdiq. Ebu Dher-ri deri ne fund të jetës së tij e mbajti fjalën që pati thënë! Gjatë kohës së kalifatit të Osmanit, e internuan në një vend jashtë Medines, të quajtur Rabze dhe aty vdiq i vetmuar. Profeti i nderuar pati thënë për Ebu Dher-rin; "Zoti e ndihmoftë Ebu Dher-rin! Ai jeton vetëm do të vdesë vetëm, dhe do të ringjallet i vetëm".[1]

Shoqata Flladi

1) Esedul Gabeti; vëll. 1, f. 301 dhe vëll. 8, f. 186. El Gadijr; vëll. 8,f. 314,botuar në Beirut.

TEK KËSHTJELLA E RUSTEMIT

Rustem Farakhzadi**,** me një ushtri të madhe dhe të armatosur mirë, ishte nisur për të thyer myslimanët, të cilët u kishin shkaktuar humbje të rëndë persianëve.Ushtria hyri brenda Kadisijes. Myslimanët, nën drejtimin e Sa'd Vekasit, ishin vendosur përballë Kadisijes. Sa'di kishte përgatitur disa trupa si front të parë dhe komandën e tyre ia kishte besuar Zuhretu ibn Abdullahut. Rustemi, i cili kaloi një natë në Kadise, doli të nesërmen jashtë qytetit dhe qëndroi për njëfarë kohe mbi një kodër duke vrojtuar gjendjen e kampit të myslimanëve. Vuri re që armatimet dhe pregatitjet e myslimanëve nuk ishin të asaj shkallë sa të t'i shtinin frikën. Mirëpo sikur iu shpall në zemër se lufta me këta njerëz nuk do të kishte fund të mirë.Rustemi, qysh atë natë, me anë të një mesazhi thirri Zuhretu ibn Abdullahun, duke i ofruar para e duke i propozuar që të bënin paqe dhe ata të ktheheshin andej nga kishin ardhur.

Me plot mburrje e krekosje, siç e kishte zakon, Rustemi thotë:

- Ju keni qënë fqinjët tanë dhe ne jemi sjellë përherë mirë me ju. Ju keni qenë dhe nën mbrotjen tonë. Sa herë që ju vinte ndonjë kërcënim, në ndonjë rajon, ishim ne ata që ju mbronim. Historia e dëshmon këtë gjë.

Kur fjala e Rustemit mbërriti këtu, Zuhretu i tha: -Të gjitha ata që ju thatë për të kaluarën, janë të vërteta. Por ti duhet të kuptosh këtë realitet: e sotmja nuk është më si e djeshmja. Ne nuk jemi më ata njerëz të cilët kërkonin të mirat dhe pasuritë. e kësaj botë. Ne i kemi lënë pas qëllimet tokësore. Kemi qëllimet e Botës së Përtejme, tashmë. Ne në të kaluarën kemi qënë ashtu siç e the dhe ti, derisa një ditë erdhi Profeti dhe na shpalli profecinë e tij mes nesh. Ai neve na ftoi drejt Zotit që është Një. Zoti i ka shpallur Profetit të tij: në qoftë se ithtarët e tu do t'i rrinë besnik asaj që të është shpallur ty, atëherë Zoti do t'i japë epërsi mbi kombete tjera dhe mbi popujt e tjerë. Kushdo që i bashkohet kësaj feje, është i dashur, kushdo që e kundërshton, do të përballet me të.

- A mund të më shpjegosh disa gjëra për fenë tënde?,- pyeti Rustemi

-Themeli dhe baza i saj janë dy dëshmitë; dëshmimi për Njësinë e Zotit, dhe dëshmia se Muhamedi është i Dërguari i Tij, e çfarëdo që ka thënë ai, është nga ana e Zotit, - tha Zuhretu.

-Kjo që nuk përbën asnjë problem, -u përgjigj Rustemi. Tjetër çfarë ka?

-Çlirimi i robve të Zotit nga robëria e njerezve të tjerë si ata, -tha Zuhrete.

- Edhe kjo e mirë është.Tjetër çfarë ka?

-Njerëzit kanë lindur nga një baba dhe nga një nënë, të gjithë janë bijtë e Ademit dhe të Havasë; prandaj të gjithë janë vëllezër dhe motra midis tyre. Edhe kjo është shumë e drejtë. Po t'i pranojmë këto që thoni, atëherë ju a do të ktheheni?, – e pyeti Rustemi.

-Po, -u përgjigj Zuhrete. Betohem për Zotin që nuk kemi më punë në tokat tuaja përveçse për tregti dhe shkëmbime mallrash. Ne nuk kemi qëllim tjetër përveç atyre që thashë.
-Shumë mirë. Mirëpo këtu këmi një problem- tha Rustemi. Që nga koha e Ardeshirit të populli persian ekziston një zakon, i cili nuk pajtohet me fenë tuaj. Që nga ajo kohë ka qënë traditë që klasat e ulëta, si bujqit dhe punëtorët nuk kanë të drejtë të ndryshojnë zanat dhe të merren me një punë tjetër. Nëse këto klasa do të ndryshonin zanat e do të ngriheshin në pozitë duke u rreshtuar në mesin e klasave të larta të aristokracisë, duke i shtrirë këmbët përtej jorganit të tyre, atëherë, do të krijojohej konflikt me shtresat e klasat e larta të aristokracise dhe të elitës. Pra, është më mirë që një fëmijë bujku ta dijë që është fëmijë bujku dhe ai i kovaçit ta dijë që është fëmijë kovaçi dhe nuk ka të drejtë të bëjë punë tjetër përveç atij zanati…"
-Mirëpo ne jemi më të mirët nga të tjerët për të gjithë njerëzit, -u përgjigj Zuhrete. Ne nuk mund të jemi si ju e të bëjmë kështu lloj ndarjesh në mes të njerëzve. Ne kemi besim që atë urdhrin e Zotit ta zbatojmë edhe për ato klasat e ulëta. Ashtu si e thashë, ne kemi besim që të gjithë njerëzit janë lindur nga një baba dhe nga një nënë. Ne jemi të bindur që detyrën tonë, ta zbatojmë më së miri edhe për të tjerët. Edhe sikur ne ta bëjmë detyrën tonë ata të mos e bëjnë, sërish ne nuk pësojmë asnjë dëm. Zbatimi i detyrës na krijon imunitet. Zuhrete ibn Abdullah mbaroi këto fjalë dhe iku. Rustemi mblodhi të parët e ushtrisë së tij dhe u tregoi fjalët e këtij myslimani. Ata nuk e vlerësuan fare fjalët e myslimanët. Pastaj Rustemi i dërgoi fjalë Sa'd Vekasit që të dërgonte një

përfaqësues zyrtar për të zhvilluar bisedime. Sa'di deshte që të dërgonte një delegacion, mirëpo Rabi' ibn Ymeri që ishte i pranishëm në mbledhje tha:

"Persianët kanë një karakter të habidtshëm. Kur shkon një delegacion tek ata si përfaqësues zyrtar, ata e shikojnë si shkak të rëndësisë së tyre dhe kujtojnë që për shkak të rëndësisë që kanë, ne kemi dërguar delegacion. Vetëm një njeri mjafton."

Atëherë vetë Rabiu e mori përsipër këtë punë.

Rustemin e njoftuan se kishte ardhur përfaqësuesi i Sa'd Vekasit. Rustemi u këshillua me këshilltarët se si duhej të sillej me përfaqësuesin e myslimanëve. Ata i thanë që nuk duhej t'i jepte rëndësi, sepse ata ishin shumë më të vegjël se ata!

Për të treguar madhështinë persiane përballë myslimanit, Rustemi dha urdhër që t'i sillnin fronin e tij të artë dhe u ul vetë mbi të. Shtruan sixhadet më të bukura dhe jastekët më të butë. Përfaqësuesi mysliman hipur mbi kalin i tij, hyri me një shpatë në brez dhe me harkun e shigjetat e tij, hedhur pas shpine. Sapo hodhi hapat e para, e kuptoi që e gjitha ishte bër për t'iu mburrur atij. Myslimani, për të treguar se myslimanët nuk i kushtonin asnjë rëndësi këtyre zbukurimeve dhe stolive dhe se kishin qëllim tjetër, egoditi me thembra në bark kalin dhe u nis drejt sallonit ku rrinte Rustemi. Rojet i dolën përpara dhe i thanë të zbriste. Ai nuk pranoi dhe shkoi deri pranë fronin të Rustemit i hipur mbi kalë. Nxori harkun dhe shpoi njërin prej jastekëve të artë me shigjetë dhe kaluar u hodh mbi jastekët e tjerë duke i shkelur. Iu afruan dhe i thanë që të dorëzonte armët e të shkonte te

Rusemi.-"Nuk i dorëzoj, -tha. Ju kërkuat prej nesh një përfaqësues dhe unë kam ardhur si përfaqësues. Nëse nuk doni, unë kthehem".

Rabi' ibn Ymeri, duke u hedhur me kalin e tij mbi jastekët dhe sixhadet, arriti deri te froni i Rustemi. Zbriti nga kali, largoi tutje njërën prej sixhadeve dhe u ul mbi dysheme. E pyetën: "Përse u ule mbi dysheme?

– Neve nuk na pëlqen të ulemi mbi këto rrecka, -u përgjigj.

Përkthyesi personal i Rustemit e pyeti:- Ju përse keni ardhur?

-Ne na ka dërguar Zoti, -u përgjigj Rabiu. Zoti na ka dërguar që të çlirojmë njerëzit e tij nga vuajtjet dhe mjerimet, të shpëtojmë njerëzit që janë nën zgjedhë dhe shtypje e t'u japim atyre drejtësinë e Islamit.

Ne do ta përhapim fenë e Zotit, që ka në themel këtë gjë, tek të gjitha kombet. Nëse do ta pranojnë këtë fe, atëherë do të jetojnë në paqe dhe në harmoni; nëse nuk e pranojnë, ne do t'i luftojmë ata. Atëherë, ose do të vritemi dhe do të shkojmë në Xhennet ose do të fitojmë mbi armikun."

-Shumë mirë, e kuptuam fjalën tuaj, - tha Rustemi. Tani a ka mundësi që vendimin tuaj ta shtyni për pak më vonë që ne të shikojmë se si të veprojmë?

-Shumë mirë! Sa ditë afat doni? Një ditë apo dy ditë?,- pyeti Rabiu.

-Nuk mjaftojnë as një ditë dhe as dy. Ne duhet të këshillohemi me të mëdhenjtë tanë. U duhet dërguar atyre letër, dhe derisa ata të mendohen e të marrin vendim, shkon shumë kohë,- u përgjigj Rustemi.

Rabiu, i cili e kishte kuptuar qëllimin e tyre dhe e dinte që ata kërkonin që të harrohej çështja, tha: - Ajo që na kanë

mësuar Profeti dhe të parët tanë është që në kësisoj rastesh të mos presim më shumë se tri ditë. Unë ju jap tri ditë afat që ju të zgjidhni njërën prej këtyre tri punëve: ose të pranoni Islamin, ne në këtë rast kthehemi nga rruga që erdhëm, dhe të gjitha tokat me ato që ju keni, janë tujat, ne nuk kërkojmë as mallin, as tokën tuaj, ose të na paguani neve haraç, ose bëhuni gati për luftë."

- Ti je komandanti i përgjithshëm që na flet kështu?!, - e pyeti Rustemi.

-Jo, unë jam një njeri i thjeshtë, - u përgjigj Rabiu. Por myslimanët janë të gjithë si organet e një trupi. Janë të gjithë një. Nëse dikush jep fjalën, është njësoj sikur ta kenë dhënë të gjithë. Ata e respektojnë fjalën e njëri-tjetrit.

Pas kësaj ngjarjeje, Rustemi i cili kishte mbetur shumë i ndikuar nga këto fjalë, u këshillua më krerët e ushtrisë së tij për myslimanët dhe i pyeti: - Si ju duken ata? A keni parë dhe dëgjuar fjalë më të forta dhe më të qarta se fjalimi i këtij burri? Tani ju si mendoni?

Ne nuk mund ta pranojmë fenë e këtij qeni. A nuk e pe se çfarë rrobash të vjetra e zhele kishte veshur;- iu përgjigjën ata

- Po ju ç'punë keni me rrobat e tij? Ju shikojini fjalët dhe veprën e tij, – tha Rustemi.

Fjalët e mbretit nuk patën aspak ndikim tek ata. Ata ishin kaq shumë të verbuar nga mendjemadhësia e tyre, saqë s'mund ta dallonin dot realitetin. Rustemi e pa që nuk kishte asnjë njeri të një mendjeje me të. Ai nuk arriti të gjente rrugëzgjidhje të përshtashme mes myslimanëve dhe krerëve

të ushtrisë së tij. Ai u fut në luftë dhe pësoi një disfatë shumë të madhe që rrallë herë është parë në histori. Në këtë betejë ai humbi dhe jetën e tij.[1]

1) Kamil, i ibn Ethijr; vëll. 2, f. 319- 321, ndodhitë e vitit 14 të hixhrit.

ARRATISJE NGA SHTRATI

Profeti i nderuar qe pesëdhjetë e pesë vjeç kur u martua me një vajzë të re, të quajtur Aishe. Martesa e parë e Profetit qeme Hadixhenë, e cila pati qenë dy herë e martuar dhe ishte pesëmbëdhjetë vjet më e madhe se ai. Profeti u martua me Hadixhenë kur Profeti ishte njëzet e pesë vjeç dhe Hadixheja ishte dyzet vjeç Për njëzet e pesë vjet me radhë. Hadixheja qe gruaja e vetme e Profetit në shtëpinë e tij e i lindi dhe fëmijë. Hadixheja vdiq në moshën gjashtëdhjetëepesëvjeçare. Pas Hadixhesë, Profeti u martua me një vejushë tjetër, e cila quhej Sude. Pas saj u martua me Aishen, e cila ishte vajzë e re dhe e pamartuar më parë. Ajo erdhi drejtëpërdrej nga shtëpia e të atit te shtëpia e Profetit. Aishja e shihte që Profeti kishte marrë shumë gra, e asnjëra nuk ishte e re dhe vajzë shtëpie si ajo, por vejusha dhe përgjithësisht, në moshë të madhe, madje, disa prej tyre kishin edhe fëmijë.

Ajo shpesh e mburrte veten e saj përballë grave të tjera të Profetit: "Unë jam e vetmja grua e cila nuk kam pasur burrë tjetër përveç Profetit." Ajo mburrej edhe për bukurinë e rininë që kishte. Kjo shpesh e mërziste Profetin.

Aishja priste në vetvete që me praninë e saj, Profeti të mos i afrohej asnjë gruaje tjetër. Sigurisht është e natyrshme që një burrë, duke pasur një grua të re dhe të bukur, të mos u afrohet grave të tjera që janë të mëdhaj në moshë dhe jo shumë të bukura, përveçse për të ruajtur harmoninë dhe respektin, e aq më tepër, një njeri si Profet, i cili i kushtonte rëndësi respektimit të së drejtës dhe radhës së kujtdo duke vendosur drejtësi.

Por, Profeti, i cili kishte bërë martesa të shumta në bazë të ruajtjes së pastërtisë dhe të drejtësisë shoqërore e politike të Islamit dhe jo për shkak të diçkaje tjetër, nuk bënte dallime nga këto anë dhe që nga kjo kohë e deri në fund të jetës së tij, periudhë e cila zgjati afro dhjetë vjet, Profeti mori nën përkujdesjen e tij si bashkëshort gra që kishin mbetur vejusha ngaqë burrat u ishin vrarë në luftë, a gra të cilat për shkaqe të ndryshme kishin mbetur të vobekta dhe pa përkujdesje.

Çështja tjetër, e cila e shqetësonte shumë Aishen ishte se Profeti asnjëherë nuk e kalonte natën të plotë në shtrat. Nganjëherë kalonte vetëm gjysmën e saj, herë çerekun e saj dhe më të shumtë e natës e kalonte jashtë shtratit duke u marrë me adhurimin e Zotit dhe me këndimin e Kur'anit.

Një natë ishte radha e Aishes. Përpara se të binte për të fjetur, Profeti la rrobën e tij dhe këpucët nën shtrat. Ra për të fjetur. Pas njëfarë qetësie, duke kujtuar se Aishen e kishte zënë gjumi, u ngrit me ngadalë, veshi këpucët, hapi derën dhe e mbylli atë me ngadalë dhe doli jashtë. Mirëpo Aishja ishte ende zgjuar, nuk e kishte zënë gjumi. Kjo gjë për Aishen ishte shumë e habitshme: netve të tjera ajo kishte parë që Profeti ngrihej në mes të natës, shkonte në cep

të dhomës e bënte adhurim; kurse këtë natë, që ishte radha e saj, ai doli jashtë dhome. Ajo tha me vete se duhej të mësonte patjetër se ku kishte shkuar Profeti. Mos ndoshta ai kishte shkuar në shtëpinë e një gruaje tjetër! - mendonte ajo. A është e mundur që Profeti ta bëjë këtë gjë, këtë natë që është radha ime,-mendonte ajo, - të shkojë në shtëpinë e dikujt tjetre?! Ah, sikur të ishin të gjitha vajzat e tjera të bukura dhe të reja, e ai t'i kishte mbledhur ato të gjitha bashkë! Ai këtë punë nuk e kishtë bërë. Ai kishte mbledhur rreth vetes një grusht grash në moshë dhe vejusha. Megjithatë atë, duhet ta mësoj patjetër se ku ka vajtur ai në këtë orë të natës, e kaq shpejt, kur mua ende nuk më kishte zënë gjumi.

Aishja veshi menjëherë mbulesën e saj dhe doli si hije në ndjekje të Profetit. Pa që Profeti doli nga shtëpia dhe mori menjëherë rrugën drejt Bekies, që ishte një varrezë e ndërtuar në cep të Medines me urdhër të Profetit. Profeti shkoi te varrezët dhe ndali aty. Aishja, e cila po e ndiqte atë, u fsheh pas një muri. Ajo pa që Profeti i ngriti duart tri herë drejt qiellit, pastaj iu fut një rruge tjetër. Aishja iu vu sërish pas. Profeti filloi t'i shpejtonte hapat. Aishja më shpejt se ai. Profeti filloi të vraponte. Edha Aishja iu qep nga pas me vrap. Pastaj Profeti u nis drejt shtëpisë. Aishja, si rrufe, sapo e pa, u turr me vrap drejt shtëpisë, hyri e para dhe menjëherë shkoi e u shtri në shtrat. Kur Profeti u fut brenda, dëgjoi frymëmarrjet e shpejta të Aishes dhe i tha: "- Oj Aishe! Pse merr frymë si ndonjë kalë që ka ecur me të katra?

-Jo, s'ka gjë, o i Dërguari i Zotit,-u përgjigj Aishja.

- Fol se Zoti nuk më mban gjë të fshehtë, - i tha Profeti.

- O Profet, të qofsha falë! - u përgjigj Aishja. Kur dole nga dhoma, unë isha zgjuar. Doja ta dija se ku shkoje në këtë orë të natës dhe të ndoqa nga pas. Gjatë gjithë kësaj kohe po të shikoja nga larg.

-Pse, ajo hija që pashë kur ktheva kokën, ti paske qenë?, – pyeti Profeti.

-Po, o Profet i nderuar, - u përgjigj Aishja.

Profeti duke e prekur lehtë me dorë pas shpine Aishen, i tha; "A thua ke kujtuar se Zoti dhe Profeti i Tij po të bëjnë padrejtësi ty dhe të drejtën tënde ia japin dikujt tjetre?!"

- O Profeti i nderuar! Atë gjë të cilën njerëzit e mbajnë të fshehtë, e di Zoti dhe të gjitha t'i zbulon ty?, – pyeti Aishja.
- Po, - u përgjigj Profeti. Shkaku që shkova sonte në varreza ishte meleku i Zotit Xhebraili. Ai erdhi e më thirri fshehtas teje. Unë iu përgjigja dhe e mbajta të fshehtë përgjigjen time për ty. Duke menduar që ty të kishte zënë gjumi, nuk doja të të zgjoja. Më duhet të të them që për marrjen e Zbulesës së Zotit duhet të jem vetëm. Përveç kësaj, pata frikë se mos trembesh. Gjithashtu kjo ishte dhe arsyeja përse u ngrita e dola ngadalë prej dhome. Meleku i Zotit më dha urdhër që të shkoja në varreza dhe të kërkoja falje për të vdekurit.

-O Profeti i Zotit!,- tha Aishja. Në qoftë se unë dua të kërkoj falje për të vdekurit, çfarë duhet të them?

Thuaj; "Paqja qoftë mbi banorët besimtarë e prej muslimanëve. Allahu i mëshiroftë të parët e të fundit. Vërtet, inshallah, jemi do të vijmë pas." [1]

---

1) Musnedi i Ahmed ibn Hanbel; vëll. 6 f. 221.

PROGRAMI I PUNËS

Pas vrasjes së Osmanit dhe gjendjes kaotike që ishte krijuar, kandidat tjetër për kalif përveç Aliut (a.s) nuk kishte. Të gjithë njerëzit vinin grupe-grupe duke i dhënë atij besën. Gjatë ditës së dytë të lidhjes së besës, Aliu (a.s) hipi në faltore dhe, pasi falënderoi dhe, lavdëroi fuqinë e Zotit dhe Profetin e fundit, mbajti fjalimin e tij **"**O njerëz! Pasi u largua Profeti nga kjo botë, njerëzit zgjodhën Ebu Bekrin si kalif të tyre. Ebu Bekri paraqiti Omerin si zëvendës të tij. Omeri ia la në dorë këshillit, vendimin për caktimin e kalifit të ri. Këshilli zgjodhi Osmanin si kalif. Osmani veproi në mënyrë të tillë që ju ta kundërshtonit. Si përfundim, ai u rrethua në shtëpinë e tij dhe u vra. Pastaj ju erdhët tek unë dhe kërkuat që unë ta marr përsipër drejtimin e kalifatit. Unë jam një njeri si ju dhe prej jush. Ajo që është për ju, është dhe për mua. Ajo është në përgjegjësinë tuaj, është dhe në përgjegjësinë time. Zoti e ka hapur derën mes jush dhe prijësve, duke zbuluar çdo gjë. Peshën e kalifatit mund ta mbajë një njeri, i cili është i aftë dhe i duruar, mendjehapur dhe i ditur. Plani im, është që t'ju kthej drejt praktikës së Profetit. Atë çfarë them, do ta zbatoj, me qëllim që edhe ju të jeni të qëndrueshëm dhe ta zbatoni. Dhe, sigurisht, do të kërkojmë ndihmë prej

Zotit. Ta dini se unë jam për Profetin, pas vdekjes së tij, po ai që isha gjatë kohës kur ai ishte gjallë.
Ju duhet të ruani disiplinën dhe bindjen. Të zbatoni të gjitha ato që ju them. Nesë diçka ju duket e çuditshme dhe e paprannueshme, mos ngurroni dhe mos e pranoni. ta hidhni poshtë. Unë nuk do të marr përsipër t'i kryej asnjë punë, nuk e kam për detyrë dhe nuk kam falje nga ana e Zotit për të. Zoti na shikon të gjithëve ne dhe na i di të gjitha punët që bëjmë.
Unë, personalisht nuk kam ndonjë rivalitet a qëllim për të marrë përsipër Kalifatin. Përveç kësaj, kam dëgjuar prej Profetit të thotë: "Kushdo që do të marrë pas meje në dorë drejtimin e punëve, Dtën e Gjykimit, melekët do t'i tregojnë listën e punëve që ka bërë. Po të ketë qenë i drejtë dhe i ndershëm, Zoti e shpëton atë. Po të ketë qënë shtypës e i padrejtë, i çahet toka nën këmbë dhe i lidhur me zinxhirë, do të hidhet në xhehennem."
Por, meqë ju njëzëri dhatë votat tuaja, duke më zgjedhur mua si kalifin tuaj, unë nuk kisha mundësi që të mos e pranoja atë".
Pastaj e ktheu kokën djathtas e majtas, i vështroi të gjithë njerëzit dhe e vazhdoi kështu fjalën e tij:
"O njerëz! Tani unë do të deklaroj: Ata njerëz, të cilët e kanë mbushur xhepin e tyre nga xhepi i popullit dhe i arkës së shtetit, kanë marrë pronat për vete, kanë shtuar pasuritë e tyre, kanë hipur në kuaj shumë të mirë, kanë blerë skllave të bukura dhe lëkurëbuta e janë zhytur në qefin e kësaj bote, nesër do t'ua pres rrugën, do t'ua marr të gjitha ato që i kanë përfituar në rrugë të padrejtë e do t'u lë aq sa u

takon e jo më shumë, të mos më vinë e të më thonë që Ali ibn Ebu Talibi na bëri padrejtësi. Unë deklaroj me çiltërsinë më të madhe se të gjitha ato previlegje që janë marrë për shërbim ndaj Profetit dhe të islamit në të kaluarën, do ti anuloj. Ai që i ka bërë një shërbim Islamit, shbërblimi i tij takon Zotit. Kjo e kaluar e shkëlqyer nuk duhet të bëhet shkak që mes atyre dhe të tjerëve të krijohën ndarje e dallime. Kujtdo, që do të ndjekë sot zërin e së Vërtetës, e do të futet në fenë sonë, e do të kthehet drejt kibles sonë, do t'i japim të drejta të barabarta me myslimanët e parë. Ju jeni robtë e Zotit dhe malli është mall i Zotit dhe duhet të ndahet barabar në mes të të gjithëve. Nga kjo anë, askush nuk qëndron mbi tjetrin. Nesër të jeni të gatshëm që ta ndani pasurinë e arkës së shtetit (bejtul mal)".

Të nesërmen, të gjithë njerëzit erdhën vetë dhe pasurinë që ishte në arkën e shtetit e ndanë në mënyrë të barabartë. Secillit i takoi nga tre dinarë. Një burrë tha: "O Ali! Ti më jep mua tre dinarë, edhe shërbëtorit tim, që deri dje ishte skllavi im, i jep tre dinarë?"

"Kështu është, siç e shikon",- ia ktheu Aliu

Disa njerëz të tjerë, të cilët kishin vite që ishin mësuar me privilegje dhe merrnin më shumë se të tjerët si, Talha, Zubejri dhe Abdullah ibn Omeri dhe Sei'd ibn Asi dhe Mervan Hakemi, nuk e pranuan pjesën e tyre dhe dolën të mërzitur jashtë xhamisë.

Ditën tjetër kur njerëzit ishin mbledhur në xhami sërish, erdhën edhe këta, por të veçuar nga të tjerët, u ulën në një cep të xhamisë dhe nisën të bënin zhurmë. Pas njëfarë kohe

zgjodhën Velid ibn Ukbe nga mesi i tyre dhe e dërguan që të fliste me Aliun.

Velidi shkoi tek Aliu (a.s) dhe i tha: "O Ebu Hasan! Ti vetë e di mirë që asnjëri prej nesh që jemi ulur këtu, nuk kemi ndonjë simpati ndaj teje dhe të kaluarës tënde në luftrat mes Islamit dhe padijes. Në ato ditë, prej nesh janë vrarë shumë veta nga dora jote. Për shembull, ti mua më ke vrarë babanë në luftën e Bedrit. Prandaj mund të ndryshojmë mendje ndaj teje dhe të lidhim besën me ty vetëm me dy kushte: Njëri kusht, është që t'i të tërhiqesh nga fjalët që the dje e të mos kesh më punë me të kaluarën. Ajo që ka ndodhur, ka ndodhur. Në kohën e kalifëve të kaluar kush ka marrë diçka, e ka marrë, ti mos ki më punë me të se në ç'rrugë e ka marrë ai atë. Ti vetëm kujdesu që gjatë kohës që je ti kalif të mos shpërndahet gjë.

-Kushti i dytë: Të na dorëzosh vrasësit e Osmanit, që t'i marrim hakun. Dhe, nëse ne nuk do të kemi siguri nga ana jote, atëherë jemi të detyruar që të largohemi e të shkojmë në Siri e të bashkohemi me Muavijen".

Aliu (a.s) iu përgjigj: "Për çështjen e gjakrave që janë derdhur gjatë luftës së Islamit me injorancën, unë nuk kam aspak përgjegjësi. Ajo nuk ka qenë luftë personale. Ishte lufta e së Drejtës me të padrejtën, me të pavërtetën. Nëse ju keni ndonjë kundërshtim, duhet që nga pozita e së shtrembrës, të ngriheni kundër së Drejtës e kundër meje. Lidhur me të drejtat që janë shkelur në të kaluarën: unë kam për detyrë që të drejtën e shkelur t'ia kthej të zotit. Nuk është në dorën time që të fal dhe të ndryshoj mendje. Për çështjen e vrasësve

të Osmanit: Po ta shikoja atë si detyrë timen, qysh dje i kisha ndëshkuar e nuk kisha pritur për sot."
Pasi dëgjoi këto përgjigje, Velidi shkoi dhe ua tregoi të gjitha ato shokëve të tij. Ata e dinin dhe iu bë edhe më e qartë që politika e Aliut nuk ishte e përkulshme. Që nga ajo orë ata filluan me provokime e rrëmuja.
Një grup prej shokëve të Aliut erdhën dhe i thanë atij: "Ky grup do të sjellë si pretekst vrasësin e Osmanit dhe do të bëjë një revoltë e trazira. Vrasësi i Osmanit është vetëm një pretekst, sepse e gjithë pakënaqësia e tyre është te barazia që vure mes myslimanëve të rinj dhe atyre arabë. Nëse ti do të ruash privilegjet e tyre dhe do të ndryshosh vendimin tënd, revolta do të shuhet."
Në këtë mënyrë, nëse protestat do të vazhdonin, edhe shokët e Aliut mund të ngrinin pikëpyetjen se përse e gjithë kjo këmbëngulje në zbatimin e barazisë? Kështu, Aliu të nesërmen, i veshur me dy copa rrobe të thjeshta, njërën lidhur për beli dhe tjetrën e hedhur mbi shpinë e me shpatë në dorë, hyri në xhami, u ul në faltore dhe tha:
"Falënderojmë Zotin që është Krijuesi ynë. Të gjitha bekimet e tij janë për të mirën tonë. Të gjitha bekimet e tij janë ndihmë dhe nder për ne, në mënyrë që të na provojë: jemi nga ata që falënderojmë, apo jemi të pafe. Ndër ju më i afërti me Zotin është ai që i bindet Zotit dhe ndjek më së miri traditën e Profetit dhe mban gjallë më mirë librin e Zotit. Askush nuk qëndron më lart se të tjerët përveçse në bindjen ndaj Zotit dhe Profetit. Ky është libri i Zotit mes nesh dhe jush. Dhe ju që jeni të vetëdijshëm, e dini mirë traditën dhe sjelljen e Profetit."

Pastaj lexoi këtë ajet nga Kur'ani Fisnik: *(Sure "Huxhurat, ajeti)*

Pas këtij fjalimi, si shokëve, ashtu dhe armiqve iu bë e qartë që vendimi i Aliut është i prerë. Ai që e kuptonte detyrën e tij, që deshi të ishte i devotshëm, ashtu qëndroi. Ai që nuk e pranoi këtë plan pune, ose që tërhoq dhe u veçua si Abdullah ibn Omeri, ose bëri si Talhaja, Zubejri dhe Mervani, u bë gati për luftë dhe gjakderdhje.[1]

Shoqata Flladi

1) *Sherh Nehxhul Belaga I ibn ebi Hadijdit; vëll. 2, f. 271-273, shpjegimi I fjalimit 90, botuar në Beirut.*

JE NË GJUMË APO ZGJUAR?

Një natë, Habe Erani dhe Neuf Bekali kishin rënë për të fjetur në oborr të pallatit të prijësit në Kufe. Pas mesit të natës, panë që Emirul Mu'menini, Aliu (a.s), shumë ngadalë u fut në pallat dhe erdhi drejt oborrit në një gjendje shumë të pazakontë: një frikë e jashtëzakonshme e kishte pushtuar atë**.** Ai nuk ishte në gjendje të ruante ekuilibrin e tij, kishte mbështetur dorën në mur dhe i përkulur po ecte duke u mbajtur për mur. Duke ecur, ai pëshpëriste me vete ajetet e fundit të sures "Al Imran:"

"Në krijimin e qiejve e të Tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe mendje."

"Për ata që Zotin e përmendin me përkujtim, kur janë më këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve dhe të Tokës, (duke thënë): "**Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot. I lartësuar qofsh! Ruajna prej dënimit të zjarrit!"**

"Zoti ynë, atë që Ti e fute në Zjarr, e ke poshtëruar; për mizorët nuk ka ndihmëtarë!.

"Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim (e që thoshte): **Të besoni Zotin tuaj! E ne besuam! Zoti**

ynë, na i fal gjynahet tona, na i mbulo të metat tona dhe pas vdekjes na bashko me të mirët!

"Zoti ynë, jepna atë që nëpërmjet të dërguarve të Tu, na e premtove dhe në Ditën e Gjykimit mos na turpëro! Vërtet, Ti je Ai që nuk e shkel premtimin!"

Sapo i përfundoi këto ajete, ai filloi t'i përsëriste sërish ato nga e para. I këndonte në një kohë që ishte i përhumbur fare, a thua se kishte rënë plotësisht pa ndjenja.

Habeja dhe Nufi kishin mbetur që të dy të shtangur në shtrat dhe po vështronin këtë skenë. Habeja po qante me zë të mbytur. As Neufi nuk mundi t'i ndalonte lotët e tij dhe filloi të qante pa zë.

Aliu iu afrua Habesë dhe e pyeti: "Je në gjumë apo i zgjuar?

-Jam zgjuar o Emirul Mu'menin,- u përgjigj ai. Ti që je kaq pranë Zotit, dhe qan kur përgjëron në këtë mënyrë, atëherë mjerë ne të shkretët! - i tha Habeja.

Emirul Mu'menini uli sytë përtokë dhe qau, pastaj tha:

"O Habe! Të gjithë ne një ditë do të rreshtohemi përpara Zotit dhe asnjë veprimi ynë nuk do t'i mbetet i fshehtë Atij. Tek ti dhe tek unë ai është më i afërt se damari ynë i qafës. Asgjë nuk mund të mbetet e fshehur mes nesh dhe Zotit".

Pastaj u kthye nga Neufi dhe i tha:

-Je gjumë?

-Jo, o Emirul Mu'menin. Jam zgjuar, - u përgjigj ai. U bë një kohë që po derdh lot.

-O Neuf!, – tha Aliu. Nëse sot do të qash shumë nga frika për Zotin, nesër sytë do t'i kesh të ndriçuar.

Çdo pikë loti që shikon se del nga frika për Zotin, derdh detet plot me zjarr.

Askush nuk ka post dhe pozitë më të lartë se ai që qau nga frika e Zotit, dhe që dojë për hir të Zotit.

Ai njeri që do Zotin dhe do çfarëdo që do Ai, nuk pëlqen gjë tjetër përveç miqësisë me Zotin. Dhe ai që e ka armik diçka, e ka për hir të Zoti; nga kjo armiqësi, do të vijë vetëm mirësi për të. Kur të arrini në këtë gradë, keni arritur plotësisht të vërtetat e besimit.

Pastaj iu drejtua të dyve dhe u tha një këshillë Fjalia e fundit që tha, ishte "Kini frikë Zotin!

Pastaj ai u largua nga ata, dhe filloi sërish të luten si më parë dhe thoshte; "O Zot! Sikur ta dija gjatë kohës që unë nuk të kujtoj për t'u afruar te Ti, e Ti më largohesh, apo përkujdesesh ende për mua! Sikur ta dija që në këto ëndrrat e gjata dhe në këtë falënderim të shkurtër, si është gjendja ime pranë Teje"

Habeja dhe Neufi shqiptuan; "Betohemi për Zotin, se ka ecur gjatë gjithë natës dhe këtë gjendje kishte deri në mëngjes." [1]

1) Biharul Anuar; vëll. 9, f. 589, botuar në Tebriz dhe Ek Kunaa uel Elkab.

PRIKA E GJAKUT

Lufta e Sifinit do të kishte përfunduar me thyerjen përfundimtare të ushtrisë siriane, sikur Omar ibn Aasi të mos përdorte hilenë e tij, e cila i shpëtoi sirianët.

Pasi e pa që nuk kishte mbetur gjë tjetër përveç thyrjes së plotë, Oman ibn Aasi i dha urdhër ushtrisë së tij që t'i ngulnin librat e Kur'anit në shtiza e t'i ngrinin ato lart duke dhënë shenjë që ishin gati që mes të dy palëve sundues të ishte Kur'ani.

Të gjithë shokët mendjehapur të Aliut e dinin që ajo nuk ishte gjë tjetër përveç se një hile, e bërë me qëllim për të ndaluar sulmet ushtarake e për t'i shpëtuar thyerjes së plotë. Përpara se kjo dredhi të vihej në jetë, Aliu u kishte propozuar sirianëve që ne mes të dy palëve të vendoste Kur'ani; mirëpo ata nuk kishin pranuar.

Kështu, një grup njerëzish, të cilët i kushtojnë vëmendje vetëm dukjes e respektojnë aspak disiplinën ushtarake, i ndaluan sulmet e tyre. Nuk mjaftoi me kaq, por erdhën menjëhere tek Ali (a.s) e kërkuan me shumë këmbëngulje që të ndërpriteshin plotësisht të gjitha veprimet ushtarake ne front. Ata besonin se kushdo që luftonte tani, kishte

luftuar Kur'anin! Aliu (a.s) u tha: "Mos u mashtroni nga këto dredhi. Nuk është gjë tjetër veçse mashtrim. Urdhri i Kur'anit është që ne të luftojmë.Ata nuk kanë qenë dhe nuk janë të gatshëm të zbatojnë Kur'anin. Konflikti ynë me ta bëhët pikërisht për zbatimin e Kur'anit. Tani që ne jemi gati t'i mundim plotësisht,, ata kanë përdorur këtë dredhi." Ata i thanë: "Mirëpo ata thonë që ne jemi të gatshëm që mes jush dhe nesh të lëmë Kur'anin të vendosë. Kështu që ne nuk mund të luftojmë me ta. Pra, tani, të luftojmë me ta, ne po luftojmë me Kur'anin. Nëse nuk jepni që tani urdhrin e ndalimit të sulmin, të bëmë copa-copa mu këtu".

Atëherë u pa që qëndresa nuk kishte më dobi. U krijua një gjendje shumë e vështirë. Nëse Aliu (a.s) do të vazhdonte të këmbëngulte në besimin e tij, lufta do të mbaronte shumë keq për të dhe do të fitonte armiku. Dha urdhër që përkohësisht ta ndalonin sulmin dhe ushtarët të tërhiqeshin nga fronti.

Omar ibn Aasi dhe Muavija, kur parë që plani i tyre u përmbush, u gëzuan tej mase. Ata panë që kishin arritur të godisnin në shenjë sepse në mes të shokëve të Aliut kishte plasur përçarja, dhe për këtë ata nuk përmbaheshin dot nga gëzimi. Mirëpo as Muavija, as Omar ibn Aasi dhe asnjë politikan tjetër largpamës, sado i aftë që të ishte, nuk do të kishte qenë i zoti të parashikonte që ajo ngjarje e vogël do të çonte në formimin e një ideologjie dhe të një mënyre të menduari në çështjet fetare islame, duke krijuar një sekt shumë të rrezikshëm brenda tyre, i cili më vonë do të sillte shqetësime e probleme të mëdha edhe për vetë Muavijen

e kalifët e tjerë si ai. Kështu, si rezultat i kësaj dredhie e i asaj ngjarjeje, ajo mendësi solli krijimin e këtij sekti.

Rebelët e ushtrisë së Aliut u quajtën me emrin "Havarixh" (të përjashtuarit), të cilët në atë ditë historike, me një gjakftohtësi të plotë dhe despotizëm e ndaluan luftën dhe u dorëzuan. U vendos që të dyja palët të caktonin nga një përfaqësues të vetin dhe këta përfaqësues të vendosin në bazë të Kur'anit. Nga pala e Muavijes u zgjodh Omar ibn Aasi. Aliu dëshironte që të zgjidhte Abdullah ibn Abasin, që ishte rivali i Omar ibn Aasit. Mirëpo sërish ndërhynë "havarixhët", të cilët, nën preteksin që përfaqësuesi duhet të ishte asnjanës, kurse Abdullah ibn Abasi ishte krahu i Aliut, u bënë pengesë, dhe si përfundim, zgjodhën një njeri fare të papërshtatshëm për këtë detyrë.

Të dy përfaqësuesit u mblodhën, mirëpo ende pa filluar mirë bisedimet, Omar ibn Aasi, me një dredhi, bëri që biseda të mbyllej pa rezultat.

Bisedimet u bënë aq shumë qesharake, e humbën fare seriozitetin e tyre, pa asnjë ndikim social, madje as për Muavijen dhe për Omar ibn Aasin. I tërë fitimi që Muavija dhe Omari nxorën nga ajo ngjarje ishte vetëm ndalimi i sulmeve ushtarake duke i shpëtuar thyerjes, dhe futën përçarjen në mesin e shokëve të Aliut, e ndërkohe gjëtën kohë për të mbledhur forcat e tyre.

Nga ana tjetër, Havarixhët, pasi u mbyll e tërë ngjarja, e kuptuan që vendosja e Kur'anit në shtiza e propozimi për bisedime, të gjitha ishin thjesht dredhi dhe mashtrime. Atëherë, e kuptuan që kishin vepruar shumë gabim, por sërish nuk e pranonin gabimin e tyre duke vazhduar

të ngulnin këmbë në gabimin e tyre. Ata thoshin që njeriu nuk aspak ka të drejtë aspak të negociojë dhe të qeverisë, sepse pushteti i takon vetëm Zotit dhe gjykatës është libri i Tij.

Ata kërkonin që ta ndreqnin gabimin që kishin bërë, mirëpo u futën në një rrugë, e cila i çoi drejt gabimeve të tjera edhe më të rrezikshme.

Gabimi i tyre i parë ishte kryekëput një gabim ushtarak dhe politik. Gabimi ushtarak, sado i madh që të jetë lidhet me kohën dhe me vendin, pra edhe mund të ndreqet. Gabimi i tyre i dytë ishte gabim në të menduar, e nxori një filozofi shumë të gabuar në çështjet shoqërore islame e cila kërcënoi themelet e Islmait dhe as nuk mund të ndreqej.

Havarixhët, nxorën dhe një parrullë të tyren në bazë të këtij mendimi, që thoshte: "Përveç Zotit, askush tjetër nuk ka të drejtë të vendosë".

Aliu (a.s) thoshte: "Kjo është një parullë e drejtë, që përdoret për një qëllim të shtrembër. Vendim do të thotë ligj. Ligjvënia, sigurisht është e drejta e Zotit dhe e drejta e atij njeriu, të cilit Zoti i jep leje. Kurse qëllimi i "havarixhëve" me parullë ishte që pushteti është vetëm për Zotin, ndërkohë që shoqëria njerëzore ka nevojë, sido që të jetë për drejtuesit, hartuesit dhe zbatuesit e ligjit".

Pas kësaj havarexhët u detyruan që t'i ekuilibronin disa nga bindjet e tyre.

Hauarexhët e quanin gjynah pushtetin e të tjerëve, përveç pushtetin e Zotit. Dhe, meqë ata e kishin bërë këtë gjynah, u penduan. Meqë dhe Aliu (a.s), në fund të fundit, i ishte

dorëzuar pushtetit duke marrë qeverisjen në dorë, i kërkuan që edhe ai të pendohej. Aliu u tha:

"Ndërprerja e luftës dhe vajtja drejt bisedimeve ishte një gabim, për të cilin përgjegjës jeni ju, dhe jo unë. Ndërsa që qeverisja është gabim dhe e palejueshme, unë nuk e pranoj."

Havarixhët filluan të shkonin edhe më thellë në mëndimet e tyre. Meqë Aliu (a.s) e quante të lëjueshme, qeverisjen filluan ta sulmonin e quanin të pafe. Pak nga pak, ata filluan që ta zgjeronin veprimtarinë e tyre duke u paraqitur tashmë si një sekt fetar, ku me shumicën e myslimanëve binin në kundërshtim të ashpër për shumë çështje. Gjëja për të cilën ata dalloheshin më shumë ishte dhuna dhe rebelizmi. Ata thoshin që nuk ka asnjë kusht e kufi dhe duhet luftuar pa frikë e me forcë.

Gjatë kohës që havarexhët i mbanin mendimet e tyre vetëm për vete, Aliu (a.s) nuk iu kundërvu; madje, edhe kur ata e quajtën si të pafe, sërish ai nuk u dha rëndësi atyre fjalëve. Ai as nuk ua preu rrogat nga arka e shtetit dhe me fisnikëri u la atyre lirinë e të menduarit dhe të shprehjes në bisedime. Por kohën kur ata filluan të rebeloheshin, duke shkaktuar trazira të dhunshme e rrëmuja ai dha urdhër për mposhtjen e tyre.

Në Nehrevan, mes atyre dhe Aliu (a.s) u bë luftë dhe Aliu u shkaktoi një humbje shumë të rëndë.

Lufta me havarixhët ishte një problem shumë i madh sepse ata ishin besimtarë. Ata ishin njerëz që nuk gënjenin e këtë gjë e tregonin si miqtë ashtu dhe armiqtë e tyre; ishin shumë të sinqertë, kryenin adhurimin e faljet, lexonin shumë Kur'anin, natën e gdhinin duke u falur; mirëpo nga ana tjetër

ata ishin shumë mëndjengushtë e injorantë. Islamin e shikonin në mënyrë shumë të thatë, monotone dhe të pajetë, dhe e paraqitnin dhe si të tillë.

Shumë të paktë ishin ata veta që mund të ishin të gatshëm për të hyrë në luftë dhe për të derdhur gjakun e njerëzve të tillë. Nëse nuk do të kishte qenë personaliteti madhështor dhe jashtëzakonshëm i Aliut, ushtarët nuk do të shkonin në luftë kundër tyre. Betejën e tij me havarixhët Aliu (a.s)" e shikonte si një nga krenaritë e tij më të mëdha dhe të pashoqe e për këtë ka thënë: "Isha unë ai që ia nxora sytë nga koka trazirës dhe kaosit. Askush tjetër nuk do të mund ta bënte, përveç meje". Dhe me të vërtetë, ashtu ishte. Ishte vetëm Aliu ai që nuk i dha rëndësi pamjes së tyre të qetë dhe, gati gjoja të shenjtë. Ai e dinte që ata ishin armiku më i rrezikshëm i fesë, megjithëse dukeshin dhe hiqeshin sikur ishin shumë të devotshëm dhe asketë, Aliu e dinte që, nëse kjo filozofi dhe ky lloj të menduari do të zgjerohej, sidomos ne mesin e shtresave të paditura e të vinte rrënjë në botën islame, do ta tërhiqte botën e islamit drejt obskurantizmi dhe arrogancë, e do ta thante këtë pemë që nga rrënja.

Sipas Aliu (a.s), beteja me havarixhët nuk ishte një betejë, thjesht me një grup prej një mijë vetash, por një betejë me atë mendim të errët, me injorancën dhe me atë filozofi të gabuar për çështjet shoqërore të Islamit. Kush tjetër përveç Aliut mund të hapte një betejë të tillë në këtë front?

Lufta e Nehrevanit u shkaktoi një goditje shumë të rëndë havarexhëve saqë nuk mundën më ta arrinin atë vend që kërkonin në botën islame. Beteja e Aliut me ta ishte dëshmi shumë e mirë për kalifët që do të vinin më pas, që luftën

ndaj tyre ta shikonin si diçka të nevojshme dhe të drejtë. Mirëpo, të mbeturit e havarexhëve nuk hoqën dorë nga veprimtaria e tyre.

Tre veta prej tyre u mblodhën në Mekë dhe me fantazinë e tyre filluan të studionin dhe analizonin gjendjen e botës Islame. Ata arritën në përfundimin që të gjitha fatkeqësitë dhe vuajtjet e botës islame vinin prej tre njerëzve: Aliut, Muavijes dhe Omar ibn Aasit.

Tre veta, që quheshin Abdurrahman ibn Mulxhem, Berk ibn Abdullah dhe Omar ibn Bekr Temimi, lidhën besën në Qabe dhe u betuan që këta tre persona (Aliun, Muavijen dhe Omar ibn Aasin) t'i vënin përballë myslimanëve dhe brenda një nate, që ishte caktuar data nëntëmbëdhjetë e muajit Ramazan (ose data 17) t'i vrisnin që të tre ata.

Abdurrahmani u caktua që të vriste Aliun, Berku mori përsipër vrasjen e Muavijes, ndërsa Omar ibn Bekri vendosi që të vriste Omar ibn Aasin. Me këtë besë dhe vendim, ata u ndanë nga njëri tjetri dhe secili u nis drejt vendit ku kishte marrë misionin e tij. Abdurrahmani u nis drejt Kufes, qendra e Kalifatit të Aliut. Berku u nis drejt Sirisë, qendra e pushtetit të Muavijes dhe Omar ibn Bekri u nis drejt Egjiptit, komanda e Omar ibn Alasit.

Dy veta prej këtyre, pra Berk ibn Abdullahu dhe Omar ibn Bekri, nuk e arritën rezultatin që kërkonin. Berku, i cili kishte marrë përsipër vrasjen e Muavijes, atë natë arriti t'i jepte vetëm një goditje pas të ndenjurave, plagë e cila iu shërua Muavijes pas ndërhyrjes mjekësore. Omar ibn Bekri, i cili kishte për detyrë vrasjen e Omar ibn Aasit, nuk e njihte atë personalisht. Rastësisht atë natë Omari kishte qenë i sëmurë

e nuk shkoi në xhami. Ai dërgoi një njeri tjetër në vend të tij që quhej Kharexheteh ibn Hezafe. Omar ibn Bekri, duke kujtuar se Omar ibn Aasi ishte pikërisht ai, e goditi dhe e vrau atë. Pastaj u kuptua që kishte vrarë një njeri gabim. I vetmi person nga këta të tre që e arriti qëllimin e tij, ishte Aburrahman ibn Mulxhemi.

Molxhemi u fut brenda në Kufe. Askujt nuk i bëri fjalë se çfarë qëllimi kishte. Ai ishte shumë i pasigurt dhe i lëkundur në vendin që kishte marrë.Shpesh herë behej gati që të terhiqej e të largohej nga ai vend. Nga ana tjetër, personaliteti i Aliut nuk ishte i atillë që, çfarëdo mërzitjeje dhe pakënaqësie që të kishe ndaj tij, ta tregoje veten të gatshëm me lehtësi për t'a vrarë atë. Mirëpo ato rastësi që ndodhën në Siri dhe Egjipt, të cilat ndihmuan dhe shpëtuan Muavijen dhe Omar ibn Aasin, nuk ndodhën në Irak. Në Irak ndodhi një rastësi e cila e bëri ibn Mulxhemin që të ishte I vendosur ne vendimin që kishte marrë. Nëse nuk do të kishte qenë ajo rastësi, ibn Mulxhemi do të hequr dorë një herë e mirë nga vendimi që pati marrë. E gjitha ajo gjë u bë për shkak të dashurisë së një femre.

Një ditë, Abdurrahman ibn Mulxhemi shkoi të takonte njërin prej shokëve të tij havarixhë. Aty u njoh me Ketamin, që ishte vajza e njërit prej havarixhëve, i ati i së cilës ishte vrarë gjatë luftës së Nehrevanit. Ketami ishte shumë e bukur dhe tërheqëse. Sapo e pa, Mulxhemi u magjeps i tëri pas saj. Duke parë Ketamin, e harroi fare betimin e Mekës. Vendosi që të gjithë jetën e tij, tashmë ta kalonte në qetësi dhe lumturi me Ketamin dhe bindjet e veta t'i harronte plotësisht. Ibn Mulxhemi i propozoi Ketamit për martesë. Ketami e pranoi

propozimin e tij, por kur ajo filloi të kërkonte kushtet e pajës**,** ajo tha diçka që e bëri ibn Mulxhemin të nxjerrë tym nga koka Ketami tha: "Pajën time e dua që të jetë tre mijë dërhem, një shërbëtor, një skllave dhe gjakun e Ali ibn Ebu Talibit!!!"

Ibn Mulxhemi iu përgjigj: "Paratë, shërbëtorin dhe skllaven e çfarëdo gjëje tjetër që të duash, t'i siguroj, por vrasja e Aliut nuk është punë e lehtë. Pastaj ne a nuk duam të jetojmë të lumtur? Si mundet që unë të vë dorë mbi Aliun e ta vras atë, e unë vetë të shpëtoj gjallë pastaj?!" Ketami i tha; "Këto janë kushtet e mia. Aliun nuk mund të vritet në luftë, por kur falet mund ta kapësh në befasi. Nëse ti do të shpëtosh i gjallë pastaj, ne do të jetojme një jetë të lumtur dhe pranë njëri-tjetrit; nëse ti do të vritesh, shpërblimi yt do të jetë pranë Zotit, do të jetë një shpërblim shumë më i mirë dhe më i lartë. Përveç kësaj unë mund të të jap dhe njerëz të tjerë që ti të mos mbetesh vetëm".

Molxhemi, kishte rënë keqas ne lakun e dashurisë së Ketamit. Kjo dashuri ia ngjalli sërish atë konfliktin e brëndshëm që kishte, e atë e kishte sjellë atë deri këtu. Prandaj për herë të parë e hapi zemrën dhe i tha Ketamit: "E vërteta është se unë jam arratisur më përpara nga ky qytet dhe tani kam ardhur vetëm me qëllimin për të vrarë Ali ibn Ebu Talibin". Ketami u gëzua shumë kur dëgjoi këto fjalë. Ajo takoi një burrë tjetër, të quajtur Verdan dhe i tha tij që ta shoqëronte ibn Mulxhemin. Një ditë tjetër vetë ibn Mulxhemi takoi njërin prej shokëve të tij të besueshëm, Shabib ibn Bexhrateh dhe i tha: - A je gati të marrësh pjesë në një punë që është nderi i kësaj bote dhe asaj tjetrës?

- Çfarë pune?
- Të vrasim Ali Ibn Ebu Talibin.
- Zoti të vraftë, çfarë thua? Të vrasim Aliun? Burri që ka bërë më shumë për Islamin?,- u përgjigj i habitur Shabibi.
- Po! A nuk u kthye ai në një të pafe? E kaluara e tij islam është ashtu siç është. Pastaj ai në Nehrevan ai vrau vëllezërit besimtarë e të devotshëm e për këtë arsye ne mund të marrim hak ndaj tij, -tha ibn Mulxhemi.
- E si mund t'i afrohemi Aliut?, –e pyeti Shabibi.
- Është e thjeshtë, - tha ai. E ngremë kurthin në xhami, kur ai të vijë për të falur namazin e mëngjesit, ne nxjerrim shpatat e fshehura nën rroba dhe e godasim.

Ibn Mulxhemi foli aq shumë saqë arriti ta bënte për vete më në fund Shabibin. Pastaj e mori atë dhe e njohu me Ketamin. Ketami, e cila në atë kohë ishte në xhami dhe qëndronte e fshehur pas perçes, u tha: "Shumë mirë, edhe Verdani është me ju.Atë natë që do vendosni të kryeni këtë punë, në fillim ejani tek unë! "Ibn Mulxhemi priti deri natën e nëntëmbëdhjetë të Ramazanit, ashtu siç e kishte lënë me ortakët e tij. Atë natë, së bashku me Shabibin, ai shkoi te Ketami dhe ajo me dorën e saj u vuri atyre nga një copë rrecke në gjoks. Pastaj, aty erdhi dhe Verdani e u bashkua me ta, dhe që të tre shkuan në xhami dhe u ulën pranë derës ku zakonisht hynte Aliu. Ata nisën të faleshin si gjithë të tjerët.

Aq shumë u falën, ranë në gjunë e u ngritën e u përkulën sërish, pa dhënë aspak shenja lodhjeje, saqë të gjithë të pranishmëve u tërhoqën vëmendjen.

Gjatë muajit të Ramazanit, Aliu (a.s) kishte hartuar një program të veçantë. Çdo natë, e hante iftarin në shtëpinë e njërit prej djemve osë të vajzave të tij. Asnjë natë nuk hante më shumë se tri kafshata. Fëmijët i luteshin që të hante më shumë, mirëpo ai u thoshte: "Dua që, kur të shkoj të takohem me Zotin, të jem i uritur." Shpesh herë përsëriste: "Sipas shenjave që më ka dhënë Profeti, është afër që mjekra ime e bardhë, të skuqet nga gjaku i kokës sime".

Atë natë, Aliu ishte mik te bija e tij, Umu Kulthum. Më shumë se çdo natë tjetër në fytyrën e tij vihej re shenja e gëzimit dhe e pritjes. Kur të tjerët ranë në shtrat, ai shkoi te qoshja e tij dhe filloi të lutej e të falej.

Ishte gati në të gdhirë. Hasani, i biri, i vjen pranë. Aliu (a.s) i tha të birit të dashur: "Biri im! Unë sonte nuk kam vënë gjumë në sy, sa zgjova dhe njerëzit e shtëpisë. Sot është nata e xhumasë dhe Nata e Kadrit. Por, një çast, siç isha ulur, më vodhi gjumi. Në ëndërr m'u shfaq Profeti dhe i thashë: "O i Dërguari i Zotit, prej ymetit (kombit) tënd kam vuajtur shumë." Profeti më tha; "Ankohu ndaj tyre". Unë u ankova, dhe ankimi im ishte kështu: "O Zot, merrmë sa më shpejt prej këtyre dhe më ringjall me njerëz më të mirë se këta! Për këta dërgo një njeri që ta meritojnë. Një njeri që të jetë më i keq se unë për ta.

Në këtë kohë, muezini i xhamisë thirri ezanin; Aliu u çua dheu nis drejt xhamisë. Në shtëpinë e Aliut kishte disa rosa, që ishin të fëmijëve. Rosat filluan të përplasnin krahët dhe të gagarritnin me të madhe. Një prej njerëzve të shtëpisë kërkoi t'i ndalonte. Aliu i tha: "Mos i ngacmo! Po vajtojnë."

Ibn Mulxhemi dhe shokët e tij po prisnin me padurim ardhjen e Aliut në xhami. Sekretin e tyre nuk e dinte askush përveç Ketamit dhe Eshath ibn Kajsit, një njëri me karakter shumë të ulët, që nuk e pranonte drejtësinë e Aliut, e që ishte i lidhur me Muavijen. Një ngjarje shumë e vogël desh ua nxori në shesh sekretin, por një rastësi tjetër bëri që sekreti dhe qëllimi i tyre të mbetë i fshehtë deri në fund. Eshati shkoi me nxitim në xhami dhe i tha ibn Mulxhemit: "Nxito, se për pak zbardh dita. Po u zbardh, do të zbuloheni." Këto fjalë qëlloi që t'i dëgjonte Hixhër ibn Udej, një prej shokëve të ngushtë dhe të çiltër të Aliut dhe e kuptoi që ata kishin bërë një plan. Ai kishte lënë kalin e tij përpara derës së xhamisë, sepse sapo ishte kthyer nga një detyrë dhe kërkonte t'i raportonte çdo gjë Emirul Mu'meninit Aliut (a.s).

Hixhër, me të dëgjuar këto fjalë, doli nxitimthi nga xhamia dhe vrapoi t'i dilte Aliut përpara, që ta shmangte nga rreziku. Por pikërisht në atë kohë që Hixhri po nxitonte drejt shtëpisë së Aliut, Aliu po vinte nga rruga tjetër drejt xhamisë.

Megjithëse shumë herë fëmijët dhe shokët i qenë lutur e Aliut që të formonin përcjellin, eskortën, Imami nuk pranonte. Ai shkonte vetëm dhe vinte vetëm. Edhe atë natë kjo kërkesë iu parashtrua sërish atij, por përsëri ai nuk pranoi. Aliu u fut në xhami dhe thirri: "O njerëz! Namaz, namaz:!" Në këtë kohë dy shpata shkëlqyen si rrufeja në errësirë dhe thirrja "El hukme li-lah ja Ali, la leke" i tronditi të gjithë. Shpatën e parë e goditi Shabibi, por i ra murit. Pastaj, menjëherë goditi me shpatë ibn Mulxhemi. Goditja e mori Aliun në mes të kokës. Haxhari u kthye me shpejtësi në

xhami, por, kur hyri, dëgjoi njerëzit që ulërisnin të tronditur: "Emirul Mu'menini ra dëshmor, Emirul Mu'menini ra dëshmor".

Një nga fjalët që u dëgjuan nga Aliu menjëherë pasi u godit në kokë, ishte:

"Betohem për Zotin e Qabes se fitova". Fjala tjetër që dëgjuan prej tij ishte: "Ky burri të mos ikë"!

Abdurrahman ibn Mulxhemi, Shabibi dhe Verdani vrapuan menjëherë jashtë që të zhdukeshin. Verdani, i cili nuk qe afruar, nuk u njoh. Shabibi, duke vrapuar, u kap nga një shok i Aliut. Ai ia mori nga dora shpatën Shabibit dhe u bë gati t'ia ngulte në gjoks. Mirëpo pa se njerëzit po vinin me vrap grupe - grupe dhe u frikësua se mos njerëzit do ta ngatërronin me vrasësit e do ta vrisnin në vend të Shabibit.

E hoqi shpatën nga gjoksi i tij dhe Shabibi shkoi me vrap në shtëpinë e tij. Në shtëpi, i erdhi djali i xhaxhait, i cili, pasi e kuptoi që Shabibi kishte dorë në vrasjen e Aliut, mori menjëherë shpatën e tij dhe e vrau Shabibin brënda në shtëpi të tij.

Ibn Mulxhemin e kapën njerëzit dhe duarlidhur e sollën në xhami. Njerëzit ishin aq shumë të inatosur dhe të tërbuar prej ibn Mulxhemit për atë që kishte bërë, sa kërkonin t'i shqyenin mishin nga çasti në çast me dhëmbë.

Aliu tha: "Ma sillni këtu Abdurrahmanin!"

Kur ia sollën, Aliu i tha: "A nuk të kam bërë të mira unë ty?!

-Po, më ke bërë, -u përgjigj ibn Mulxhemi.

-Atëherë, pse e bërë këtë?, – pyeti Aliu.

Këtë shpatë kam dyzet mëngjese që e laj me helm,- foli ai, - dhe i jam lutur Zotit që me këtë shpatë të vritej krijesa më e keqe e Zotit.

- Kjo lutja jote u realizua. Po dhe ti vetë do të vritesh nga po kjo shpatë.

Pastaj Aliu u tha familjarëve dhe të afërmve tij rrinin rreth tij dhe tha:

"Bijtë e Abdul Mutalibit! Kurrë mos u futni në mes të njerëzve dhe të shkaktoni gjakderdhje, arrestime e raprezalje me preteks për vrasjen time!"

Pastaj i tha Hasanit, djalit të tij; "Biri im! Po të mbetem gjallë, e di unë se ç'do të bëj me këtë njeri. Por, nëse unë vdes, ju mos e goditni atë përveçse njëherë. Kurrë mos e masakroni atë! Mos ia prisni atij as hundën, as veshët e as gjuhën. Profeti vetë ka thënë: "Hiqni dorë nga masakrimi, qoftë ai edhe për një qen të egër" Me robin tuaj silluni mirë! Kujdesuni për ushqimin dhe qetësinë e tij!

Me urdhër të Imam Hasanit, aty sollën mjekun e njohur të asaj kohe Ethijr ibn Amru. Ai pasi e pa plagën tha: "Shpata ka qënë e helmuar dhe helmi ka arritur në tru. Nuk bën dot punë mjekimi!"

Që nga ai çast kur Aliu u godit dhe deri në çastin kur ai ia dorëzoi shpirtin e tij Krijuesit të shpirtit, nuk kaluan më shumë se dyzet e tetë orë. Mirëpo Aliu arriti ta shfrytëzonte këtë kohë, duke dhënë këshilla e udhëzime. Ai la një testament prej njëzet pikash të cilat arritën të shkruheshin: "Me emrin e Zotit, të Gjithëmëshirshmit Mëshirplotit. Kjo është ajo që Aliu, biri i Ebu Talibit lë trashëgim. Aliu dëshmon se Zoti është Një dhe shpall se Muhamedi është

rob dhe i dërguari i Zotit. Zoti e ka dërguar atë që ta ngrejë fenë e vet mbi fetë e tjera. Lutjet e mia, faljet e mia, adhurimi im, veprat e mira dhe jeta ime janë nga Zoti dhe për Zotin. Zoti nuk ka ortak, është Një. Unë jam i bindur për këtë dhe jam prej të dorëzuarve tek Zoti. Biri im, Hasan! Ty dhe të gjithë bijtë e Ehli Bejtit tim dhe këdo, të cilit do t'i mbërrijë ky shkrimi im unë iu këshilloj dhe ju jap porositë e mëposhtme:

1- Kurrë mos e harroni fuqinë, përpiquni deri në buzë të vdekjes t'i qëndroni besimit të Zotit.

2- Të gjithë sëbashku punoni për njohjen e Zotit dhe për afrimin me Zotin në bazë të besimit. Qëndroni të bashkuar dhe largohuni nga përçarja. Profeti ka thënë: "Pastrimi i njerëzve vjen nga falja dhe nga agjërimi, kurse ajo që i largon ata nga feja janë korrupsioni dhe kontraditat.

3- Mos i harroni të afërmit dhe familjarët tuaj.I mëshironi ata, sepse mëshira e bën gjykimin e njeriut më të lehtë përpara Zotit.

4- O Zot, O Zot! Jetimët kurrë të mos mbeten të uritur dhe pa përkujdesje!

5-O Zot, O Zot! Për fqinjët. Profeti aq shumë na i ka këshilluar për fqinjët saqë ne kemi kujtuar se ai kërkon t'i bëjë fqinjit pjesë e trashëgimisë sonë.

6- O Zot, O Zot! Për Kur'anin. Asnjëherë të mos ua kalojnë të tjerët më veprat që bëjnë në zbatim të Kur'anit.

7- O Zot, O Zot! Për faljen. Faluni se falja është themeli i besimit tuaj.

8- O Zot, O Zot! Për Qaben, shtëpinë e Zotit. Haxhi të mos ndalet asnjëherë. Po të rrallohet haxhi, nuk do të

keni aspak kohë dhe të tjerët do t'ju bëjnë pre e manive të tyre.

9- O Zot, O Zot! Për luftën në rrugën e Zotit. Mos kurseni as mallin dhe as jetën tuaj në këtë rrugë!

10- O Zot, O Zot! Për sadakanë.Sadakaja e ul zjarrin e zemërimit të Zotit

11.- O Zot, O Zot! Për gjenezën e Profetit tënd. Kurrë të mos shtypen.

12- O Zot, O Zot! Për shokët dhe miqtë e Profetit. Profeti i Zotit, na i ka lënë amanet.

13- O Zot, O Zot! Për të varfrit dhe nevojtarët. Ata bëjini ortakë të jetës suaj!

14- O Zot, O Zot! Për skllevërit. Këshilla e fundit e Profetit ka qënë pikërisht për ata.

15- Bëni atë punë, në të cilën është kënaqësia e Zotit dhe mos u ndikoni nga fjalët e njerëzve!

16- Me njerëzit silluni mirë dhe me butësi, ashtu siç urdhëron Kur'ani!

17- Mos hiqni dorë kurrë prej këshillimit dhe udhëzimit për të bërë dhe për të larguar të keqen. Po i latë këshillën dhe udhëzimin të këqijtë dhe të ndyrët do hypnin mbi ju dhe do t'ju shtypin. Atëherë, sado që të mirët tuaj të luten, lutjet e tyre nuk përmbushen.

18- Ju lumtë që ju i shtoni marrëdhëniet miqësore mes jush, që i bëni të mira njëri-tjetrit. Largojuni ftohtësisë dhe prerjes së marrëdhënieve me njëri-tjetrin!

19- Punët e mira, bëjini për të ndihmuar njëri-tjetrin dhe të shoqërisë dhe, largohuni nga çdo punë, e sjell gjynah, ligësi dhe armiqësi!

20- Kijeni frikë Zotin, se zemërimi i Zotit është shumë i ashpër!
Zoti me madhërinë e Tij ju ruajtë të gjithëve dhe e ndriçoftë ymmetin e tij që të ruani respektin mes jush dhe respektin e Profetit tuaj. Ju lë të gjithëve në duart e Zotit. Lavdia dhe paqja e Allahut qoftë mbi të gjithë ju!
Pas këtij testamenti, fjalë tjetër, përveç "Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut" (La ilahi il-lallah) prej Aliut nuk u dëgjua dhe ia dorëzoi shpirtin e tij Shpirtkrijuesit.[1]

Shoqata Flladi

1) Mukatilu't Talibijne; f.28 – 44. Kamil I ibn Ethijr; vëll.3,f. 194 – 197.Muruxhu Dheheb,I Mes'udit; vëll. 2,f. 40 – 44. Esed ul Gabeti; vëll. 4, dhe Biharul Anuar; vëll. 9, botuar në Tebriz.

Ç'U BËNË DJEMTË E TU?

Pas martirizimit të Aliut (a.s) dhe sundimit të plotë të Muavije ibn Ebu Sufjanit mbi Kalifatin islamik, dashje pa dashje lindën konflikte mes këtij dhe shokëve të ngushtë të Aliut (a.s). E gjithë përpjekja e Muavijes ishte që ata të tregonin që miqësia dhe përkrahja e tyre për Aliun nuk u kishte sjellë atyre asnjë fitim, dhe në këtë rrugë, ata ta quanin veten e tyre të humbur. Muavija u përpoq shumë që të dëgjonte me veshët e tij prej tyre fjalët e pendimit, mirëpo kjo dëshirë e tij nuk u realizua asnjëherë. Ithtarët e Aliut, pas martirizimit të tij, u dhanë më shumë në përkujtimin dhe nderimin e madhështisë dhe të personalitetit të tij. Në këtë mënyrë, ata tregoheshin më të devotshëm sesa gjatë kohës kur Aliu (a.s) ishte gjallë. guxim dhe me trimëri, të gjitha energjitë e veta i harxhonin për të ruajtur dhe mbajtur gjallë rrugën, miqësinë, stilin, dhe shkollën e Aliut. Nganjëherë, puna shkonte deri aty, saqë masat që merrte Muavija, i jepnin atij efekt të kundërt, dukë bërë që vetë ai dhe të afërmit e tij të ndikoheshin nga ndjenjat dhe bindjet e pasuesve të rrugës së Aliut.

Një prej shokëve dhe pasuesve të pastër, të devotshëm dhe largpamës ishte dhe Udeji, biri i Hatemit. Eadi ishte prijësi

i fisit të madh, Tai. Ai kishte disa djem. Vetë ai, djemtë e tij dhe i tërë fisi i tij ishin ushtarë besnikë të Aliut. Tre prej djemve të tij Turfe, Tarif dhe Taref patën rënë dëshmorë në krah të Aliut, në luftën e Sifinit.

Pas përfundimit të luftës së Sifinit dhe martirizimit të Aliut (a.s) Muavija u bë kalif. Rastësitë e jetës, e përplasën Eadi ibn Hatemin me Muavijen. Muavija me qëllim që t'i kujtonte ditët e hidhura e t'i merrte atij një fjalë për atë se sa dëm kishte pasur që kishte ndjekur Aliun, i tha:

- Ç'u bënë djemtë e tu, Tarfe, Tarijfi dhe Tarefi?

-Ranë dëshmorë përkrah Ali ibn Ebu Talibit në Sifin, - u përgjigj Udeji.

-Aliu nuk është treguar i drejtë më djemtë e tu, - i tha Muavija.

-Përse?, –pyeti Udeji.

-Sepse ai i hodhi djemtë e tu në luftë për t'u vrarë, kurse djemtë e vet i mbajti pas frontit për t'i ruajtur, -u përgjigj Muavija.

-Jo, jam unë që nuk kam vepruar drejt me Aliun, -u përgjigj Udeji.

-Pse?, –pyeti Muavija.

-Sepse ai u vra dhe unë mbeta gjallë. Duhej ta kisha dhënë jetën time për të, kur ai ishte gjallë, – tha Eadi.

Muavija e pa që nuk i doli gj. Ai dëshironte shumë të dëgjonte për karakterin dhe gjendjen e Aliut nga goja e njerëzve që kishin ndenjur për një kohë të gjatë, ditë e natë pranë Aliut. Iu lut Udejit që t'i fliste e t'i tregonte për Aliun, ashtu siç e kishte njohur ai vetë atë nga afër. Udeji tha: -Mos ma kërko këtë gjë.

-Patjetër që duhet të më tregosh,- u ashpërsua Mavija.

-Të betohem për Zotin që Aliu ishte shumë largpamës dhe i fuqishëm. Fliste me drejtësi. Urtësia dhe dituria e mbulonte atë nga të gjitha anët. Nuk e pëlqente aspak shkëlqimin dhe luksin e botës dhe rrinte me natën dhe vetminë e natës. Derdhte shumë lot dhe mendonte shumë. Kur ishte në qetësi, i kërkonte llogari vetes për të kaluarën. Vishte rroba të thjeshta dhe pëlqente jetën e thjeshtë. Kur ishte në mesin tonë, sillej njësoj si ne. Po t'i kërkonim diçka, e pranonte. Kur shkonim për ta takuar, na merrte pranë menjëherë dhe nuk mbante largësi aspak me ne. Ishte kaq madhështor dhe kaq dinjitar, saqë ne mbeteshim pa fjalë përballë tij. Nuk guxonim as ta vështronim. Kur buzëqeshte, dhëmbët e tij shkëlqenin si rruaza margaritarësh. Ai respektonte dhe nderonte besimtarin dhe të devotshmin, e ndihmonte të varfërit. As i fuqishmi nuk kishte frikë nga shtypja e tij e as i dobëti nuk ishte i pashpresë nga drejtësia e tij. Të betohem për Zotin se një natë, e pashë me sytë e mi që po bënte me adhurim dhe lutje. Kur errësira e natës kishte mbuluar të gjithë vendin, i rridhin lotët duke gjarpëruar nëpër fytyrë dhe mjekër. Po qante si të mjerët.

Më duket sikur ia dëgjoj zërin edhe tani. Ai i drejtohej botës dhe i fliste: "O botë, je bërë kundërshtari im dhe tani më ke kthyer shpinën. Shko e mashtro dikë tjetër! Ty të kam divorcuar, dhe s'ka më kthim prapa. Lumturia jote është diçka fare e vogël, me pak rëndësi.Ah, sa keq që harxhi (torba) është i vogël, udhëtimi është i gjatë dhe shokët janë paktë!

Kur fjala e Udejit mbërriti këtu, Muavijes i dolën lot pa dashje nga sytë. I fshiu lotët me mëngët e tij dhe tha: -Zoti pastë

mëshirë për Ebu Hasanin! Ashtu ishte, siç e the ti. Tani më thuaj si ndihesh që nuk e ke atë?"
-Si një nënë e cila mban në prehër birin e saj kokëprerë, -u përgjigj Udeji.
- A do të mundesh ta harrosh ndonjëherë?, –pyeti Muavija.
-Asnjëherë në jetë, -u përgjigj Udeji.[1]

Shoqata Flladi

1) El Kunaa uel Elkab; vëll. 2, f. 105, marrë nga libri El Mehasinu uel Mesaua i Ibrahim ibn Muhamed Bejhakij, i cili ka qenë prej dijetarëvë tëë njohur të shekullit të tretë të hixhrit.

KËSHILLA E MËSUESIT

Muavija, i biri i Ebu Sufjanit, pasi u bë sundimtar në vitin 41 (Hixhri), vendosi që me armën e propagandës dhe me krijimin e parullave të kundërta, ta nxirrte Aliun (a.s) si njeriun më të keq të botës islame. Për këtë qëllim ai përdori mjete të ndryshme: nga njëra anë përdori shpatën dhe shtizat kundër frymës së Aliut, duke mos i dhënë rast askujt që të kishte mundësi të përmendte hadith a tregim për Ali Ibne Abu Talibin; nga ana tjetër, tërhoqi disa njerëz materialistë dhe duke u dhënë atyre shuma të mëdha parash, u kërkoi që të shpiknin disa hadithe të Profetit kundër Aliut (a.s).

Por të tëra këto nuk i mjaftuan Muavijes. Ai thoshte që ai duhej të bënte diçka që fëmijët të rriteshin me ndjenjën e inatit kundër Aliut dhe pleqtë të vdisnin me ndenjat kundër Aliut.Gjëja e fundit që i sosi në mendje ishte që në të gjithë territorin e gjërë islam, sharjet dhe mallkimin ndaj Aliut ta nxirrte si një parullë të përgjithshme popullore dhe fetare. Dha urdhër që në çdo vend, nëpër xhami të thuhej mallkimi kundër Aliut. Ky veprim u përhap dhe u zbatua. Pas Muavijes, këtë taktikë e vazhduan dhe të gjithë kalifët e tjerë, me qëllim që t'i përndiqnin alevitët dhe t'u shkulnin atyre njëherë

e mirë dëshirën për kalifatin. Brezat e mëvonshëmu mësuan me atë parullë dhe e përsëritnin atë vetvetiu. Kjo punë ndikoi shumë në njerëzit e thjeshtë dhe naivë, saqë një ditë, një burrë shkoi te gjykatësi dhe duke iu ankuar, i tha; "Familja ime më ka bërë dëm të madh sepse ma ka vënë emrin Ali, tani të kërkoj ndihmë që të më ndryshosh emrin." Gjykatësi ndyshoi emrin dhe i tha: "Meqë zgjodhe një mjet të mirë (urrejtjen ndaj Aliut) për ndihmë, ty po të lë filan post drejtues, shko e merre!" Kështu pra, propaganda dhe parullat e kishin bërë punën e tyre. Mirëpo kush e dinte që një ngjarje fare e vogël do ta bënte të pavlefshëm efektin e asaj propagande prej më shumë se gjysmë shekulli duke e zhdukur atë plotësisht , duke e nxjerrë të vërteten në shesh pas të gjitha atyre intrigave.

Omer ibn Abdul Azizi, i cili i përkiste beni umovitëve, kur ishte fëmijë, një ditë, po luante me të gjithë moshatarët e tij, dhe siç ishte bërë zakon, në gojën e fëmijëve qarkullonte fjala dhe mallikimi për Ali ibn Ebu Talibin. Fëmijët luanin dhe qeshnin njëri me tjetrin dhe për çdo rast të vogël përsërisin mallkimin ndaj Aliut.

Edhe Omer ibn Abdul Azizi ishte pjesë e asaj zhurme dhe potereje. Rastësisht, aty po kalonte dhe mësuesi i tij, një besimtar i denjë, i urtë dhe largpamës. Mësuesi dëgjoi me veshët e tij që nxënësi i tij i dashur po mallkonte Aliun. Mësuesi nuk tha gjë, kaloi që andej dhe vajti në xhami. Pak nga pak, erdhi ora e mësimeve. Omeri shkoi në xhami që të merrte mësimet e tij. Sapo mësuesi pa Omerin, u ngrit menjëherë nga vendi dhe shkoi të falte namazin, i cili i zgjati shumë. Omeri e ndjeu që namazi ishte një preteks dhe se

problemi qëndronte diku tjetër. Omeri priti derisa mësuesi e mbaroi namazin e tij. Pasi e fali namazin e tij, mësuesi i hodhi një vështrim shumë të rreptë nxënësit të tij. Omeri i tha: " A është e mundur, o zoti mësues të më thoni shkakun e mërzisë suaj"?

- Biri im, ti sot po mallkoje Aliun ashtu?,- e pyeti mësuesi
- Po,- u përgjigj ai.
- Kur e ke mësuar ti që Zoti, pasi mbeti i kënaqur nga pjesëmarrësit e Luftës së Bedrit, i ndëshkoi ata dhe dha të drejtën që ata të mallkohen?, - pyeti mësuesi.
- Pse ka marë pjesë Aliu në Luftën e Bedrit?–pyeti Omeri
- Pse Bedri dhe ngjarjet e Bedrit a i takojnë njeriu tjetër përveç Aliut?, –pyeti mësuesi.
- Të betohem se nuk do ta përsëris më këtë gjë, -tha Omeri.
- Betohu!, - i tha mësuesi.
- Betohem,. – u përgjigj Omeri.

Ky fëmijë i qëndroi besnik fjalës dhe betimit të tij. Përherë ai kujtonte fjalët e mençura të mësuesit dhe që nga ajo ditë e më pas nuk e përmendi më kurrë mallkimin kundër Aliut. Mirëpo ai shikonte se ky mallkim thuhej në rrugë, xhami, pazare, etj. Derisa pas disa vitesh të tjera një ngjarje tjetër i tërhoqi sërish atij vëmendjen duke ia ndryshuar plotësisht mëndjen. Ngjarja ishte kjo:

I ati ishte guvernatori i Medines. Sipas rregullit, ditëve të xhuma falej namazi xhumasë. Sipas zakonit, i ati fillonte faljen e namazit dhe sërish sipas zakonit që kishin nxjerrë umavitë, e përmbyllte namazin duke përmendur mallkimin kundër Aliut. Omeri vuri re një ditë që i ati, sa herë që fliste për ndonjë çështje, cilado që ajo të ishte, fliste me zë

të lartë dhe rrjedhshëm, duke treguar besim dhe siguri në fjalët që thoshte. Mirëpo, kur vinte radha për të përmendur mallkimin ndaj Aliut, atij i merrej goja dhe e thoshte atë duke iu dridhur zëri. Kjo gjë i tërhoqi shumë vëmendjen Omerit. Ai mendoi me vete që me siguri, në thellësi të shpirtit dhe të zemrës së të atit ishte diçka të cilën ai nuk mund ta thoshte dot me gojë. Ajo gjë, do apo s'do, ndikonte në të shprehurit e tij dhe bënte që t'i merrej goja.

Një ditë Omeri vajti dhe i tha të atit: -Baba! Unë nuk e di përse për çështjet e tjera shprehesh shumë qartë dhe pastër, kurse sa herë vjen puna te mallkimi, ty sikur të ikën gjuha e nuk hap dot gojë?

-Biri im! E paske vënë re ti këtë gjë?, – e pyeti i ati.

-Po baba, kjo gjë duket shumë qartë tek ti.

-Biri im i dashur! Vetëm kaq po të them: Sikur këta njerëz që ulen nën këmbët e altarit tonë, të dinin për madhështinë e atij burri sa di babai yt, nuk do të na ndiqnin më ne, por do t'u shkonin pas djemve të tij.

Omari, i cili nuk i kishte harruar fjalët e mësuesit të tij dhe këtë rrëfim e dëgjoi nga vetë babai i tij, pësoi një tronditje të madhe brenda vetes dhe lidhi besën me Zotin e tij që, nëse një ditë do të merrte pushtetin në dorë, ta fshinte njëherë e mirë këtë zakon të ndyrë, që ishte kujtim i ditëve të errëta të Muavijes.

Erdhi viti 99 (Hixhri). Që nga koha kur Muavija e pati pjellë atë zakon të keq, kishin kaluar afro gjashtëdhjetë vjet. Në atë kohë kalif ishte Sulejman ibn Abdul Meliku. Sulejmani u sëmur dhe e dinte shumë mirë që nuk e kishte të gjatë. Megjithëse me testament të të atit, Abdul Malikut e kishte

të caktuar që pasardhës të linte të vëllanë, Jezid ibn Abdul Malikun, Sulejmani nuk veproi kështu; ai la si kalif pas vetes Omer ibn Abdul Azizin.

Sapo Sulejmani vdiq, testamenti i tij u hap në xhami dhe aty mbetën të gjithë të befasuar. Abdul Azizi ishte ulur në fund të xhamisë. Kur dëgjoi që testamenti ishte lënë në emër të tij, tha: "ne të Zotit jemi dhe te Ai do të kthehemi". Pastaj, një grup njerëzish e kapën për krahësh dhe e hipën në faltore. Njerëzit e pranuan me kënaqësi atë si sovran.

Gjëja e parë që bëri Omer ibn Abdul Azizi, ishte fshirja e menjëhershme e mallkimit ndaj Aliut. Dha urdhër që pas përfundimit të faljes së ditës së xhuma, në vend të mallkimit të Aliut të vihej ajeti i Kur'anit **"All-llahu urdhëron për drejtësi dhe mirësi..."**

Poetët dhe dijetarët e lavdëruan shumë atë për këtë vepër që beri, duke e bërë emrin e tij të mirë të pavdekshëm.[1]

Shpata Islami

---

1) Sherh Nehxhul Belaga i ibn ebi Hadijdit; vëll. 1, f. 464, botuar në Beirut. Kamilu, i ibn Ethijrit; vëll. 4,f. 154.

115

E DREJTA E VËLLAIT MYSLIMAN

Abdul Aliu, biri i Ainit, u dërgua nga Kufa për në Medine. Shokët dhe pasuesit e imam Sadikut (a.s) shfrytëzuan rastin dhe nxituan të shkruanin për imamin të gjitha gjërat që u duheshin dhe ia dhanë Abdul Aliut, që përgjigjet e tyre t'i merrte nga imami dhe t'i sillte kur të kthehej. Ndërkohë, atij i kërkuan që ta pyeste imamin veçanërisht për një çështje e cila kishte të bënte me një të drejtë që mund të kishte një mysliman mbi myslimanët e tjerë.

Abdul Aliu u fut në Medine dhe shkoi të takonte imamin. I dorëzoi pyetjet me shkrim dhe i parashtroi pyetjen me gojë. Mirëpo, përkundër asaj që priste ai, imami u dha përgjigje të gjitha pyetjeve me shkrim, përveç asaj që kishte të bënte më të drejtën e myslimanit mbi myslimanët e tjerë. Abdul Aliu atë ditë nuk tha gjë dhe doli jashtë. Edhe gjatë ditëve të tjera imami nuk tha asnjë fjalë për këtë çështje.

Abdul Aliut i erdhi dita për t'u larguar nga Medinia dhe vajti të ndahej me imamin. Mendoi që t'ia thoshte sërish pyetjen,

e tha: -O Biri i Profetit! Ajo pyetja ime e asaj dite mbeti pa përgjigje.
-Unë me qëllim nuk t'u përgjigja, -tha imami.
-Pse?, –pyeti Abdul Aliu.
-Sepse kam frikë që të them të vërtetën e ju nuk do të veproni sipas saj dhe do të dilni nga feja e Zotit, -u përgjigj imami.
Pastaj imami filloi të përgjigjej dhe tha: "Tri janë detyrat më të vështira që ka caktuar Allahu për njerëzit.
Njëra është zbatimi i drejtësisë dhe ruajtja e drejtësisë mes vetes dhe të tjerëve. Sillu me vëllanë tënd mysliman ashtu siç ka dëshirë ai të sillet me veten.
Tjetra: Mallin tënd mos e krahaso me atë të vëllait mysliman, por sillu me ta me barazi.
E treta: Përmendja e Zotit sido që të jesh. Kjo nuk do të thotë që të rrish e të thuash pa ndërpreje Zoti është i madh, falënderoj Zotin etj. Qëllimi i fjalës sime është që njeriu të jetë i atillë që, kur të përballet më një punë të ndaluar, përmendja e Zotit që është përherë në zemrën e tij, ta ndalojë atë nga kjo punë."[1]

Shqeta Fllaçi

1) Usulul Kafij; vëll. 2, f. 170.

E DREJTA E NËNËS

Zekeria, biri i Ibrahimit,megjithëse i kishte të gjithë familjarët e tij me prindër të krishterë dhe vetë i përkiste po asaj feje, kishte njëfarë kohe që po ndiente një prirj etë veten drejt Islamit. Ndërgjegjja e thërriste drejt Islamit. Si përfundim, përkundër dëshirës së nënës, babait dhe familjarëve të tij, ai u kthye nga feja islame dhe u bë mysliman.

Erdhi koha e Haxhit. Zekeria, si djalë i ri, synonte të shkonte në haxh. Doli nga qyteti i Kufës dhe shkoi në Medine. Aty takoi imam Sadikun (a.s). I shpjegoi imamit se si e kishte pranuar Islamin dhe imami i tha: "Ç'gjë të tërhoqi drejt Islamit?"

Zekeria tha: "Vetëm kaq mund të them: fjala e Zotit në Kur'an, kur i thotë Profetit të tij: O Pejgamber! Ti më përpara as nuk e dije se çfarë është libri, nuk e dije çfarë është besimi, por Ne që të shpallëm ty Kur'anin, dhamë dritë dhe nëpërmjet kësaj drite udhëzojmë cilindo që duam. Kjo për mua ishte e drejtë".

Imami i tha: " E miratoj Zoti ty të ka drejtuar."

Pastaj imami tha tri herë: "O Zot, vetë Ti qofsh drejtuesi i tij!". Dhe më pas: "Biri im! Tani çfarëdo pyetjeje që të kesh, thuaje!". Djaloshi pyeti: - Babai, nëna, dhe të gjithë

familjarët e mi, janë të krishterë. Nëna ime është e verbër. A do të ringjallem unë me ata, dhe a duhet të ha ushqim së bashku me ta? Si i bëhet punës sime në këtë mes?
-A e përdorin ata mishin e derrit?, –pyeti imami.
-Jo, o biri i Profetit, as nuk e prekin dot mishin e derrit, -u përgjigj Zakaria.
- Atëherë, të hash bashkë me ta nuk ka anjë pengesë, -u përgjigj imami.
Pastaj imami i tha Zekerias: "Kujdesu për nënën tënde! Sa të jetë gjallë, sillu mirë me të! Kur të vdesë, mos ia lë varrimin e saj askujt tjetër. Përgatiti vetë të gjitha gjërat që duhen për varrim! Këtu mos i thuaj askujt që je takuar me mua. Edhe unë do të vij në Mekë, dhe po deshi Zoti, takohemi edhe atje."
Kur shkoi në Mekë, djaloshi vajti ta takonte sërish imamin. U habit kur pa sesi njerëzit i vinin atij nga prapa si fëmijët që e rrethojnë mësuesin e tyre duke i bërë pyetje të njëpasnjëshme, dhe merrnin përgjigjet nga imami.
Ditët e haxhit mbaruan dhe djaloshi u kthye në Kufë. Këshillën e imamit e mbante në mendje gjithmonë. Filloi të përkujdesej për të ëmën e tij të verbër, pa përtuar për asnjë çast. E ushqente atë me duart e tij, madje dhe rrobat ia lante dhe ia pastronte vetë. Ky ndryshim në sjelljen e djalit, sidomos pas ardhjes nga udhëtimi në Mekë, ishte shumë i habitshëm për nënën. Një ditë ajo i tha djalit të saj; "Biri im! Ti, më pas kur ishe i besimit tonë, nuk silleshe kaq mirë e me dashuri me mua? Ç'ka ndodhur, tani që ti dhe unë nga feja nuk jemi të njëjtë, sillesh më ëmbël me mua.?"

-Nënë e dashur! Njëri prej djemve të Profetit tonë kështu më udhëzoi, - u përgjigj i biri.

- Po ai vetë është Profet?, –pyeti nëna.
- Jo, ai nuk është profet. Ai është djali i Profetit,- u përgjigj sërish i biri.

-O biri im,- i tha e ëma,- unë mendoj që ai vetë është profet, sepse këto këshillat e tij nuk i thotë tjetër kush përveç profetëve.

-Jo, o nënë, të jesh e sigurtë që ai nuk është profet, ai është djali i Profetit. Pas Profetit tonë, në botë nuk do të vijë asnjë profet tjetër, -u përgjigj djali.

-Biri im! Feja jote është një fe shumë e mirë, është më e mirë se çdo fe tjetër. Ma jep dhe mua fenë tënde, -foli e ëma.

Djali i mësoi nënës shehadetin (dëshminë) dhe nëna u kthye në myslimane. Pastaj djali nisi t'i mësonte nënës së tij të verbër rregullat e faljes dhe mësimet e Islamit. Nëna i mësoi dhe filloi të falte namazin e drekës dhe të pasdites. U bë natë. Nëna u ngrit të falte namazin e mbrëmjes. Pastaj, vonë në darkë, ajo u sëmur dhe ra në shtrat. Ajo thirri të birin e saj dhe i tha:

"Biri im!, i thuaj dhe njëherë ato gjëra që më mësove"!

I biri i tha dhe një herë fjalinë e shehadetit dhe rregullat e tjera islame, dhe i foli për besimin, Profetin, melekët, librin e Allahut dhe Ditën e Ringjalljes. E ëma i përsëriti të gjitha ato pas të birit dhe ia dorëzoi shpirtin e saj Shpirtkrijuesit. Kur u bë mëngjes, erdhën myslimanët dhe e bënë trupin e saj gati për varrim.[1]

---

1) Usulul Kafij; vëll. 2, f. 160 dhe 161.

TEK DIJETARI

Njëri prej shokëve erdhi te Profeti dhe e pyeti: "O i Dërguari i Zotit! Nëse kemi një njeri për të varrosur e ndërkohë kemi mësim, pra nuk kemi kohë që të marrim pjesë në të dyja veprimtaritë njëkohësisht,sepse po të shkojmë te njëra, do të humbasim tjetrën, cilën prej tyre parapëlqeni që të zgjedh?" Profeti i nderuar tha: " Nëse ka njerëz të tjerë që mund të bëjnë varrimin, ti shko në mësime në kuvendin shkencor. Pjesëmarrja në një tubim mësimor është më i mirë se pjesëmarrja në një mijë varrime, më i mirë se një mijë vizita të sëmurët, më e mirë se një mijë net adhurimi, më e mirë se një mijë ditë agjërimi, më i mirë së një mijë dërhem të fituar, më i mirë se një mijë haxhe jo të nevosjhme dhe me i mirë se një mijë xhihade (lufta të shenjta) të panevojshme. Ku këto e ku të jesh prani dijetarit?! A nuk e di se nëpërmjet dijes i bindemi Zotit dhe nëpërmjet dijes vjen adhurimi i Zotit? Mirësia e botës dhe e Ahiretit vjen nëpërmjet dijes. Ashtu siç vjen e keqja e botës dhe e Ahiretit prej padijes, prej injorancës.[1]

---

1) Biharul Anuar; vëll. 1,f. 204.

HISHAMI DHE TAUUSU'L JEMANI

Hesham ibn Abdul Meliku, kalif Umovit, gjatë ditëve të kalifatit të tij, vajti për haxh në Mekë. Dha urdhër që t'i sillnin një njeri, i cili kishte jetuar në kohën e Profetit sepse kërkonte t'i bënte disa pyetje për atë atë kohë. I thanë se prej shokëve të Profetit nuk kishte mbetur asnjë sepse kishin vdekur të gjithë. Hishami tha: " Atëherë, më sillni njërin prej "tabiunëve"[1] dhe të flas me të."

Hishamit i sollën Tauus Jemanin.

Kur hyri brenda Tavusi, i hoqi këpucët përpara Hishamit dhe i la mbi qilim. Kur e përshëndeti Tavusi, nuk i tha siç i thoshiin të gjithë të tjerët, "Selam Alejkum o Emirul Mu'menin", po vetëm "Selam Alejkum", pra pa e përmendur Emirul Mu'meninin fare. Shkoi dhe u ul menjëherë përpara Hishamit dhe nuk priti aspak që t'i jepnin leje për t'u ulur. Zakonisht të tjerët qëndronin përballë kalifit dhe nuk uleshin pa u dhënë leje kalifi. Më e habitshme qe kur Tauusi tha: "Hisham, pa hë, si je?"

---

1) Tabiunë - quheshin njerëzitë cilët nuk kishin arritur ta jetonin vetë kohën e Profeti, e ta njihnin vetë personalitetin dhe dinjitetin e tij, por e kishin mësuar atë nga goja e shokëve të tij.

Sjellja dhe fjalët e Tauusit e inatosën shumë Hishamin dhe i tha: -Ç'janë këto punë që bën ti përpara meje?
-Ç'bëra?, –pyeti Tauusi.
-Ç'bëre?!, –tha Hishami. Pse i hoqe këpucët përpara meje? Pse nuk më thirre Amir Ul Mumenin? Pse u ule pa të dhënë leje unë?
Pse më pyet si jam në mënyre kaq fyese?
" Unë i heq këpucët pesë herë në ditë përpara Zotit të Madhëruar, dhe ai nuk inatoset me mua për këtë ," - foli Tauusi: "Nuk të thirra Mbret i besimtarëve (Emirul Mu'menin), sepse ti nuk je me të vërtetë, mbreti i të gjithë besimtarëve; shumë veta janë të pakënaqur prej teje."
" Të thirra me emër, sepse edhe Zoti Profetët e vet i thërriste me emër dhe në Kur'an thuhet "O Davud" "O Jahja", "O Isa", dhe kjo gjë nuk është quajtur fyerje nga ana e Profetëve. Në të kundërt, Zoti e thërret Ebu Lehebin me nofkë."
" Nuk të mora leje që të ulesha, sepse kam dëgjuar nga Emirul Mu'menini Ali ibn Ebu Talibi që ka thënë: " Nëse do që të shikosh një njeri që është banor i Zjarrit, shiko njeriun i cili qëndron i ulur dhe të gjithë të tjetër përreth tij, rrinë në këmbë". Kur fjala e Tauusit mbërriti këtu, Hishami tha: Tauus, më kërko falje!
- "Kam dëgjuar Emiru Mu'menin Ali ibn Ebu Talibin të thotë që në xhehennem ka gjarpërinj dhe akrepa të mëdhenj. Këta gjarpërinj dhe këta akrepa kanë për detyrë që të pickojnë atë mbret që nuk sillet drejt me njerëzit."
Tauusi tha këto fjalë, u ngrit shpejt, ia dha vrapit dhe doli menjëherë jashtë.[1]

---

1) Sefinetul Bihari; fjala "Tauese"

PENSIONI

Një plak i krishterë kishte punuar dhe derdhur djersë gjatë gjithë jetës së tij dhe, në fund të punës ishte verbuar. Pleqëria, verbëria dhe varfëria ishin mbledhur të gjitha bashkë duke mos i lënë rrugë tjetër për të mbijetuar përveç lypjes. Qëndronte i ulur pranë ndonjë rrugice e zgjaste dorën për të lypur. Njerëzit kalonin aty pranë dhe i falnin ndonjë gjë të vogël e kështu, ai kalonte ditët e tij. Ha sa për të mbajtur frymën gjallë.

Një ditë, aty pranë kaloi Emirul Mu'menini Ali ibn Ebu Talibi dhe e pa plakun ashtu në atë gjëndje. Aliu u interesua menjëherë për plakun, çfarë i kishte ndodhur që tani ishte në këtë gjëndje; a nuk kishte më asnjë njeri që të kujdesej për të; a nuk kishte rrugë tjetër ky burrë i moshuar që t'i jetonte ditët e fundit të jetës së tij në mënyrë të nderuar dhe jo duke lypur.

Njerëzit që e njihnin plakun, erdhën dhe treguan që ai ishte i krishterë, që në rini e për sa kohë i kishte pasur sytë, kishte punuar, ndërsa tani që edhe rinia i kishte ikur, po ashtu, edhe shikimi, nuk mundtë punonte më, nuk kishte

grumbulluar dot asnjë pasuri, e për të mbijetuar, kërkonte sadaka. Aliu (a.s) tha:

"E habitshme! Për sa kohë që ai ka qenë i aftë, kërkuat punë prej tij, ndërsa tani e keni lënë fillikat vetëm?! E kaluara e këtij burri tregon që deri në kohën kur kishte fuqi dhe ishte i aftë, ka punuar dhe shërbyer. Prandaj e ka detyrë shteti dhe shoqëria që derisa të jetë gjallë, të përkujdesen për të. Shkoni dhe caktojini pension nga arka e shtetit dhe jepini atij!"[1]

Shoqata Flladi

1) Uesail; vëll. 2,f. 425.

QOFTË DHE SHITËS SKLLEVËRISH

Historia tërheqëse dhe e këndshme e atij burrit që shiste vetëm vaj ulliri dhe që e donte shumë Profetin e nderuar, ishte një nga historitë më të parapëlqyera të njerëzve. Të gjithë e dinin që ai e donte çiltërsisht Profetin dhe, në qoftë se i kalonte ndonjë ditë pa e parë Profetin, ndihej pa qejf dhe i mërzitur. Sa herë që dilte për të bërë një punë, patjetër do të kalonte në fillim ose nga shtëpia e Profetit, ose nga xhamia, ose nga çdo vend tjetër ku mund të përshëndetej me Profetin. Pasi takohej me të, mbushej me frymëzim dhe energji dhe vazhdonte pastaj drejt punës së tij.

Nganjëherë, kur njerëzit ishin tubuar rreth Profetit dhe ai rastiste të ishte në fund të turmës e nuk mund ta shikonte Profetin, zgjaste kokën, ose hidhej pupthi, qoftë edhe për një sekondë te vetme që sytë e tij ta shikonin madhështinë e Profetit.

Një ditë, Profeti i nderuar vuri re që nga fundi i turmës së njerëzve ai po mundohej ta shikonte patjetër. Edhe Profeti lëvizi drejt tij, që ai burri të kishte mundësi ta takonte. Pasi u

çmall me Profetin, burri vazhdoi drejt punës së tij, mirëpo nuk zgjati shumë dhe u kthye sërish. Sapo Profeti e vuri re për herë të dytë atë ditë, ia bëri me shenjë që të vinte drejt atij. Ai erdhi te Profeti dhe u ul. Profeti i tha: "Dita jote e sotme kishte ndryshim nga ditët e tjera. Ditëve të tjera vije e më shikoje vetëm një herë, pastaj shkoje në drejt punën tënde, kurse sot shkove e u ktheve sërish. Përse?"

Burri i tha: " O i Dërguari i Zotit! E vërteta është që sot aq shumë ma pushtoi zemrën mirësia, saqë nuk munda të shkoja drejt punës sime, e kështu që u ktheva mbrapsht:"

Profeti bëri për të një lutje mirësie. Atë ditë ai u kthye në shtëpi dhe nuk u pa më. Kaluan disa ditë dhe prej atij burrit nuk dukej më asnjë shenjë. Profeti u tha shokëve të tij që të interesoheshin për të e të gjithë shokët iu përgjigjën: " U bë kohë që nuk e shohim."

Atëherë Profeti u nis vetë të interesohej për të e të shikonte se çfarë i kishte ndodhur atij. U nis së bashku me një grup shokësh dhe vajti drejt pazarit ku shitej vaji i ullirit. Sapo arritën te dyqani i tij, panë që dyqani ishte i mbyllur dhe aty rrotull nuk kishte njeri. Pastaj pyeti në dyqanet që ishin aty pranë dhe ata i thanë: "O Profet i nderuar! U bënë disa ditë që ai ka vdekur."

Pastaj shtuan: "O Profet i Zotit! Ai ishte njeri shumë besimtar dhe i sinqertë, mirëpo kishte dhe një ves të keq"

-Çfarë vesi?, –pyeti Profeti.

- Nuk hiqte dorë nga disa punë të shëmtuara. Për shembull, shkonte shumë pas femrave.

-Zoti pastë ndjesë për të dhe e mëshiroftë! Ai më donte mua aq shumë, që edhe sikur të ishte shitës skllevërish, Zoti do ta falë, –tha Profeti.[1]

1) Reudatul Kafij; f. 77.

SHITËSI I TRANGUJVE

Në shekullin e dytë (Hixhri), çështja e divorcimit të gruas tri herë në një kohë bëri që mes analistëve dhe teoricienëve të lindin bisedime dhe debate të mëdha. Shumë prej klerikëve dhe dijetarëve të asaj kohe ishin të mendimit që tri divorce përnjëherësh, pa u bërë një ndarje mes tyre nuk ishte e drejtë. Klerikët dhe dijetarët e medhhebit të Ehli Bejtit (a.s.)**,** të cilët ndiqnin udhën e Imamëve të tyre të lartë, këtë lloj divorci e quanin të pavlefshëm. Ata thonë që divorcimi i gruas është i rregullt kur bëhet tri herë, radhaz, njëri pas tjetrit. Pra, burri e ndan një herë gruan e kthen përsëri, pastaj e ndan dhe e kthen, e ndan dhe e kthen sërish. Pas ndarjes së tretë, ai nuk ka më të drejtë të martohet sërish me këtë grua, por duhet që gruaja të martohet me një burrë tjetër, të bashkohet me të, pastaj të ndahen me divorc ose t'i ndajë vdekja.

E tërë historia kishte nisur kur një burrë në Kufe kishte divorcuar gruan e tij tri herë brenda një radhe dhe pastaj ishte penduar. Ai e donte ende gruan e tij dhe shkak për ndarjen ishin bërë disa gjëra shumë të vogla. Edhe gruaja

e donte ende burrin e saj. Prandaj edhe burri edhe gruaja filluan të mendonin për një rrugëzgjidhje.

Ua parashtruan çështjen dijetarëve shiitë. Të gjithë ata ishin të mendimit që, meqë kishin ndodhur tri divorce përnjëherësh dhe për këtë arsye ky divorc ishte i pavlefshëm, ata ishin sërish ligjirisht burrë e grua.Mirëpo shumica e njerëzve, të cilët dëgjonin dijetarët dhe klerikët e tjerë, thoshin që divorci ishte i vlefshëm dhe ata nuk mund të bashkoheshin me njëri-tjetrin.

Kështu, ishte krijuar një problem i çuditshëm: bëhej fjalë për gjënë e lejuar (hallallin) dhe të ndaluarën (haramin) në çështjet bashkëshortore. Si gruaja, ashtu edhe burri donin sërish që ta vazhdonin jetën e tyre si më parë, mirëpo ishin të shqetësuar se mos ndoshta divorci ishte i drejtë dhe bashkimi i tyre me njëri-tjetrin ishte i ndaluar dhe fëmijët e tyre të ardhshëm nuk do të ishin të ligjshëm.

Burri vendosi që të vepronte sipas mendimit të dijetarëve shiitë. Mirëpo gruaja i tha atij që pa vajtur të fliste vetë me imam Sadikun për këtë çështje, ajo nuk do të qetësohej.

Në atë kohë, imam Sadiku (a.s) ishte vendosur në qytetin antik të Hiresë (afër Kufës). Kishte kohë tashmë që ai përndiqej nga regjimi i kalifëve Abasitë. Ata e kishin sjellë imamin nga Medinia në Hire dhe aty e mbanin nën mbikëqyrje pa lejuar askënd të takohej me imamin, a të afrohej te imami.

Sido që bëri çmos ta takonte imamin, kurrë nuk ia arriti dot. Një ditë po qëndronte pranë vendit ku banonte imami, duke menduar se si ta gjente mënyrën që ta takonte imamin, kur aty pranë, papritur sytë i zunë një burrë nga anët e Kufës,

i cili mbante një tabaka me tranguj mbi kokë e po kalonte duke thërritur

"Hajde tranguj! Hajde tranguj!"

I shkrepi si rrufe në kokë një ide. I shkoi afër dhe i tha:

-Sa e shet të gjithë tabakanë?

-Një dërhem, -u përgjigj burri nga Kufa.

Pasi i bleu tabakanë, i kërkoi që t'i jepte për disa çaste dhe veshjen e tij dhe i premtoi se do t'ia kthente shumë shpejt. Shitësi pranoi. Ai i veshi rrobat dhe e pa veten që ishte bërë tamam si një shitës ambulant trangujsh. E vuri tabakanë e trangujve mbi kokë e duke thirrur "Hajde tranguj! Hajde tranguj! ,shkoi drejt shtëpisë së imam Sadikut. Kur mbërriti përpara derës së shtëpisë së imamit, i doli një shërbëtor dhe i tha: " O ti që shet tranguj, eja këtu!"

Me gjithë gëzim u fut brenda dhe pa lënë as dyshimin më të vogël te rojet, shkoi e takoi imamin. Imami i tha: -Ah, të lumtë, plan të bukur përdore. Tani më thuaj për çfarë ke ardhur të më pyesësh?

- O i biri i Profetit! Unë e kam ndarë gruan time tri herë, radhaz. Kam pyetur dijetarët shiitë dhe më kanë thënë që ky lloj divorci është i pavlerë, por sërish zemra e gruas sime nuk qetësohet, më thotë që pa marrë përgjigje nga imami, nuk pranon. Kështu, maskuar në këtë mënyrë, erdha të marr përgjigjen për këtë çështje.

-Shko dhe të jesh i sigurt që divorci nuk ka pasur vlerë, – iu përgjigj imami.- Ju jeni bashkëshortë të ligjshëm të njëri-tjetrit.[1]

---

1) Biharul Anuar; vëll. 11, f. 154.

DËSHMIA E UMU ALA

Myslimanët në Medine ishin të ndarë në dy grupe: grupi i banorëve rrënjës, vëndës, autoktonë dhe grupi i ardhësve i banorëve që kishin ardhur gjatë emigrimit të Profetit në Medine. Ata të cilit kishin ardhur nga jashtë quheshin " të ardhurit", kurse banorët që kishin qënë aty, quheshin "vendësit". Të ardhurit të cilët i kishin lënë gjithçka - vendlindje, shtëpi, familje, grua, fëmijë e pasuri, nuk kishin asgjë për jetën a tyre në atë qytet. Për këtë arsye vendësit, me kulmin e humanzimit dhe të fisnikërisë, i pranuan vëllezërit e tyre të fesë në shtëpi. Aty nuk llogariteshin fare gjërat për miqtë. Llogaritë dhe shpenzimet vazhdonin për të gjithë njësoj si më parë. Ata i mbanin miqtë pranë duke i bërë ortakë të jetës së tyre dhe i respektonin shumë.

Osman ibn Mazuni ishte njëri prej të ardhurve nga Meka dhe jetonte në shtëpinë e njërit prej vendasve. Qëlloi që Osmani u sëmur Të zotët e shtëpisë e veçanërisht Umu Ala, e cila ishte një nga gratë e denja besimtare dhe nga të parët njerëz që kishte lidhur besën me Profetin, përkujdesej për të me gjithë zemër. Mirëpo sëmundja e tij po përparonte dita-ditës, saqë, më në fund ai vdiq.

Të zotët e shtëpisë e kishin parë besimin që kishte Osman ibn Mazuni dhe e dinin atë për një mysliman të vërtetë. Ata e dinin, gjithashtu që edhe Profeti e nderonte dhe e donte atë. Për çdo njeri të zakonshëm mjaftonin këta dy fakte që atë njeri ta quanin njeri të xhennetit.

Kur po bëheshin gati për të kryer varrimin e Osmanit, në shtëpi vjen Profeti. Umu Ala në atë kohë u kthye drejt Osmanit të vdekur dhe tha: "Mëshira e Zotit qoftë me ty o Osman! Unë dëshmoj se qysh tani Zoti të ka futur në mëshirën e Tij."

Sapo Umu Ala tha këtë fjalë, Profeti i u kthye asaj: -Ti nga e kuptove që Zoti e ka marrë Osmanin në mëshirën e Tij?

-O Profet i nderuar! Unë thjesht e thashë kështu, pa, ku di unë se a është e vërtetë, - u përgjigj ajo.

-Osmani shkoi në një botë ku të hiqen të gjitha perdet nga sytë. Sigurisht, unë uroj të mirën dhe lumturinë e tij. Unë, që jam vetë Profet, as për vete dhe as për askënd nuk mund të shprehem ashtu si ti,- tha Profeti.

Um Ala-ja që aty nuk u shpreh më për asnjë njeri në atë mënyrë. Për cilindo që vdiste po ta pyesnin, do të thoshte: "Vetëm Zoti e di se ç'gjëndje ai është tani."

Pas njëfarë kohe nga vdekja e Osmanit, Umu Ala e pa atë në ëndërr, duke ndenjur pranë një burimi uji. ajo vajti dhe ia tregoi ëndrrën Profetit.

Profeti i tha: "Ai ujë është vepra e tij që vazhdon të rrjedhë."[1]

---

1) Sahijhul Buharij; vëll. 9, f. 48 dhe Esedul Gabeti; vëll. 5, f. 604.

EZANI I MESNATËS

Gjatë sundimit të kalifatit Umovit, e vetmja racë e cila kishte epërsi dhe pushtetin në dorë përgjatë të gjithë territorit të gjërë islami, ishte raca arabe. Por gjatë kohës së kalifatit Abasit, ca nga ca pushtetin filluan ta merrnin në dorë edhe persianët, duke u vënë në poste e detyra të rëndësishme.

Kalifët Abasitë, megjithëse ishin vetë arabë, ishin të pakënaqur nga arabët. Politika e tyre ishte që të largonin arabët dhe të sillinin në pushtet persianët. Madje, në disa zona të Iranit (Persisë) ata ndaluan përdorimin e gjuhës arabe. Kjo politikë vazhdoi deri në kohën e kalifit Me'mun.

Pas vdekjes së Me'munit, në postin e kalifit u ul i vëllai, Mu'tasami. Me'muni dhe Mu'tasami ishin vëllezër me nëna të ndryshme; nëna e Me'munit ishte persiane, ndërsa nëna e Mu'tasamit ishte turke. Për këtë arsye persianët nuk e shikonin me sy të mirë ardhjen e Mu'tasamit në pushtet. Persianët donin që pushtetin ta merrte Abasi, djali i Me'munit. Mu'tasami e kishte nuhatur këtë gjë dhe kishte frikë tani se mos nipi i tij, me ndihmën e persianëve bënte ndonjë kryengritje dhe e rrëzonin. Kështu, mendoi që të zhdukte Abasin dhe t'i kapte iranianët, që ishin përkrahësit e Abasit. Abasin e futi në burg, ku edhe vdiq më pas. Ndërsa

për të parandaluar influencën e persianëve, ai mendoi që postet dhe detyrat që kishin ata, t'ua jepte njerëzve të tjerë. Për këtë qëllim, ai solli drejt Bagdadit grupe të shumta njerëzish nga Turkestani dhe grupe nga raca e nënës së tij e ua dha atyre detyrat e të tjerëve. Pak nga pak, turqit ua morën dorën të gjitha punëve dhe fituan pushtet mbi iranianët dhe arabët.

Mu'tasami, i cili, tashmë kishte besim dhe siguri nga turqit, u jepte atyre hapësirë dita-ditës. Kështu, turqit e morën të tërë pushtetin islamik në dorë. Turqit ishin të gjithë myslimanë dhe kishin mësuar gjuhën arabe dhe islamit i qëndronin besnikë. Mirëpo, qysh nga fillimi i futjes së tyre brenda qytetërimit islamik dhe marrjes së pushtetit në dorë nuk kishte kaluar ndonjë kohë e gjatë, ata nuk kishin njohje të mirëfilltë me kulturën, traditën dhe filozofinë e qytetërimit islam. Ndërsa në të kundërt, persianët vinin nga një qytetërim shumë i lashtë dhe ishin shumë të dhënë pas kulturës dhe filozofisë islame dhe quheshin si përparimtarët e Islamit. Gjatë kohës që persianët kishin pushtetin në dorë, shumica e myslimanëve të tjerë ishin të kënaqur prej tyre, kurse me turqit të gjithë njerëzit ishin të pakënaqur dhe të inatosur, sepse gjatë kohës së influencës dhe pushtetit të tyre ata ishin shumë të egër dhe vulgarë. Ushtarët turq, kur u hipnin kuajve dhe dilnin nëpër rrugët dhe rruginat e Bagdadit, as nuk shihnin që mund të kishte njerëz përpara tyre e ndodhte shpesh që ata të shkelnin me kuaj këmbësorësh fëmijët, gratë a të moshuarit

Aq shumë u zemëruan njerëzit me ta, saqë i kërkuan Mu'tasamit që kryeqytetin ta lëvizte nga Bagdadi në një qytet

tjetër. Populli ia bëri të qartë atij se në qoftë se ai nuk do ta shpërngulte qëndrën e pushtetit, ata do të ngriheshin kundër tij. Mu'tasami iu përgjigj: "Me çfarë force do të luftoni me mua?! Unë kam 80 mijë ushtarë të armatosur!".

Njerëzit iu kthyen: "Me shigjetat e natës, me mallkimet e mesit të natës do të luftojmë me ty."

Pas kësaj bisede me ta, Mu'tasami e pranoi kërkesën e tyre dhe e shpërnguli qendrën nga Bagdadi për në Samara.

Pas Mu'tasamit, erdhi periudha e Vasekut, Muevekelit, Muntasarit dhe e disa kalifëve të tjerë si puna e tyre. Turqit sërish vazhdonin të kishin në dorë pushtetin dhe drejtimin. Disa prej kalifëve Abasitë, në fillimet e tyre u munduan që t'ua shkurtonin duart turqve, mirëpo dështuan. Njëri prej kalifëve Abasitë, i cili deri diku arriti ta zbehte influencën e turqve ishte Mutazedi.

Në kohën e Mutazedit, një tregtar i moshuar i kishte dhënë borxh njërit prej oficerëve të ushtrisë një shumë të madhe parash dhe tani ia kërkonte. Por, nuk arrinte t'ia merrte dot borxhin. I detyruar, vendsoi që këtë problem t'ia shtronte vetë kalifit. Mirëpo, sa herë shkonte te pallati mbretëror, nuk arrinte të hynte brënda. Rojet e oborrtarët i bëheshin atij pengesë.

I zhgënjyer nga të gjitha anët, tregtari nuk pati më shpresa, derisa një ditë, takoi një njeri i cili i tregoi një rrobaqepës në Seshanbe Pazar dhe i tha që ai do t'i zgjidhe hallin. Tregtari plak shkoi te rrobaqepsi dhe i qau hallin. Rrobaqepsi i dha urdhër oficerit të ushtrisë që të kthente borxhin menjëherë, dhe ai e ktheu atë pa e vonuar aspak.

Kjo gjë e habiti jashtë mase tregtarin plak. Me këmbëngulje të madhe e pyeste rrobaqepësin: "Si ka mundësi që këta që nuk pyesin asnjë njeri, të binden ty menjëherë?"
Rrobaqepsi i tha: " Unë kam një histori, që duhet të ta tregoj: Një ditë, po kaloja në rrugë. Në rrugë po kalonte dhe një grua shumë e bukur. Rastësisht, njëri prej oficerëve turq doli i dehur nga shtëpia e tij dhe u ul para portës së shtëpisë dhe po shikonte njerëzit që kalonin në rrugë. Sapo i zunë sytë këtë gruan e bukur, u turr si i çmëndur drejt saj dhe në sy të të gjithëve e kapi dhe e tërhoqi drejt shtëpisë së tij. Gruaja e shkretë filloi të ulërinte dhe të thërriste, "Ndihmë! Unë nuk jam femër e tillë; unë kam nder; burri është betuar që, edhe një natë të vetme sikur ta kaloj jashtë shtëpisë, do të më ndajë menjëherë e do të më, më shkatërrohet familja, do të më quajnë të përdalë. Ndihmë, më ndihmoni, ju lutem!"
Mirëpo askush nuk guxonte të ndërhynte nga frika.
Unë bëra përpara dhe i fola oficerit me butësi dhe iu luta që ta lëshonte gruan. Ai më goditi fort në kokë me biçakun që kishte në dorë dhe e futi gruan në shtëpi. Atëherë vajta e mblodha disa njerëz dhe shkuam te shtëpia e oficerit dhe i kërkuam të lëshonte gruan. Papritur, ai doli nga shtëpia me një grup shërbëtorësh dhe skllevërish e filluan të na gjuanin e të na godisnin.
Të gjithë u shpërndamë; edhe unë shkova në shtëpinë time. Mirëpo, për asnjë çast nuk më largohej nga mendja ajo grua e shkretë. Mendoja me vete: Po të rrinte deri në mëngjes në shtëpinë e tij, jeta e saj do të shkatërrohej plotësisht deri në vdekje dhe nuk do ta pranonin më as në shtëpi e as në ndonjë vend tjetër. Ndenja zgjuar, duke menduar deri në mes

të natës. Papritur më shkrepi një ide në mendje; thashë me vete: Sonte ky burrë është i pirë e i bërë tapë dhe nuk ka haber fare nga koha; Po të dëgjojë ezanin tani, do të kujtojë se është bërë mëngjes dhe do ta lërë gruan të lirë që të ikë, dhe gruaja, pa mbaruar nata, do të kthehet në shtëpinë e saj. Vrapova menjëherë në xhami dhe thirra majë minares ezanin me sa fuqi kisha. Njëherazi po ruaja dhe rrugën, të shikoja a do të dilte gruaja nga shtëpia apo jo. Papritur, pashë që nëpër rrugë e rrugica u derdhën ushtarët. Ata po kërkonin se kush ishte ai që këndoi ezanin në mes të natës? Ndërkohë, edhe pse kisha shumë frikë e paraqita veten dhe u thashë që isha unë ai që e këndoi ezanin. Më thanë të zbrisja poshtë menjëherë se më kërkonte kalifi. Më çuan te kalifi. Pashë që kalifi ishte ulur dhe po më priste. Më pyeti përse e kisha kënduar ezanin në atë kohë të natës? Ia shpjegova ngjarjen nga fillimi deri në fund. Menjëherë, dha urdhër që t'i sillnin oficerin bashkë më gruan dhe ia sollën menjëherë. Pasi u bëri disa pyetje, dha urdhër ta vrisnin oficerin. Gruan e dërgoi në shtëpi dhe theksoi që burri të mos e ndëshkonte atë, por t'i rrinte afër e të kujdesej për të, sepse kalifi ishte bindur që gruaja ishte e pafajshme.

Pastaj, Mutazedi më dha urdhër që sa herë që të shikoj që ndodhin të tilla gjëra e ndonjë padrejtësi, ta përsëris këtë gjë dhe ai menjëherë do të hetonte si qëndronte puna. Ky lajm u përhap menjëherë mes njerëzve. Që nga ajo kohë të gjithë këta më respektojnë dhe ma kanë frikën. Kjo ishte dhe arsyeja që sapo i dhashë urdhër atij oficerit, u bind menjëherë."[1]

---

1) Dhuhurul Islam; vëll. 1, f. 32 dhe 33.

ANKESA NDAJ BURRIT

Gjatë kohës së kalifatit të tij, Aliu (a.s) e kishte marrë vetë në dorë pritjen e ankesave dhe nuk lejonte njeri tjetër të bënte këtë punë. Gjatë ditëve të nxehta, kur zakonisht, njerëzit gjysmën e ditës e kalonin brenda në shtëpi, për të pushuar, ai rrinte ulur në hijen e murit të pallatit dhe nëse dikush do të kishte ndonjë ankesë, vinte pa asnjë pengesë e ia shprehte drejtadrejt atij. Nganjëhere, dilte edhe nëpër rrugina e rrugë për ta parë nga afër, me sytë e vet gjendjen e shoqërisë.

Në njërën prej ditëve të nxehta, i lodhur dhe i djersitur, shkoi te vendi i punës. Pa përpara portës një grua. Sapo gruaja pa Aliun, i doli para dhe i tha se kishte një ankesë:

-Im shoq është treguar i padrejtë më mua. Më ka nxjerrë nga shtëpia, dhe përveç kësaj, ka dashur të më rrahë; po u ktheva në shtëpi, do të më rrahë, - ka thënë. Tani kam ardhur tek ti për drejtësi.

- O rob Zoti!, – iu kthye Aliu. Tani është shumë nxehtë, prit deri pasdite sa të freskohet pak dhe më dëshirën e Zotit, do të vij vetë me ty dhe do ta rregulloj punën.

-Po do të rri për kohë të gjatë jashtë shtëpisë, kam frikë se ai do të inatoset edhe më shumë, dhe do ta kem më keq punën, -tha gruaja.

Aliu e uli kokën për një çast, pasta e ngriti prapë dhe pëshpëriti: "Jo, për Zotin, nuk duhet vonuar e drejta e të shtypurit. Duhet marrë e drejta e tij patjetër nga shtypësi dhe inati i shtypësit duhet shkulur nga zemra e tij. Me trimëri dhe pa frikë duhet qëndruar përballë shtypjes dhe duhet marrë e drejta."

- Më thuaj, ku e keni shtëpinë?, –pyeti Aliu.
- Në filan vend, -u përgjigj gruaja
- Ikim.

Aliu u nis së bashku me gruan dhe shkuan tek dera e shtëpisë. Aliu qëndroi përpara derës dhe thirri:

"O i zoti i shtëpisë! Selam Alejkum!"

Nga shtëpia doli një i ri. Ishte burri i asaj gruas. I riu nuk e njohu Aliun, vetëm pa që me gruan e tij ishte një burrë plak, afër të gjashtëdhjetave. E kuptoi që gruaja e kishte sjellë këtë burrin për përkrahje dhe ndihmë e nuk foli asnjë fjalë. Aliu (a.s) i tha:

- Kjo zonja, e cila është gruaja juaj, ka një ankesë; thotë që e keni trajtuar keq dhe e keni nxjerrë jashtë nga shtëpia. Përveç kësaj e kërcënoni se do ta rrihni. Unë kam ardhur t'ju them kijeni frikë Zotin, dhe silluni mirë dhe me dashuri me gruan tuaj."

-Ç'lidhje ka me ty që unë jam sjellë mirë apo keq me gruan time?!, – pyeti i riu?! Po, unë e kam kërcënuar se do ta godas, por tani që ajo ka ardhur tek ti dhe të ka sjellë ty, e ti m'i thua mua fjalët e saj, do ta djeg për së gjalli."

Aliu sapo dëgjoi këto fjalë, rrudhi vetullat, vuri dorën tek doreza e shpatës dhe e nxori atë nga këllëfi, dhe tha: "Unë po të këshilloj që të bësh ashtu siç të thashë, e ti më

përgjigjesh mua në këtë mënyrë?! Më thua menjëherë që do të djegësh gruan?! Kujton se bota nuk ka llogari aspak?!"
Kur Aliu e ngriti zërin e tij, njerëzit që po kalonin nga rrugica, u mblodhën aty. Kushdo që vinte, i përkulej Aliut dhe i thoshte:
"Selam Alejkum o Emirul Mu'menin"!
I riu fodull tani e kuptoi se përballë kujt njeriu kishte qëndruar, u shastis dhe ra menjëherë në gjunjë duke kërkuar falje; "O Emirul l Mu'menin, të lutem më fal, e pranoj gabimin tim. Betohem që tani se do të kujdesem për gruan dhe do të bej çfarë të dojë dhe të urdhërojë ajo."
Aliu u kthye nga gruaja dhe i tha:
" Tani shko në shtëpinë tënde, por dhe ti ki kujdes që të mos sillesh në atë mënyrë që ta dëtyrosh atë të veprojë kështu!"[1]

1) Biharul Anuar; vëll. 9, f. 598.

PUNËT E SHTËPISË

Ali ibn Ebu Talibi (a.s) dhe Fatime Zahra (s.a), pasi u martuan dhe filluan jetën e tyre të përbashkët, për rregullin dhe ndarjen e punëve të shtëpisë e këshilluan me Profetin:
"O Profet i Zotit! Ne duam që ndarja e punëve tona të shtëpisë lihet nga ti."

Profeti i la detyrë të Aliut punët jashtë shtëpisë dhe punët brënda shtëpisë ia la detyrë Fatimesë. Aliu dhe Fatimja futën brenda jëtës së tyre private Profetin e Zotit dhe Profeti i Zotit e pranoi me dashuri dhe ngrohtësi të veçantë propozimin e tyre e për këtë u gezuan shumë. Veçanërisht, Fatimja ishte shumë e gëzuar që Profeti nuk i kishte lënë për detyrë punët jashtë shtëpisë dhe thoshte: " Jam shumë e gëzuar që Profeti i Zotit nuk më la të punoja me burrat." Kështu, punë të tilla si mbushja e ujit, blerja e grurit dhe shpenzimet e tjera në pazar i kryente Aliu, ndërsa punët e tjera, si shtypja e grurit, gatimi i bukës, pjekja e bukës, gatesat pastrimi dhe rregullimi i shtëpisë i kryente Fatimeja. Në të njëjtën kohë, Aliu (a.s) sa herë që kishte koh ëtë lirë e ndihmonte Fatimenë edhe në punët e brëndshme të shtëpisë. Nga ana tjetër, sa herë që për Aliun dilte ndonjë

punë e largët, udhëtim, a luftë, punët jashtë shtëpisë i bënte Fatimja. Një ditë, Profeti erdhi në shtëpinë e tyre dhe pa se ata po punonin. Pyeti, kush prej tyre ishte më i lodhur që ta zëvëndësonte. Aliu tha: "O Profeti i Zotit! Fatimja është më e lodhur". Profeti u ngrit dhe e zëvëndësoi Fatimenë.
Kjo mënyrë jetese vazhdonte; Aliu dhe Fatimja i bënin bashkë punët e shtëpisë dhe nuk kishin nevojë për shërbëtor. Kur u bënë me fëmijë, të cilët ishin si yje drite dhe me të gjitha virtytet që kishin ata të dy, natyrisht, puna e Fatimes në shtëpi u shtua dhe u bë më e vështirë.
Një ditë, Aliut (a.s) iu dhimbs shumë gruaja e tij e dashur. Pa që ajo bënte pa përtim të gjitha punët e shtëpisë, -si gatuante, lante, shtypte grurin, mbushte ujë, rriste fëmijët etj; dhe të gjitha këto lodhje kishin ndikuar në trupin e saj.
I propozoi gruas së tij të dashur që të shkonte te Profeti dhe të merrte nga një shërbëtore, që ta ndihmonte.
Fatimja e pranoi propozimin dhe u nis për të shtëpia e Profetit. Rastësisht, atë ditë në shtëpi kishin ardhur njerëz dhe po bisedonin me Profetin. Fatimes i erdhi turp që në mes të njerëzve të thoshte kërkesën e saj dhe u kthye sërish në shtëpinë e saj. Profeti e vuri re që Fatimja erdhi në shtëpi dhe iku pastaj. E kuptoi që e bija kishte punë me të, por, meqë nuk ishte çasti i duhur, ajo iku.
Të nesërmen herët në mëngjes Profeti shkoi vetë te shtëpia e tyre. Në atë çast Aliu dhe Fatimja ishin shtrirë përkrah njëri-tjetrit dhe ishin mbuluar me një batanije. Profeti thirri nga jashtë dhomës me zë të lartë:
"Selam Alejkum"!
Aliu dhe Fatimeja nuk u përgjigjën dot prej turpit.

Ai thirri sërish: "Selam Alejkum"!
Sërish ata heshtën.
Profeti e kishte zakon që kur shkonte në shtëpinë e dikujt, thërriste jashtë derës së shtëpisë ose jashtë derës së dhomës, tri herë me zë të lartë "Selam Alejkum!" Nëse i përgjigjeshin, ai merrte leje për të hyrë brenda; nëse nuk i përgjigjeshin, ai e përsëriste selamin e vet tri herë dhe pastaj largohej.
Aliu (a.s) e dinte që, nëse nuk i përgjigjej dhe herën e tretë Profetit, ai do të ikte, dhe kështu që nuk do të kishte mundësi që Profeti të vinte në shtëpinë e tyre; prandaj thirri me zë të lartë: "Alejkum Selam, o Profet i Zotit! Urdhëroni."
Profeti u fut brenda dhe u ul pranë Fatimes dhe i tha:
"Ti erdhe dje tek unë dhe u ktheve, patjetër duhet të keshë pasur ndonjë punë. Ma thuaj punën!
"O Profet i Zotit,- i tha Aliu,- më lejoni mua t'ju them se për çfarë pune erdhi dje tek ti Fatimja. Unë e dërgova atë te ju. Arsyeja ishte kjo: Unë pashë që punët e shtëpisë janë shtuar shumë dhe ajo m'u dhimbs. Pashë që duke pastruar muret nga tymi i oxhakut, i kishte vrarë duart; mbarjtja e shtambës së ujit i ka lënë shenjë në shpinë; kështu, thashë që ajo të vijë te ju, dhe me lejen tuaj, të kishim një shërbyese që të ndihmonte Fatimen."
Profeti nuk donte që jeta e tij dhe e të dashurve të tij të ishte qoftë dhe pakëz më lart sesa niveli i jetës së ymetit të tij. Ato ditë, Medinia ishte në varfëri. Veçanërisht, të ardhurit që vinin në Medine, jetonin në kushte shumë të vështira. Nga ana tjeter, ai njihte temperamentin e së bijës, dhe e dinte sa e dhënë ishte ajo pas adhurimit dhe se sa fuqi e gëzim i jepte asaj përmëndja e Zotit! Për këtë arsye tha;

" A doni që t'ju mësoj diçka që të jetë më e mirë se të gjitha këto?
-Urdhëroni, O i Dërguari i Zotit!,- i thanë ata.
-Sa herë që të doni të flini, thoni 33 herë rresht **Subhan Allah** e pastaj 33 herë **Elhamdulilah,** pastaj 34 herë **Allahu Ekber.** Ky veprim do t'ju falë forcë në shpirt shumë herë më tepër se ndihma që mund t'ju japë një shërbëtor.
Fatimja, e cila ende nuk e kishte nxjerrë kokën jashtë nga batanija, nxori kokën dhe me shumë gëzim tha tri herë:
"Jam e gëzuar me atë që Zoti dhe Profeti janë të gëzuar." [1]

Shoqata Flladi

1) Biharul Anuar; vëll. 10, f. 24 dhe 25.

Përmbajtja

Fjala e botuesit.....5
Referenca për jetën dhe veprimtarinë e Shehid Murteda Mutahhariut.....7
Parathënie e autorit.....13
Profeti i nderuar dhe dy grupet e njerëzve.....20
Burri që kërkoi ndihmë.....21
Kërkim Lutjeje.....23
Lidhja e gjunjëve të devesë.....24
Bashkëudhëtari i Haxhit.....25
Ushqimi i përbashkët.....26
Vargani që po shkonte në Haxh.....27
Myslimani dhe ithtari i librit.....29
Tek yzengjia e Kalifit.....31
Imam Bakiri dhe burri i krishterë.....32
beduini dhe Profeti i Madhërishëm.....33
Burri nga Shami (Siria) dhe Imam Hyseni.....35
Burri që kërkonte këshilla.....37
I krishteri dhe armatura e Aliut (a.s).....39
Imam Sadiku dhe një grup asketësh.....40
Aliu dhe Asimi.....52
I varfri dhe i pasuri.....54
Tregtari dhe kalimtari.....56
Gazaliu dhe banditët.....58
Avicena dhe ibn Muskeuej.....60
Këshilla e asketit.....61
Në festën e Kalifit.....63
Namazi i Festës.....65
Dëgjimi i lutjes së Nënës.....69
në prani të gjykatësit.....70
Në tokën e Mina-së.....71

Shqata Fllaçi

Peshëngritësit....73
Myslimani i ri....75
Sofra e Kalifit....78
Ankesa e fqinjit....80
Pema e hurmës....81
Te shtëpia e Um Selemes....83
Tregu i zi....85
I mbeturi i varganit....87
Lidhësja e këpucës....90
Hishami dhe Ferazdaku....91
Bizanti....94
Akili, miku i Aliut....96
Ëndrra e frikshme....99
Tek streha e beni Sa'ad....100
Selami (përshëndetja) i hebreut....102
Një letër për Ebu Dher-rin....103
Shpërblimi i pacaktuar....105
Është rob apo i lirë....107
Tek MeikatI....109
Ngarkesa e palmës....110
Djersa e punës....111
Miqësia që u shkëput....112
Një mallkim....114
Gjuhëmprehti....118
Dy kolegët....119
Ndalimi i pijes....121
Këmisha e Kalifit....123
I riu në gjendje të hutuar....124
Emigrantët e Habeshesë....126
Punëtori dhe dielli....133
Fqinji i ri....134
Fjala e Fundit....135
Nusejbeja....136

Kërkesa e Isait.....139
Mbledhja e shkarpave në shkretëtirë.....140
Vera në sofër.....141
Dëgjimi i Kur'anit me vëmendje.....142
I famshmi i popullit.....143
Fjala që i dha fuqi Ebu Talibit.....146
Studenti në moshë të madhe.....149
Botanisti.....152
Oratori.....155
Fryti i udhëtimit në Taif.....157
Ebu Is'hak Sabi.....161
Në kërkim të së Vërtetës.....163
Kërkuesi i qetësisë.....166
I eturi që mbante shtambën e ujit mbi supe.....169
Goditja për të rrëzuarin.....172
Burri i panjohur.....174
Djali i Hatemit.....176
Provimi i inteligjencës.....182
Xhujberi dhe Zelfa.....183
Një këshillë.....189
Vendimi i papritur.....190
Paraja me bereqet.....193
Shtrenjtësimi i ushqimeve.....196
Rezervimi i hamamit.....198
Vështirësia për ujë.....199
Ankesa ndaj jetës.....204
Qortimi i mësuesit.....205
Iftari.....208
Punonjësi në dyqanin e metrazheve.....210
Supersticiozi - Horoskopi.....212
Astrologu.....214
Zgjidhja e problemit.....216
Kush është më adhuruesi.....218

Aleksandri i madh dhe Diogjeni.....219
Mbreti dhe i urti.....221
Uniteti i Mufadalit.....224
Garat me deve.....229
Krishteri i etur.....231
Miqtë e Aliut.....232
Lebrozët.....234
Ibn Siabeja.....235
Miku i gjykatësit.....238
Fjala e dyqanxhive.....239
Plaku dhe fëmijët.....242
Mesazhi i Sa'adit.....244
Lutja që u plotësua.....247
Imuniteti që u anullua.....251
Parulla e parë.....256
Tek kËshtjella e Rustemit.....261
Arratisje nga shtrati.....268
Programi i punës.....272
Je në gjumë apo zgjuar?.....279
Prika e gjakut.....281
Ç'u bënë djemtë e tu?.....298
Këshilla e mësuesit.....302
E drejta e vëllait mysliman.....307
E drejta e nënës.....309
Tek dijetari 312
Hishami dhe Tauusu'l Jemani.....313
Pensioni.....315
Qoftë dhe shitës skllevërish.....317
Shitësi i trangujve.....320
Dëshmia e Umu Ala.....323
Ezani i mesnatës.....325
Ankesa ndaj burrit.....330
Punët e shtëpisë.....333

Commission Nationale Iranienne
Pour
U. N. E. S. C. O.
Avenue du Musée - Téhéran

Notre Réf :
Votre Réf :
Annexe
Date

کمیسیون ملی تربیتی علمی و فرهنگی
علی‌شعبه (یونسکو)

تهران خیابان موزه
تاریخ ۲٤/ ۱۳۴۴
شماره ۳/٤/ ۲۳۸۷
ضمیمه

Shoqata Flladi

دانشمند ارجمند آقای مرتضی مدبری

احتراماً بعالی تحت عنوان "داستان راستان" ازجانب کمیسیون ملی یونسکو رایران
برند مجایزه یونسکو مبلغ چهارصد دلار (معادل سی هزارریال) شناخته شده است .
ضمن اظهار تبریک بمناسبت توفیقی که حاصل فرموده مانند بدین وسیله چک شماره
۲۲۰۷۵ بمبلغ سی هزارریال تقدیم میشود .
موفقیت وجود محترم را در امور خدمات فرهنگی واجتماعی آرزومند است .

دبیرکل کمیسیون ملی یونسکو رایران

تقدیرنامه‌ای که در سال ۱۳۴۴ از سوی کمیسیون ملی یونسکو به کتاب داستان راستان تعلق گرفت.